GABRIEL GARSIA

MARKES

gjethurinat
një histori me paskuinë

Gabriel Garsia Markes

GJETHURINAT
NJË HISTORI ME PASKUINË

GABRIEL GARSIA MARKES

GJETHURINAT
NJË HISTORI ME PASKUINË

RILINDJA
Redaksia e botimeve
Prishtinë
1988

Titulli i origjinalit

Gabriel Garcia Marquez

LA HOJARASCA

●

LA MALA HORA

Përktheu

AUREL PLASARI

Kopertinën e punoi

SALIH LUTOLLI

PARATHËNIE

Librin e tij të parë, «Gjethurinat», Garsia Markesi e shkroi me një frymë, kur qe gazetar mëntëmbëdhjetëvjeçar. Në atë moshë qe bërë një ndër fejtonistët në zë kolumbianë: shkrimet e tij për betejat e gjelave, për mbytjen e një anijeje apo për trimëritë e një çiklisti përpiheshin nga lexuesit. Por netëve vonë, pas punës, fshehur të tjerëve, ai mbërthehej pas makinës së shkrimit dhe deri në mëngjes s'kish gjumë: personazhet dhe ngjarjet e Makondos i gumëzhinin në kokë, kujtimet e fshatit të fëmijërisë nuk e linin të qetë.

Arakataka quhej fshati i tij i fëmijërisë. Me trenin e saj të verdhë e të pluhurosur, me shtëpitë e vjetra prej druri dhe rrugët e zhuritura nga dielli, Arakataka kishte tamam pamjen e një Far Uesti. Ajo kishte mitet dhe legjendat e veta: rreth 1910-s, kur kompania amerikane «Junajtëd Fruit» pllakosi në Arakataka, fshati njohu një epokë të shkurtër begatie e shkëlqimi, të shoqëruar nga një luzmë aventurierësh e prostitutash («Gjethurinat») që u bënë zotër vendi.

Në një shtëpi të madhe plot gra, shtëpi nga më të vjetrat e fshatit, e kaloi fëmijërinë shkrimtari i ardhshëm. Personazhi më i rëndësishëm i kësaj shtëpie që gjyshi, ish-koloneli Nikolas Raul Markes Mehija, pjesëmarrës i luftërave civile të liberalëve federalistë kundër qeverive konservatore të përkrahura nga pronarët e mëdhenj, kleri dhe ushtria e rregullt. Për Gabrielin ai që njeriu me të cilin merrej vesh më mirë, me të cilin kalonte gjithë ditën dhe që ndikoi më shumë te fëmija... Im gjysh, koloneli, ishte liberal, një nga ata liberalë që patën luftuar me armë në dorë kundër qeverive konservatore. Ka të ngjarë që formimi im politik të ketë filluar me të, se në vend që të më tregonte përralla e dokrra të këtij lloji, ai më rrëfente episode nga më të tmerrshmet të luftës sonë të fundit civile, luftë e liberalëve dhe antiklerikalëve kundër qeverisë konservatore. Gjyshi fliste edhe për masakrimin e punëtorëve të plantacioneve, që që bërë në rrethin tonë po atë vit që kisha lindur unë.

Kolonel Markesi i kishte filuar gradat duke luftuar në krahinat e Bregdetit Atlantik, nën komandën e prijësit liberal legjendar, gjeneralit Uribe Uribe. Disa tipare të karakterit dhe shumë tipare fizike të këtij, Garsia Markesi do t'i përdorte për të krijuar figurën e kolonelit Aureliano Buendia, i cili është i pranishëm, si personazh ose si hije, gati në të gjitha veprat e autorit. S'e kisha parë asnjëherë Uribe Uriben, natyrisht, por gjyshja rrëfente që, para se të lindja unë, ai kishte kaluar nga Arakataka, që mbledhur në kabinetin e tim gjyshi me ish-pjesëmarrës të tjerë të luftërave të tij dhe kish pirë birrë së bashku me ta. Ime gjyshe e sillte nëpër mend tamam ashtu siç e përshkruan Adelaida, gruaja e kolonelit te «Gjethurinat», kur sheh për së pari mjekun francez. Ky, siç thotë ajo vetë në vepër, i ngjan

me një ushtarak. Në libër nuk është thënë, por unë brenda vetes e di, që ajo e pandehu për gjeneral Uribe Uriben (kolonel Aureliano Buendian).

Por ndoshta mbi të gjitha këto tregime e mësime, te shkrimtari i ardhshëm do të ndikonte e gjyshja, Donja Trankilina, e cila dinte të rrëfente vetëm gjëra të jashtëzakonshme. Duke u plakur ajo e humbi të pamët, kufiri midis të gjallëve e të vdekurve për të u zhduk, ditët e fundit të jetës ajo fliste me të vdekurit, dëgjonte psherëtimat dhe rënkimet e tyre. Kishte në shtëpinë tonë një dhomë të zbrazët ku pat vdekur teto Petra, — *i tregon Garsia Markesi mikut të tij, shkrimtarit peruan Vargas Ljosa.* — Kishte edhe një dhomë të zbrazët ku pat vdekur xha Lasaroja. Në orën gjashtë të mbrëmjes gjyshja më ulte në një cep dhe më thoshte: «Mos lëviz nga vendi, se po lëvize, vjen teto Petra nga dhoma e saj dhe xha Lasaroja nga e tija.» Dhe unë rrija urtë e s'pipëtija... Në librin tim të parë «Gjethurinat» ka një personazh, djali shtatëvjeçar, i cili nga fillimi deri në fund rri ulur në karrige. Sot e kam të qartë se ai djalë pjesërisht jam unë, që rri ulur në karrige në shtëpinë e mbushur gjithë tmerre.

Tragjedia e Arakatakës së shtrydhur nga «Junajted Fruit Kompëni», kujtimet e gjyshit nga luftërat civile, rrëfimet e gjyshes me të gjallë e me të vdekur, do të ngjiznin vite më pas thuajse krejt veprën e Garsia Markesit, duke filluar nga «Gjethurinat».

Veprimi i «Gjethurinave» zhvillohet brenda gjysmë ore, por kujtimet e personazheve përfshijnë një periudhë prej jo më pak se tridhjetë e pesë vjetësh. Në sfond të këtyre kujtimeve është figura e doktorit jabanxhi, ardhur në fshat para një çerek shekulli. Drejtpërdrejt ne atë nuk e shohim, kemi përpara vetëm mbeturinat e tij. Tiparet e tij të gjalla shfaqen hera-herës si një imazh i skicuar vetëm me pika.

Dhe kur arrin t'i bashkojë këto pika me vijë, lexuesit i del përpara portreti i një vetmie të tmerrshme.

Hipostaza e parë e vetmisë është ndjesia e pashpueshmërisë së korracës së saj. I padepërtueshëm prej vështrimit të tregimtarëve dhe tonit, doktori shndërrohet në një enigmë të frikshme. Autori tregon se mbyllja në guaskën vetjake është jo vetëm e rëndë, ajo është vdekjeprurëse. Njëzet e pesë vjetët e jetës së doktorit, që i rikujtojnë tregimtarët, janë rruga që shpie pashmangësisht në vetëvrasje.

Shtytje për këtë zgjidhje katastrofike shërben konflikti i doktorit me fshatin. Por kujtimet e tregimtarëve te «Gjethurinat» vërtiten jo vetëm rreth një heroi, por rreth dy heronjsh. Që në këtë vepër të parë të Garsia Markesit shfaqet një personazh i rëndësishëm i shumë veprave të tij: Makondoja. Edhe ky fshat, i humbur diku në tropik, vuan prej së njëjtës sëmundje si dhe doktori: prej braktisjes. Vetmia e Makondos, si dhe vetmia e doktorit, nënvizon autori, është jo vetëm e rëndë, por shkatërruese. Mbyllja në vetvete të hedh në amulli, amullia në kalbëzim.

Fatet dramatike të njeriut e të vendit, për të cilat shqetësohet autori, jo vetëm reflektojnë njëri-tjetrin, por edhe takohen, ndeshen mes tyre. Dhe vihet re se shkrimtari nuk e përligj gjithçka në kurriz të historisë. Për fatin e njeriut, sipas mendimit të tij, janë fajtorë jo vetëm rrethanat, por edhe vetë njerëzit që s'kanë guximin të veprojnë në kundërshtim me to. Ndaj na pëlqen aq fort guximi, pa çka se i krisur, i kolonelit për të vepruar i lirë, siç ia thotë zemra edhe në kundërshtim me opinionin publik. Ndaj dhe vepra nuk ngjan me një tablo shkretie a vdekjeje. Në të kumbojnë, krahas thirrjes për dhembshuri, edhe notat heroike të sypatrembjes.

Shkrimtari peruan bashkëkohës i Garsia Markesit, Plinio Mendosa, thotë se «Gjethurinat» do të kish-

mjaftuar për ta bërë të njohur autorin në mbarë Amerikën Latine. Por nuk ndodhi kështu.

Garsia Markesit iu deshën pesë vjet për të gjetur botues. Ia dërgova doreshkrimin shtëpive botuese «Losada» të Buenos Airesit dhe ma kthyen me një letër të kritikut spanjoll Giljermo de Torre, ku ai më këshillonte të mos e humbja kohën e të merresha me letërsi. Por ama ai pranonte diçka që mua sot më mbush me gëzim: një farë dimensioni poetik. *Në kohën kur shkruante «Gjethurinat» shkrimtari qe i bindur se çdo vepër e mirë' letrare duhet të jetë një transpozim poetik i realitetit. Mirëpo libri doli në kohën kur Kolumbia jetonte një epokë përndjekjesh politike të përgjakshme. Pati disa prej miqve që e akuzuan shkrimtarin se libri i tij qe një vepër e paangazhuar drejtpërdrejt në luftën revolucionare.* Sot unë e kuptoj se ky gjykim është simplist, por në atë kohë e ndjeva veten të detyruar të merresha me realitetin imediat të vendit. *Disa herë, në esetë dhe intervistat e tij, Garsia Markesi ka ngulmuar në faktin se letërsinë e një kombi nuk e përbëjnë vetëm temat «e mëdha», vetëm rrokja e problemeve «imediate», por një larushi e tërë temash e subjektesh.* Populli që vuan, e që shpesh i njeh më mirë sesa vetë shkrimtarët këto vuajtje, ka po aq nevojë për një roman «social» sa edhe për një roman «dashurie».

«Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë», «Një histori me paskuinë» dhe mjaft nga novelat e tregimet e përmbledhjes. «Varrimi i Nënëmadhes» janë vepra të frymëzuara drejtpërdrejt nga realiteti kolumbian.

Në vitin 1955 Garsia Markesi u vendos në Paris si korrespondent në Evropë i gazetës kolumbiane «Spektatori». Qe tashmë gazetar shumë i njohur, porse vazhdonte të ishte «shkrimtar klandestin». Siç e përshkruan vetë, ishte koha e luftës së Algjerisë, e

këngëve të Brasansit dhe e të dashuruarve që putheshin dëshpërimisht nën fenerët e metrosë. Shkrimtari i ri, në një mansardë të Lagjes Latine, pasi gjunjët pas kaloriferit dhe i kalonte netët duke shkruar romanin «Një histori me paskuinë» (titulli përfundimtar: «Ora e ligë»). Por shpejt i fillojnë problemet ekonomike: Rohas Pinilja, diktatori i ri i Kolumbisë, e ndalon gazetën për të cilën punonte Garsia Markesi. «S'prish punë», u thotë ai miqve. Por punë prishte që ç'ke me të. Nga Kolumbia nuk i vinte më rrogë dhe ai në fillim s'kishte me se të paguante hotelin. Pastaj s'kishte me se të hante bukë. Brasansi vazhdonte të këndonte, të dashuruarit vazhdonin të putheshin në metro, por Parisi s'qe më ai i muajve të parë; për shkrimtarin ai qe bërë qytet i mjerimit.

Garsia Markesi e ndërpret punën për «Një histori me paskuinë». Historia e një koloneli plak, që pret në fshat pensionin e veteranit të luftës civile, pension i cili humb nëpër labirintet e burokracisë administrative, i pushton imagjinatën; pjesërisht për t'i rrafshuar rrugën «Një historie me paskuinë», por pjesërisht edhe për të shfryrë mllefin e tij të përditshëm: edhe ai, si personazhi i tij, nuk dinte se si do t'ia bënte për të ngrënë të nesërmen dhe priste vazhdimisht një letër dhe një urdhër postar që nuk vinin kurrë.

Romanin «Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë» Garsia Markesi e ka mbajtur si veprën e tij më të mirë, sa pa botuar «Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar» më 1981. Është një vepër tek e cila për një kohë të gjatë nuk mund ta kuptosh ku qëndron forca e saj magjepsëse. Se ajo jo vetëm që është e varfër në ngjarje konkrete, por duket sikur s'ka fare ngjarje. Të ngjan sikur më e drejtë do të qe të titullohej «Kolonelit s'ka çfarë t'i ndodhë». Megjithatë, qysh në fillim të saj ndihet njëfarë lëvizjeje e pare-

shtur dhe e shqetësuar, e cila të lejon të ndjesh pulsimin e konfliktit dramatik: koloneli lufton me një armik që asnjëherë nuk mund të prapsohet — me kohën. (...është një roman, stili i të cilit të kujton një skenar filmi. Thua se një kamera.) *Bukur e thotë një studiues se në këtë vepër nuk ndodhin ngjarje, por ndodh kohë. Koloneli është plak, s'e ka të lehtë t'i bëjë ballë fuqisë shkatërruese të kohës: çdo vjeshtë që vjen do t'ia shtojë florën në rropulli, çdo shtator do t'ia bëjë zorrët sallatë gjithnjë e më shumë...*

Në një kuptim, lufta e kolonelit me kohën ngjan e barabartë me luftën me absurdin. Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë, sepse institucionet që duhet t'i dërgojnë pensionin nuk përgjigjen, kurse shokët e luftës i janë ekzekutuar ose kanë vdekur sygjyn. Tronditëse janë fjalët e avokatit: «Mos harroni se ka pasur shtatë presidentë dhe çdo president e ka ndërruar kabinetin të paktën dhjetë herë, kurse çdo ministër i ka ndërruar nëpunësit jo më pak se njëqind herë...» Tabloja është e afërt me atë të burokracisë kancelareske të «Procesit». Por, ndërsa Jozef K-së së Kafkës ankthi i lig i duket si një presion hipnotik, para të cilit ai e ndien veten të paralizuar e të pafuqishëm, koloneli e sheh të vetmen shpresë për të mposhtur absurdin (dhunën, urinë etj.) nëpërmjet luftës.

Nuk është e çuditshme këmbëngulja e kolonelit që s'pranon të shesë gjelin. Shitja e gjelit për të do të thotë dorëzim, heqje dorë nga pritja. Kurse koloneli, të cilit nuk i ka mbetur asgjë, vetëm me pritjen jeton. Ai pret letrën e pensionit, ashtu siç pret drejtësinë. Pret ndeshjet e gjelave, ashtu siç pret ndëshkimin e vrasësve të të birit. Ne nuk dimë konkretisht se ç'ka bërë koloneli në kohën e luftës, por shohim se si, edhe pesëmbëdhjetë vjet pas mbarimit të saj, vazhdon të luftojë për ekzistencë dhe për dinjitet. Dhe kolo-

neli mund të mburret me vitet e tij. Të jetosh si ai do të thotë të qëndrosh në postin luftarak. Ditët e tij llogariten si ditët në front.

«Gjethurinat» dhe «Koloneli» janë, në njëfarë mënyre, dy shkallë që do ta çonin Garsia Markesin drejt romanit të tij të njohur «Njëqind vjet vetmi». Ajo çka i lidh këto vepra është tema e vetmisë. «Gjethurinat» me të drejtë mund të titullohej edhe «Njëzet e pesë vjet vetmi» kurse «Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë» — «Pesëdhjetë vjet vetmi». Personazhi i «Gjethurinave» është një njeri që jeton dhe vdes në vetminë më absolute. Përsëri shfaqet vetmia te personazhi i «Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë» — koloneli, me të shoqen dhe me gjelin, tek pret të premte për të premte pensionin e veteranit që nuk vjen kurrë. Vetmia rishfaqet edhe te personazhi i alkaldit në «Një histori me paskuinë», që nuk arrin të fitojë dot besimin e fshatit e që provon, pas mënyrës së tij, vetminë e pushtetit.

Togeri i «Historisë» është orvatja e parë e shkrimtarit për të hulumtuar «misterin e pushtetit» siç e quan. Për këtë ai ndërton një afresk të gjallë, me protagonistë të shumëfishtë, me personazhe që përbëjnë së toku një ndërgjegje kolektive, ku revolta, e parandier dhe e parapritur gjatë gjithë thurjes së subjektit, së fundi do të shpërthejë. Paskuinët, që shfaqen çdo mëngjes nëpër portat e fshatit, shërbejnë për të ringjallur plagët e vjetra, për të sjellë në kujtesë, e më në fund në realitet, epoka jo shumë të largëta, kur terrori dhe vdekja bridhnin rrugëve. Dalëngadalë, si një mister, zbulohet e vërteta e një diktature të vazhdueshme, herë të dukshme e herë të padukshme, me ngjitje-zbritje. Të kota janë përpjekjet e alkaldit dhe të rrogëtarëve të tjerë të paguar nga qeveria për të mbajtur fshatin zap, po ashtu dhe përpjekjet e një prifti me veladon të

rrjepur e thonj të pistë që bën demagogji i papaguar... Paskuinët shndërrohen në trakte, revolta e heshtur — në revoltë të armatosur.

Në këtë vepër, veprimi i së cilës rrjedh për njëzet e një ditë, kanë rolin e tyre edhe vapa e shiu, dhembja e kokës dhe e dhëmballës, kinemaja dhe cirku. Por, mbi të gjitha këto pluskon fantazma e kalimit të kohës — thuajse gjithmonë dihet se ç'orë është — dhe frika nga paskuinët. Nga ana tjetër, lufta e ngulmët për të zhdukur minjtë prej sakristisë dhe kishës, është një simbol mjaft i goditur. Ndonëse «Një histori me paskuinë» nuk është vendosur në Makondo, ajo në një mënyrë lidhet me të dhe bën pjesë në botën e saj. Makondoja, më tepër se një pikë e globit, është një gjendje shpirtërore, *ka pohuar Garsia Markesi.*

«Një histori me paskuinë», e mbaruar më 1962, iu përgjigj gjendjes politike në Kolumbinë e asaj kohe, si dhe në pjesën tjetër të kontinentit latinoamerikan: qeveria ushtarake e gjeneralit Rohas Pinilja, e ardhur në fuqi në janar të 56-s, në maj të 57-s detyrohet t'ia lëshojë vendin një junte që premton kthim në një sistem reprezentativ; në fund të po atij viti një referendum vendos sistemin e «frontit kombëtar», në të cilin liberalë e konservatorë ndajnë pushtetin; në janar të 58-s rrëzohet diktatori venezuelian Peres Himenes; në janar të 59-s fiton revolucioni kuban, ndërsa në prill të 61-shit dështon sulmi janki kundërrevolucionar në Plazhin e Hironit.

Struktura artistike e «Historisë» është mjaft e thjeshtë, por e përllogaritur mjeshtërisht. Pa qenë vepër lakonike, si «Koloneli», ajo është vepër relativisht e kursyer në ngjarje, veprime e përshkrime, ku nuk gjen gjë të tepërt. Nga ana tjetër, është ndoshta vepra e Garsia Markesit ku bie në sy më shumë karakteri anekdotik. Autori është mjeshtër i përqasjes

së anekdotikes me tragjiken. Humori këtu (si dhe te «Koloneli») jo vetëm është ana e prapme e panjohur e dramatizimit, por është edhe kapërcimi i tij.

Botimi përfundimtar i romanit «Një histori me paskuinë» u bë më 1966. Më 1967 Garsia Markesi boton romanin «Njëqind vjet vetmi», një ndër kulmet e krijimtarisë së tij.

Në këtë vepër, ku jep historinë e degradimit dhe rënies së një fisi gjysmë mitik, romancieri, në mënyrë të vetvetishme, shpërthen në një fantastikë që është dëshmi e potencës së tij krijuese, por edhe e prirjes së popullit të tij ndaj një konceptimi magjepsës. Makondoja del këtu si një oaz i fshehtë, i shtrënguar në ëarën e një realiteti padrejtësie e dhune, prej të cilit nuk e shkëpusin dot as tridhjetë e dy luftëra.

Kritika e radhit këtë vepër në letërsinë e quajtur të «realizimit fantastik» («magjik», «të mrekullishëm» etj.), ndonëse vetë Garsia Markesi është përgjigjur se e quan metodën e vet krijuese «tmerrësisht realiste». Këtu ka diçka që duhet sqaruar: depërtimë i thellë në realitet zbatohet prej shkrimtarit nëpërmjet një fantazie të guximshme, të habitshme, një grotesku me ngjyra të ndezura, një përzierje elementesh përrallore dhe detajesh historike. Unë them se jam shkrimtar tmerrësisht realist, mbasi mendoj se në Amerikën Latine gjithçka është e mundur, gjithçka është reale. Them se duhet ta fusim në librat tanë këtë realitet dhe të bëjmë që letërsia t'i përgjigjet jetës sonë, ku ndodhin përditë gjëra të çuditshme... Unë njoh shumë njerëz të popullit që e kanë lexuar «Njëqind vjet vetmi» me shumë kënaqësi e shumë vëmendje, por pa çudinë më të vogël, mbasi në fund të fundit ajo u tregon vetëm gjëra që ata i shohin përditë me sytë e tyre. *Trajtimi mitik i temës nuk do të thotë për Garsia Markesin ikje prej realitetit, por një nga rru-*

gët e efektshme artistike drejt letërsisë sociale. Është fjala, si me thënë, për një proces të njëkohshëm pohimi dhe mohimi të realitetit. Pjesa më e madhe e gjërave të botës së sotme, nga piruni te transplatimi i zemrës, kanë ekzistuar në imagjinatën e njerëzve, para se të ekzistonin në realitet, socializmi ka ekzistuar në mendjen e Marksit para se të ekzistonte në Bashkimin Sovjetik.

Ashtu si Garsia Markesi, edhe shumë shkrimtarë të tjerë realistë të Amerikës Latine (Asturiasi në Guatemalë, Borhesi në Argjentinë, Rulfoja në Meksikë etj.) flasin me ngulm për një karakter «magjik», «mitik» e «të mrekullishëm» të realitetit latinoamerikan, karakter i cili ka një bazë të vërtetë që fillon prej mitologjisë specifike të këtyre vendeve, gjeografisë e dukurive natyrore, gjer në konstitucionin shpirtëror të banorëve.

Më 1972 dhe 74 Garsia Markesi botoi përmbledhjet me novela e tregime «Historia e trishtë dhe e pabesueshme e së dëlirës Erendirë dhe së gjyshes së pashpirt» dhe «Sy qeni të kaltër», ndërsa më 1975 romanin «Vjeshta e patriarkut» — histori ngjethëse dhe e neveritshme e një diktatori absolutist, e pushtetit unipersonal në një sistem dhune, grabitjesh e luftërash civile.

«Kronikën e një vdekjeje të paralajmëruar», që e boton më 1981, ai gjer më sot e konsideron veprën e tij më të mirë. M'u deshën më pak se dy vjet për të shkruar: «Njëqind vjet vetmi». Por, sa pa u ulur para makinës, e kisha menduar librin më se pesëmbëdhjetë vjet. Kurse për «Kronikën e një vdekjeje të paralajmëruar» m'u deshën tridhjetë vjet.

«Kronika», që autori nuk e quan as roman, as novelë, ka parapëlqyer të jetë tregim i zhveshur i një ndodhie të dhimbshme provinciale (të ngjarë në Jugun e Kolumbisë, në pjesën më të prapambetur të

këtij vendi). Thurja e subjektit të veprës duket e rëndomtë: vrasja e të riut Santiago Nasar me dashje dhe paramendim prej vëllezërve Vikario, për të vënë në vend nderin (për dhunimin e të cilit akuzohet Santiagoja) e motrës së tyre të sapomartuar me Bajardo San Romanin e të kthyer në shtëpi prej këtij qysh natën e parë. Gjatë kronikës, episodet e ndryshme shtrihen hera-herës, pastaj pluskojnë sërish në detin e gjakut të derdhur: historia e të dashurit misterioz të Anhela Vikarios; historitë paralele dhe të ndërvarura të vëllezërve Vikario; fanitja vegullore dhe e pakëndshme e ipeshkvit mbi anije; dëfrimet e shfrenuara të pasunarit Santiago Nasar etj.

Tema qendrore e veprës mbetet ajo e nderit, e këqyrur në dy aspekte të ndryshme. Autori, që e ka njohur mirë Bajardo San Romanin, thotë diku në vepër se, pas manierave të tij mondane, fshiheshin një qerre paragjykimesh tipike për klasën e tij. Ky bukurosh vanitoz me burime financiare të pashtershme, me të vënë re se nusja që ka marrë nuk është e virgjër, e kthen në shtëpi të prindërve pa ngurrimin më të vogël, madje me një vendosmëri sa duket sikur mezi ç'ka pritur sa ta kthejë. Ndërsa të dy vëllezërit Vikario, te këta dy djem të ndershëm 24-vjeçarë, bij të një familjeje të varfër e të ndershme, paragjykimet për nderin janë të një lloji tjetër. Përbrenda vetes ata nuk duan ta vrasin Santiago Nasarin, jo se e kanë shok, por se nuk janë vrasës e nuk duan të bëhen të tillë (...e vërteta është se tema më rrëmbeu përnjëmend vetëm kur, pasi e kisha menduar për vite me radhë, kapa atë që m'u duk se qe elementi thelbësor: dy vrasësit nuk deshën të vrisnin, ata bënë çmos që dikush t'i ndalonte dhe nuk ia dolën dot. Kjo është, tekefundit, e vetmja gjë me të vërtetë e re e kësaj drame, që, me thënë të drejtën, është mjaft e rëndomtë për Amerikën La-

tine). *Por ligji i pashkruar është i pamëshirshëm, dhe më e keqja është se nganjëherë bëhen të pamëshirshëm edhe vetë të afërmit: nëna, e fejuara që mezi pret sa i fejuari të vërë në vend nderin e së motrës dhe ajo të mund të krenohet për «burrërinë» e tij, vjehrra e ardhshme që i nxit ta bëjnë vrasjen sa më shpejt, se «nderi nuk pret!»*

Krahas kësaj teme që orienton gjithë veprën, shkrimtarin e shqetëson vazhdimisht edhe një temë tjetër, ajo e përgjegjësisë së cilës i bëjnë bisht thuajse të gjithë: kush prej mendjelehtësisë, kush prej indiferencës, kush prej përtacisë e kush për konformizëm. Edhe një herë (si te «Gjethurinat») na shfaqet ideja e autorit se fajtorë për fatin e njeriut nuk janë vetëm rrethanat, por edhe vetë njerëzit që s'kanë guxim të veprojë në kundërshtim me to. Duke bërë «kronikën» e një kronike, shkrimtari jo vetëm vë re se si pleksen fijet e fatit (në kuptimin popullor të shprehjes — këtë gjë e kish vënë re edhe hetuesi anonim), por zbulon edhe se njerëzit e dobët e indiferentë janë fajtorë për këtë pleksje të mbrapshtë. Ndoshta askush nuk mund ta quajë veten fajtor konkretisht, sepse të gjithë kanë justifikimet e tyre, po në të njëjtën kohë të gjithë së toku janë përgjegjës për krimin e kryer. Si një nga pjesëmarrësit e dramës, as autori nuk e përjashton veten nga kjo përgjegjësi.

Sigurisht që një nga arsyet e suksesit të «Kronikës» është edhe forma e saj e përkryer artistike. Vështirësia kryesore ka qenë gjetja e një strukture unike. Tema vetë ndillte nevojën e një strukture romani policor. Mirëpo historia në të vërtetë mbaron njëzet e pesë vjet pas krimit, kur Bajardo San Romani vjen përsëri për të jetuar me nusen e kthyer, ndërkohë që autorit i ka interesuar përshkrimi i hollësishëm i krimit. Zgjidhjen ai e ka gjetur duke futur një tregimtar —

veten e vet, për herë të parë — të cilit i ka dhënë liri të lëvizë poshtë e përpjetë rrjedhës së subjektit, nëpër kohën strukturore të veprës. Pas tridhjetë vjetësh, *kujton autori,* zbulova diçka që ne romancierët shpësh e harrojmë: formula më e mirë letrare është e vërteta.

Gabriel Garsia Markesi është sot figura më e shquar e prozatorëve latinoamerikanë dhe vazhdon të jetë në vlug të krijimtarisë. (Tani së fundi, një tjetër vepër e tij e re pa dritën, romani «Dashuri në kohë të kolerës» — histori tronditëse e një dashurie adoleshentësh të penguar nga paragjykimet patriarkale e konvencionet provinciale, e cila më së fundi ngadhënjen për t'u realizuar në... pleqëri.) Veprat që i jepen lexuesit tonë në këtë përmbledhje janë vetëm një pjesë nga krijimtaria e tij më e mirë, megjithatë ato i japin një portret të qartë të këtij individualiteti të fuqishëm krijues. Njëkohësisht përbëjnë edhe një tablo të ngjyrshme të realitetit të sotëm latinoamerikan.

Në frontin e madh e të ndërlikuar antiimperialist, të krijuar sot në perëndim prej inteligjencies progresiste, Garsia Markesi mund të quhet me siguri një shkrimtar i angazhuar i krahut revolucionar. Unë kam besim se, herët a vonë, bota do të jetë socialiste, dhe dua që kjo të ndodhë sa më shpejt, aq më mirë... Por gjithashtu kam bindjen se një nga faktorët që mund ta pengojnë këtë proces të pashmangshëm është letërsia e keqe. Detyra e një shkrimtari — detyra e tij revolucionare, po e deshët kështu — është të shkruajë mirë! — *kështu e ka përcaktuar ai prej kohësh pozitën krijuese të tij dhe të shkrimtarëve me të vërtetë realistë në perëndim.*

AUREL PLASARI

GJETHURINAT

Befas, sikur në mes të fshatit të qenkësh ngritur një shtjellë ere, ia mbërriti kompania e bananeve me një shkulm gjethurinash nga pas. Qenë ca gjethurina të shpështjella e të shprishura, një lyshtër e tërë njerëzish dhe sendesh ardhur prej tjetërkundi; gjethe endacake të një luftе civile që dukej gjithnjë më e largët, më e pabesueshme. Dhe qenë të pamëshirshme këto gjethurina. Molepsnin gjithçka me kutërbimin e tyre të krupshëm prej mizërie, kutërbim sekrecioni lëkure dhe vdekjeje të fshehtë. Pa shkuar viti, u zbrazën mbi fshat mbeturinat e mynxyrave të panumërta, duke mbushur rrugët dëng me lloj-lloj lëmizhdesh. Dhe, sa hap e mbyll sytë, këto mbeturina, pas të fryrës së marrë e të harbuar të erës, erdhën e u seleksionuan, u individualizuan, gjersa u shndërruan në një rrugicë me një lumë nga njëra anë dhe një varrezë nga tjetra, në një fshat tashmë të kokolepsur e të përçudnuar, ngritur mbi mbeturinat e fshatrave të tjerë.

Dhe çatisën te ne këto mbeturina njerëzore, plehra bakallhanesh, spitalesh, sallonesh të dëfrimit, centralesh elektrike, gra të vetmuara dhe burra që lidhnin mushkën pas një shtylle të buj-

tinës, vetëm me një baule dërrase ose me një bohçe plaçkash për bagazh dhe që brenda pak muajsh bëheshin me shtëpi, me dy dashnore edhe me titullin ushtarak që kishin mbetur pa e marrë ngase kishin arritur vonë në luftë.

Gjer edhe bëzhdilet e dashurisë së trishtme të qyteteve të mëdha erdhën me qjethurinat, dhe ndërtuan ca kasolle prej druri, dhe bënë në fillim vetëm një qoshk sa për të kaluar një natë, mandej një rrugë të zhurmshme me strofulla klandestinc e së fundi një fshat të tërë shtëpish publike brenda fshatit.

Mes atij pështjellimi, mes asaj vorbulle fytyrash të panjohura, dyqankash në udhën e madhe, burrash që ndërronin rrobat në mes të rrugës, grash ulur mbi baule me ombrella të hapura dhe mushkash të braktisura që ngordhnin urie në ahurin e bujtinës, ne që qemë të parët u bëmë të fundit, u bëmë ne të huajt, ardhacakët.

Pas lufte, kur erdhëm në Makondo për të parë në kish tokë pjellore apo jo, e dinim që gjethurinat kishin për t'ia mbërritur një ditë, por nuk e kishim llogaritur vrullin e tyre. Kështu që, kur ua ndiem dyndallën, e vetmja gjë që mundëm të bënim ishte të shtronim sofrën e të rrinim e të prisnim me durim derisa të porsaardhurit të na njihnin. Atëherë fërshëlleu për herë të parë sirena e trenit. Gjethurinat bënë një të rrotullluar, u sulën t'i dilnin përpara dhe në këtë rrotullim e sipër e borën vrullin, porse u bënë më të ngjeshura e më të rënda, pësuan procesin e natyrshëm të kalbëzimit, u shndërruan në pleh dhe u bënë njësh me tokën.

(Makondo, 1909)

Për herë të parë pashë një kufomë. Është e mërkurë, po mua më duket sikur është ditë e diel, ngaqë nuk kam vajtur në shkollë dhe më kanë veshur këtë kostum prej kadifeje jeshile që seku më shtrëngon. Për dore me mamanë, mbrapa gjyshit që në çdo hap prek gjërat me bastun për të mos u përplasur (ai nuk shikon mirë në të errët dhe çalon), kalova para pasqyrës së sallonit dhe u pashë nga koka te këmbët, i veshur me kostumin jeshil e me këtë fjongo të kollarisur që më shtrëngon në një anë të qafës. U pashë në pasqyrën e rrumbullakët e të papastër dhe thashë me vete: «Ja ku jam unë, sikur të ishte ditë e diel.»

Erdhëm në shtëpinë ku është i vdekuri.

Në dhomën e mbyllur të merret fryma nga vapa. Dëgjohet cinxërima e diellit në rrugë dhe asgjë tjetër. Ajri është i ndenjur, i rrasur nguc e nguc, sa të duket se mund ta përkulësh si një brisk çeliku. Në dhomën ku kanë vënë kufomën bie erë baulesh, por unë nuk shoh baule në asnjë vend. Në qoshe është një hamak[1] i

---

1 *Hamak* — rrjetë ose cohë e varur horizontalisht nga dy skajet, që përdoret si shtrat. (Shënimet janë të përkthyesit.)

lidhur në një gremç nga njëri cep. Mban erë mbeturinash. Besoj se sendet e prishura e gati të shkatërruara që kemi përreth duken tamam si sende që duhet të mbajnë erë mbeturinash, sido që në të vërtetë kanë tjetër erë.

Gjithmonë kujtoja se të vdekurit duhet të mbanin sombrero.[1] Tani e kuptoj që s'mbakan. Kokën e paskan të shtrënguar me një shami pas nofullave. Gojën e mbakan pak të hapur dhe prapa buzëve të mavinjta iu dukkan dhëmbët e pistë e të çrregullt. Gjuhën e paskan të kafshuar nga njëra anë, të trashë si shollë, pak më të errët se ngjyra e fytyrës, që është si ajo e gishtave kur t'i zë dera. Sytë i paskan të hapur shumë më tepër nga ç'i ka njeriu, të frikur e të zgurdulluar, dhe lëkura u duket si tokë e lagur dhe e shkelur. Kujtoja se i vdekuri dukej si njeri i qetë që fle gjumë, kurse tani e shoh se qenka fare ndryshe. Ai u dukka si një njeri i zgjuar nga gjumi dhe i zemëruar pas një zënke.

Edhe mamaja është veshur si për ditë të diel. Ka vënë sombreron e vjetër prej kashte, që i mbulon veshët dhe ka veshur një fustan të zi, të mbyllur sipër, me mëngë të gjata. Mua, meqë është e mërkurë, ajo më ngjan e largët, e panjohur dhe më duket sikur diç do të më thotë ndërkohë që gjyshi ngrihet për të pritur burrat që kanë sjellë arkën. Mamaja është ulur afër meje, me kurriz nga dritarja e mbyllur. Merr frymë me zor dhe një e dy rregullon tufëzën e flokëve që i del nga poshtë sombreros të vënë si për rrugë. Gjyshi u dha urdhër burrave ta vënë arkën afër krevatit. Vetëm atë-

---

1 *Sombrero* — kapelë me strehë të gjera, përdoret në Spanjë dhe në Amerikën e Jugut.

herë m'u mbush mendja se ajo mund ta nxinte të vdekurin. Kur e sollën burrat, mua m'u duk se ishte shumë e vogël për një trup që zë gjithë shtratin.

Nuk e di pse më kanë marrë. Asnjëherë nuk kisha hyrë në këtë shtëpi dhe bile as që e dija se këtu banonte njeri. Është një shtëpi e madhe, në qoshe të rrugës, me ca dyer që ma merr mendja që s'duhet të jenë hapur kurrë. Unë nuk e dija që në të banonte njeri. Vetëm tani, pasi mamaja më tha: «Sot mbasdite nuk do të shkosh në shkollë» dhe unë s'u gëzova, sepse ma tha me hije të rëndë dhe pashë të vinte me kostumin tim prej kadifeje dhe ma veshi pa më folur fare dhe dolëm te porta dhe u nisëm bashkë me gjyshin dhe kaluam tri shtëpitë që e ndajnë këtë shtëpi nga jona, vetëm atëherë e mora vesh se te kjo qoshe banonte dikush. Dikush që ka vdekur dhe që duhet të jetë ai për të cilin e kishte fjalën mamaja kur më tha: «Duhet të rrish urtë në varrimin e doktorit.»

Kur hyra, nuk e pashë të vdekurin. Pashë gjyshin te dera, duke folur me burrat, pastaj e pashë se si u dha urdhër të vazhdonin rrugën. Atëherë thashë se mos kishte njeri brenda në dhomë, por kur hymë pashë se dhoma ishte e errët dhe bosh. Vapa ma veshi në fytyrë që në fillim dhe ndjeva atë erën e mbeturinave, që në krye qe e fortë, kurse tani, ashtu si vapa, fluturon valë-valë dhe ikën e zhduket. Mamaja më tërhoqi për dore nëpër dhomën e errët dhe më uli afër saj, në një kënd. Vetëm pas një çasti fillova t'i dalloja sendet. Pashë gjyshin që mundohej të hapte një dritare që dukej si e ngjitur dhe e bërë njësh me drurin e kornizës, e pashë të godiste me bastun dorezat, me blu-

zën që i mbushej me pluhurin që shkundej pas çdo tronditjeje. Ktheva kokën andej nga u drejtua gjyshi kur tha se nuk e hapte dot dritaren dhe vetëm atëherë pashë që në shtrat kishte një njeri. Që një njeri i errët, i shtrirë pa lëvizur. Atëherë ktheva kokën nga mamaja, që vazhdonte të ngjante e largët dhe hijerëndë, me sytë të kthyer në anën tjetër të dhomës. Meqenëse këmbët nuk më arrijnë deri në dysheme, por më rrijnë të varura në ajër në treçerek, vura duart poshtë kofshëve, me pëllëmbët të mbështetura pas karriges, dhe fillova t'i tund pa e pasur mendjen asgjëkundi, derisa m'u kujtua se mamaja më kishte thënë: «Duhet të rrish urtë në varrimin e doktorit.» Atëherë ndjeva një si të ftohtë mbrapa kurrizit, u ktheva të shikoja, por pashë vetëm murin prej dërrasash të thata e të plasaritura. Megjithatë, m'u duk sikur dikush më tha që nga muri: «Mos i lëviz këmbët, se ai njeriu në shtrat është doktori dhe ka vdekur.» Dhe, kur hodha sytë nga shtrati, nuk e pashë si më parë. Nuk e pashë më të shtrirë, por të vdekur.

Qysh atë çast, sado që të përpiqem të mos e shoh, më duket sikur dikush ma kthen me zor kokën nga ajo anë. Dhe sado që të përpiqem të shikoj në ndonjë pikë tjetër të dhomës, atë prapëseprapë e shoh në çdo anë, me sytë të zgurdulluar dhe fytyrën jeshile e të vdekur në mes të errësirës.

S'e di pse nuk ka ardhur asnjeri në varrim. Kemi ardhur gjyshi, mamaja dhe unë dhe katër indianët që punojnë te gjyshi. Burrat sollën një qese me gëlqere dhe e zbrazën në arkë. Sikur mamaja ta kishte mendjen, do ta pyesja pse e zbrazin atë qese. S'e kuptoj pse duhet të derdhin gëlqere në arkë. Kur qesja mbaroi, njëri

nga burrat e shkundi mbi arkë dhe prej saj ranë edhe disa copëza, që më shumë dukeshin si tallash sesa si gëlqere. E ngritën të vdekurin nga supet e nga këmbët. Ka një palë pantallona të zakonshme, të mbajtura në mes me një rrip të gjerë e të zi, dhe një këmishë ngjyrë gri. Në këmbë ka vetëm këpucën e majtë. E ka, siç thotë Ada, një këmbë në sahan e një në tavan. Këpuca e djathtë është vërvitur në një cep të krevatit. Në shtrat i vdekuri dukej sikur mezi rrinte. Kurse në arkë duket më rehat, më i qetë, dhe fytyrën, që e kishte si të një njeriu të gjallë, të zgjuar nga gjumi e të zemëruar pas një zënke, tani ia ka pushtuar një qetësi dhe një siguri. Profili i është bërë i ëmbël, sikur aty në arkë ta ndiekësh veten në vendin që i takon.

Gjyshi ka ardhur një herë rrotull nëpër dhomë. Ka marrë ca gjëra dhe i ka vënë në arkë. E ktheva edhe një herë kokën nga mamaja, se mos më tregonte përse i hedh gjyshi në arkë ato gjëra. Por mamaja as që do t'ia dijë fare, ashtu e veshur me fustanin e zi, dhe duket sikur përpiqet të mos shikojë nga vendi ku është i vdekuri. Edhe unë dua të mos shikoj, por nuk mundem. Ia ngul sytë dhe e shikoj mirë e mirë. Gjyshi hedh në arkë një libër, u bën një shenjë burrave dhe tre prej tyre i vënë kapakun arkës. Vetëm atëherë më lëshojnë ato duart që ma mbanin kokën nga ajo anë dhe filloj të vështroj dhomën.

Kthehem edhe një herë nga mamaja, Ajo, për herë të parë qysh kur kemi ardhur në këtë shtëpi, më shikon dhe buzëqesh me zor, me një buzëqeshje që mua më duket fare boshe. Dhe dëgjoj nga larg fërshëllimën e trenit që humbet pas kthesës së fundit. Dëgjoj një zhurmë

nga qoshja ku është kufoma. Shoh se si njëri nga burrat ngre një cep të kapakut dhe se si gjyshi fut në arkë këpucën e të vdekurit, atë që ishte harruar në krevat. Fërshëllen prapë treni, kësaj here më larg, dhe unë befas them me vete: «Ora dy e gjysmë.» Dhe më kujtohet se në këtë orë (ndërsa treni fërshëllen te kthesa e fundit e fshatit) kalamajtë do të jenë duke u vënë në rresht para shkollës për t'u futur në orën e parë të mbasdites.

«Abrahami», them me vete.

Nuk duhet ta kisha marrë djalin. S'janë pamje për fëmijë këto. Edhe mua, që po mbush të tridhjetat, s'më bën mirë ky vend i mbyllur, ku të zihet fryma prej kufomës. Tani mund të dilnim. Mund t'i thoshim babait se nuk e ndiejmë veten mirë në një dhomë ku për shtatëmbëdhjetë vjet rresht janë grumbulluar mbeturinat e një njeriu që asgjë të ngjashme me përzemërsinë ose dashamirësinë nuk e lidh më me këtë botë. Ndoshta i vetmi njeri që ka ndier njëfarë simpatie për të ka qenë im atë. Një simpati e pashpjegueshme kjo, falë së cilës ky njeri tani nuk ka për t'u kalbur brenda katër mureve.

Shqetësohem ngaqë në gjithë këtë ngjarje ka diçka qesharake. Merakosem ngaqë pas pak do të dalim në rrugë, duke u çapitur mbrapa një arkivoli, i cili gjithkujt që ka për ta parë do t'i shkaktojë veç kënaqësi. Përfytyroj ngërdheshjet e grave nëpër dritare, tek do të shohin të

kalojë im atë, tek do të shohin të kaloj unë me tim bir mbrapa një arkivoli, brenda të cilit do të kalbet i vetmi njeri që fshati pikërisht kështu do të deshte ta shihte: të braktisur prej të gjithëve, duke vajtur në varrezë i përcjellë vetëm prej tri vetësh që u ka shkrepur të bëjnë një sevap, që ka për të qenë njëkohësisht edhe fillimi i turpit të tyre. Ka të ngjarë që, prej këtij vendimi të babait, nesër-pasnesër neve vetë të mos na vijë askush në varrim.

Mbase prandaj e mora djalin. Kur babai më tha qëparë: «Duhet të vish edhe ti», gjëja e parë që më vajti ndër mend ishte të merrja edhe djalin për ta ndier veten disi të mbrojtur. Dhe ja ku rrimë tani në këtë dhomë, në zagushinë e kësaj pasditeje shtatori, dhe na duket se tërë sendet rreth e qark bëjnë punën e armiqve tanë. Babai s'ka pse bëhet merak. Ai gjithë jetën e ka kaluar duke bërë këso gjërash, pa çarë kryet se ç'thotë fshati, mjafton të përmbushte ca zotime nga më të pakuptimtat, paçka se duke shkelur çdo rregull e zakon. Qysh para njëzet e pesë vjetësh, kur ky njeri erdhi në shtëpinë tonë, babai duhet ta kishte marrë me mend (duke parë të sjellat e çuditshme të mysafirit) se sot në fshat s'do të gjendej një njeri, as edhe një për be, që t'ua hidhte kufomën e tij zhgabave. Ndoshta babai i kishte parashikuar të gjitha pengesat, i kishte peshuar të gjitha pasojat. Dhe tani, pas njëzet e pesë vjetësh, ndoshta e ndien se kjo s'është veçse përmbushja e një detyre të bërë mend prej kohësh, që ai do ta kishte përmbushur se s'bën, sikur ta dinte se kishte për ta tërhequr zvarrë ai vetë kufomën rrugëve të Makondos.

Megjithatë, kur erdhi çasti, nuk pati fuqi ta kryente vetë këtë punë e më shtrëngoi edhe

mua të marr pjesë në këtë marrëveshje që duhet të jetë lidhur shumë kohë para se unë të vija në mendtë e mia. Kur më tha: «Duhet të vish edhe ti», s'më la kohë të mendohesha e ta rrokja tërë kuptimin e fjalëve të tij. Dhe unë s'e llogarita dot sa qesharake dhe e turpshme është të varrosësh një njeri, të cilin gjithë fshatti mezi ç'ka pritur sa ta shohë të bërë pluhur brenda strofullës së tij. Sepse fshati jo vetëm ka pritur, por edhe është mprehur që punët të venë kësisoj. Dhe e ka pritur këtë me gjithë zemër, pa brejtje ndërgjegjeje, madje me kënaqësinë paraprake se do të vinte një ditë kur do të ndiente kutërbimin e këndshëm të kalbjes së tij tek flatronte nëpër fshat dhe askush nuk do të tronditej, të shqetësohej apo të skandalizohej, porse do t'i bëhej zemra mal tek shihte se pat mbërritur më në fund ora e shumëpritur e do të uronte që kjo gjë të vazhdonte derisa kutërbimi i pështirshëm i të vdekurit të ngoptë edhe poret më të vockëla të mërisë.

Tani ne do t'ia heqim Makondos këtë kënaqësi të shumëpritur. Dhe mua çuditërisht më ngjan sikur ky vendim i yni ka për t'u ngjallur njerëzve në zemër, në vend të ndjenjës së zymtë të një zhgënjimi, diçka të ngjashme me ndjesinë e shtyrjes së një afati.

Edhe për këtë arsye nuk duhet ta kisha marrë djalin, për të mos e ngatërruar në armiqësinë, e cila, ashtu siç pat mbështjellë doktorin për dhjetë vjet rresht, do të na mbështjellë ne që sot e tutje. Djali nuk duhej përzier në këtë punë. Ai as që e di përse ka ardhur këtu, përse e kemi sjellë në këtë dhomë gjithë rrangullina. Rri i heshtur, i hutuar, si të presë që ndokush t'i shpjegojë se ç'kuptim ka e gjithë kjo, si të presë, ashtu i ulur e duke tundur këmbët me

duart të mbështetura në karrige, që ndokush t'ia zgjidhë këtë gjëegjëzë të frikshme. Dhe unë dua të jem e sigurt që askush nuk ka për ta bërë këtë, që askush nuk do t'ia çelë këtë derë të padukshme, e cila s'e lejon të depërtojë përtej shqisave të tij.

Gjithë ato herë m'i ka hedhur sytë dhe unë e di që i jam dukur e çuditshme, e panjohur, me këtë fustan të mbyllur e këtë sombrero të moçme që kam vënë, për t'u fshehur edhe prej vetë ndjenjave të mia.

Po të qe gjallë Memeja, këtu në shtëpi, mbase atëherë do të ndryshonte puna. Njerëzit mund të pandehnin se kisha ardhur për të, për të marrë pjesë në dhimbjen e saj. Vërtet që ajo s'kishte për të ndier ndonjë dhimbje, por kishte për t'u shtirur dhe fshati kishte për ta besuar. Por Memeja ka gati njëmbëdhjetë vjet që është zhdukur dhe, tani që vdiq doktori, s'ka më asnjë shpresë për të marrë vesh se ku prehet ajo, ose së paku ku i prehen eshtrat. Memeja nuk është më këtu, por ka të ngjarë që po të ishte, — sikur të mos kishte ndodhur ajo që ndodhi e që kurrë nuk u mor vesh, — të mbante anën e fshatit dhe të ngrihej kundër burrit që për gjashtë vjet radhazi ia pat ngrohur shtratin me dashurinë e përzemërsinë e një mushke të rëndomtë.

Dëgjoj fërshëllimën e trenit pas kthesës së fundit. «Është ora dy e gjysmë», them me vete dhe s'më shqitet mendimi se në këtë orë e gjithë Makondoja e ka mendjen te kjo shtëpi, te ne dhe te veprimet tona. Më vete mendja te senjora Rebeka, e fishkur dhe e flashkët, me diçka prej lugati shtëpiak në veshje e në vështrim, ulur pranë ventilatorit elektrik e me fy-

tyrën të hijesuar prej kafazit të dritares. Ndërsa dëgjon trenin që humbet pas kthesës së fundit, senjora Rebeka përkul kokën nga ventilatori, e torturuar prej zagushisë e prej mërisë, me flatrat e zemrës që i rrahin si krahët e ventilatorit (veçse në drejtim të kundërt) dhe pëshpërit: «Këtu ka dorë qoftëlargu.» Dhe ngjethet, ashtu e lidhur pas jetës me rrënjëzat e holla të ngjarjeve të përditshme.

Kurse ulokja Ageda sheh Solitën tek kthehet nga stacioni pasi ka përcjellë të fejuarin, e sheh tek hap ombrellën me të marrë kthesën pas cepit të shkretë, e ndien tek afrohet e pushtuar prej atij ngazëllimi seksual që dikur e pat provuar edhe ajo vetë e që më pas iu kthye në këtë lëngatë religjioze, e cila e bën të përsërisë vazhdimisht me vete: «Do të vërtitesh në shtrat si derri në të pëgërat e veta.»

S'më shqiten këto mendime. Nuk mund të mos mendoj që është ora dy e gjysmë dhe që po kalon mushka e postës, e mbështjellë në një vorbull pluhuri të amullt, e pasuar nga njerëzit që kanë prishur gjumin e zhegut të së mërkurës për të marrë pakon me gazeta. At Anhelin e ka kapluar gjumi të ulur në sakristi, me një libër uratash hapur mbi barkun e ngjallmë. Ai dëgjon mushkën e postës tek kalon, përzë mizat që i prishin gjumin, gromësin e thotë: «Më morën në qafë këto qoftet me salcë.»

Babai s'e prish gjakun për asgjë. Madje jep urdhër që ta ngrenë kapakun e arkivolit e t'i vënë brenda këpucën që qe harruar në krevat. Vetëm ai mund t'i marrë kaq seriozisht rëndomësinat e jetës së këtij njeriu. Unë s'do të çuditesha aspak që, kur të dilnim me arkivolin, turma e njerëzve të na priste te porta me

jashtëqitjet e natës ndër duar e të na bënte helaq kokë e këmbë, ngaqë kemi shkelur vullnetin e fshatit. Mbase s'kanë për ta bërë, meqë është fjala për babanë. Po mbase edhe e bëjnë, meqë është vërtet punë e poshtër t'i hequr tjetrit të drejtën e një kënaqësie të cilën ai mezi ç'e pret prej kushedi sa kohësh, duke e përfytyruar për sa e sa mbasdite të angështa, gjithsaherë që burra e gra kalonin para kësaj shtëpie e thoshin me vete: «Akoma s'paska ngordhur.» Krejt Makondoja e thoshte këtë, nga shtëpia e parë tek e fundit.

Edhe pak e ora do të shkojë tre. Senjorita tashmë e di këtë. Senjora Rebeka e pa tek kalonte rrugës, e thirri dhe, duke dalë për një çast nga orbita e ventilatorit, ashtu e padukur pas kafazit të dritares, i tha: «Këtu ka gisht qoftëlargu, senjorita, ta dish.» Dhe nesër nuk do të jetë më im bir ai që do të shkojë në shkollë, por një djalë tjetër, krejt i ndryshëm, një djalë që do të rritet, do të bëhet me fëmijë e së fundi do të vdesë, edhe askush nuk do ta ndiejë veten të detyruar për ta varrosur siç i ka hije një të krishteri.

Sikur para njëzet e pesë vjetësh të mos kish ardhur tek im atë me një letër rekomandimi ky njeri që s'u mor vesh kurrë prej nga erdhi, dhe të mos kish ndenjur te ne duke ngrënë bar e duke këqyrur gratë me ata sy zilarë e nepsqarë prej qeni, që tani i kanë dalë vendit, unë këtë çast do të rrija rehat-rehat në shtëpinë time. Po ja që dënimi im paskësh qenë shkruar qysh para se të lindja e paskësh mbetur i strukur e i fshehur deri këtë vit të zi visek, kur do të mbushja të tridhjetat dhe babai do të më thoshte: «Duhet të vish edhe ti.» Mandej, pa më lënë kohë për të pyetur, do të shtonte duke

goditur dyshemenë me bastun: «Duhet ta mbarojmë këtë punë, bijë. Doktori vari veten sot në mëngjes.»

Burrat dolën dhe u kthyen prapë në dhomë me një çekiç e një kuti me gozhdë. Por nuk e mbërthyen arkën. I vunë gjërat në tavolinë dhe u ulën në shtratin ku kishte qenë i vdekuri. Gjyshi duket i qetë, por qetësia e tij seç ka diçka që nuk shkon. Nuk është si qetësia e kufomës në arkë, por qetësi e një burri që i ka sosur durimi dhe që përpiqet ta fshehë. Qetësi gjithë shqetësim kjo qetësi e gjyshit tim, që vjen vërdallë nëpër dhomë duke çaluar e duke lëvizur çdo gjë që i zë dora.

Kur shikoj që në dhomë ka miza, më tiposet mendimi që edhe arka është mbushur plot me miza. Ende s'e kanë mbërthyer, po mua më ngjan se kjo zukamë, që në fillim m'u duk si zhurmë ventilatori nga ndonjë shtëpi ngjitur, është zhurma e mizave që përplasen verbtazi pas faqeve të arkës dhe pas fytyrës së të vdekurit. Tund kokën, mbyll sytë, shoh gjyshin që hap një baule dhe nxjerr ca plaçka që nuk i dalloj dot se ç'janë, shoh në krevat katër xixëllimat e cigareve të ndezura, kurse njerëz jo. I bezdisur nga vapa që të zë frymën, nga koha që nuk ecën fare, nga zhurma e mizave, më bëhet sikur dikush më thotë: «Kështu do të katandisesh edhe ti: në një arkë plot me miza. Sa po mbush njëmbëdhjetë vjeçët, por një ditë kështu do të katandisesh, i mbyllur në një arkë,

në dorë të mizave.» Dhe shtrij këmbët e puqura e shikoj këpucët e mia të zeza e të lustruara. «Më qenka zgjidhur një lidhëz», them me vete dhe kthej përsëri kokën nga mamaja. Ajo më shikon e përkulet të ma lidhë. Edhe afshi që del prej kokës së mamasë, një afsh i nxehtë e me erë si prej dollapi të kyçur ose prej druri të vjetër, më kujton arkën e mbyllur. Mezi marr frymë. Dua të dal prej këndej, dua të thith ajrin e zhuritur të rrugës, Dhe bëj përpjekjen e fundit. Kur mamaja ngrihet, i them me zë të ulët: «Mama!» Ajo buzëqesh dhe thotë: «Ëh?» Dhe unë, duke u përkulur nga ajo, nga fytyra e saj e rreptë dhe e shndritshme, vazhdoj duke u dridhur: «Dua të dal përjashta.»

Mamaja thërret gjyshin dhe seç i thotë. Unë shikoj sytë e tij të picërruar e të palëvizshëm pas xhamave, kur më afrohet e më thotë: «Tani nuk ke si të dalësh.» Dhe mbështetem në karrige e rri urtë, pa e prishur gjakun që s'më eci. Mirëpo përsëri gjërat lëvizin shumë ngadalë. Pastaj një lëvizje e shpejtë, edhe një tjetër, edhe një tjetër. Pastaj përsëri mamaja, që përkulet mbi supin tim e më thotë: «Të kaloi?» Dhe e thotë me një zë të rreptë e të prerë, sikur të mos ishte pyetje, por qortim. Barku më është tharë e më është bërë gur, por pyetja e mamasë ma zbut e ma squll, dhe atëherë të gjitha, deri edhe ajo hija e saj e rëndë, më acarojnë e më ngrenë nervat. «Jo, — i them. — S'më kaloi fare.» Shtrëngoj stomakun dhe bëj të përplas këmbët pas dyshemesë (përpjekje e fundit edhe kjo), por poshtë këmbëve kam boshllëkun: largësinë që më ndan nga dyshemeja.

Dikush hyn në dhomë. Është një nga indianët e gjyshit, i pasuar nga një polic dhe një bu-

rrë që, edhe ai, ka veshur pantallona prej doku jeshil, ka një rrip mesi me pisqollë dhe mban në dorë një sombrero me strehë të gjera e të kthyera përpjetë. Gjyshi del përpara për ta pritur. Burri me pantallona jeshile kollet në errësirë, seç i thotë gjyshit, kollet përsëri dhe, duke u kollur, i jep urdhër policit të shkallmojë dritaren.

Muret prej dërrase nuk shihen me sy. Duket sikur janë ndërtuar me hi të ftohtë e të ngjeshur. Kur polici ia vesh dorezës së dritares me qytë të pushkës, mua më duket se nuk do të hapen kanatat, por do të shembet shtëpia, muret do të bëhen copë e thërrime, veçse pa pikë zhurme, si një pallat prej hiri që e shkatërron era. Më duket sikur, pas goditjes së dytë, ne kemi për të mbetur në rrugë, në piskun e vapës, të ulur e me kokën të mbuluar me copëra gërmadhash. Por me goditjen e dytë dritarja hapet dhe drita futet në dhomë, hyn furishëm si një kafshë e tërbuar së cilës i hapet dera dhe ajo vërsulet, nuhat, skërmitet dhe gërvisht muret, duke u jargavitur, derisa zë vend qetë-qetë në qoshen më të freskët të kuvlisë.

Kur hapet dritarja, gjërat fillojnë të dallohen, porse atëherë duken edhe më të pabesueshme, më të pavërtetë. Mamaja merr frymë thellë, më zgjat duart e më thotë: «Eja të shohim shtëpinë tonë nga dritarja.» Dhe nga krahët e saj unë shoh edhe një herë fshatin, si të kthehesha tek ai pas një udhëtimi. Shikoj shtëpinë tonë të dalëboje e gjysmë të rrënuar, por të freskët nën bajamet, edhe që këndej ku jam më duket sikur asnjëherë s'kam qenë brenda asaj freskie të blertë e të përzemërt, sikur shtëpia jonë të qenkësh një shtëpi nga ato të përrallave, që më ka premtuar mamaja netve kur s'më zë gjumi. Shoh edhe Pepen, që kalon pa na parë, pa e pasur mendjen. Pastaj çunin e

shtëpisë ngjitur, që kalon duke fërshëllyer, i tjetërsojtë e i panjohur, sikur sapo ka qethur flokët.

Tani alkaldi[1] ngrihet, me këmishën të hapur, qull në djersë, dhe me një fytyrë krejt të shpërfytyruar. Më afrohet i skuqur flakë nga gazmimi i asaj çka do të më thotë. «S'mund të jemi të sigurtë që ka vdekur, sa pa nisur të vijë erë.» Mbaron së mbërthyeri këmishën dhe ndez një duhan, me fytyrën të kthyer përsëri nga qivuri, ndoshta duke thënë me vete: «Tani nuk mund të thonë se po shkel ligjin.» Ia ngul sytë dhe e ndiej se ia kam ngulur me aq vendosmëri, sa për t'i dhënë të kuptojë që e di se ç'bluan në kokë. I them: «Ju po shkelni ligjin për t'u bërë qejfin të tjerëve.» Dhe ai, sikur pikërisht këtë priste të dëgjonte, përgjigjet: «Ju jeni burrë i zgjuar, kolonel, dhe duhet ta kuptoni se unë jam brenda ligjit.» «Ju e dini më mirë se unë që ai ka vdekur», i them. Kurse ai thotë: «Vërtet, por unë s'jam veçse një nëpunës. I vetmi dokument ligjor do të ishte çertifikata e mjekut.» Dhe unë i them: «Përderisa keni ligjin në dorë, jepni urdhër të vijë një mjek për të bërë çertifikatën.» Kurse ai, me kryet lart, veçse aspak krenar, po qetshëm, pa shenjën më të vogël të dobësisë ose të hutimit,

1 Kryetar komune në vendet e Amerikës Latine, që mban në dorë pushtetin ekzekutiv (qeverisje e administrim). Në vendet e diktaturave ushtarake, është ushtarak.

thotë: «Ju jeni burrë i zgjuar dhe e dini se ky do të qe një akt arbitrar.» Kur dëgjoj këtë përgjigje, e kuptoj se ai nuk është edhe aq i trullosur prej të pirit, sesa prej frikës.

Tani e kam të qartë që edhe alkaldi është nga ana e fshatit. Është kjo një ndjenjë mërie e ushqyer për dhjetë vjet rresht, qysh asaj nate të stuhishme kur doktorit i prunë të plagosurit te porta dhe i thirrën (sepse ai nuk e hapi, foli nga brenda) dhe i thirrën: «Doktor, bëni diçka për këta të plagosur, se mjekët e tjerë janë mbushur plot», e ndërkohë që porta nuk hapej (para saj qenë shtrirë të plagosurit): «Ju jeni i vetmi mjek ku mund të përplasim kokën. Vini dorën në zemër», ai u përgjigj (as atëherë nuk e hapi portën) duke qëndruar, siç e pat përfytyruar gjindja, në mes të dhomës, teksa mbante lart llambën që i ndriçonte sytë e ashpër e verdhashë: «Unë s'marr vesh më nga zanati. Shpjerini gjetiu», dhe vazhdonte ta mbante mbyllur portën (që qysh atëherë nuk u hap kurrë më), ndërkohë që urrejtja rritej, shtohej, zmadhohej, shndërrohej në një epidemi të përgjithshme, e cila gjer ditën e fundit të jetës së tij nuk kishte për t'i lënë të qetë banorët e Makondos, në veshët e të cilëve vazhdonte të jehonte mallkimi i asaj nate, që e kishte dënuar doktorin të ngordhte brenda katër mureve.

Dhjetë vjet u bënë që ai nuk piu më ujët e fshatit, nga frika se mos ishte i helmuar, dhe hëngri vetëm zarzavatet që ai dhe e dashura e tij indiane mbillnin në oborr. Tani fshati e kupton se erdhi ora të tregohet i pamëshirshëm me të, siç u tregua ai me fshatin para dhjetë vjetësh. Dhe Makondoja, që tashmë e di që ai ka vdekur (se të gjithë duhet të jenë zgjuar sot në mëngjes disi më të lehtësuar), përgatitet ta shijojë këtë kënaqësi të shumëpritur, që të gjithëve u duket se e kanë

hak. S'duan gjë tjetër veçse të kënaqin hundët me kutërbimin e njeriut të ngordhur pas portës që nuk u hap asaj nate.

Tani po filloj ta kuptoj se zotimi im s'qenka asgjë në krahasim me egërsinë e gjindjes dhe se urrejtja e ngulmët dhe e pashqitshme e një zhgani të tërbuarish më ka lidhur këmbë e duar. Madje edhe kisha gjeti një mënyrë për ta kundërshtuar vendimin tim. At Anheli më tha aty më parë: «As që do të lejoj të varroset në tokën e shenjtë një njeri që var veten gjashtëdhjetë vjet pasi s'ka besuar në zot. Edhe ju do të bënit mirë të hiqnit dorë nga zbatimi i një vendimi që për sytë e zotit s'do të qe një akt përdëllimi, por një mëkat rebelimi.» Kurse unë i thashë: «Të varrosësh të vdekurit, siç shkruan elëçia e shenjtë, është ngaherë akt përdëllimi». Por at Anheli ma ktheu: «Po, porse në këtë rast nuk na takon neve, i takon shërbimit sanitar.»

Megjithatë unë erdha. Mora me vete katër indianët që janë rritur tek unë. E shtrëngova edhe time bijë Isabelën të vinte me mua. Kështu veprimi bëhet disi më familjar, më njerëzor, jo vetjak e provokues, siç do të ngjante sikur unë vetë ta hiqja zvarrë kufomën rrugëve të fshatit deri në varreza. Ç'nuk më kanë parë sytë këtë shekull, ndaj dhe e di që Makondoja është e zonja të bëjë çfarë s'ta pret mendja. Veçse, në mos paçin respekt për mua, që jam plak, kolonel i republikës me trupin gjytrym, por me ndërgjegjen të pastër, të paktën them se do të kenë respekt për time bijë, që është grua. Nuk e bëj për vete, jo. Ndoshta as për shpirt të të ndjerit. Dhe jo aq për të përmbushur një zotim të shenjtë. Isabelën nuk e mora me vete prej frikës, por prej dhembshurisë. Ajo mori edhe djalin (unë e kuptoj që për të njëjtën arsye) dhe tani rrimë

këtu të tre, duke mbajtur mbi shpinë peshën e kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme.

Kur erdhëm pak më parë, pandehja se do ta gjenim kufomën ende të varur në traun e tavanit. Por indianët kishin ardhur përpara, e kishin shtrirë në shtrat dhe madje e kishin qefinosur me mendimin se e gjithë kjo punë do të merrte fund brenda orës. Me të ardhur, pres të sjellin qivurin, shoh time bijë me djalin që ulen në qoshe dhe i hedh një sy dhomës, duke menduar se doktori mund të ketë lënë ndonjëfarë shpjegimi për këtë vendim që mori. Tryeza e punës është e hapur, por ndonjë pusullë të shkruar prej tij nuk ka. Është mbi tryezë manuali receptuar, po ai që pat sjellë në shtëpi njëzet vjet të shkuar, kur hapi atë baule të madhe që mund të nxinte brenda krejt plaçkat e familjes sime. Mirëpo në baule kishte vetëm dy këmishë të zakonshme, një protezë dhëmbësh (që s'mund të ishte e tija thjesht ngaqë ai i kishte dhëmbët në vend, të fortë e të plotë), një portret dhe një manual receptuar. Hap sirtarët dhe gjithkund gjej letra të shtypura, letra, vetëm letra, të lashta, të pluhurosura, kurse poshtë, në sirtarin e fundit, përsëri proteza e dhëmbëve që pat sjellë para njëzet e pesë vjetësh, e pluhurosur, e zverdhur nga koha e nga mospërdorimi. Mbi komodinë, pranë llambës së fikur, ka disa pako me gazeta të pahapura. U hedh një sy. Janë frëngjisht dhe më të rejat janë të para tre muajve: *Korrik 1928*. Ka edhe të tjera, po ashtu të pahapura: *Janar 1927, nëntor 1927*. Dhe më të vjetrat: *Tetor 1919*. Them me vete: «Ka nëntë vjet, një vit pasi iu dha mallkimi, që ai s'i hapte më gazetat. E pat këputur qysh atëherë edhe fillin e fundit që e mbante të lidhur me atdheun dhe njerëzit e tij.»

Indianët sjellin qivurin dhe zbresin kufomën.

Atëherë më vjen ndër mend ajo ditë e njëzet e pesë vjetëve të shkuar, kur ai më erdhi në shtëpi e më dha letrën e rekomandimit, të shkruar për mua në Panama nga 'intendenti i përgjithshëm i Bregdetit Atlantik, kolonel Aureliano Buendia. Kërkoj nëpër terrin e asaj bauleje të pafund rraqet e tij të hapërdara. Baulja pa çelës ndodhet në një qoshe, me pp ato gjëra që ai pat prurë para njëzet e pesë vjetësh. Dhe unë sjell ndër mend: «Kishte dy këmishë të zakonshme, një protezë dhëmbësh, një fotografi dhe këtë manual të vjetër receptuar.» I mbledh një nga këto sende për t'ia hedhur në qivur para se ai të mbyllet. Fotografia është ende në fund të baules thuajse në të njëjtin vend ku qe edhe atëherë. Është fotografia e një ushtaraku të dekoruar. Hedh protezën e dhëmbëve dhe më së fundi manualin. Kur mbaroj, u bëj shenjë indianëve ta mbyllin qivurin. Dhe them me vete: «Tani ai përsëri është gati për udhë. Dhe është e natyrshme që në udhëtimin e fundit të marrë me vete po ato gjëra që pat marrë edhe në të parafundit. Asgjë për t'u çuditur s'ka». Atë grimë, për herë të parë, sikur e shoh të ndjerin të rehatuar.

I hedh një sy dhomës dhe më zë syri në krevat një këpucë të harruar. U bëj prapë një shenjë indianëve, me këpucën në dorë, dhe ata e ngrenë përsëri kapakun mu në çastin kur fërshëllen treni teksa humbet pas kthesës së fundit. «Ora dy e gjysmë», them me vete. «Ora dy e gjysmë e 12 shtatorit të 1928-s, thuajse e njëjta orë e asaj dite të 1903-shit, kur ky njeri u ul për herë të parë në tryezën tonë dhe kërkoi bar për të ngrënë. Adelaida atëherë i tha: «Ç'lloj bari, doktor?» Dhe ai, me atë zërin e tij të prajshëm prej ripërtypësi, ku ende ndihej theksi hundor, u përgjigj: «Bar të zakonshëm, zonjë. Nga ai që hanë gomerët.»

Puna është se Memeja nuk ndodhet më në shtëpi dhe askush nuk mund ta thotë me saktësi se kur filloi ajo të mos ndodhet. Për herë të fundit unë e pashë këtu e njëmbëdhjetë vjet të shkuar. E kishte ende te qoshja dyqanin e verërave, që kërkesat e fqinjëve e kishin ndryshuar pakuptuar, derisa e kishin kthyer në një dyqan artikujsh të përzier. Gjithçka aty qe e vendosur me rregull e në vendin e vet prej meraklies Meme që tërë ditën e kalonte duke qepur për fqinjët në një nga katër makinat «Domestik» që kishte asohere fshati, ose duke ndenjur prapa banakut për të pritur klientët me atë përzemërsinë prej indianeje që s'iu meh kurrënjëherë e që ishte njëkohësisht e hapur dhe e përmbajtur, një përzierje çiltërie e mosbesimi.

Unë s'e kisha parë Memenë qyshse pat ikur prej shtëpisë sonë por, ç'është e vërteta, nuk mund ta thosha me saktësi se kur erdhi të banonte te shtëpia e qoshes me doktorin, as se si ish e mundur që e uli veten gjer në atë pikë sa të bëhej dashnorja e një njeriu që s'kishte pranuar t'i vinte në ndihmë, në kohën kur banonin të dy tek im atë, ajo si shërbëtore e rritur në shtëpinë tonë, kurse ai si mysafir i përhershëm. Ime njerkë

më pat treguar se doktori kishte qenë një mizerje dhe se qe grindur një copë herë të madhe me tim atë për t'i mbushur mendjen që puna e Memesë s'qe gjë me rrezik. Dhe këtë e kishte bërë pa e parë, pa e vizituar, pa lëvizur prej dhome. Sido që të ishte puna, sikur edhe një dhemkë të lehtë të kishte pasur indianka, ai duhej ta kishte ndihmuar qoftë edhe për hir të asaj sajdie që i qe bërë në shtëpinë tonë për tetë vjetët që jetoi aty.

Unë nuk e di si ngjanë punët. Di vetëm që një ditë prej ditësh Memeja nuk u gdhi në shtëpi, dhe ai gjithashtu. Atëherë njerka i hodhi drynin dhomës dhe s'e zuri më në gojë emrin e tij për dymbëdhjetë vjet rresht, deri kur erdhi koha e po qepnim fustanin tim të nusërisë.

Tri-katër javë si pat ikur prej shtëpisë sonë, Memeja kishte vajtur në kishë në meshën e orës tetë me një fustan fëshfëritës prej mëndafshi ngjyra-ngjyra, me një sombrero qesharake me një degë lulesh artificiale në majë. Unë qeshë mësuar ta shihja ngaherë të thjeshtë në shtëpinë tonë, zbathur pjesën më të madhe të ditës, kështu që asaj të diele kur hyri në kishë, m'u duk si një Meme krejt tjetër.E dëgjoi meshën e mëngjesit në radhët e para, midis zonjave, e veshur dhe e kapistallur me një qerre plaçkurinash përsipër, që e bënin të dukej e tjetërsojtë, e re, por me një të ri gjithë pohe e bujë. Ra më gjunjë në radhët e para. Madje edhe devocioni me të cilin dëgjoi meshën s'i shkonte asfare, edhe në mënyrën si e bënte kryqin kishte diçka prej atij pispillimi larushan e vetëtitës, me të cilin pat hyrë në kishë, duke i çuditur ata që e dinin shërbëtore në shtëpi tonë dhe duke i mahnitur ata që e shihnin për herë të parë.

Unë (atëherë s'qeshë me shumë se trembëdhjetë vjeç) pyesja veten se ç'kuptim kishte

gjithë ky ndryshim, pse vallë Memeja qe zhdukur prej shtëpisë sonë e qe dukur atë të diel në kishë, e veshur jo si një zonjë, por si ato figurinat nëpër ikonat me grazhd krishtlindjesh, ose si tri zonja së toku, nisur e stolisur për meshën e pashkëve, e madje me dantella e xhingëla sa edhe për një zonjë të katërt. Kur mbaroi mesha, gratë dhe burrat u ndalën te porta për ta parë tek dilte. Zunë vend në atrium, në dy sërë para hyrjes kryesore, madje unë do të thosha se kishte diçka të paramenduar në atë madhështi ngalakaqe e qesëndisëse me të cilën ndenjën dhe e pritën, pa bërë zë, deri kur Memeja u dha te porta, mbylli sytë e mandej i çeli njëherësh me ombrellën shtatëngjyrëshe. Kaloi kështu mes dy sërëve gra e burra, qesharake sa më s'ka me atë veshje prej pavode e me ato taka të larta, derisa njëri prej burrave filloi ta mbyllte rrethin dhe Memeja ngeli në mes si miu në çark, duke u përpjekur të buzëqeshte me një buzëqeshje të zoritur, që i doli po aq e fryrë dhe e sajuar sa dhe krejt pamja e saj. Por, sapo Memeja kishte dalë, sapo kishte hapur ombrellën e kishte filluar të ecte, im atë më qe afruar e më pat tërhequr drejt turmës. Kështu që, kur burrat zunë ta mbyllnin rrethin, im atë çau udhë deri aty ku Memeja e hutuar po përpiqej të gjente një shteg për t'ia mbathur. Babai e kapi për krahu, pa ua varur të tjerëve, me atë qëndrimin kryeneç e provokues që e ka të tijin gjithsaherë bën diçka që e di se të tjerëve nuk do t'u pëlqejë.

U desh të kalonte njëfarë kohe, pa të merrja vesh se Memeja qe bërë dashnorja e doktorit. Asohere ajo e kishte hapur dyqanin e verërave dhe vazhdonte të vinte në meshë si zonjë e rëndë, pa çarë krye për fjalët e botës,

si të kishte harruar se ç'i pati ngjarë të dielën e parë. Sidoqoftë, kaluan dy muaj dhe ajo nuk u duk më në kishë.

Unë e mbaja mend doktorin në shtëpinë tonë. Ia mbaja mend mustaqet e zeza spic dhe atë mënyrën se qysh i vështronte gratë me ca sy zilarë e nepsqarë prej qeni. Por mbaj mend që kurrë nuk i qeshë afruar, ndoshta ngaqë e kundroja si një kafshë të çuditshme, që ulej në tryezë pasi të gjithë qenë ngritur dhe hante bar nga ai që hanë gomerët. Kur u sëmur babai, tash e tre vjet, doktori nuk kishte dalë asnjëherë në rrugë, qysh nga ajo natë kur s'pat pranuar t'u vinte në ndihmë të plagosurve, ashtu siç nuk kishte pranuar t'i vinte në ndihmë gjashtë vjet më parë as gruas me të cilën pas dy ditësh do të jetonin bashkë pa kurorë. Dyqani i verërave u mbyll para sesa fshati t'i jepte mallkimin doktorit. Por unë e di që indianka jetoi në këtë shtëpi edhe disa muaj ose disa vjet pas mbylljes së dyqanit. Ajo u zhduk, ose u mor vesh që u zhduk ngase kështu thoshte paskuini[1] i ngjitur te porta, shumë kohë më pas. Paskuini thoshte se doktori e kishte vrarë gruan dhe e kishte varrosur në oborr nga frika se mos fshati e helmonte me dorën e saj. Por unë, para se të martohesha, e kisha parë Memenë. Këtu e njëmbëdhjetë vjet, tek kthehesha nga kisha, indianka doli te dera e dyqanit e më tha gjithë gaz

1 Satirë e shkurtër me fyerje dhe sharje, veçanërisht me përmbajtje politike. Në ngjarjet që përshkruan autori, këtu e në vepra të tjera, është një copë fletushkë që ngjitet nëpër porta, nëpërmjet të cilës qarkullojnë në fshat thashethemet «e rrema» e «të vërteta» (shih, për shembull, edhe «Një histori me paskuinë»).

e me një fije shpotie. «Po si, moj Çabela, do t'u martoke e mua s'më ke thënë gjë.»

— Ja, — i them, — kështu duhet ta ketë bërë.

Zgjas litarin, në një skaj të të cilit duket ende vendi i sapoprerë me thikë, bëj edhe një herë nyjën që indianët e mi e kanë prerë për të çvarur trupin dhe hedh njërin skaj përsipër traut të tavanit, derisa laku varet poshtë, pothuajse i gatshëm për të shkaktuar edhe kushedi sesa vdekje të tjera të ngjashme me atë të këtij njeriu. Ndërkohë që bën fresk me sombrero, me fytyrën si spec nga zagushia e nga të pirët dhe me sytë te laku, duke llogaritur forcën e tij, alkaldi thotë: «S'ka mundësi që një litar kaq i hollë të ketë mbajtur gjithë atë trup.» Kurse unë i them: «Është po ky litar që e ka mbajtur në hamak për kushedi sa vjet.» Ai afron një karrige, më lë në dorë sombreron dhe varet pas lakut duke u skuqur prej sforcimit. Mandej kthehet, rri në këmbë pranë karriges me sytë gjithmonë te laku, dhe thotë: «S'ka mundësi. Mua ky litar s'më arrin rreth e qark qafës.» Unë e kam të qartë që ai flet pa kurrfarë logjike, sajon lloj-lloj pengesash për të mos më lënë ta varros. E vështroj ballazi, me ngulm, e i them: «Mos vallë nuk e kishit vënë re se ai ishte të paktën një kokë më i gjatë se ju?» Ai kthehet e këqyr qivurin. «Sidoqoftë, — thotë, — mua për vete nuk më mbushet mendja që ta ketë bërë me këtë litar.»

Unë e di mirë që kështu ka qenë. Këtë e di

edhe ai, por do si e si të shtyjë kohën, mbasi nuk i pëlqen të ngatërrohet në këtë punë. Nga ajo mënyra e hallakatur se si vete e vjen, duket menjëherë që është i frikësuar. Një frikë e dyfishtë dhe e përkundërt kjo: frikë ta ndalojë ceremoninë dhe frikë ta lejojë. Atëherë, kur arrin përpara qivurit, bën një të vërtitur, më vështron e më thotë: «Pa e parë të varur, s'më mbushet mendja.»

Unë mund ta kisha bërë edhe këtë, mund t'u kisha dhënë urdhër indianëve ta hapnin qivurin e ta varnin përsëri të varurin siç kish qenë gjer aty më parë. Por kjo do të qe e tepërt për time bijë. Do të qe e tepërt edhe për djalin e vogël që ajo s'duhej ta kishte marrë me vete. Sikur të mos më vinte ndohtë të veproja asisoj me një të vdekur, të dhunoja mishin e pambrojë, t'i prishja qetësinë një njeriu që për herë të parë gjeti qetësi brenda guaskës së tij, sikur fakti i të lëvizurit të një kufome që prehet e qetë e siç e ka hak në qivurin e vet të mos binte ndesh me parimet e mia, unë kisha për ta varur përsëri vetëm e vetëm për të parë deri ku do të arrinte pafytyrësia e këtij njeriu. Por kjo është gjë që s'bëhet. «Mblidheni mendjen top se unë urdhër të tillë s'kam për të dhënë. Po deshët, vareni vetë me dorën tuaj dhe mbajeni ju përgjegjësinë për gjithë ç'mund të ngjasë. Mos harroni se nuk e dimë sa kohë ka i vdekur.»

Ai nuk lëviz nga vendi. Është ende pranë qivurit, me sytë nga unë, pastaj nga Isabela, pastaj nga djali e pastaj përsëri nga qivuri. Pas pak nxihet në fytyrë dhe merr një pamje kanosëse. «Ju duhet t'i dini pasojat që mund të kini», thotë. Dhe unë tani e kuptoj se deri ku arrin kërcënimi i tij. «S'do mend që i di, — i them. — Jam në një moshë që mund ta mbaj përgjegjësinë, apo

jo?» Atëherë ai, me krahë të kryqëzuar, ujë në djersë, çapitet drejt meje me ca lëvizje të llogaritura e qesharake, me të cilat pandeh se mund të më fusë frikën, dhe thotë: «A mund t'ju pyes se si e morët vesh që ky njeri mbrëmë kish varur veten?»

Unë pres sa të më vijë përballë. S'lëviz prej vendit dhe e vështroj derisa më godet në fytyrë firoma e tij e nxehtë dhe e ashpër, derisa ai ndalet, ende me krahë të kryqëzuar, duke lëvizur sombreron nga mbrapa sqetullës. Atëherë i them: «Kur të ma bëni këtë pyetje zyrtarisht, do të kem kënaqësinë e madhe t'ju përgjigjem.» Ai vazhdon të më rrijë përballë, në të njëjtin qëndrim. Teksa unë i flas, as çuditet dhe as hutohet. Thotë: «S'do mend, kolonel, që zyrtarisht po jua bëj.»

Jam gati t'ia zgjas muhabetin sa t'ia ketë qejfi. E di që, sado që të dridhet e të spërdridhet, në fund të fundit unë do ta mund, në qoftë se i bëj ballë vendosmërisht, por me durim e qetësi. I them: «Këta burra e çvarën trupin, ngaqë unë nuk mund të lejoja të rrinte aty i varur deri kur t'ju mbushej juve mendja të vinit. Ka dy orë që ju kam lajmëruar dhe juve ju deshën dy orë për të bërë këta dyqind e pesëdhjetë metra. Kjo është e para.»

Ai përsëri s'lëviz prej vendit. Unë i rri ballaballas, i mbështetur në bastun, pakëz i përkulur para, dhe vazhdoj: «E dyta, unë e kam pasur mik.» Pa mbaruar mirë unë fjalën, ai shpie buzën në gaz me shpoti, përsëri pa lëvizur prej vendit, duke më përplasur fytyrës një duhmë të fortë e të athët. «S'ka gjë më të thjeshtë se kjo, apo jo?» E menjëherë pushon së buzëqeshuri. Shton: «Pra, ju e dinit që ai pat vendosur të varte veten?»

I qetë, pa e humbur durimin, i bindur se ai do si e si t'i ngatërrojë punët, i përgjigjem: «Po jua përsëris se gjëja e parë që bëra kur mora vesh se kishte varur veten ishte që të vija te ju dhe këtë e bëra para dy orësh.» Dhe, sikur unë t'i paskësha bërë ndonjë pyetje e jo sqarim, ai thotë: «Unë po haja drekë.» «E di, — ia kthej. — Madje më ngjan se patët kohë t'ia merrnit edhe një sy gjumë pas drekës.»

Atëherë ai e qep pipëzën. Zmbrapset. Vështron Isabelën e ulur pranë djalit, vështron indianët, pastaj mua. Por tani shprehja e fytyrës i ka ndryshuar. Duket sikur po vendos për diçka që i ka shkrepur në kokë aty më parë. Më kthen kurrizin, shkon te polici dhe diç i thotë. Polici bën një lëvizje dhe del nga dhoma.

Mandej kthehet nga unë e më zë për krahu. «Sikur të bisedonim pakëz në dhomën matanë, kolonel», më thotë. Tani zëri i ka ndryshuar krejtësisht. I është bërë i shqetë e i tendosur. Dhe, ndërkohë që kaloj në dhomën matanë, duke ndier shtrëngimin e sigurt të dorës së tij në krahun tim, më befason mendimi që e di qysh më parë se ç'do të më thotë.

Kjo dhomë, në ndryshim nga tjetra, është e madhe dhe e freskët. Mbushet me dritë prej oborrit. Këtu i shoh sytë e hutuar, buzëqeshjen që nuk i shkon kurrkund me vështrimin. I dëgjoj zërin që më thotë: «Kolonel, mund ta rregullonim edhe ndryshe këtë punë.» Unë, pa i lënë kohë të mbarojë, ia pres: «Sa?» Dhe atëherë ai kthehet në një njeri krejt tjetër.

Memeja kishte sjellë një pjatë me ëmbëlsira dhe dy kuleçë me kripë, nga ata që pat mësuar të

bënte me time ëmë. Kishte rënë ora nëntë. Ajo qe ulur përballë meje, në kthinën e pasme të dyqanit, dhe hante pa qejf, sikur ëmbëlsirat dhe kuleçët duheshin vetëm që kalimi im në kthinën e saj të zihej tamam vizitë. Unë e kuptoja dhe e lija të kridhej nëpër labirintet e së shkuarës, me atë ngazëllimin e përmallshëm e të trishtmë që, në dritën e llambës që digjej mbi banak, e bënte të dukej edhe më e venitur e më e plakur sesa ditën kur kish hyrë në kishë me sombreron dhe takat e larta. Dukej qartas që asaj mbrëmjeje Memesë ia kish ënda të ndillte kujtimet. Dhe në atë kohë e sipër, mua më bëhej sikur vitet e fundit ajo kish mbetur në një moshë të pandryshueshme, të pakohët dhe sikur asaj nate, teksa ndillte kujtimet, e vinte në lëvizje kohën e saj vetjake dhe po fillonte të pësonte me shumë vonesë procesin e të plakurit.

Tregonte Memeja truphedhur dhe hijerëndë për kohët e lume të shkëlqimit të familjes sonë gjatë viteve të fundit të shekullit të shkuar, para luftës së madhe. Solli ndër mend time ëmë. E solli ndër mend asaj mbrëmjeje kur unë kthehesha nga kisha e ajo më pat thënë me atë të folurën e saj gjithë gaz e me një fije shpotie: «Po si, moj Çabela, do t'u martoke e mua s'më ke thënë gjë.» Qenë pikërisht ato ditë kur mua më pat marrë malli për time ëmë dhe mendja më punonte vazhdimisht tek ajo. «Ti je gjallë jot ëmë», më tha ajo. Dhe unë e besoja vërtet. Isha ulur përballë indiankës, në rrëfimin e së cilës kthjelltësia përzihej me paqartësinë, sikur pjesa më e madhe e tij të ishte një legjendë e stisur, por që ajo e sillte ndër mend me besim e madje me bindjen se kalimi i kohës e paskësh kthyer legjendën në një të vërtetë, të vërtetë të largët, natyrisht, por të paharrueshme. Më rrëfeu ajo për endjet e pri-

ndërve të mi gjatë luftës, për shtegtimin e mundimshëm që do të merrte fund me vendosjen e tyre në Makondo. Prindërit e mi u shmangeshin tallandive të luftës dhe kërkonin një kënd të qetë e të begatë ku të mund të nguleshin. Dëgjuan të flitej për «dashin e artë» dhe erdhën ta kërkonin në këtë vend që asohere pat qenë veç një katund në formim e sipër, me disa familje muhaxhirësh, pjesëtarët e të cilave merreshin hem me ruajtjen e traditave e të praktikave fetare, hem me majmjen e derrave. Makondoja qe për prindërit e mi toka e premtuar, paqja dhe «bashka e artë». Këtu gjetën vendin e përshtatshëm për të ndërtuar kasollen, që pas pak vjetësh do të shndërrohej në një konak të vërtetë, me tre salla dhe dy dhoma mysafirësh. Memeja i sillte ndër mend hollësitë pa pikë druajtjeje dhe tregonte edhe për gjërat më të çuditshme e më të pabesueshme, thuajse kish një dëshirë të zjarrtë për t'i jetuar sërishmi ose se ia pikte zemrën siguria që s'kish për t'i jetuar më. Udhëtimi kishte kaluar pa dëme e pa rreziqe, më tregonte ajo. Gjer edhe kuajt flinin me kunupierë, jo ngase babai qe shkapërdar ose i lajthitur, por ngase ime ëmë qe aq shpirtdhembshur, sa mendonte që për sytë e zotit ishte një kënaqësi jo vetëm mbrojtja e njerëzve prej mushkonjave, por edhe e kafshëve. Gjithkund ata sillnin pas vetes një barrë të çuditshme e të bezdishme: baule plot plaçka të njerëzve që kishin vdekur para se të lindnin ata vetë, të të parëve që jo vetëm u kish mbirë bari, por nuk u gjendeshin as eshtrat; arka me enë kuzhine që prej kohësh kishin dalë nga përdorimi dhe u përkisnin stërgjyshërve të tyre (prindërit e mi qenë kushërinj të parë njëri me tjetrin); gjer edhe një valixhe me shenjtorë, me të cilët ngrinin altarin e shtëpisë në çdo vend tek ndaleshin. Qenë tamam

një cirk i çuditshëm, me kuaj, pula dhe katër indianë (shokë të Memesë) që ishin rritur në shtëpi dhe i vinin pas tim eti ngado që shkonte, si kafshë besnike.

Memeja sillte ndër mend me trishtim. Të dukej sikur kalimi i kohës të paskësh qenë për të një humbje vetjake, sikur zemra e lavosur prej kujtimeve t'i thokësh që, po të mos kishte kaluar koha, ajo do të ishte ende në atë shtegtim që për prindërit e mi kish qenë një vuajtje e madhe, kurse për fëmijët një festë, me shfaqje e pamje të çuditshme, si ajo puna e kuajve nën kunupierë.

Mandej gjithçka mori për ters, më tregoi Memeja. Ditët e fundit të shekullit në katundin Makondo mbërriti një familje e pocaqisur, ende e lidhur pas një të shkuare të afërme shkëlqimplote, por e shpartalluar nga lufta. Indianka sillte ndër mend time ëmë kur pat ardhur në fshat, ulur në mushkë vëngërthi, shtatzënë, me fytyrën jeshile nga malarja dhe me këmbët të zëna prej buhavitjes. Ndoshta në shpirt të tim eti pat filluar të mugullonte farëza e pendimit, por ai vendosi të hidhte spirancë aty, përkundër erërave e dallgëve, në kohë e sipër që kujdesej që ime ëmë të lindte atë fëmijë që i qe rritur në bark gjatë shtegtimit të mundimshëm e që po i shkaktonte vdekjen sa më tepër afrohej ora e lindjes.

Drita e llambës i binte Memesë në profil. Me fytyrën e prerë prej indianeje, me flokët e drejtë e të ashpër si krifë kali, ajo ngjasonte si një idhull i ulur ndenjur, një lugat i jeshiltë në atë kthinë të pasme gjithë zagushi, tek fliste ashtu sikundër kish për të folur edhe një idhull që do të kish nisur të sillte ndër mend jetën e tij të lashtë tokësore. Ajo kurrë s'më qe dukur e afërt, por atë natë, pas asaj hapjeje të beftë e të çiltër, e ndieja

veten të lidhur me të me ca fije më të forta nga ato të gjakut.

Befas, gjatë një pushimi të Mëmesë, dëgjova kollën e tij pikërisht prej kësaj dhome ku jam tani me djalin e babanë. U koll thatë e shkurt, kroi fytin e mandej u dëgjua ajo zhurma e njohur që bën njeriu kur vërtitet në shtrat. Memeja heshti në çast. Një re e ngrysur dhe e heshtur ia terratisi fytyrën. Unë e kisha harruar fare. Sa kohë ndenja aty (ora duhej të ishte nja dhjetë), kisha pasur përshtypjen se indianka dhe unë qemë vetëm në shtëpi. Ambienti i tendosur atëherë ndryshoi. Ndjeva këputje në krahun ku po mbaja pjatën me ëmbëlsirat dhe kuleçët që ende s'i kisha provuar. U përkula dhe i pëshpërita: «Ende s'ka fjetur.» Dhe ajo, me gjakftohtësi e mospërfillje, ma ktheu: «S'ka për të fjetur deri në mëngjes.» Dhe menjëherë e pata të qartë se ç'qe ai pikëllim që e pushtonte Memenë tek sillte ndër mend të kaluarën e shtëpisë sonë. Jeta kishte ndryshuar, patën ardhur kohë të mira dhe Makondoja qe bërë një qytetth i zhurmshëm, ku paraja dilte e tepronte edhe për t'u prishur të shtunave mbrëma. Ndërkohë që përjashta qethnin «dashin e artë», këtu, në kthinën e pasme të dyqanit, jeta e saj rridhte e shterpët dhe e pangjyrë, tërë ditën pranë banakut, ndërsa natën me një burrë që s'e zinte gjumi deri në mëngjes, që e shkonte kohën duke u hallavitur nëpër shtëpi e duke e këqyrur pangopshmërisht me ata sytë zilarë e nepsqarë prej qeni, të cilët unë s'kam për t'i harruar dot kurrë. Më merrte të qarët tek përfytyroja Memenë me një burrë që një natë s'kishte pranuar t'i vinte në ndihmë e që sërish pat mbetur shtazë e pagdhendur, që s'dinte ç'është as dhimbja e as hidhërimi, por grindej tërë ditën e ditës nëpër

shtëpi sa për të nxjerrë mendsh edhe gruan më të urtë e më të duruar.

Kur e morà veten dhe munda të flas përsëri, duke e ditur që ai qe aty pranë, i zgjuar, mbase edhe duke hapur sytë prej qeni sa herë që fjalët tona dëgjoheshin gjer në dhomën e tij, u mundova ta ktheja gjetiu bisedën:

— Po si ia shpie me dyqanin? — e pyeta.

Memeja buzëqeshi. Qe një buzëqeshje e trishtme dhe e nemitur, sikur të mos qe pasojë e një ndjenje që provonte atë çast, por sikur të qe një buzëqeshje që ajo e mbante në sirtar dhe e nxirrte sa herë të qe e domosdoshme, vecse duke e përdorur me ngathtësi, ngaqë të shtënit rrallë në punë e pat bërë ta harronte mënyrën normale të përdorimit. «Ja ashtu», tha duke lëvizur kokën në mënyrë të papërcaktuar dhe përsëri heshti në përhumbje. Atëherë e kuptova se duhej të ngrihesha e të ikja. I dhashë pjatën Memesë, pa asnjë shpjegim pse nuk kisha prekur gjë prej saj, dhe e pashë si u ngrit e si e la mbi banak. Më vështroi që andej e më tha: «Gjallë jot ëmë je.» Gjatë gjithë kohës që ajo kishte folur, unë kisha ndenjur me kurriz nga drita, e cila më binte nga mbrapa dhe Memeja nuk ma kish parë fytyrën. Më pas, kur u ngrit për të lënë pjatën te banaku, matanë llambës, më pa ballazi e prandaj më tha: «Gjallë jot ëmë je.» Mandej erdhi e u ul përsëri.

Zuri të sillte ndër mend ditët kur ime ëmë mbërriti në Makondo. Nga mushka kishte zbritur drejt e në një karrige përkundëse, ku pat ndenjur e mbërthyer për tre muaj rresht, duke e ngrënë çdo ushqim pa qejf. Nganjëherë e merrte mëngjesin dhe rrinte deri në drekë me pjatën në dorë, e ngrirë, duke ndier se si përbrenda trupit i rritej vdekja, derisa ndokush vinte e ia hiqte pjatën nga dora. Kur i erdhën dhimbjet e lindjes, ajo sikur

e mori veten papritmas e u ngrit në këmbë por, e sfilitur siç qe prej një vdekjeje që e pat pushtuar të tërën gjatë nëntë muajsh lëngate, u desh ndihmuar për t'i hedhur ato njëzet hapa që ndanin rruginën e brendshme nga dhoma e gjumit. Rruga nga karrigia te krevati kish qenë shumë më e dhimbshme e më e mundimshme sesa i gjithë shtegtimi që pat bërë disa muaj më parë, por ajo arriti aty ku e dinte se duhej të arrinte pashmangësisht për të përmbushur aktin e fundëm të jetës së saj.

Babai u pikëllua shumë nga vdekja e mamasë, tregoi Memeja, Por, sikundër pat thënë vetë më vonë, kur kishte mbetur vetëm në shtëpi, «burri nderin e shtëpisë e ka te gruaja». Ai kishte lexuar diku se, kur të vdes një njeri i dashur, duhet të mbjellësh një jasemin për ta kujtuar natë për natë. Dhe mbolli një rrënjë jasemini pas muit të oborrit. Kurse pas një viti u martua e mori për grua të dytë Adelaidën, time njerkë.

Nganjëherë më dukej sikur Memeja do të shkrehej në të qara teksa tregonte. Por ajo e mbajti veten, e kënaqur që me këtë rrëfim e kishte larë fajin që pat bërë duke hequr dorë me dëshirën e vet prej lumturisë së dikurshme. Pastaj buzëqeshi. U mbështet në karrige dhe u bë njeri siç kish qenë. Thua se, duke sjellë ndër mend një për një brengat e saj, të kish vënë re papritmas se prej kujtimeve të mira i patën mbetur edhe plot të tjera. Atëherë buzëqeshi me atë përzemërsinë e saj të njëhershme, gjithë shend e gaz, dhe tha se historia tjetër kishte filluar pas pesë vjetësh, kur ajo kish shkuar deri në dhomën e bukës ku im atë po hante drekë e i kish thënë: «Kolonel, kolonel, në kabinet ju kërkon një jabanxhi.»

Prapa kishës, matanë rrugës, ishte një oborr pa pemë. Kjo qe aty nga fundi i shekullit të kaluar, kur sapo kishim ardhur në Makondo dhe ndërtimi i kishës ende s'pat filluar. Ishin toka të zhveshura, terake, ku luanin kalamajtë kur dilnin nga shkolla. Më pas, kur filloi ndërtimi i kishës, ngulën katër shtylla në cep të oborrit dhe u pa se në atë hapësirë mund të bëhej një dhomë. E bënë dhe futën në të qerestenë për kishën.

Kur punimet e kishës morën fund, dikush i suvatoi me baltë muret e dhomës dhe në murin e pasmë çeli një derë që binte në oborrin e vogël, të zhveshur e gjithë gurë, ku s'rritej fije bari. Pas një viti dhoma qe ujdisur sa për të jetuar dy vetë. Brenda binte erë gëlqereje të pashuar, e vetmja erë e këndshme që qe ndier prej shumë kohësh e që do të ndihej ndonjëherë në atë dhomë. Pasi leu muret me gëlqere, e njëjta dorë që i kishte dhënë fund ndërtimit, i vuri llozin derës së brendshme dhe i hodhi drynin portës së rrugës.

Dhoma nuk kishte zot. Askush nuk u merakos të kërkonte të drejtat mbi truallin e mbi lëndën e ndërtimit. Kur erdhi famullitari i parë, zuri vend në njërën prej familjeve të vjetra të Makondos. Pastaj u transferua në një famulli tjetër. Porse ato ditë (dhe ka të ngjarë para se të

largohej famullitari i parë) një grua me një fëmijë në gji e kishte zënë dhomën, pa e marrë vesh kush se si e qysh e tek kish ardhur dhe e kish hapur derën. Në qoshe kishte një qyp të zi të veshur me myshk dhe një katruve të varur në gozhdë. Por nga gëlqerja s'kish mbetur gjurmë. Në oborr, sipër gurëve, qe formuar një kore dheu e fortë nga shiu. Meqenëse s'ia mbante xhepi t'i vinte dhomës çati prej degësh palme, prej tjegullash ose prej zinku, mbolli një rrënjë hardhie me pjergull dhe te porta e rrugës vari një tufë aloeje e një çyrek buke për t'u ruajtur nga syri i lig.

Kur më 1903 u njoftua ardhja e famullitarit të ri, gruaja vazhdonte të banonte në dhomë me fëmijën. Gjysma e fshatit doli në rrugën kryesore për ta pritur. Banda u ra ca pjesëve sentimentale, derisa erdhi duke dihatur një çunak që mend binte përtokë e u tha se mushka e famullitarit ndodhej pas kthesës së fundit. Atëherë banda ndërroi vend dhe ia mori një marshi. I ngarkuari për fjalimin e mirëseardhjes u ngjit në podiumin e sajuar për atë rast dhe priti sa të dukej famullitari për të filluar përshëndetjen. Por pas një grime marshi u ndal, oratori zbriti nga podiumi dhe turma e çmeritur pa të kalonte një jabanxhi hipur mbi një alamet mushke, në vithet e së cilës varej baulja më e madhe që qe parë ndonjëherë në Makondo. Jabanxhiu bëri drejt fshatit pa ia hedhur sytë kujt. Edhe sikur famullitari të qe veshur civil për udhëtim, askujt nuk do t'i kishte shkuar mendja se ai shtegtar i nxirë nga dielli, me kallca ushtarake, të ishte prifti i veshur civil.

Dhe vërtet nuk ishte, mbasi në të njëjtën orë, nga monopati, nga ana tjetër e fshatit, u pa të hynte një prift i çuditshëm, tmerrësisht i do-

bët, me fytyrë të hequr e të fishkur, hipur po mbi mushkë, me veladonin ngritur deri te gjunjët dhe i mbrojtur nga dielli prej një ombrelle shkatarraqe e dalëboje. Kur iu afrua kishës, famullitari pyeti se ku ndodhej qela e priftit dhe, siç dukej, pyeti ndonjërin që as ia kishte haberin, sepse ai iu përgjigj: «Ajo dhoma mbrapa kishës, at i shenjtë.» Gruaja kishte dalë, kurse kalamani luante brenda, prapa derës gjysmë të hapur. Prifti i zbriti mushkës dhe shtyu deri te dhoma një valixhe të fryrë, gjysmë të hapur e pa bravë, lidhur vetëm me një rrip prej lëkure të ndryshme nga ajo e valixhes. Si i hodhi një sy dhomës, afroi mushkën dhe e lidhi në oborr, në hije të shermendeve. Mandej hapi valixhen, nxori një hamak që duhej të qe po aq i përdorur sa dhe ombrella, e vari për tërthori në dhomë nga një shtyllë te tjetra, zbathi çizmet dhe ra të flinte pa çarë kryet për fëmijën që e vështronte me sy të zgurdulluar nga tmerri.

Kur gruaja u kthye, duhet të ketë mbetur gojëhapur nga prania e çuditshme e priftit, fytyra e të cilit qe aq e pashprehje, sa dukej tamam si kafkë lope. Asaj iu desh të kalonte në dhomë në majë të gishtërinjve, të nxirrte shtratin portativ deri te dera, të bënte bohçe plaçkat e saj e të të birit dhe të dilte nga dhoma si e topitur, pa u bërë merak as për qypin e as për katruven, mbasi një orë më vonë, kur zhgani që kishte dalë për të pritur famullitarin, me në krye bandën që i binte një muzike marciale, e qarkuar nga një trumë kalamajsh që kishin lënë shkollën, i ra fshatit në drejtim të kundërt, e gjetën priftin të vetëm në dhomë, të zdërgjuar në hamak, me veladonin të shkopsitur e pa këpucë. Dikush duhej ta kishte shpënë lajmin te rruga kryesore, por askujt

nuk iu dha të pyeste se ç'deshte në atë dhomë famullitari. Me ç'dukej, menduan se mos qe gjë me gruan, ashtu si dhe gruaja duhet të jetë larguar prej dhomës duke pandehur se mos famullitari kishte urdhër për ta zënë, se mos qe pronë e kishës, ose thjesht nga frika se mos e pyesnin përse kishte banuar më se dy vjet në një dhomë që nuk ishte e saja, pa paguar qira e pa marrë leje prej kujt. Edhe njerëzve nuk iu dha të kërkonin shpjegime, as atë çast e as kurrnjëherë më vonë, mbasi famullitari i kishte fjalët të shkurtëra. Ai i la dhuratat në dysheme dhe u mjaftua vetëm me një përshëndetje të ftohtë që u dha burrave e grave që patën dalë në rrugë. Sikundërse tha, «kishte gjithë natën pa mbyllur sy».

Njerëzit u shprishën përpara asaj pritjeje të ftohtë të priftit më të çuditshëm që u patën zënë sytë. U pa se fytyrën e kishte tamam si kafkë lope, se kishte flokë të hirtë, të qethur rrafsh dhe se nuk kishte buzë, por një të çarë horizontale që s'dukej të qe në vendin e gojës qysh prej lindjes, por e bërë më vonë prej një të prere të shpejtë me thikë. Qysh atë mbrëmje u mor vesh se me kë ngjante. Dhe, para se të gdhinte, gjithë fshati e dinte se kush qe. Sollën ndër mend se e kishin parë cullak, me llastika e gurë në dorë, në ato kohë kur Makondoja pat qenë vetëm një konak i mjerë muhaxhirësh. Veteranëve u kujtoheshin bëmat e tij në luftën civile të tetëdhjetë e pesës. U kujtohej që ishte bërë kolonel në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, që pat qenë trim i krisur dhe luftonte kundër qeverisë. Vetëm se në Makondo s'qe marrë më vesh gjë për të gjer asaj dite kur ai u duk sërish, kësaj radhe për të marrë në dorë famullinë. Pakkujt i kujtohej emri i tij i pagëzimit. Përkundrazi,

shumicës së veteranëve u kujtohej nofka që i pat ngjitur e ëma (ngaqë ishte kokëfortë e i pabindur) dhe me të cilin e patën njohur më pas edhe shokët e luftës. Të gjithë e thërrisnin *Kacorr*. Dhe kësisoj vazhduan ta thërrisnin në Makondo derisa vdiq:

— *Kacorr*, more *Kacorr*.

Ai njeri pra erdhi në shtëpinë tonë po atë ditë e thuajse po atë orë që mbërriti *Kacorri* në Makondo. Ai erdhi nga rruga e madhe, kur asnjeri s'e priste e s'ia kishte dëgjuar zërin, kurse famullitari erdhi nga një monopat, ndërkohë që në rrugën kryesore kish dalë ta mirëseardhte mbarë fshati.

Unë u ktheva në shtëpi pas pritjes. Sapo qemë ulur në tryezë, — një çikë më vonë se zakonisht, — kur Memeja u afrua e më tha: «Kolonel, kolonel, në kabinet ju kërkon një jabanxhi.» «Fute këtu», i thashë unë. Kurse Memeja ma ktheu: «Po ju pret në kabinet dhe thotë se e ka me ngut.» Adelaida la lugën, me të cilën po mëkonte Isabelën (atëherë ajo qe a s'qe pesë vjeç) dhe vajti ta priste të sapoardhurin. Pas një grime u kthye dhe dukej mjaft e shqetësuar. «Po vejevinte nëpër kabinet», tha.

Që prapa shandanëve e pashë tek ulej në vendin e vet. Pastaj vazhdoi t'i jepte supën Isabelës. «Ta kishe futur këtu», i thashë unë duke vazhduar të haja: «Atë desha të bëja, — tha ajo. — Mirëpo ai po vejevinte nëpër kabinet kur unë hyra e i thashë mirëmbrëma, dhe nuk m'u përgjigj, se po shikonte në raft balerinën me kurdisje. Sa po matesha t'i thosha edhe një herë

mirëmbrëma, ai zu të kurdiste balerinën, e la mbi tryezën e punës dhe ndenji ta shihte se si vallëzonte. Ndoshta e kishte fajin muzika, që ai nuk më dëgjoi kur i thashë edhe një herë mirëmbrëma dhe ngela si hu përpara tryezës ku ai qe përkulur e kundronte balerinën që kishte kurdisje edhe për një copë herë.» Adelaida po mëkonte Isabelën: «Siç duket, — i thashë unë, — i ka tërhequr vëmendjen ajo lodërz.» Ajo, gjithnjë duke mëkuar Isabelën, vazhdoi: «Po vejevinte nëpër kabinet, por me të parë balerinën në raft, e zbriti, sikur ta dinte që më parë përse hynte në punë, sikur ta dinte se qysh punonte. Po e kurdiste, kur unë i thashë mirëmbrëma për herë të parë, sa pa filluar muzika. Atëherë ai e vuri mbi tryezë dhe ndenji e e vështroi pa buzëqeshur aspak, si të mos i interesokësh vallëzimi, por mekanizmi.»

Vinte kush vinte në shtëpi, mua nuk më lajmëronin. Dhe thuajse përditë vinin mysafirë: rrugëtarë të njohur që linin kafshët në stallë dhe hynin plot besim, sikurse hyn njeriu te një i veti ku e di me siguri që e gjen një vend në sofër. «Me ç'duket, ka ndonjë porosi», i thashë Adelaidës. Kurse ajo tha: «Sidoqoftë, ka një sjellje të çuditshme. Rrinte e kundronte balerinën sa t'i mbaronte e kurdisura, ndërsa unë kisha ngelur si hu para tryezës pa ditur ç't'i thoja, ngase e dija që ai nuk do të më përgjigjej sa pa mbaruar muzika. Mandej, kur balerina bëri atë të kërcyerën që bën gjithmonë kur i mbarohet e kurdisura, ai vazhdoi të rrinte e ta shihte sikur s'kish parë ndonjëherë balerinë me sy, i përkulur mbi tryezë, por pa u ulur. Pas një çasti m'i hodhi sytë dhe unë e kuptova se ai e dinte që kisha hyrë në zyrë, por s'ma kishte varur, ngaqë deshte të dinte se për sa kohë do të zgjaste vallëzimi i balerinës.

Atëherë unë nuk i thashë më mirëmbrëma, por shpura buzën në gaz kur ai m'i nguli sytë, sepse pashë që kishte ca sy jashtëzakonisht të mëdhenj, me qeska të verdha, që e këqyrin njeriun njëherësh, kokekëmbë. Kur i buzëqesha, ai s'e bëri veten fare, vetëm tundi kokën sa për të thënë dhe pyeti: «Është koloneli? Kolonelin desha.» E ka zërin të thellë, si ata që flasin me gojë mbyllur dhe e nxjerrin zërin nga barku».

Adelaida po vazhdonte të mëkonte Isabelën. Unë vazhdova të haja, mbasi thashë me vete se qe fjala vetëm për ndonjë porosi. Nuk e dija që asaj pasditeje zinte fill historia që po mbaron tani.

Adelaida vazhdoi të mëkonte Isabelën dhe tha: «Në fillim ai vejevinte nëpër kabinet.» Atëherë e kuptoya që jabanxhiu i kishte bërë një përshtypje të pazakontë dhe që mezi priste sa ta takoja. Megjithatë, unë vazhdova të haja, ndërkohë që ajo mëkonte Isabelën dhe fliste: «Pastaj, kur tha që dua kolonelin, unë i thashë urdhëroni në dhomën e ngrënies, kurse ai u drejtua, me balerinën në dorë, dhe ngriu si një ushtar që rri gatitu, ngaqë më duket se ka çizme të larta dhe një veshje si punë uniforme, me këmishën të mbërthyer deri në fyt. Unë s'dija më ç't'i thosha, kur ai nuk u përgjigj e s'bëzajti, me lodërzën në dorë, sikur të priste të dilja unë nga kabineti që ta kurdiste edhe një herë. Me ta pikasur se qe ushtarak, atëherë s'di se me kë më ngjau.»

«Pra, ti thua se do të jetë ndonjë gjë me rëndësi», thashë unë dhe e vështrova që sipër shandanëve. Ajo nuk më shihte. Vazhdonte të mëkonte Isabelën. Tha: «Kur hyra unë, ai po vejevinte nëpër kabinet, kështu që nuk e pashë dot për fytyrë. Por mandej, kur u ndal në fund të kabinetit, kokën e kishte të ngritur aq lart dhe sytë aq të ngulitur, saqë m'u duk si ushtarak

dhe i thashë: doni të bisedoni vetëm për vetëm me kolonelin, apo jo? Dhe ai ia bëri po me kokë. Atëherë unë i thashë se i ngjan dikujt, ose më saktë, se është vetë ai dikushi të cilit i ngjan, sido që nuk e kuptoj se si ndodhet këtu.»

Unë vazhdova të haja, por e këqyrja që sipër shandanëve. Ajo pushoi së mëkuari Isabelën dhe tha: «Jam e sigurt që nuk është punë porosie. Jam e sigurt se nuk i ngjan dikujt, por është vetë ai dikushi të cilit i ngjan. Jam e sigurt, që ta them troç, se nuk është ushtarak. Ka mustaqe të zeza spic dhe fytyrë si prej bakri. Çizmet i ka të larta dhe jam i sigurt se nuk i ngjan dikujt, por është vetë ai dikushi të cilit i ngjan.»

Fliste me një ton të njëjtë, monoton e të ngulmët. Qe vapë dhe ndoshta prej vapës e ndjeva veten të bezdisur. «Po kujt i ngjaka, pra?» e pyeta. Dhe ajo tha: «Kur vejevinte nëpër kabinet, nuk e pashë dot për fytyrë, vetëm pastaj...» Kur-se unë, i acaruar nga monotonia dhe ngulmëria e fjalëve të saj, ia prita: «Mirë, pra, mirë. Po shkoj ta takoj sa të mbaroj së ngrëni.» Ajo, gjithnjë duke mëkuar Isabelën, filloi prapë: «Në fillim nuk e pashë dot për fytyrë, se po vejevinte nëpër kabinet. Por pastaj, kur i thashë urdhëroni ju lutem, ai ngriu aty te muri me balerinën në dorë dhe s'bëzaiti. Atëherë më ra ndër mend se kujt i ngjante dhe erdha të ta them. Sytë i ka jashtëzakonisht të mëdhenj e kureshtarë dhe, kur u ktheva për të dalë, e ndjeva që m'i kishte ngulur te këmbët.»

Dhe pas kësaj heshti. Në dhomën e bukës dëgjohej vetëm tringëllima metalike e lugës së saj. Unë i dhashë fund të ngrënit dhe futa pecetën poshtë pjatës.

Atë çast u dëgjua nga kabineti muzika gazmore e lodërzës me kurdisje.

Në kuzhinën e shtëpisë ka një karrige të vjetër prej druri të gdhendur, pa tërthorca, në fundin e prishur të së cilës gjyshi vë këpucët për t'u tharë pranë zjarrit.

Dje në këtë orë, Tobiasi, Abrahami, Hilbertoja dhe unë lamë shkollën dhe ikëm te plantacionet me një palë llastika, një sombrero për të hedhur zogjtë dhe një sojak të ri. Rrugës mua m'u kujtua karrigia e keqe e lënë në një cep të kuzhinës, në të cilën një herë e një kohë uleshin mysafirët, kurse tani e përdor i vdekuri, që ulet në të natë për natë, pa e hequr sombreron nga koka, dhe bën sehir hirin e zjarrit të fikur.

Tobiasi dhe Hilbertoja qenë futur nga fundi i korridorit të errët të bimëve. Meqë në mëngjes kishte rënë shi, këpucët u shkëlqenin në barin e përbaltur. Njëri fërshëllente dhe fërshëllima e tij e fortë dhe e drejtë kumbonte nëpër korridorin e bimëve, ashtu si kur një njeri ia merr këngës në një tunel. Abrahami ishte mbrapa, me mua. Ai me llastikat dhe gurin gati për të shtënë, unë me sojakun të hapur.

Befas dielli çau çatinë prej gjethesh të dendura e të pleksura dhe një copë drite ra mbi bar duke u përpëlitur tamam si zog i gjallë. «E

pe?» tha Abrahami. Unë hodha sytë përpara dhe pashë Hilberton e Tobiasin, në fund të korridorit të bimëve. «S'është zog, — thashë. — Është dielli që doli me fuqi.»

Kur arritëm te bregu, ata u zhveshën dhe filluan të pllaquriteshin e të spërkatnin njëri-tjetrin me atë ujin e mugët, që dukej sikur nuk ua lagte fare lëkurën. «S'paska asnjë zog sot mbasdite», tha Abrahami. «Kur bie shi nuk ka zogj», thashë unë. Dhe e besova edhe vetë. Abrahami ia dha të qeshurit. Ka një të qeshur maroqe e të rëndomtë, si llokoçitja e currilit të ujit në postaf. U zhvesh edhe ai. «Do të futem në ujë me sojak dhe do ta mbush sombreron me peshq.»

Abrahami rrinte i zhveshur para meje me dorën të hapur, duke pritur sojakun. Nuk iu përgjigja menjëherë. E mbaja shtrënguar sojakun dhe ndieja në dorë tehun e tij të mprehtë e të lëmuar. «Nuk do t'ia jap sojakun», thashë me vete. Dhe ia thashë: «Sojakun s'ta jap. Mua dje ma dhanë dhe do ta mbaj vetë gjithë mbasditen.» Abrahami priti edhe pak me dorën të shtrirë. Atëherë unë i thashë:

— Të jëmba nëu.

Abrahami më mori vesh. Vetëm ai më merr vesh kur flas kështu. «Si të duash», tha dhe u nis drejt ujit nëpërmes ajrit të ngjeshur e të athët. Tha: «Zhvishu dhe po të presim te guri.» E tha para se të zhytej dhe pastaj doli prapë si peshk i madh ngjyrargjendi, sikur uji t'u paskësh bërë i lëngshëm me të prekur trupin e tij.

«Hë, pra, ç'pret?» tha Abrahami nga ana tjetër. Tobiasi po fërshëllente i ulur sipër gurit. Atëherë unë thashë me vete: «Sot s'kam për t'u larë. Nesër.»

Kur po ktheheshim, Abrahami u fut mbrapa ferrave. Sa do të shkoja dhe unë, kur ai më tha:

«Mos ec këndej, se kam pak punë.» Unë ndenja larg, i ulur në rrugë mbi gjethet e rëna, duke vështruar të vetmen dallëndyshe që bënte një hark në qiell. Thashë:

— Sot vetëm një dallëndyshe paska.

Abrahami nuk u përgjigj menjëherë. Rrinte e s'bëzante aty mbrapa ferrave, sikur zëri im nuk i arrinte, ose sikur ishte duke lexuar ndonjë gjë. Heshtja e tij qe e thellë dhe e përqendruar, plot me diçka të mistershme. Si heshti kësisoj një copë herë të madhe, psherëtiu. Dhe tha:

— Dallëndyshe.

Unë i thashë edhe një herë: «Vetëm një paska sot mbasdite.» Abrahami vazhdonte të rrinte mbrapa ferrave dhe unë s'e kuptoja ç'po bënte. Heshtte dhe kushedi ku e kishte mendjen. Por më tepër se një heshtje e ngrirë, ajo qe një qetësi e ankthshme dhe e stuhishme.

— Vetëm një? Aha, po, sigurisht.

Atëherë unë s'fola më. Lëvizi ai i pari që mbrapa ferrave. I ulur mbi gjethet, dëgjoja që atje ku ishte ai zhurmën e gjetheve të tjera nën këmbët e tij. Për një çast heshti përsëri, sikur të kishte ikur fare. Pastaj mori frymë thellë dhe pyeti:

— Si the ti?

Unë i thashë edhe një herë: «Vetëm një dallëndyshe paska sot.» Dhe ndërsa i thosha këtë, shikoja flatrën e përkulur tek bënte rrathë në qiellin që ishte i kaltër, aq i kaltër sa s'të besohej. «Po fluturon lart», thashë.

Abrahami ma ktheu aty për aty:

— Ehë, sigurisht. Prandaj, siç duket.

Doli që mbrapa ferrave, duke mbërthyer pantallonat. Hodhi sytë lart, atje ku dallëndyshja vazhdonte të bënte rrathë dhe, përsëri pa m'i hedhur sytë, pyeti:

— Ç'po më thoshte për dallëndyshet?

Me këtë muhabet u vonuam. Kur u kthyem në Makondo, qenë ndezur dritat. Unë hyra me vrap në shtëpi dhe në korridor u përplasa me ty trashaluqet e verbëra, bînjaket e Shën Jeronimit, që vinin të këndonin për gjyshin të martë për të martë, qysh kur mua ende s'më pat rënur koka, siç thoshte ime ëmë.

Gjithë natën e pata mendjen te dita e sotme kur, pasi të dilnim nga shkolla, do të shkonim në lumë. Por jo me Hilberton dhe Tobiasin. Unë kam qejf të shkoj vetëm me Abrahamin, për ta parë se si i vezullon barku kur futet me not zhyt dhe del përsëri si peshk ngjyrargjendi. Gjithë natës pata qejf të kthehesha me të nëpër mugëtirën e tunelit të blertë, që t'ia prekja kofshën gjatë rrugës. Sa herë që ia prek, më duket sikur më kafshon njeri ngadalë-ngadalë dhe më bëhet lëkura si mish pule.

Po të mbarojë punë shpejt ai burri që kaloi në dhomën tjetër për të biseduar me gjyshin, ndoshta mund të kthehemi në shtëpi para orës katër. Atëherë kam për të shkuar në lumë me Abrahamin.

Ai ndenji të banonte në shtëpinë tonë. Unë e pashë të udhës t'i lija një nga dhomat e rruginës, atë që binte nga rruga, mbasi e dija që një njeri i kallëpit të tij s'kish për të gjetur rehat në bujtinën e fshatit. Vuri një lajmërim te dera (gjer para pak vitesh, kur po lyenim shtëpinë, lajmërimi qe ende aty, shkruar me laps me germa të pjerrëta prej dorës së tij) dhe javën tjetër u desh

të shpinim karrige të reja për të përballuar klientelën e shumtë.

Pasi më dha letrën e kolonel Aureliano Buendias, bisedimi ynë në kabinet zgjati aq shumë, sa Adelaidës duket iu mbush mendja top se kish të bënte me një ushtarak me funksion të rëndësishëm dhe e shtroi tryezën si ditëve të shënuara. Ne folëm për kolonel Buendian, për të bijën shtatanike dhe për djalin e parë marrok. Që në krye të bisedës e kuptova se ai njeri e njihte mirë Intendentin e Përgjithshëm dhe e respektonte aq sa ta kishte hak besimin e tij. Kur Memeja erdhi të na thoshte se tryeza qe gati, unë thashë se ime shoqe do të kishte sajuar gjësend për nder të mysafirit të sapoardhur. As që më shkonte mendja e të përfytyroja një tryezë aq madhështore, shtruar me sofrabez të ri, me serviset prej fajance kineze që i përdornim vetëm për darkat familjare të Krishtlindjeve e të Vitit të Ri.

Adelaida qe kapardisur në krye të tryezës, e veshur me fustanin prej kadifeje të mbyllur deri në fyt, atë që para se të martoheshim e përdorte në pritjepërcjelljet e familjes së saj në qytet. Adelaida kishte zakone më të stërholluara nga tonat, kishte njëfarë përvoje në të sjellat në shoqëri, e cila qysh prej martesës sonë filloi të ndikonte në gjithë jetën e shtëpisë sime. Atë mbrëmje kishte vënë medaljonin familjar, që vetëtinte vetëm në momente me rëndësi të jashtëzakonshme. Ajo vetë, si dhe tryeza, mobiljet, madje edhe ajri i dhomës së bukës të linin një përshtypje të rreptë rregulli e pastërtie. Kur hymë në sallon, edhe ai, që ngaherë qe aq i shkujdesur në të veshur e në të sjella, duket se e ndjeu veten ngushtë, si një njeri që nuk e ka vendin në atë mjedis, ngaqë kontrolloi kopsën e fytit, si të kishte pasur kra-

vatë, dhe një turbullim i lehtë u vu re në atë të ecurën e tij të rëndë e mospërfillëse. Gjëja që mbaj mend më me saktësi është pikërisht ai çast kur sapo hymë në dhomën e bukës dhe unë vetë e ndjeva veten të veshur në mënyrë krejt të pahijshme për një tryezë si ajo që pat përgatitur Adelaida.

Nëpër pjata kishte mish gjëje e mish gjahu — e zakonshme kjo për drekedarkat tona të asaj kohe. Porse nxjerrja e tyre nëpër serviset e reja, nën dritën e shandanëve të pastruar rishmës, qe diçka e bujshme dhe aspak e zakonshme. Ndonëse ime shoqe e dinte që kishim vetëm një mysafir, kishte vënë tetë servise, kurse shishja e verës e vendosur në mes ishte një shenjë e tepruar e zellit me të cilin qe gatitur pritja për njeriun që ajo, qysh në çastin e parë, e kishte ngatërruar me një funksionar të lartë ushtarak. Ambient më irreal se ai s'më ka zënë syri kurrë në shtëpinë time.

Rrobat e Adelaidës mund të ishin dukur qesharake, po të mos qenë të punuara prej dorës së saj (dhe, ç'është e vërteta, qenë mjaft të bukura, shumica të bardha), gjë që sikur e zbuste disa salltanetin e tepruar e të shtirur të krejt pamjes së saj. Pikërisht kur ai kontrolloi kopsën e fytit dhe u lëkund një grimë, unë u shpejtova të thosha: «Gruaja ime e dytë, *doktor.*» Një re e zymtë ia terratisi fytyrën Adelaidës dhe sikur e tjetërsoi. Ajo s'lëvizi prej vendit, me dorën të shtrirë, me buzën në gaz, veçse jo më me atë kapardisjen që kish pasur kur ne hymë në dhomë.

I porsaardhuri përpoqi çizmet si ushtarak, preku tëmblin me majë të gishtërinjve e mandej u çapit deri tek ajo.

— Gëzohem shumë, zonjë, — foli. Por nuk tha emër.

Vetëm kur e pashë se si shtrëngoi dorën e Adelaidës me një të shkundur të ngathët, e kuptova se ç'të sjella të trasha e prej harbuti kishte.

U ul në skajin tjetër të tryezës, midis qelqurinave të reja, midis shandanëve, dhe në gjithë praninë e tij kishte diçka aq të çrregullt, saqë binte në sy si një njollë supe në sofrabezin e bardhë.

Adelaida shërbeu verën. Trondítja e fillimit i qe shndërruar në një nervozitet që ajo e përmbante, por që dukej sikur thosh: «Mirë, pra, hë për hë kështu po e lëmë, por më pas do të ma shkoqitësh këtë muhabet.» Dhe pikërisht mbasi ajo shërbeu verën e u ul përsëri në krye të tryezës, ndërkohë që Memeja po bëhej gati të sillte pjatat, ai u hodh praptas në karrige, mbështeti duart mbi sofrabez e tha buzagaz:

— E dini si është puna, zonjushë? A mund të më zieni pak bar e të ma sillni në vend të supës?

Memeja s'lëvizi. Filloi të sajonte një buzëqeshje, por nuk e mbaroi dot. U kthye nga Adelaida. Atëherë ajo, po ashtu me buzë në gaz, por që dukej se e kish humbur fare, e pveti: «Ç'lloj bari, doktor?» Dhe ai, me atë zërin e prajshëm prej ripërtypësi, iu përgjigj:

— Bar të zakonshëm, zonjë. Nga ai që hanë gomerët.

Vjen një çast e zhegu i pasdrekës këputet. Madje atë çast resht edhe ajo lëvizje imtësore, e fshehtë dhe e padukshme e kandrave. Rrjedha e natyrës ndalet në vend, rruzullimi mbarë lëkundet buzë kaosit dhe gratë, me jargë në gojë, me gjurmën e nënkresës së qëndisur në faqe, ngrihen frymëzëna prej të nxehtit e prej inatit dhe thonë me vete: «S'ka të mbaruar kjo e mërkurë në Makondo.» Atëherë struken sërishmi në qoshe, përziejnë ëndrrën me zhgjëndrrën dhe merren vesh shoqja me shoqen për të thurur një çuçurimë, sikur çuçurima të qenkësh një çarçaf i madh i endur prej të gjitha grave të fshatit.

Po të kishte koha brenda po atë ritëm që ka edhe koha përjashta, atëherë ne do të ndodheshim në pisk të diellit, me arkivolin në mes të rrugës. Përjashta do të ishte më vonë, do të ishte natë. Një natë e rëndë shtatori, me hënë dhe gra të ulura nëpër oborre, duke kuvenduar nën vezullimin e hënës, teksa në rrugë, në pisk të diellit të këtij shtatori zhuritës, do të çapiteshim ne, tre tradhtarët e fshatit. Askush nuk do ta ndalojë dot varrimin. Unë prisja që alkaldi të ngulte këmbë në vendimin e tij për ta ndaluar dhe ne të mund të ktheheshim në shtëpi: djali në shkollë, kurse im

atë te nallanet e tij, te musilluku që i derdh ujë të freskët mbi krye dhe te kana me limonatën e ftohtë akull në krahun e majtë. Por tani ndryshon puna. Im atë arriti që arriti t'ia mbushte mendjen, sado që mua në fillim alkaldi m'u duk me mendjen të mbledhur. Jashtë është fshati që zien, duke çuçuritur pa pushuar e pa u lodhur, dhe rruga e shkretë, pa një hije në pluhurin e pastër e të pashkelur qyshse duhma e fundit e erës e fshiu edhe gjurmën e buallit të mbramë. Dhe është një fshat xhanxhin ky, me shtëpi të mbyllura, nëpër dhomat e të cilave s'dëgjohet veçse zhurmimi i shurdhët i fjalëve të shqiptuara me zemërligësi. Kurse këtu në dhomë djali i ulur, i shtangur, duke këqyrur këpucët, i hedh një sy llambës, tjetrin gazetave, tjetrin këpucëve e pastaj të dy të varurit, gjuhës së tij të kafshuar, syve të tij të qelqtë prej qeni tashmë pa neps, prej qeni të cofur, që s'i punojnë më dhëmbët. Djali vështron, krejt i përhumbur pas të varurit të shtrirë në arkivol, bën një lëvizje të dëshpëruar dhe atëherë gjithçka shpërfytyrohet: te dera e rrojtores del një stol, pas tij poltrona me pasqyrën, pudrat dhe kolonja. Dora e vogël rritet e mbulohet me qime, nuk është më dora e tim biri, shndërrohet në një dorë të madhe e të shkathët që fillon të mprehë briskun me qetësi e gjakftohtësi, ndërkohë që ndihet zukama metalike e tehut të kalitur dhe në kokë vërtitet mendimi: «Sot do të vijnë më herët, se është e mërkurë në Makondo.» Dhe atëherë ata vijnë, mbështeten nëpër karrige në hijen e freskët të hajatit, me sy çakërrë, vëngëroshë, me këmbën mbi këmbë, me duart lidhur mbi gjunjë, kafshojnë bishtat e cigareve, bëjnë sehir, i bien fyellit po në një vrimë, vështrojnë përkundruall dritaren e mbyllur, shtëpinë e heshtur ku rri senjora Rebeka. Por edhe ajo diç ka harruar: ka ha-

rruar të heqë ventilatorin nga priza dhe vetevjen nëpër dhomat me dritare me kafazë, e acaruar, e përndezur, duke lëvizur nga vendi një për një rrangullat e vejanisë së saj të shterpët e torturuese, derisa t'ia mbushë mendjen vetes edhe me shqisën e të prekurit se nuk ka vdekur ende dhe është gjallë për të pritur varrimin. Ajo do të hapë e do të mbyllë dyert e dhomave, duke pritur që sahati i të parëve të zgjohet nga gjumi i zhegut e ta sjellë në vete me tri të rënat. Dhe të gjitha këto në kohë e sipër që djali ul duart poshtë, rri përsëri drejt e palëvizur, për një grimë herë edhe më të shkurtër nga ç'do t'i duhej gruas që të shkonte tegelin e fundit në makinë e të ngrinte kokën gjithë bigudi. Para se djali të shtanget sërishmi i kredhur në mendime, gruaja afron makinën deri te qoshja e korridorit dhe burrat në këtë kohë kanë parë briskun të vejë e të vijë mbi rripin prej lëkure dhe i kanë kafshuar dy herë cigaret. Ulokja Ageda bën një përpjekje të fundit për të shkrythur gjunjët e zënë, ndërkohë që senjora Rebeka e kthen edhe një herë çelësin në bravë dhe mendon: «E mërkurë në Makondo. Tamam ditë për të varrosur qoftëlargun.» Mirëpo atëherë djali fillon të lëvizë përsëri dhe koha shpërfytyrohet edhe një herë. Me të lëvizur diçka, atëherë kuptohet që koha kalon. Sa pa lëvizur, jo. Sa pa lëvizur, ka vetëm amshim, djersë këmishë bërë qull mbi lëkurë, ka dhe të vdekur të pabindur. të ngrirë, akull e me gjuhë të kafshuar. Ndaj edhe nuk rrjedh koha për të varurin, sepse edhe po të lëvizë dora e djalit, ai nuk e di. Dhe ndërsa i vdekuri nuk e di (mbasi djali vazhdon të lëvizë dorën), Ageda duhet ta ketë shkokluar edhe një rruzë në rruzare, senjora Rebeka, e shtrirë në shezlong, duhet ta ketë humbur fare duke parë se si

akrepi i sahatit ka mbetur shtang buzë minutës së pritme dhe Ageda duhet të ketë pasur kohë (sido që në sahatin e senjora Rebekës nuk ka luajtur sekonda) të shkoklojë edhe një rruzë tjetër në rruzare e të thotë me vete: «Ja ç'do të bëja, sikur të shkoja dot deri tek at Anheli.» Pastaj dora e djalit ulet poshtë dhe brisku përfiton nga rasti për të kaluar edhe një herë nëpër rrip, kurse njëri prej burrave të ulur në hijen e freskët të hajatit thotë: «Duhet të ketë vajtur nja tre e gjysmë, apo jo?» Atëherë dora ndalet në vend. Edhe një herë akrepi i shtangur buzë minutës së vdekur, edhe një herë brisku i ndalur në hapësirën e vet të çeliktë dhe Ageda duke pritur edhe një të lëvizur të dorës për të vënë në lëvizje këmbët e për të hyrë vrikthi në sakristi, me krahët të hapur e me gjunjët të shkrythur, duke thirrur: «At, o at i shenjtë!» Dhe at Anheli, i rraskapitur prej palëvizshmërisë së djalit, duke shkuar gjuhën nëpër buzë për të ndier vlagën veshtullore të makthit të qofteve me salcë dhe duke vështruar Agedën, do të thotë: «Patjetër që duhet të jetë ndonjë mrekulli.» Mandej, duke u kotur edhe njëherë në topitjen e zhegut, do të jargavitet, do të dërsijë e do të rënkojë nëpër gjumë: «Sidoqoftë, Ageda, s'është ora tani për t'u thënë meshë shpirtërve të purgatorit.» Por dorës i mbetet lëvizja në ajër, ngaqë në dhomë hyn im atë dhe të dy kohët puqen, të dy gjysmat bashkohen e ngjiten, dhe sahati i senjora Rebekës e kupton se e pat humbur fillin mes ngesë së djalit dhe nxitimit të vejushës. Atëherë gogësin, pulit qepallat, kridhet në paqen e mrekullishme të çastit dhe, duke vrujuar një kohë të lëngshme, kohë të saktë e të korregjuar, bën një të përkulur e thotë gjithë pohe e bujë: «Është ora dy e dyzetë e shtatë minuta fiks.» Im atë, që pa dashur e ka thyer shtangien e kësaj

grime, thotë: «E ke humbur fare, moj bijë.» Kurse unë e pyes: «Si thua, do të ndodhë gjë?» Dhe ai, i bërë ujë në djersë, buzëqesh: «Për një gjë jam i sigurt, që në shumë shtëpi ka për t'u djegur pilafi e ka për t'u ciknosur qumështi.»

Tani arka u mbyll, por unë e mbaj mend fytyrën e të vdekurit. Më është ngulitur aq fort në mendje, sa po të shikoj nga muri, shoh sytë e zgurdulluar, faqet e rrufitura dhe të hirta si tokë e lagët, gjuhën e kafshuar në një cep të gojës, dhe atëherë s'e ndiej veten hiç rehat. Siç duket, pantalloni s'do të pushojë së më shtrënguari nga njëra anë e këmbës.

Gjyshi tani u ul pranë mamasë. Kur erdhi nga dhoma matanë, afroi një karrige dhe tani po rri aty, i ulur pranë saj, pa folur asnjë fjalë, me mjekrën të mbështetur në bastun dhe me këmbën e sëmurë të shtrirë përpara. Gjyshi po pret. Edhe mamaja po pret si ai. Edhe burrat te krevati, që nuk pijnë më duhan, por rrinë urtë e s'ndihen, pa ia hedhur sytë fare arkës, edhe ata presin.

Sikur të m'i lidhnin sytë, të më merrnin për dore, të më sillnin njëzet herë rreth e rrotull fshatit e të më binin përsëri në këtë dhomë, unë kisha për ta njohur nga era. Kurrë nuk do ta harroj se kjo dhomë mban erë mbeturinash dhe baulesh të vëna njëra mbi tjetrën, megjithëse kam parë vetëm një baule, ku mund të fshiheshim Abrahami dhe unë e të kishte vend edhe për Tobiasin. Unë i njoh dhomat nga era.

Vjet Ada më kishte ulur në prehër. Unë i kisha mbyllur sytë dhe e shikoja nëpërmes qerpikëve. E shikoja dhe më dukej sikur ajo s'qe grua, por vetëm një fytyrë që më shikonte dhe tundej e blegërinte si dele. Sa po më zinte gjumi, kur befas ndjeva erën.

S'ka erë në shtëpi që të mos e njoh. Kur më lënë vetëm në rruginë, unë mbyll sytë, shtrij krahët dhe ec. Dhe them me vete: «Kur të ndiej një erë rumi me kamfur, do të jem në dhomën e gjyshit.» Vazhdoj të ec me sy të mbyllur dhe krahë të shtrirë. Dhe them me vete: «Tani do të kaloj nëpër dhomën e mamasë, sepse bie erë letrash të reja bixhozi. Pastaj do të bjerë erë peshkve dhe naftalinë.» Vazhdoj të ec dhe ndiej erën e letrave të reja, tamam në çastin kur dëgjoj edhe zërin e mamasë që këndon në dhomë. Atëherë ndiej edhe erën e peshkves e të naftalinës. Dhe them me vete: «Tani bie erë naftalinë, ndërsa kur të kthehem majtas, do të bjerë erë të linjtash dhe erë dritareje të mbyllur. Aty do të ndaloj.» Pastaj, pasi bëj tre hapa, ndiej erën e re, ndalem në vend me sytë të mbyllur dhe krahët të shtrirë dhe dëgjoj zërin e Adës që thërret: «Po ecën symbyllazi, mor djalë.»

Atë natë, kur po më zinte gjumi, ndjeva një erë që s'ka në asnjë dhomë të shtëpisë. Qe një erë e fortë dhe e vakët, si të kishin shkundur një lule jasemini. Hapa sytë, duke nuhatur ajrin e trashë e të rënduar. Dhe thashë: «E ndien?» Ada po më vështronte por, kur unë i fola, mbylli sytë dhe u kthye nga ana tjetër. Unë i thashë prapë: «E ndien? Duket sikur ka jasemin në ndonjë vend.» Atëherë ajo tha:

— Është era e jasminëve që kanë qenë te muri para nëntë vjetësh.

Unë iu ula në prehër. «Po tani s'ka më jasemínë», i thashë. «Tani s'ka, — tha ajo. — Po para dhjetë vjetësh, kur linde ti, ka pasur një rrënjë jasemini pas murit të oborrit. Natën bënte vapë dhe binte erë mu si tani.» Unë u mbështeta pas supit të saj dhe i shikoja gojën në kohën që fliste. «Po kjo ka qenë para se të lindja unë», i thashë. «Asohere bëri një dimër i ashpër dhe u desh spastruar kopshti», tha ajo.

Era vazhdonte të ndihej, e vakët, thuajse e prekshme me dorë, duke shpështjelluar të gjitha erërat e tjera të natës. «Dua të ma tregosh», i thashë Adës. Ajo heshti për një çast, pastaj vështroi nga muri i zbardhur prej gëlqeres e prej hënës dhe tha:

— Kur të rritesh do ta mësosh se jasemini është një lule që *del*.

Unë nuk mora vesh gjë, por më hynë ca të dridhura të çuditshme, si të më kish prekur njeri me dorë. «Ëhë», thashë. Dhe ajo vazhdoi: «Edhe jasemini, si i vdekuri, del natën lugat.»

Ndenja i mbështetur pas trupit të saj dhe s'bëra zë. E kisha mendjen tjetërkund, te karrigia e kuzhinës me fund të prishur, ku gjyshi vë këpucët për t'u tharë kur bie shi. Unë qysh atëherë e dija se në kuzhinë ka një të vdekur që për natë, pa hequr sombreron, ulet dhe bën sehir hirin e zjarrit të fikur. Pas një copë here thashë: «Si puna e atij të vdekurit që ulet në kuzhinë.» Ada më vështroi me sy të zgurdulluar dhe tha: «Cilë i vdekur?» «Ai që ulet për natë në karrigen ku gjyshi vë këpucët për t'u tharë», thashë unë. Kurse ajo tha: «Aty s'ka kurrfarë të vdekuri. Karrigia është vënë afër zjarrit, ngaqë s'hyn në punë për gjë tjetër, veçse për të tharë këpucët.»

Kjo ndodhi vitin e kaluar. Tani ndryshon puna. Tani kam parë një kufomë me sy dhe mjafton t'i mbyll sytë për ta parë përsëri aty brenda, në errësirën e syve. Do t'ia thosha mamasë, por ajo filloi të bëjë muhabet me gjyshin. «Si thua, do të ndodhë gjë?» pyet ajo. Dhe gjyshi, duke ngritur mjekrën nga bastuni e duke lëvizur kokën, përgjigjet: «Për një gjë jam i sigurt, që në shumë shtëpi ka për t'u diegur pilafi e ka për t'u ciknosur qumështi.»

Në fillim ai flinte deri në orën shtatë. Hynte në kuzhinë me këmishën pa jakë, të kopsitur deri në fyt, me mëngët e rrudhura e të pista të përveshura deri te bërrylat, me pantallonat e palara të ngritura në lartësi të gjoksit dhe me rripin të lidhur shumë më poshtë qemerit. Të ngjante sikur pantallonat do t'i rrëshqitnin e do t'i binin, ngaqë s'kishin ku të mbaheshin pas atij trupi të hollë. Jo se qe dobësuar, por fytyra e tij s'kishte më atë shprehjen kryelartë prej ushtaraku të vitit të parë, por një shprehje të pavullnetshme e të kapitur të njeriut që nuk e di se si do t'i vejë filli pas një çasti, dhe madje as që do t'ia dijë. Pinte kafenë pas orës shtatë dhe kthehej përsëri në dhomën e vet, duke shpërndarë më të majtë e më të djathtë ca mirëmëngjese sa për të thënë.

Kishte katër vjet që banonte te ne dhe në Makondo pat bërë emër si mjek serioz, ndonëse karakteri i tij i ashpër dhe të sjellat e çrregullta u bënë shkak që të rrethohej me një atmosferë e cila më fort i ngjante frikës sesa respektit.

Që i vetmi mjek në fshat deri kur erdhi kompania e bananeve dhe filluan punimet e hekurudhës. Atëherë karriget në dhomën e pritjes zunë të mbeteshin bosh. Klientela e katër vjetëve

të parë të qëndrimit të tij në Makondo filloi t'i largohej sapo që kompania organizoi shërbimin mjekësor për punëtorët e vet. Ai me siguri e vuri re që gjethurinat po merrnin kot, por s'bëri zë. Vazhdoi të çelte derën e rrugës, të ulej në karrigen e tij prej lëkure tërë ditën e ditës dhe, kur kaloi shumë kohë e s'i vinte më asnjë i sëmurë, e mbylli derën, bleu një hamak edhe u ndry në dhomë.

Në atë kohë Memeja e bëri zakon t'i shpinte për mëngjes banane e portokalle. Ai hante kokrrat dhe i hidhte lëvozhgat në një qoshe, prej nga indianka i hiqte të shtunë për të shtunë, kur i pastronte dhomën. Por ai vepronte në një mënyrë të tillë, që mund të thoshte se aq i bënte sikur një të shtune të mos ia pastronin më dhomën e ajo t'i mbushej me plehra.

Atëherë nuk bënte më asgjë. E kalonte tërë ditën në hamak, duke u përkundur. Dukej nëpërmes errësirës prej derës gjysmë të hapur dhe, nga fytyra e thatë dhe e pashprehje, nga flokët e shpupurisur dhe nga përndezja si prej të sëmuri e syve të tij të ashpër e verdhashë, ngjante me një njeri që tashmë e ka marrë rrokullimën.

Vitet e para të qëndrimit të tij në shtëpinë tonë, Adelaida u duk sikur me të vërtetë i qe mbushur mendja që ai të rrinte te ne, ose u shtir sikur i qe mbushur. Por, kur ai e mbylli konsultoren dhe filloi të dilte nga dhoma vetëm për t'u ulur në tryezë e për të ngrënë, me atë apatinë e tij të përhershme të heshtur e të pikëlluar, sime shoqeje iu sos durimi: «Është mëkat prej zotit po ta mbajmë edhe më. Njësoj si të ushqenim djallin», më tha. Kurse unë, gjithmonë i prirur ndaj tij me një ndjenjë ku përziheshin mëshira, admirimi e keqardhja (se, sidoqoftë, duhet ta pranoj se në ndjenjën time kishte mjaft keqardhje), ngul-

ja këmbë: «Duhet ta durojmë. Është njeri pa nje-ri dhe duhet t'ia qajmë hallin.»

Pak më vonë filloi të punonte hekurudha. Makondoja po lulëzonte, qe mbushur me fytyra të reja, qe bërë me kinema e me plot vende dëfrimi, ku mund të shkonin gjithë bota veç ai jo. Ai vazhdonte të rrinte i mbyllur brenda, deri atij mëngjesi kur u fanit në dhomën e bukës ndërsa ne po hanim dhe zu të fliste me pasion e madje me ngazëllim për perspektivat e mrekullueshme të fshatit. Atëherë e dëgjova për herë të parë fjalën. E tha ai: «Gjithçka do të kalojë, kur të mësohemi me *gjethurinat*.»

Muaj më vonë zu të dilte shpesh në rrugë mbasditeve. Shkonte e ulej në rrojtore gjer ndaj të ngrysur dhe merrte pjesë nëpër grupet që formoheshin te dera, pranë raftit portativ, pranë poltronës që berberi e nxirrte në rrugë që klientët të kënaqeshin me të freskëtit e mbrëmjes.

Mjekët e kompanisë nuk u mjaftuan që i hoqën kafshatën e gojës. Më 1907, kur në Makondo asnjë pacienti s'i binte ndër mend për të dhe ai vetë kish hequr dorë nga të priturit, njëri prej mjekëve të kompanisë i mbushi mendjen alkaldit që t'u kërkonte gjithë mjekëve të fshatit dokumentet e profesionit. Kur një të hëne në të katër anët e sheshit u shfaqën njoftimet, ai, me ç'dukej, as që e lidhi këtë me veten. Isha unë që i thashë se do të qe mirë ta përmbushte edhe ai këtë kërkesë. Kurse ai, i qetë e mospërfillës, tha vetëm: «Unë jo, kolonel. Unë s'merrem më me këso punësh.» Kurrë nuk e mora vesh me siguri në i kishte apo jo në rregull dokumentet e profesionit, ashtu siç nuk mora vesh edhe në qe a s'qe francez, sikundër mendohej, dhe në kishte kujtime prej një familjeje që duhej ta kishte pasur, por që asnjëherë nuk e zuri në gojë. Pas disa ja-

vësh, kur alkaldi me sekretarin erdhën në shtëpinë time për t'i kërkuar dokumentet, ai s'mori mundimin të dilte nga dhoma. Atë ditë — pesë vjet pasi jetonim në një strehë e hanim në një oryezë — u kujtova se ne nuk i dinim as emrin.

S'qe nevoja të ishe shtatëmbëdhjetë vjeçe, siç isha unë asokohe, për të vënë re — qysh kur pashë Memenë e pispillosur në kishë e, më pas, kur bisedova me të në dyqanin e verërave — se dhoma e rrugës qe kyçur. Më vonë mora vesh se ime njerkë i kishte hedhur drynin e nuk lejonte të prekeshin plaçkat që qenë brenda: shtrati që doktori e kishte përdorur derisa bleu hamakun, tryezka me barna, prej së cilës, kur u bart te shtëpia e qoshes, mori vetëm të hollat e mbledhura gjatë viteve që i kishte ecur puna (dhe duhej të qenë shumë, mbasi ai s'kishte shpenzuar fare në shtëpi dhe përderisa i mjaftuan Memesë për të hapur dyqanin e verërave) e sidomos gazetat e vjetra e të shkruara në gjuhën e tij, takëmi i të larit dhe ndoca rroba vetjake që s'hynin në punë. Thua se tërë këto plaçka qenkëshin molepsur prej një sëmundjeje që ime njerkë e quante ngjitëse, të rrezikshme e madje djallëzore.

Mua më duket se e vura re dhomën e kyçur në tetor ose në nëntor (tre vjet pasi ai dhe Memeja kishin ikur prej shtëpisë), ngaqë në fillim të vitit të ardhshëm fillova të thurja plane për të futur Martinin në atë dhomë. Ma kishte qejfi të banoja aty kur të martohesha. Ia kisha vënë syrin. Kur bisedoja me time njerkë, ia silllja fjalën se kishte ardhur koha që të hapej dryni e t'i hiqej

karantina njërit prej vendeve më të rehatshme e më të këndshme. Por, sa pa filluar të qepnim fustanin tim të nusërisë, askush nuk më pat folur me hollësi për doktorin e aq më pak për dhomën që vazhdonte të ishte si diçka e tija, si një pjesë e personalitetit të tij, që s'mund të shkëputej prej shtëpisë sonë për sa kohë do të jetonte në të dikush që mund ta sillte nëpër mend.

Për më pak se një vit unë do të martohesha. Ndoshta qenë vetë rrethanat në të cilat pat rrjedhur jeta ime gjatë fëmijërisë e vajzërisë ato që s'më lejonin t'i kuptoja si duhej ngjarjet dhe sendet. Sidoqoftë, në ato muaj kur bëheshin përgatitjet për dasmën time, unë ende nuk dija shumë të fshehta. Një vit para se të martohesha me Martinin, e sillja atë nëpër mend përmes një mjegulle pavërtetësie. Dhe mbase prandaj desha ta kisha pranë, në dhomën e rrugës, për t'i mbushur mendjen vetes se qe fjala për një njeri të vërtetë e jo për një burrë të parë në ëndërr. Por nuk isha e zonja t'i flisja sime njerke për planet e mia. Kreft e natyrshme do të kish qenë po t'i thosha: «Do t'ia heq drynin, do ta vë tryezën te dritarja dhe krevatin te muri përballë, do të vë një tufë karafilash në raft dhe një degë aloeje sipër derës.» Por frikën e pavendosmërinë ma shtonte edhe ai mjegullim që mvishte të fejuarin, që mua vazhdonte të më përhihej si një figurë e vagullt, e rrëshqitshme dhe e parrokshme, të vetmet tipare konkrete të së cilës qenë mustaket e shndritshme, koka pakëz e anuar më të majtë dhe ajo setra me katër kopsa që ai s'e hiqte kurrë nga trupi.

Kish qenë nga ne në fund të korrikut. Rrinte në shtëpi gjithë ditën dhe kuvendonte me tim atë në kabinet, duke rrahur t'i mbushte mendjen për ca punë të mistershme treqtie që unë kurrë nuk i mora vesh. Mbasditeve Martini, unë dhe ime

njerkë dilnim nga plantacionet. Porse kur e shihja tek kthehej nëpër vezullimin ngjyrëmëllage të muzgut, kur më afrohej pranë e më ecte në krah, atëherë më dukej edhe më abstrakt e më i pavërtetë. E dija se asnjëherë s'kisha për ta përfytyruar dot njeri si gjithë të tjerët, me atë qëndrueshmërinë e domosdoshme që kujtimi i tij të më jepte forcë në çastin kur do të thosha: «Do t'ia rregulloj dhomën Martinit.»

Madje edhe mendimi se do të bëhesha gruaja e tij më dukej i pabesueshëm një vit para dasmës. E kisha njohur në shkurt, tek përgjonim fëmijën e Palokemados. Qemë mbledhur disa vajza që këndonim e përplasnim shuplakat, duke u munduar të përfitonim nga i vetmi dëfrim që na lejohej. Në Makondo kishte një kinema, kishte një sallë vallëzimi e plot vende të tjera dëfrimi, por babai dhe njerka ishin të mendjes se ato s'qenë për vajza të moshës sime. «Janë vende për t'u zbavitur gjethurinat», thoshin.

Shkurtit në drekëherë bënte vapë. Njerka dhe unë uleshim në rruginën e brendshme dhe qepnim pëlhurë të bardhë, ndërsa im atë bënte gjumin e zhegut. Ne qepnim derisa kalonte ai duke hequr zvarrë nallanet dhe shkonte të fuste kokën në muslluk. Por natën shkurti qe i freskët e i qetë dhe në mbarë fshatin ndiheshin zërat e grave që këndonin nëpër vëngjillat e fëmijëve të vdekur.

Atë natë që ruanim fëmijën e Palokemados duhej të dëgjohej më mirë se çdo herë zëri i Meme Oroskos. Ajo qe e dobët, këllqeshkundur e thatuqe si fshesë, por për të kënduar s'e kishte shoqen. Në pushimin e parë Henoveva Garsia tha: «Përjashta ka ardhur një jabanxhi.» Më duket se të gjitha e lamë këngën, përveç Meme Oroskos. «Përfytyroni që ka ardhur me setër. — tha Henoveva Garsia. — Ka gjithë natën që flet

dhe të tjerët e dëgjojnë me gojë hapur. Ka një setër me katër kopsa, ka hedhur këmbën mbi këmbë dhe i duken këpucët me lidhësa e çorapet me llastika.» Meme Oroskoja vazhdonte të këndonte, kur ne përplasëm shuplakat dhe thirrëm: «Haj ta marrim për burrë!»

Më pas, kur rrija dhe e mendoja duke ndenjur në shtëpi, nuk gjeja asnjë lidhje mes këtyre fjalëve dhe realitetit. Më kujtoheshin si fjalë të thëna prej një trume grash të përfytyruara, që përplasnin shuplakat e ia thoshin këngës në shtëpinë ku kish vdekur një fëmijë i pavërtetë. Gra të tjera pinin duhan në anën tonë. Ato rrinin rëndë-rëndë, me sytë katër, duke zgjatur deri te ne qafat e gjata prej zhgabash. Pas tyre, në hijen e çardakut, një grua tjetër, e mbështjellë deri te kryet me një shami të madhe e të zezë, priste kafenë të ziente. Pas pak një zë mashkulli u fut mes zërave tanë. Në fillim ai qe i hallakatur e i papërqendruar. Por më pas u bë i dridhshëm e metalik, sikur burri të këndokësh në kishë. Veva Garsia më ra me bërryl në brinjë. Atëherë unë ngrita sytë dhe e pashë për së pari. Qe i ri e fytyrëpastër, me qafën të fuqishme dhe setrën të mbërthyer katërkopsash. Dhe po më vështronte.

Kur dëgjova se do të vinte përsëri në dhjetor, thashë me mend që vend më të mirë për të se dhoma e kyçur, nuk kishte. Mirëpo s'e përfytyroja dot. Përsërisja me vete: «Martin, Martin, Martin.» Dhe emri i tij, i shkoqitur e i shkokluar copë-copë, e humbte për mua çdo kuptim.

Tek po dilnim nga vëngjilla, ai lëvizi një filxhan të zbrazët para meje dhe më tha: «Jua lexova fatin në filxhan të kafesë.» Unë po shkoja për nga dera mes vajzave të tjera dhe dëgjoja zërin e tij të thellë, të prajshëm, mbushamendës: «Numuroni shtatë yje dhe do të më shihni në ën-

dërr.» Kur po kalonim pranë derës, pamë fëmijën e Palokemados në arkivolin e vogël, me fytyrën të mbuluar me miell orizi, me një trëndafil në gojë dhe sytë të hapur me kleçka. Shkurti sillte duhmën e vakët të vdekjes së tij dhe nëpër dhomë pluskonte kundërmimi i jasemineve dhe i vjollcave të përzhitura nga të nxehtit. Por, ndërkohë që i vdekuri heshtte, mua më erdhi në vesh zëri tjetër, i njëllojtë e i pandryshueshëm: «Mos harroni. Vetëm shtatë yje».

Në korrik ai qe te ne. I pëlqente të mbështetej pas parmakëve me saksi. «Mos harroni që asnjëherë s'ju kam parë në sy, — më thoshte. — Ky është sekreti i njeriut që ka filluar të ketë frikë se mos ka rënë në dashuri.» Dhe me të vërtetë, unë nuk ia mbaja mend sytë. S'isha në gjendje të thosha në korrik se ç'ngjyrë i kishte sytë njeriu që do të merrja për burrë në dhjetor. Sidoqoftë, kishin kaluar gjashtë muaj prej atij shkurti me heshtje të thellë në drekëherë, me dy bubuzhele, mashkull e femër, të shkapetur në dyshemenë e banjës, me lypësen e të martave që kërkonte një degë melise dhe me Martinin e krekosur e me setër të mbërthyer deri lart, që thoshte: «Do t'ju detyroj të mendoni për mua orë e çast. Kam vënë një fotografi tuajën mbrapa derës dhe i kam ngulur dy gjilpëra te sytë.» Kurse Henoveva Garsia mekej gazit: «Këto janë budallallëqe që burrat i mësojnë prej indianëve.»

Në të dalë të marsit ai vejevinte nëpër shtëpi. Orë të tëra mbyllej në kabinet me tim atë, duke rrahur t'i mbushte mendjen për rëndësinë e diçkaje që unë nuk e mora vesh kurrë. Tani kanë kaluar njëmbëdhjetë vjet prej martesës sime dhe nëntë vjet qysh kur e pashë të ma bënte me dorë nga dritarja e trenit e të më porosiste të hapja sytë e të kisha kudjes djalin derisa të kthehej ai.

Dhe do të kalonin këta nëntë vjet pa u marrë vesh më gjë për të, ndërkohë që ish atë, i cili e pat ndihmuar të vinte në vijë përgatitjet për atë udhëtim të pambarim, nuk do ta zinte më në gojë kthimin e tij. Por edhe gjatë tre vjetëve që zgjati martesa jonë, ai që po aq abstrakt e i parrokshëm sa ç'pat qenë në vëngjillën e fëmijës së Palokemados, apo asaj të diele marsi kur e pashë për së dyti, ndërsa kthehesh im nga kisha së toku me Veva Garsian. Aí kishte ndaluar te porta e bujtinës, i vetëm, me duar në xhepat e anëve të setrës së tij me katër kopsa. «Tani do të mendoni për mua sa të jenë gjallë, — më tha, — se gjilpërat ranë nga fotografia.» Dhe e tha me një zë aq të qetë e të tendosur, sa dukej si e vërtetë. Por edhe kjo e vërtetë qe e tjetërsojtë, e çuditshme. «Pordhë indianësh», ngulte këmbë Henoveva. Pas tre muajsh ajo ia mbathi me drejtorin e një kompanie kukullash, por asaj të diele pat qenë ende serioze dhe e përmbajtur. «E ndiej veten të qetë kur mendoj se dikush do të kujtohet për mua në Makondo», tha Martini. Kurse Henoveva Garsia, duke u ngërdheshur prej mllefit, shfryu:

— Shkërdhata! Ka për t'iu kalbur në trup ajo setër me katër kopsa.

Deshte, s'deshte, ai mbeti për fshatin një personazh i huaj, apatik, sado që u përpoq të dukej i shkueshëm e i dashur me të tjerët. Rronte mes banorëve të Makondos, vërtet, por e ndante prej tyre kujtimi i një të shkuare të cilën dukej se qe e kotë të mundoheshe ta ndreqje. E shikonin me kureshtje, si një kafshë që qe mësuar të jetonte në të errët dhe tani dilte në dritë me ca të sjella të çuditshme, që fshatit s'kishte si të mos i dukeshin të shtira, pra edhe të dyshimta.

Kthehej nga rrojtorja kur qe ngrysur dhe mbyllej në dhomë. Ç'prej disa kohësh kish hequr dorë nga darka. Në fillim ne na u duk se kthehej i lodhur dhe binte drejt e në hamak për t'u zgjuar vetëm të nesërmen. Por s'kaloi shumë dhe unë nuhata se diçka e jashtëzakonshme ndodhte me të netëve. Dëgjohej se si sillej nëpër dhomë me një ngulmim torturues e çmendurak, sikur t'u takokësh atyre netëve me fantazmën e njeriut që pat qenë ai vetë gjer atëherë, dhe të dy, njeriu i dikurshëm dhe njeriu i tanishëm, t'u përleshkeshin shurdhtas, i dikurshmi për të mbrojtur vetminë e tij të tërbuar, ekuilibrin e pacenueshëm, personalitetin e patjetërsueshëm, kurse i tanishmi dëshirën e zjarrtë e të papërballueshme për t'u çliruar nga ai që pat qenë më parë. E dëgjoja të

vërtitej nëpër dhomë deri ndaj të gdhirë, derisa lodhja e vet ia shterte fuqitë edhe kundërshtarit të padukshëm.

Vetëm unë e kuptova plotësisht ndryshimin e tij, qyshse i hoqi kallcat dhe filloi të lahej për dite e të spërkaste rrobat me kolonjë. Pas disa muajsh ai kish ndryshuar deri në atë pikë, sa ndjenja ime për të nga durim i thjeshtë u shndërrua në keqardhje. Nuk më mallëngjenin daljet e tij në rrugë, jo. Mallëngjehesha kur e përfytyroja të mbyllur netëve në kthinën e tij, duke pastruar rrobat me ujët e musllukut, duke u kruar baltën e duke i lyer me xhela këpucët e rëna copë nga aq vjet së pahequri prej këmbësh. Mallëngjehesha kur mendoja për furçën dhe kutinë e xhelasë të futura poshtë raftit, të fshehura nga sytë e botës, si të qenë dëshmi e një vesi tinzar e të turpshëm, që s'i kish hije një moshe kur shumica e burrave bien në qetësi dhe e mbledhin mendjen. E vërteta është se ai po jetonte një djalëri të vonët e të shterpët, po kujdesej për të veshurit si një djalosh, duke hekurosur rrobat me duar, pa hekur, e pa patur një shok, siç kanë të rinjtë, të cilit t'ia rrëfente gënjimet e zhgënjimet.

Por edhe fshati duhej ta kishte vënë re ndryshimin e tij, se pas disa kohësh u hap fjala sikur paskësh shtënë dashuri në të bijën e berberit. Nuk e di në kishte ndonjë bazë për këto thashetheme, por e vërteta është se ato më bënë të kuptoja papritmas vetminë e tij të tmerrshme si mashkull, tërbimin biologjik që duhej ta torturonte në ata vjet fëlliqësie e braktisjeje.

Mbasdite për mbasdite e shihnim tek shkonte për në rrojtore, gjithnjë e më i kujdesur në të veshur, me këmishën me jakë false, me manshetat me sumbulla të praruar dhe me pantallonat e pastra e të hekurosura, vetëm se përsëri me rripin

e mesit sipër qemerit. Ngjanin me një bandill të veshur e të kapistallur, të mbështjellë me një kundërmim locionesh të lira, me atë bandillin përjetësisht të pafat, dashnor ndajnate, të cilit gjithmonë i mungon degëza me lule për takimin e parë.

Kështu u zunë muajt e parë të 1909-s dhe, ndonëse e vetmja bazë për gojët e liga ishte fakti që ai ulej çdo mbasdite në rrojtore e shkëmbente dy fjalë me jabanxhinjtë, askush nuk mund të thoshte ndërkohë se e kishte parë qoftë edhe një herë të vetme të bijën e berberit. Unë e kuptova ç'fshihej prapa këtyre thashethemeve. Gjithë fshati e dinte se e bija e berberit kish mbetur fatpadalë, mbasi kish hequr të zitë e ullirit një vit të tërë prej një lugati që s'e linte rehat, që i hidhte grushte me dhé në gjellët, turbullonte ujët e kanës, mjegullonte pasqyrat e rrojtores dhe e rrihte vajzën sa ia bënte fytyrën pleh. Më kot dha e mori *Kacorri* me marifetet me stolë, me kurat me ujë të bekuar, me reliktet e shenjta e me barnat e posaçme që iu dhanë me një përkujdesje dramatike. Tekefundit, e shoqja e berberit e mbylli të bijën e magjepsur në dhomën e gjumit, hodhi oriz me grushte nëpër sallon edhe ia dha dashnorit të padukshëm për një muaj mjalti vetmitar e të pazë, pas të cilit gjer edhe burrat e Makondos thanë se e bija e berberit paskësh mbetur me barrë.

S'kaloi një vit, kur fshati hoqi dorë së prituri lindjen e saj të përbindshme dhe gojët e liga gjetën tjetër avaz: filluan të pëshpërisnin sikur doktori paskësh shtënë dashuri në të bijën e berberit, ndonëse të gjithë e dinim fare mirë se vajza e magjepsur që mbyllur në dhomë dhe, më parë bëhej pluhur e hi, sesa merrte për burrë ndonjë nga mtuesit.

Prandaj qeshë i sigurt se kjo ishte jo vetëm një hamendje e pabazë, por ishte një shpifje e ulët dhe e ligë, e kurdisur me kasd.

Në fund të 1909-s ai vazhdonte të shkonte në rrojtore dhe njerëzit vazhdonin të flisnin, t'i bënin dasmën, sido që askush nuk mund të thoshte se vajza pat dalë ndonjëherë kur kish qenë ai aty, apo se kishin pasur rast të këmbenin dy fjalë njëri me tjetrin.

Këtu e trembëdhjetë vjet, një shtatori zhuritës e të vdekur si ky, njerka filloi të më qepte fustanin e nusërisë. Mbasditeve, ndërsa im atë bënte gjumin e zhegut, ne uleshim e qepnim pranë parmakëve me saksi, pranë flakërimit të harbuar të rozmarinit Kështu ka qenë shtatori gjatë gjithë jetës sime, që këtu e trembëdhjetë e më shumë vjet. Meqenëse dasmën do ta bënim ngadalë-ngadalë e për merak, si ata njerëzit që s'kanë ngut e që në punën e tyre të pandjeshme kanë gjetur mënyrën më të mirë për të matur kohën. Dhe bisedonim. Unë e kisha mendjen te dhoma e rrugës, matesha t'ia thosha sime njerke se ai që vendi më i mirë për Martinin. Dhe asaj mbasditeje ia thashë.

Njerka po qepte bishtin e gjatë prej tyli dhe, nëpër ndriçimin verbues të atij shtatori të kthjellët e të tingullt sa s'durohej dot, dukej sikur që kredhur deri në supe mes një reje të bardhë. «Jo», tha ajo. Mandej, duke iu kthyer punës, si të ndiente t'i kalokëshin nëpër ballë tetë vjet

kujtime të hidhura, shtoi: «Mos e dhëntë zoti të hyjë më njeri në atë dhomë.»

Martini erdhi përsëri në korrik, por nuk ndenji te ne. I pëlqente të mbështetej pas parmakëve me saksi dhe të rrinte e të bënte sehir matanë. I pëlqente të thosh: «Të kish të rrija në Makondo për tërë jetën.» Mbasditeve dilnim me time njerkë nëpër plantacione. Ktheheshim në orën e të ngrënit, para se të ndizeshin dritat e fshatit. Atëherë ai më thoshte: «Edhe po të mos ishit ju, do të rrija që do të rrija në Makondo.» Edhe kjo, nga mënyra se si e thoshte, dukej si e vërtetë.

Në atë kohë bëheshin katër vjet që doktori kishte ikur prej shtëpisë sonë. Dhe pikërisht asaj mbasditeje kur filluam të qepnim fustanin tim të nusërisë — asaj mbasditeje të hamullt kur i zura në gojë dhomën për Martinin — ime njerkë më foli për herë të parë për tabiatet e tij prej tuhafi.

— Këtu e pesë vjet të shkuar, — tregoi ajo, — ai qe ende aty, i mbyllur si kafshë. Po ç'them edhe unë, si kafshë. Ai qe një shtazë barngrënëse, një bishë ripërtypëse, një ka parmende. Po të qe martuar me të bijën e berberit, me atë thëngjillkën e mbuluar që i ngriti mendjen fshatit se gjoja paskësh mbetur me barrë pas një muaji mjalti të dyshimtë me lugetrit, mbase s'do të kish ngjarë kurrgjë nga gjithë ç'ngjanë.

— Mirëpo, papritur e pa kujtuar, ai filloi të mos shkonte më në rrojtore dhe në çastin e fundit pati një ndryshim të beftë, që në të vërtetë s'qe veçse një kapitull i ri i zbatimit të planit të tij të tmerrshëm. Vetëm yt atë mund të duronte që, pas kësaj, një zarbanik si ai të vazhdonte të banonte në shtëpinë tonë, duke jetuar si kafshë, duke i kallur datën mbarë fshatit e duke u bërë shkas që

të na merrnin nëpër gojë si njerëz që e kemi ngrënë turpin me bukë. Plani që kurdiste ai në kokë do të kurorëzohej me ikjen e Memesë. Por edhe atëherë yt atë s'i pranoi që s'i pranoi gabimet e veta.

— Unë s'kam ditur gjë fare, — thashë.

Gjinkallat ia kishin krisur këngës në oborr. Njerka fliste pa e ngritur kryet nga puna, nga gjergjefi ku qëndiste lajle simbolike e thurte labirinte të bardha. Tregonte:

— Atë natë qemë ulur në tryezë (të gjithë; përveç atij, mbasi qysh prej mbrëmjes kur u kthye për herë të fundit nga rrojtorja, nuk hante më darkë), kur Memeja erdhi të na shërbente. I kishte ikur fytyra. «Ç'ke, Meme?» e pyeta unë. «Asgjë, zonjë. Pse?» ma ktheu ajo. Po ne e kuptuam që s'ishte mirë, se i merreshin këmbët pranë llambës dhe dukej që në fytyrë se qe sëmurë. «Pash zotin, Meme, ti s'je mirë», i thashë unë. Ajo mezi qëndronte në këmbë, derisa u kthye në kuzhinë me tabakanë. Atëherë yt atë, që kishte gjithë kohën që po e këqyrte, i tha: «Po s'e ndjeve veten mirë, shko e bjer.» Ajo nuk u përgjigj. Vazhdoi të merrej me tabakanë, prapa shpinës sonë, derisa dëgjuam krismën e pjatave që u bënë copë e thërrime. Memeja kishte mbetur në korridor, duke u mbajtur pas murit me thonj. Atëherë yt atë vajti ta thërriste që të bënte diçka për Memenë.

— Për tetë vjet që kishte jetuar në shtëpinë tonë, — vazhdoi ime njerkë, — asnjëherë s'i kishim kërkuar ndihmë për ndonjë rast serioz. Ne gratë vajtëm në dhomën e Memesë, e fërkuam me alkool dhe pritëm të kthehej yt atë. Por ata nuk erdhën, Isabel. Ai nuk erdhi ta shihte Memenë, megjithëse njeriu që i kish dhënë strehë për tetë vjet rresht dhe e kish mbajtur me të

ngrënë, me të pirë e me të larë, kish vajtur ta kërkonte personalisht. Sa herë që e mendoj, them se ardhja e tij qe një ndëshkim i zotit. Them se gjithë ai bar që i dhamë gjatë tetë vjetëve, gjithë ato kujdesje e përkujdesje qenë për ne një mësim nga zoti që të hapnim sytë e të mos i besonim verbtazi kujtdo që na trokiste në derë. Qe njësoj si të mblidhje tetë vjet sajdisje, ushqime e rroba të lara dhe t'ua hidhje derrave. Memeja po vdiste (të paktën kështu na dukej neve), kurse ai vazhdonte të rrinte i ngujuar në dhomën e vet, pa marrë mundimin të bënte jo një gjest mëshire, por thjesht një gjest mirësjellieje, falënderimi e respekti kundrejt të zotëve të shtëpisë.

— Më në fund yt at u kthye aty nga mesnata, — vazhdoi njerka. — Dhe tha sa për të larë gojën: «Fërkojeni me alkool, por mos i jepni pirgë.» Mua sikur ma veshi njeri me shpullë. Me fërkimet tona ne e kishim sjellë Memenë në vete. Gërthita si e xhindosur: «Posi, pra, me alkool! Por për të arritur deri tek alkooli na u paska dashur t'i biem qarit tetë vjet rresht!» Yt atë, zemërbutë si gjithnjë e si gjithnjë me atë huqin e të mbyllurit një sy, tha: «S'është gjë me rëndësi. Do ta marrësh vesh më vonë.» Sikur të paskësh qenë fallxhor i biri i botës.

Nga furia e zërit dhe nga pasioni me të cilin fliste, ngjante sikur asaj pasditeje ime njerkë po jetonte sërishmi ngjarjet e asaj nate të largët, kur doktori nuk kish pranuar t'i vinte në ndihmë Memesë. Rozmarinit dukej sikur po i zihej fryma nga kthjelltësia symarrëse e shtatorit, nga topitja e gjinkallave dhe nga dihatja e burrave që po përpiqeshin të hiqnin një derë nga menteshat në shtëpinë ngjitur.

— Kur ja që një të diel Memeja na shkon në kishë e pispillosur si zonjë e madhe, — vazhdoi

njerka. — Më kujtohet si tani se kishte një ombrellë nga ato që ndryshojnë ngjyrat. Eh, Memeja, Memeja! Edhe ajo një ndëshkim i zotit qe. Edhe kur e shpëtuam prej prindërve që ia kishin tharë zorrën, edhe kur i dhamë strehë, të ngrënë e të pirë dhe e bëmë njeri, dora e zotit pat qenë. Kur e pashë te porta të nesërmen, duke pritur që njëri nga indianët t'i nxirrte baulen, as që e dija se ku po shkonte. Kish ndryshuar e pat marrë hije të rëndë (më kujtohet si tani) dhe rrinte aty e fjalosej a s'fjalosej me tët atë. Mua nuk më pvetën për asgjë, Çabela, si të kisha qenë një hu gardhi në këtë shtëpi. Para se unë të hapja gojën e të pyesja se c'po ndodhte, se ç'qenë këto gjëra të qudltshme që po na bënin vaki në shtëpi dhe unë nuk dija asgjë, yt atë erdhi e më tha: «S'ke pse e pyet Memenë. Ajo po ikën, por ndoshta do të kthehet pas ca kohësh.» Kur unë e pyeta se ku po ikte, ai nuk m'u përgjigj. U largua duke tërhequr nallanet, tamam sikur unë të mos isha gruaja e tij, por një copë dru.

— Vetëm pas dy ditësh e mora vesh se ai i biri i botës paskësh ikur në mëngjes, pa marrë mundimin as të na linte lamtumirën. Kish hyrë te ne si në shtëpinë e vet dhe, pas tetë vjetësh, kish dalë po si prej shtëpisë së vet, pa u ngjatjetuar e pa folur fare. Hajdut e shkuar hajdutit. Thashë se mos i pat dhënë duart yt atë, ngaqë s'pat pranuar t'i vinte në ndihmë Memesë. Por, kur e pyeta qysh atë ditë, ai më tha vetëm: «Është muhabet i gjatë. Do të bisedojmë më vonë.» Kanë kaluar pesë vjet dhe ne as që e kemi zënë më në gojë atë muhabet.

— Vetëm me tët atë e në një shtëpi të shihurr si kjo, ku sikush bën ç'i do qejfi, mund të ndodhte një gjë e tillë. Makondoja zlente, kur unë ende s'e kisha marrë vesh që Memeja na paskësh

vajtur në kishë e nisur dhe e stolisur si zonjë e madhe, dhe që yt atë paskësh patur sy e faqe t'i fuste krahun e ta nxirrte nëpër shesh. Atëherë e mësova se s'rrinte aq larg sa ç'pandehja unë, porse banonte te shtëpia e qoshes me doktorin. Patën ikur për të jetuar bashkë, si dy derra, pa marrë mundimin të shkelnin pragun e kishës, sido që ajo qe e krishtere. Një ditë s'm'u durua dhe ia thashë tyt eti: «Edhe për këtë mëkat ka për ta gjetur nga perëndia.» Ai s'bëzajti. Edhe pasi pat bërë gjithë atë skandal duke iu bërë strehë jaranisë, ai vazhdonte të mos e bënte qejfin qeder.

— Po tani them shyqyr që punët rrodhën asisoj, mjaft që doktori na u sikteris prej shtëpisë. Po të mos kish ngjarë ajo çka ngjau, do ta kishim ende aty te dhoma. Kur mora vesh që iku dhe që i pat shpënë te shtëpia e qoshes ato ndyrësirat e tij, bashkë me atë baulen që s'e nxinte as porta e madhe, mora frymë rehat. Pas tetë vjetësh, më në fund kisha fituar.

— S'kaluan as dy javë, kur Memeja hapi dyqanin e verërave. Bile mori edhe makinë qepëse. Bleu një «Domestik» të ri me paratë që kish grumbulluar ai në këtë shtëpi. Mua kjo m'u duk tamam fyerje dhe ia thashë tyt eti. Ai, megjithëse nuk më përgjigjej kur i flisja, dukej që më tepër sesa i penduar, ishte i kënaqur për veprën e vet, thua se paskësh shpëtuar një shpirt, paçka se me tolerancën e tij proverbiale, me shpirtbutësinë e liberalizmin e tij (madje edhe me një grimë çmendurie) pat marrë nëpër këmbë emrin dhe nderin e kësaj shtëpie. Unë ia përplasa: «Gjithë shpirtmirësinë tënde zëre se ua hodhe derrave.» Kurse ai ma ktheu si ngaherë:

— Do ta kuptosh dhe këtë një ditë prej ditësh.

Dhjetori erdhi si një pranverë e paparashikuar, si dhjetor i përshkruar në një libër. Dhe bashkë me të erdhi Martini. Erdhi pasi ne kishim ngrënë drekë, me një çantë-valixhe, përsëri me setrën me katër kopsa, kësaj here të larë e të sapohekurosur. Mua nuk më tha asgjë, se vajti drejt e në kabinetin e tim eti për të biseduar. Dita e dasmës qe prerë për në korrik. Dy ditë pas ardhjes së Martinit në dhjetor, im atë thirri time njerkë në kabinet për ta njoftuar se dasma duhej të bëhej të hënën. Ishte e shtunë.

Fustani im qe përfunduar. Martini ndenji në shtëpi gjatë gjithë atyre ditëve, bisedonte me tim atë dhe ky na i jepte përshtypjet kur mblidheshim në tryezë. Unë nuk e njihja të fejuarin tim. S'kisha ndenjur vetëm për vetëm me të për asnjë çast. Megjithëkëtë, Martinin dukej sikur e lidhte me tim atë një miqësi e ngushtë dhe im atë fliste për Martinin sikur do të martohej ai vetë me të, jo unë.

Nuk ndieja kurrfarë emocioni për dasmën që po më afrohej. Vazhdoja të jetoja mes asaj mjegullnaje të hirtë, nëpërmes së cilës Martini vinte drejt meje, ashtu trupdrejtë e abstrakt, duke folur me këmbë e me duar dhe duke kopsitur e

shkopsitur setrën me katër kopsa. Të dielën ndenji për drekë te ne. Njerka i ndau vendet në tryezë në mënyrë që Martini të binte pranë tim eti, tri vende larg prej timit. Gjatë bukës unë dhe njerka folëm shumë pak njëra me tjetrën. Im atë dhe Martini flisnin për punët e tyre të tregtisë, kurse unë, e ulur tri vende më tej, kundroja burrin që pas një viti do të bëhej baba i tim biri e me të cilin s'më lidhte as dhe një miqësi sa për të thënë.

Të dielën në darkë vesha fustanin e nusërisë në dhomën e gjumit të sime njerke. E shihja veten në pasqyrë të zbehtë e të akullt, mbështjellë me renë fluturore të tylit, që më kujtonte fantazmën e sime ëme. Thosha me vete para pasqyrës: «Ja ku jam unë, Isabela. Jam veshur nuse për t'u martuar në mëngjes.» Dhe nuk e njihja veten time, ndihesha si e përsëdytur në kujtimin e nënës së vdekur. Memeja më pat folur për të para pak ditësh, pikërisht te kjo qoshe ku jemi tani. Më kishte treguar se, pas lindjes sime, nënën e kishin veshur me rrobat e nusërisë dhe e kishin shtënë në arkivol. Dhe ja tani, duke parë veten në pasqyrë, unë shihja skeletin e sime ëme të veshur me mykun e jeshiltë të varrit, mes një grumbulli tyli të bërë hi dhe një shtrese pluhuri të verdhë. Unë isha jashtë pasqyrës. Brenda ishte nëna, përsëri e gjallë, tek më vështronte e zgjaste krahët prej hapësirës së saj të ngrirë, si të desh të prekte vdekjen që më ish qepur pas gjilpërave të kurorës së nusërisë. Ndërsa nga mbrapa, në mes të dhomës, im atë hijerëndë e i shushatur, duke më thënë: «Tani, me këtë fustan, je krejt si ajo.»

Asaj nate mora letrën e parë, të fundit dhe të vetme të dashurisë. Një pusullë nga Martini, shkruar me laps mbrapa një fletëprogrami të kinemasë. Thoshte: *«Meqenëse sonte nuk vij dot në*

kohë, do t'jua shpjegoj në mëngjes si qe puna. Thuajini kolonelit se ajo çka biseduam pothuajse u rregullua, prandaj nuk vij dot tani. Keni shumë frikë? M.» Me shijen e mielltë të kësaj letre në gojë vajta në dhomën e gjumit dhe ende e kisha qiellzën të hidhur kur u zgjova, pas disa orësh, teksa më shkundte njerka.

Por e vërteta është se u desh të kalonin shumë orë para se të zgjohesha plotësisht. Më dukej vetja sikur qeshë veshur prapë me fustanin e nusërisë në një mëngjes të freskët e të lagësht, që binte erë myshk. E ndieja gojën të thatë, si gjatë një udhëtimi kur s'e njom dot bukën me pështymë. Të ftuarit kishin ardhur që në orën katër dhe prisnin në sallon. I njihja të gjithë, por tani më dukeshin ndryshe dhe sikur i shihja për herë të parë: burrat me kostume shajaku dhe gratë me sombrero në kokë, duke kuvenduar e duke mbushur shtëpinë me avullin e dendur e ngacmues të fjalëve të tyre.

Kisha ishte bosh. Disa gra kthyen kokat të më shihnin kur kalova nëpër lutësoren kryesore si një çupëz e shenjtë që shkon drejt gurit të flijimit. *Kacorri*, ashtu thatim e i krekosur, e vetmja figurë që shquhej qartë mes atij makthi të kokolepsur e të pazë, zbriti shkallët dhe më shpuri te Martini me katër lëvizje të duarve të tij kockë e lëkurë. Martini rrinte ngjat meje, i qetë e buzagaz, siç e kisha parë në vëngjillën e fëmijës së Palokemados, veçse tani me flokët të prerë shkurt, si për të më treguar se edhe ditën e dasmës kishte patur kujdes të dukej më abstrakt nga ç'pat qenë rëndom ditëve të tjera.

Atë mëngjes, kur u kthyem në shtëpi, pasi të ftuarit hëngrën sipas zakonit dhe thanë fjalët e rastit, im shoq doli dhe u kthye vetëm pas gjumit të zhegut. Babai dhe njerka bënë sikur nuk e

vunë re gjendjen në të cilën u ndodha. E shtynë edhe atë ditë si të tjerat, duke u përpjekur të mos binte në sy pazakonshmëria e asaj të hëne. Unë hoqa fustanin e nusërisë, e bëra shuk dhe e flaka në fund të dollapit të rrobave, duke sjellë ndër mend time ëmë e duke thënë me vete: «Të paktën për qefin do të më hyjnë në punë këto rrecka.»

Dhëndri i pavërtetë u kthye në orën dy pasdreke dhe tha se kishte ngrënë. Atëherë, kur e pashë duke ardhur me ata flokë të prerë shkurt, m'u duk se dhjetori për sytë e mi s'qe më muaj i kaltër. Martini m'u ul pranë dhe ndenjëm një grimë herë pa folur. Për herë të parë qysh kur kisha lerë, pata frikë nga të ngrysurit. Dhe duhet ta kem shfaqur këtë frikë me ndonjë lëvizje, se Martini menjëherë u ndërmend, u përkul mbi supin tim e më tha: «Ç'po mendon?» Ndjeva një ndrydhje në zemër: i panjohuri po fillonte të më fliste me «ti». Ngrita kryet lart, atje ku dhjetori dukej si një kupolë e shndritshme vigane, një muaj velëtitës kristali dhe thashë: «Po mendoj se tani vetëm një shi mungon.»

Natën e fundit që folëm në rruginën e brendshme të shtëpisë, bënte më vapë se zakonisht. Pas disa ditësh ai do të kthehej nga rrojtorja për të mos vajtur aty kurrë më dhe do të mbyllej në dhomë. Por asaj nate të fundit në rruginë, një nga netët më të nxehta e më rraskapitëse që mbaj mend, ai u tregua i dëgjueshëm e i kuptueshëm si rrallëherë. Të vetmet shenja të jetës mes asaj zjarrmie të tmerrshme dukej sikur qenë kërkërimat e shurdhëta të bulkthave të ndezur nga

ctja dhe gjalleria e mezidallueshme, e megjithëkëtë e tejmasshme, e rozmarinit dhe lulelandrës, që digjeshin në atë orë të vonë e të shkretë. Të dy heshtëm për një çast, duke djersirë një lëng të trashë e ngjitës që s'ishte djersë, por jargë e çliruar prej materies së gjallë në shpërbërje e sipër. Kur e kur ai vështronte yjet, qiellin e këputur nga ai shkëlqim i madh i verës dhe heshtte, si i kredhur i tëri në soditjen e asaj nate tmerrësisht të gjallë. Ndenjëm kësisoj të menduar, ballë për ballë, ai në karrigen e tij prej lëkure, unë në karrigen time përkundëse. Befas, nën flatrën e bardhë të një vetëtime të largët, e pashë me kokën të varur trishtëm mbi supin e majtë. Dhe solla nëpër mend jetën e tij, vetminë, brengat sfilitëse. Kujtova shpërfilljen me të cilën e kundronte ai spektaklin e jetës. Gjer atëherë më kishin lidhur me të një mori ndjenjash, nganjëherë të përkundërta e të ndryshueshme si ai vetë. Por atë çast nuk pata pikë dyshimi se kisha filluar ta doja me shpirt. M'u duk sikur zbulova përbrenda vetes atë forcë të mistershme që qysh në çastin e parë më kishte shtyrë t'i bëhesha krah dhe e ndjeva në mishin tim dhembjen e asaj kthine të errët ku të zihej fryma. E pashë ashtu të zymtë e të rraskapitur, si një njeri që jeta e ka vënë poshtë. Dhe, kur ai ngriti edhe një herë sytë e tij zhbirues, të ashpër e verdhashë, pata ndjesinë e sigurt se regëtima e tendosur e saj nate më kish zbuluar të fshehtën e vetmisë së tij të koklavitur. Para se të kisha kohë e të mendoja pse po e bëja këtë, e kisha pyetur:

— A s'më thoni, doktor: e besoni zotin?

Ai më vështroi. Flokët i binin mbi ballë dhe digjej i tëri prej një zjarri të brendshëm, por në fytyrë s'i dallohej shenjë tronditjeje apo hutimi. Me atë zërin e tij të prajshëm prej ripërtypësi, m'u përgjigj:

— Hera e parë në jetën time që ma bëjnë këtë pyetje.

— Po ju, doktor, nuk ia keni bërë ndonjëherë vetes?

Nuk u duk as shpërfillës, as i shqetësuar. U duk sikur i ngjalla njëfarë interesi unë dhe jo pyetja ime e aq më pak ajo çka fshihej pas pyetjes.

— Ec e merre vesh, — tha.

— Po a nuk ju fut frikën një natë si kjo? A nuk ju duket se një njëri më i madh nga të gjithë ne po ecën nëpër plantacionet, ndërkohë që asgjë s'pipëtin dhe çdo gjë ka mbetur e çmeritur para ecjes së tij?

Nuk u përgjigj menjëherë. Kërkërima e bulktheve mbushte hapësirën gjer përtej kundërmimit të vakët, të gjallë e gati-gati njerëzor të jasminit të mbjellë për kujtim të gruas sime të parë. Një njeri vigan po çapej i vetëm nëpër natë.

— Jo, kolonel, kjo nuk më shqetëson aspak. — Por tani edhe ai dukej i hutuar, si gjithçka rreth e përqark, si rozmarini e lulelandra që digjeshin diku më tej. — Mua më shqetëson fakti se ka një njeri, si puna juaj, që mund të thotë me siguri se e dëgjon atë viganin që ecën nëpër natë, — dhe m'i nguli sytë drejt, me ashpërsi.

— Ne përpiqemi për shpëtimin e shpirtit, doktor. Këtu është ndryshimi.

Dhe atëherë u shtyta edhe më tutje nga ç'pata menduar. I thashë:

— Ju nuk e dëgjoni, ngaqë jeni ateist.

Kurse ai m'u përgjigj i qetë, gjakftohtë:

— Më besoni, kolonel, që s'jam ateist. Puna është se mua më shqetëson si mendimi që zot ka, ashtu edhe mendimi që zot nuk ka. Ndaj dhe më pëlqen më mirë të mos mendoj fare.

Nuk e di pse kisha një parandjenjë se ai pi-

kërisht kështu do të më përgjigjej: «E ka humbur zotin dhe s'e gjen dot», mendova duke dëgjuar ato çka po më thosh ai në mënyrë të vetvetishme, me qartësi e saktësi, si t'i lexonte në ndonjë libër. Më kishte dehur topitja molisëse e natës. Më dukej vetja sikur qeshë futur mes një galerie të pafund me shëmbëlltyra profetike.

Pas parmakëve që bahçja me lule, me të cilën merreshin Adelaida dhe ime bijë. Ndaj edhe qe tërbuar rozmarini, se e përkujdesnin ato mëngjes për mëngjes, që ndër net si ajo kundërmimi i tij i zjarrtë të mbushte shtëpinë e të na e bënte gjumin më të lehtë. Jasemini dërgonte erëmimin e tij të fortë dhe ne e prisnim me kënaqësi, se ai kishte moshën e Isabelës dhe era e tij gjithësesi që një jetëzgjatim i nënës së saj. Bulkthat ia thonin në oborr, midis kaçubave, se kishim harruar t'i qëronim barërat e këqia pas shirave. E vetmja gjë e çuditshme dhe e pabesueshme ishte që ai ndodhej aty përballë meje, duke fshirë ballin e vetëtitur prej djerse me atë shaminë e tij të madhe.

Pasi heshtëm përsëri, tha:

— Do të desha të dija përse ma bëtë atë pyetje, kolonel?

— Ashtu më erdhi, — thashë unë. — Ndoshta ngaqë ka shtatë vjet që rrekem të marr vesh se ç'mendon një njeri si ju.

Fshija djersët edhe unë dhe vazhdoja:

— Ose ndoshta ngaqë më shqetëson vetmia juaj.

Prita përgjigje, por përgjigje s'pati. Rrinte përballë meje, i trishtë e i vetmuar si gjithmonë, Dhe mua mendja më vajti te Makondoja, te çmenduria e banorëve të saj që digjnin tufa parash nëpër festa, te gjethurinat që kishin marrë kot e përbuznin gjithçka, që shkarrëzeheshin në bal-

takun e instinkteve dhe gjenin në atë shfrim kënaqësinë e lakmuar. Solla nëpër mend jetën e tij para se të vinin gjethurinat. Dhe jetën e mëpastajme: kolonjat e lira, këpucët e vjetra të lustruara, thashethemet që e përndiqnin si një hije që ai vetë s'e njihte.

Dhe thashë:

— Doktor, s'keni menduar ndonjëherë të martoheni?

Para se unë të mbaroja pyetjen, ai kish filluar të më përgjigjej me një të sjellur rrotull, siç e kish zakon:

— Besoj se e doni shumë vajzën tuaj, kolonel, apo jo?

U përgjigja se kjo qe krejt e natyrshme. Ai vazhdoi të fliste:

— S'do mend. Por me ju ndryshon puna. Ju keni qejf sa ç'thuhet që gozhdët në shtëpinë tuaj t'i ngulni vetë. Ju kam parë tek i vinit mentesha një dere, megjithëse keni në shërbim gjithë ata njerëz që mund ta kishin bërë këtë në vend tuaj. Juve kjo ju pëlqen. Qejfi juaj është të veni e të vini nëpër shtëpi me një kuti veglash, duke kërkuar ku ka ndonjë gjë për të rregulluar. Madje ia dini për falemnderit ndokujt që mund t'ju prishë menteshat. Ia dini për falemnderit, mbasi ju jep mundësinë të plotësoni qejfin tuaj.

— Më është bërë zakon, — thashë unë, pa e kuptuar se ku do të dilte. — Thonë se e kam nga ime ëmë.

Ai ia bëri me kokë. Qe i qetë, por i papërkulshëm.

— Në rregull, — tha. — Dhe është zakon i mirë. Është kënaqësia më e lirë që më ka rënë rasti të njoh në jetën time. Prandaj keni një shtëpi siç e keni dhe e keni rritur bijën tuaj siç e keni rritur.

Ende s'po kuptoja se ku do të dilte me këtë të sjellur rrotull. Por, megjithëse nuk e kuptoja, e pyeta:

— Po ju, doktor, s'keni menduar ndonjëherë të bëheni me fëmijë?

— Unë jo, kolonel, — tha. Dhe buzëqeshi, por, në çast, u bë përsëri serioz. — Fëmijët e mi s'do të qenë si tuajt.

Atëherë s'pata më pikë dyshimi: ai fliste seriozisht dhe ky seriozitet më shtiu të ngjethurat. Tashë me vete: «Për këtë është për të ardhur keq më tepër, sesa për gjithë të tjerat...» Qe një njeri që duhej mbrojtur, mendoja.

— Keni dëgjuar gjë për *Kacorrin?* — e pyeta.

Ia bëri jo me kokë. I thashë:

— *Kacorri* është famullitari, por më tepër se famullitar, është mik i të gjithëve. Duhet të njiheni me të.

— Aha, po, — foli. — Edhe ai, siç duket, paska fëmijë. Apo jo?

— Tani nuk e kam fjalën aty, — i thashë unë. — Njerëzit e marrin nëpër gojë *Kacorrin* ngaqë e duan shumë. Ja pra një shembull, doktor. *Kacorri* nuk është mësallë me dy faqe, siç themi ne, nuk është shenjtor nga të ikonës. Është një njeri si gjithë të tjerët dhe bën çdo gjë që bëjnë edhe të tjerët.

Ai më dëgjonte në heshtje, i vëmendshëm e i përqendruar, me sytë e ashpër e verdhashë të mbërthyer në sytë e mi.

— Mrekullia vetë, — tha. — Apo jo?

— Unë për vete them se *Kacorri* ka për t'u bërë shenjtor, — thashë. Dhe isha i çiltër kur e thosha këtë. — Në Makondo s'qe bërë kurrë një gjë e tillë. Në fillim e pritën me mosbesim, se është vendali dhe pleqtë e mbanin mend kur dilte për të gjuajtur zogj me llastika si gjithë kala-

majtë. Kishte marrë pjesë në luftë, qe bërë kolonel, dhe kjo i vështirësonte punët. Ju e dini që njerëzit s'kanë pikë respekti për veteranët, për të njëjtat arësye që kanë një barrë respekt për priftërinjtë. Le që, ku ishim mësuar ne të na lexonin buletinin «Bristol» në vend të Ungjillit?

Ai buzëqeshi. Me siguri që iu duk diçka e lezetshme, siç na qe dukur edhe neve ditët e para.

— Interesante, — tha. — Apo jo?

— Ç't'i bësh *Kacorrit!* I pëlqen të sqarojë popullin lidhur me dukuritë atmosferike. Ka për shtrëngatat një pasion gati-gati teologjik. Çdo të diel flet për to nga hijerorja. Ndaj edhe predikimet s'i mbështet në Ungjill, por në parashikimet e motit të buletinit «Bristol».

Ai buzëqeshte e më dëgjonte gjithë kureshtje e dashamirësi. Edhe unë sikur po fluturoja.

— Po ka edhe diçka që juve do t'ju çudisë, doktor, — i thashë. — A e dini kur ka ardhur *Kacorri* në Makondo?

Ai ia bëri jo me kokë.

— Rasti e desh që ai të vinte po atë ditë që erdhët edhe ju, — i thashë unë. — Dhe, ç'është më interesantja, po të kishit pasur një vëlla më të madh, jam i sigurt që ai do të ishte tamam si *Kacorri*. Fizikisht, vetëkuptohet.

Atëherë ai u duk sikur u krodh vetëm në këtë mendim. Në seriozitetin e tij, në vëmendjen e mprehur e të përqendruar, unë pikasa çastin e volitshëm për t'ia thënë atë çka kisha menduar.

— E pra, doktor, — i thashë, — shkoni një herë te *Kacorri* dhe do ta kuptoni se bota nuk është ashtu siç ju duket juve.

Ai u përgjigj që po, që kishte për të vajtur te *Kacorri*.

I ftohtë, i heshtur, por i palodhur, dryni prodhon ndryshk. Adelaida ia vuri atë dhomës kur mori vesh se doktori iku të banonte me Memenë. Këtë ikje ime shoqe e quajti si një fitore të sajën, si kurorëzimin e një pune të zellshme, këmbëngulëse, që ajo e pat filluar qysh atë çast kur unë vendosa që ai të banonte te ne. Edhe pas shtatëmbëdhjetë vjetësh, dryni vazhdon të ruajë dhomën.

Sikur në qëndrimin tim, të pandryshueshëm gjatë tetë vjetëve, të paskësh pasur ndonjë fije fyerjeje ndaj njerëzve apo ndonjë grimë mosmirënjohjeje ndaj zotit, ndëshkimi do të më kish rënë mbi krye shumë kohë para vdekjes. Po ndoshta mua më rënka të laj për së gjalli atë që e pata quajtur detyrë njerëzore... Se dryni s'kishte filluar të zinte ndryshk, kur në shtëpinë time ia behu Martini me një çantë mbushur me projekte, për të cilat s'e mora vesh kurrë në qenë a s'qenë të vërteta, dhe me mendjen të mbushur për t'u martuar me time bijë. Erdhi me një setër me katër kopsa, duke vrujuar rini e gjallëri prej të gjitha poreve, dhe i mbështjellë me një atmosferë të shndritshme simpatie. U martua me Isabelën në dhjetor, këtu e njëmbëdhjetë vjet të shkuar. Nëntë vjet kanë kaluar

qyshse iku me çantën plot me obligacione të firmosura prej meje dhe premtoi të kthehej me të mbaruar sanksionin që kish bërë mend e për të cilin më kish kërkuar ta ndihmoja me pasurinë time. Nëntë vjet kanë kaluar, po kjo s'do të thotë se kam të drejtë ta quaj batakçi e të mendoj se u martua me time bijë vetëm për të më hedhur hi syve e për të fituar besimin tim.

Mirëpo kjo përvojë tetëvjeçare do të shërbente për diçka. Martini kishte për të zënë dhomën e rrugës, po të mos kundërshtonte Adelaida. Dhe kësaj here kundërshtimi i saj qe i prerë, i vendosur e i patundshëm. Unë e dija që ime shoqe më mirë bënte dhomë nusërie stallën e kuajve, sesa t'u jepte të sapomartuarve dhomën e rrugës. Dhe ia dëgjova fjalën. Kjo qe mirënjohja ime për fitoren e saj me tetë vjet vonesë. Nëse më pas gabuam të dy, kur i zumë besë Martinit, gabimi ndahet më dysh. S'kish as fitore as disfatë për asnjërin nga ne të dy. Megjithëkëtë, ato çka do të ndodhnin më pas qenë përtej forcave tona, qenë si dukuritë atmosferike që paralajmërohen në buletin e që do të ndodhin se s'bën.

Kur i thashë Memesë se qe e lirë të largohej prej shtëpisë sonë e të ndiqte udhën që i dukej më e përshtatshme në jetë, e më pas, kur Adelaida m'i përplasi së fytyrë dobësitë e huqet e mia, unë mund të isha bërë burrë e ta kisha ngritur zërin (kështu kisha vepruar gjithmonë) për të thënë se në shtëpinë time do të bëhej si thosha unë. Por një zë i brendshëm më thoshte se qeshë i pafuqishëm para rrjedhës që po merrnin ngjarjet. Në shtëpinë time nuk vendosja më unë, por një forcë tjetër e mistershme që mbante timonin e jetës sonë dhe për të cilën ne s'qemë veçse ca vegla të bindura e pa ndonjë vlerë. Gjithë

g'ndodhte dukej sikur përmbushte, në mënyrë të natyrshme e hallkë pas hallke, një profeci.

Nga shpejtësia me të cilën e hapi Memeja dyqanin e verërave (fundja qe gjë që dihej, se një grua e shkathët, e cila prej mëngjesi në darkë i bën hyzmetet e shtratit një mjeku fshati, herët a vonë me një dyqan verërash do të përfundojë) mora vesh se ai kishte arritur të mblidhte gjatë kohës që jetonte në shtëpinë tonë shumë më tepër të holla nga ç'mund të mendohej, se i kish rrasur nëpër sirtarë, monedha letre a metalike, ashtu siç i pat marrë gjatë vizitave dhe nuk i kishte prekur asnjëherë.

Kur Memeja hapi dyqanin, njerëzit e përfytyronin se si ai rrinte i strukur këtu në kthinën e pasme, i trembur kushedi prej ç'kafshësh profetike të pamëshirshme. Njerëzit e dinin që ai s'vinte në gojë gjëra të blera në pazar dhe kish mbjellë zarzavate në oborr. Muajve të parë Memeja blinte nga një copë mish për vete, por pas një viti hoqi dorë prej këtij zakoni, ndoshta ngaqë të ndenjurit së toku me të shoqin e bëri edhe atë vegjetariane. Atëherë u mbyllën brenda të dy, deri kur autoritetet shkallmuan derën, bastisën shtëpinë dhe gërmuan kopshtin pëllëmbë për pëllëmbë për të gjetur kufomën e Memesë.

Njerëzit e përfytyronin se si rrinte ai këtu i mbyllur, duke u përkundur në hamakun e vjetër e të ngrënë. Por unë, edhe në ata muaj kur s'kishte më shpresë për kthimin e tij në botën e të gjallëve, e dija se ngujimi i tij kokëfortë, beteja e shurdhët me zotin, kishte për ta mbërritur kulmin e vet shumë më parë se t'i vinte vdekja. E dija që herët a vonë ai kishte për të dalë, se është e pamundur që një njeri, i cili e ka kaluar gjysmën e jetës i mbyllur e larg zotit, të mos dalë befas një ditë dhe, pa pikë zoritjeje, t'i zbra-

ze te parit njeri qe do te takojë rrëfimet që as zinxhirët e as dajaku, as tortura me zjarr e me ujë, as ajo në kryq, në rrotë e në zgarrë, as spicat dhe as hekuri i nxehtë në sy, as kripa e përjetshme në gjuhë, as kavaleti i mundimeve, as fshikullimet e as dashuria s'e kishin detyruar dot t'ua thoshte inkuizitorëve. Dhe kjo orë do të vinte për të pak para se të vdiste.

Unë e dija këtë të vërtetë qyshkur, qysh natën e fundit kur kuvenduam në rruginë, si dhe më pastaj, kur vajta ta kërkoja në dhomë që të vinte e të shihte Memenë. A mund të ngrihesha unë kundër dëshirës së tij për të jetuar me indiankën si burrë e grua? Ndoshta më parë edhe mund të isha ngritur. Por tani jo, mbasi ç'prej tre muajsh një kapitull i ri qe hapur në librin e fatit.

Atë natë ai nuk qe shtrirë në hamak, por kish rënë më shpinë në shtrat, me kryet hedhur pas, me sytë ngulur në vendin ku do të kish qenë tavani sikur drita e qiriut të ishte më e fortë. Kishte llambë elektrike në dhomë, por nuk e përdori një herë. I pëlqente të shtrihej në të mugët, me sytë ngulur në errësirë. S'lëvizi prej vendit kur unë hyra në dhomë, por vura re se, qyshse shkela në prag, ai filloi të mos e ndiente veten të vetëm. Atëherë i thashë: «Më falni që po ju bezdis, doktor. Por indianka sikur nuk e ndien veten mirë.» Ai u ngrit ndenjur në shtrat. Aty më parë nuk ndihej i vetëm në dhomë. Tani e dinte që kisha hyrë unë. Pa fjalë, që qenë dy ndjesi krejt të ndryshme, sepse u shpërfytyrua në çast, shtroi flokët me dorë dhe qëndroi i ulur buzë shtratit, duke pritur.

— Adelaida, doktor, do të deshte që ju ta shihnit njëherë Memenë, — i thashë.

Kurse ai, ashtu i ulur, me atë zërin e prajshëm prej ripërtypësi, ma ktheu prerë:

— S'është nevoja, kolonel. E ka nga barra.

Pastaj u përkul përpara, thua se po shqyrtonte fytyrën time, dhe shtoi:

— Ka vite që Memeja fle me mua.

Duhet ta pranoj se nuk u çudita kushedi çfarë. As e humba, as u turbullova e ăs u zemërova. S'ndjeva kurrgjë. Mbase ky pohim i tij që aq i rëndë, sa mendja ime nuk e nxinte dot brenda kufijve të vet. Vazhdoja të rrija në këmbë, i qetë, pa e prishur gjakun, po aq i ftohtë sa dhe ai, sa dhe zëri i tij i prajshëm prej ripërtypësi. Mandej, mbas një heshtjeje të gjatë, ndërkohë që ai priste ta thyeja unë akullin, e rroka në tërë kuptimin e saj atë çka sapo më kish thënë. Por atëherë qe tepër vonë për t'u zemëruar.

— Besoj se ju e kuptoni gjendjen, doktor, — vetëm kaq munda t'i thosha.

Ai ma ktheu:

— Sikush merr masat e veta, kolonel. Njeriu i bën llogaritë kur i futet një rreziku. Pastaj, po s'eci, kjo do të thotë se është bërë sebep diçka që njeriu s'e ka në dorë.

E njihja këtë të folur me të sjellur rrotull. Veçse, si ngaherë, nuk e dija ku do të dilte. Afrova një karrige dhe u ula ballë tij. Atëherë ai u ngrit nga krevati, shtrëngoi tokëzën e rripit dhe ngriti e rregulloi pantallonat. Që nga qoshja e dhomës vazhdoi të fliste. Tha:

— Dhe fakt që unë për vete i kam marrë masat është se ajo e ka për herë të dytë. Herën e parë, këtu e një vit e gjysmë, ju nuk morët vesh gjë.

Vazhdonte të fliste pa emocion, duke iu afruar përsëri krevatit. Në të errët unë ndieja hapat e tij të lehtë e të vendosur mbi pllloçat e dyshemesë. Thoshte:

— Porse atëherë ajo qe gati për të gjitha.

Tani jo. Para dy muajsh më tha se qe prapë me barrë dhe unë i thashë po ç'i pata thënë herën e parë: eja sonte të ta përgatis si atëherë. Sot jo, nesër, më tha ajo. Kur vajta të pija kafenë në kuzhinë, i thashë se po e prisja, por ajo më tha që nuk do të vinte fare.

Kishte arritur përpara krevatit, por nuk u ul. Më ktheu përsëri shpinën dhe filloi t'i binte edhe një herë dhomës qark. Unë e dëgjoja ndërsa ai fliste. Dëgjoja baticën dhe zbaticën e zërit të tij, sikur ai të më fliste duke u përkundur në hamak. Kish qetësi në zërin e tij, por edhe siguri. E dija që do të kish qenë e kotë të përpiqeshe ta ndërprisje. Unë e dëgjoja dhe s'bëja zë. Ai thoshte:

— Megjithatë, ajo erdhi pas dy ditësh. Unë i kisha bërë të gjitha gati. I thashë të ulej këtu dhe vajta te tryeza për të marrë gotën. Por, kur i thashë: pije, e kuptova menjëherë se kësaj radhe ajo nuk kish për ta pirë. Më vështroi serioze dhe tha me një fije ligësi në zë: «Këtë nuk do ta nxjerr, doktor. Këtë do ta pjell e do ta rris.»

Mua po më acaronte ajo qetësia e tij.

— Kjo nuk ju justifikon aspak, doktor, — i thashë. — Ju s'keni bërë veçse një veprim dyfish të dënueshëm: së pari lidhjen brenda shtëpisë sime, pastaj dështimin.

— Po ju e shihni që unë bëra çmos, kolonel. Më tepër s'kisha ç'bëja. Pastaj, kur e pashë që s'kishte zgjidhje tjetër, vendosa të flisja me ju. Ndonjë nga këto ditë do të flisja.

— Unë besoj se ju e dini që ka një zgjidhje për këso rastesh. Doemos, kur njeriu s'ka vendosur ta hajë turpin me bukë. Se ju i njihni rregullat e kësaj shtëpie, — i thashë.

— Unë nuk dua t'ju shkaktoj asnjëlloj shqetësimi, kolonel. Më besoni. Pikërisht këtë desha t'ju thosha: po e marr indiankën e po e shpie të banojmë në shtëpinë e qoshes, që është bosh.

— Kjo do të ishte bashkëjetesë publike pa kurorë, doktor, — thashë unë. — A e dini ç'do të thotë për ne një gjë e tillë?

Atëherë ai u kthye te krevati, u ul, u përkul përpara dhe foli me bërrylat të mbështetur mbi gjunjë. Toni i ndryshoi. Në fillim ai kish qenë i ftohtë. Tani po bëhej i egër e provokues. Tha:

— Unë po ju propozoj të vetmen zgjidhje që s'do t'ju hapte asnjë telash, kolonel. Përndryshe, do të thosha që fëmija s'është imi.

— Do ta thoshte Memeja që është juaji, — ia ktheva unë. Po fillonin të më hipnin kacabunjtë. Mënyra si fliste tani qe tepër provokuese dhe agresive, sa s'mund të rrija e ta mbaja vesh me qetësi.

Por ai vazhdoi i ashpër e i pamëshirshëm:

— Ta dini si buka që hani, kolonel, se Memeja s'kishte për ta thënë. Pikërisht ngaqë jam i sigurt për këtë, po ju them ta marr me vete në shtëpinë e qoshes, për t'ju shpëtuar juve prej telasheve. Kaq kisha unë, kolonel.

Me aq siguri ma tha që Memeja s'kish për t'i vënë gisht atij si at i fëmijës, saqë atëherë po, atëherë e humba fare. S'di përse më dukej që bindja e tij kishte rrënjë të thella, më të thella se fjalët. I thashë:

— Ne i besojmë Memesë si bijës sonë, doktor. Kështu që ajo krahun tonë ka për të mbajtur.

— Po t'i dinit ju ato që di unë, do të flisnit ndryshe, kolonel. Më falni që po jua them, por, po qe se e krahasoni indiankën me vajzën tuaj, ju fyeni vajzën.

— Ju s'keni asnjë fakt që të flisni kësisoj, — i thashë.

Ai u përgjigj me po atë ashpërsi të hidhur në zë:

— Kam që ç'ke me të. Edhe kur ju them se ajo nuk mund të më vërë gishtin si at i fëmijës, edhe për këtë kam fakte. — Hodhi kryet pas, mori frymë thellë dhe vazhdoi: — Sikur të kishit pasur kohë për ta përgjuar Memenë kur del natën, ju as që do të ma kërkonit ta merrja me vete. Në këtë rast jam unë ai që i hap zavalle kresë, kolonel. Marr mbi vete një të vdekur, për t'ju shpëtuar juve nga telashet.

Atëherë e pata të qartë se ai nuk kishte për ta shkelur pragun e kishës me Memenë. Por më e keqja është se, pas fjalëve të tij të fundit, unë s'mora guximin të hiqja dorë prej atij veprimi që më vonë do të më rëndonte tmerrësisht në ndërgjegje. Kisha karta të forta në dorë. E megjithatë, karta e tij e vetme do të më mjaftonte që unë të kisha vepruar ndryshe.

— Atëherë në rregull, doktor, — i thashë. — Qysh sonte do të kujdesem që t'ju gatisin shtëpinë e qoshes. Por, sidoqoftë, për një gjë nuk dua të kemi fjalë: ju do të ikni, se unë po ju përzë. Pra, jo me dëshirën tuaj. Kolonelit Aureliano Buendia do t'ia kishit paguar shtrenjtë këtë proçkë që bëtë duke shpërdoruar besimin e tij.

E kur unë mendoja se do ta kisha nxehur dhe prisja prej tij ndonjë shpërthim të furishëm, ai më dërrmoi me peshën e dinjitetit të vet.

— Ju jeni burrë i ndershëm, kolonel, — tha. — Këtë kush nuk e di. Dhe unë kam jetuar aq në shtëpinë tuaj, sa të mos jetë nevoja të ma kujtoni.

Kur u ngrit në këmbë, nuk kishte ndonjë pamje fitimtari. Madje ngjante si i kënaqur që paskësh mundur të na i shpërblente përkujdesjet tona të tetë vjetëve. Isha unë ai që e ndieja veten ngushtë, që e ndieja veten fajtor. Atë natë, tek shihja se si kishin mugulluar sythat e vdekjes në sytë e tij të ashpër e verdhashë, e kuptova se po sillesha si egoist dhe se do të më duhej të vuaja derisa t'i ngrysja ditët për të shlyer këtë të vetme njollë në ndërgjegjen time. Kurse ai, përkundrazi, e kishte shpirtin të qetë. Dhe tha:

— Sa për Memenë, le ta fërkojnë me alkool. Por të mos i japin purgë.

Gjyshi erdhi prapë afër mamasë. Ajo është ulur dhe s'e ka mendjen fare. Fustani dhe sombreroja janë këtu, në karrige, por mamaja s'është më brenda tyre. Gjyshi afrohet, e sheh që ajo s'e ka mendjen dhe i lëviz bastunin para syve, duke i thënë: «Ej, çupë, zgjohu.» Mamaja pulit qerpikët dhe shkund kokën. «Ku e ke mendjen?» i thotë gjyshi. Dhe ajo, duke buzëqeshur me zor, i përgjigjet: «Te *Kacorri*.»

Gjyshi i ulet afër, me mjekrën të mbështetur në bastun. «E sheh ti sa çudi, — i thotë. — Edhe unë tek ai e kisha.»

Dhe i kuptojnë këto fjalë. Flasin pa e parë njëri-tjetrin. Mamaja e ulur në karrige me trupin drejt, me krahët të kryqëzuar e duke i goditur ngadalë, kurse gjyshi i ulur afër saj, me mjekrën të mbështetur në bastun. Megjithatë, e kuptojnë njëri-tjetrin, ashtu siç kuptohemi unë me Abrahamin kur shkojmë për të parë Lukresian.

Unë i them Abrahamit. «Ikim nita». Abrahami ecën gjithmonë tre hapa përpara. «Tani jo, — thotë ai, pa kthyer kokën, — një çikë më vonë.» Kurse unë i them: «Më nëvo ka rëznje.» Abrahami nuk e kthen kokën, por unë e dëgjoj se si qesh me zë të ulët, me një dreq të qeshuri

si prej budallai, si drithërima e ujit që ka mbetur në buzët e buallit kur sapo ka mbaruar së piri. «Tani duhet të jetë afër pesës», thotë ai. Dhe pas pak vazhdon: «Po të shkojmë tani, mund të tëke rëznje.» Por unë ngul këmbë. «Herëpër tya ka rëznje.» Ai kthehet nga unë dhe ia shkel vrapit duke thënë: «Ikim, pra.»

Për të parë Lukresian duhet të kalosh pesë oborre me pemë e me hendeqe. Duhet të kalosh avllinë jeshile me hardhucka, ku më përpara këndonte xhuxhmaxhuxhi me zë gruaje. Abrahami kalon me vrap, duke shkëndritur si një thikë nën diellin e fortë, me të lehurat e qenit pas thembrave. Pastaj ndalon. Dhe jemi mu pranë dritares. Pëshpërisim: «Lukresia», duke e bërë zërin sikur Lukresia të ishte në gjumë. Por ajo është zgjuar, e ulur në krevat, pa këpucë, me një këmishë të gjerë, të bardhë e të kollarisur, që i zbret deri te nyejt e këmbëve.

Kur ne pëshpërisim, Lukresia ngre sytë, i vërtit nëpër dhomë dhe na i ngul ne, ashtu të mëdhenj e të rrumbullakët, si sy gate. Pastaj qesh dhe fillon të afrohet drejt mesit të dhomës. Në gojën e hapur i duken dhëmbët e shkurtër e të vegjël. Kokën e ka të rrumbullakët, me flokët të prerë si çun. Kur arrin në mes të dhomës, pushon së qeshuri, përkulet dhe shikon nga dera, derisa duart i arrijnë te nyejt dhe fillon të heqë këmishën me një ngadalësi të llogaritur, që të ha shpirtin e njëkohësisht të josh. Abrahami dhe unë shikojmë nga dritarja se si Lukresia zhvesh këmishën, me buzët të tendosura prej një buzëqeshjeje gjithë gulç e shqetësim, me sytë e mëdhenj si prej gate, të shndritshëm e të ngulur në një pikë. Atëherë ne i shohim barkun e bardhë, që më poshtë bëhet blu i errët, në kohën që ajo mbulon fytyrën me këmishë dhe rri ashtu e shtri-

rë në mes të dhomës, me këmbët puqur e shtrënguar me një forcë të dridhshme që i ngjitet prej thembrave. Pas një çike, zbulon fytyrën vrullitas, na tregon me gisht, me sytë e shndritshëm të ngufatur, dhe ngre në këmbë tërë shtëpinë me ca të angullitura të tmerrshme. Atëherë hapet dera dhe hyn gruaja duke bërtitur: «Pse s'shkoni t'i çani bythën nënës suaj.»

Ka disa ditë që s'kemi vajtur për të parë Lukresian. Tani shkojmë në lumë nga rruga e plantacioneve. Edhe sot, po mbaruam shpejt këtu, Abrahami do të jetë duke më pritur. Po gjyshi as që ka ndër mend të lëvizë. Është ulur afër mamasë, me mjekrën të mbështetur në bastun. Unë rri dhe e shikoj, duke i parë me kujdes sytë mbrapa xhamave dhe ai, siç duket, e ndien që unë e shikoj, se befas psherëtin fort, lëviz nga vendi dhe i thotë mamasë me zë të mekur e të pikëlluar: «*Kacorri* do t'i kishte sjellë me shqelma.»

Pastaj ngrihet nga karrigia dhe shkon drejt arkës.

Është e dyta herë që vij në këtë dhomë. Herën e parë, këtu e dhjetë vjet, gjithçka qe po kështu si tani. Thua se ai qysh atëherë s'ka prekur gjë me dorë, apo se qysh prej atij mëngjesi kur erdhi të jetonte këtu me Memenë, s'ka çarë më kokë për jetën e vet. Letrat janë po aty ku kanë qenë. Tryeza, ato plaçka të pakta e të zakonshme, të gjitha kanë qenë po aty ku janë tani. Thua se unë dhe *Kacorri* kemi ardhur dje për të bërë paqe midis këtij njeriu dhe autoriteteve.

Asokohe kompania e bananeve na kish shtrydhur sa na kish shtrydhur dhe qe degdisur prej Makondos bashkë me gjithë plehrat që kish sjellë me vete. Dhe tok me to kishin fluturuar edhe gjethurinat, gjurmët e fundit të asaj Makondoje të lulëzuar të 1915-s. Kishte mbetur një fshat shesh e lëndinë, me katër copë dyqane ku thyeje kokën prej errësirës e me ca banorë bjerrakohës e inatçorë, që e shkonin jetën duke vajtuar të shkuarën e begatë ose duke u pikëlluar për të tashmen mbytëse e të plogësht. Gjë prej gjëje s'pritej në të ardhmen, veç një të diele kërcënuese e të ngrysur zgjedhjesh.

Para gjashtë muajsh, mëngjesherë, një paskuin u ngjit te porta e kësaj shtëpie. S'ia vari askush dhe ai vazhdoi të qëndronte i ngjitur edhe për shumë kohë, deri kur shirat e fundit ia shpëlanë germat e errëta, kurse letrën e shkulën dhe e rrëmbyen erërat e fundit të shkurtit. Por në të dalë të 1918-s, kur me afrimin e zgjedhjeve qeveria u kujtua se duhej mbajtur gjallë e duhej cytur në njëfarë mënyre nervozizmi i zgjedhësve, dikush u shtiu në vesh autoriteteve të reja historinë e këtij mjeku vetmitar, për ekzistencën e të cilit kishte fakte të shumta. Me ç'duket, autoriteteve u treguan se vitet e para indianka që jetonte me të kishte patur një dyqan verërash, të cilit i eci mbarë si çdo dyqani në Makondon e atëhershme. Një ditë prej ditësh (askush nuk e mbante mend datën, as vitin) dera e dyqanit nuk u hap më. Fshati pandehu se Memeja dhe doktori vazhdonin të jetonin të mbyllur këtu brenda, duke u mbajtur me zarzavatet që rritnin vetë në kopsht. Por në paskuinin që qe ngjitur te porta thuhej se mejku e kish vrarë dashnoren dhe e kish varrosur në kopsht nga frika se mos fshati e helmonte me dorën e saj. I pashpjegueshëm në

këtë mes qe fakti se kjo thuhej në një kohë kur në fshat askush s'kishte pse t'ia donte të keqen doktorit. Autoritetet, më duket, kishin harruar fare që ai qe gjallë, gjer atij viti kur qeveria forcoi policinë e sigurimin me njerëz të besuar. Atëherë doli nga varri legjenda e paskuinit dhe autoritetet shkallmuan këto dyer, bastisën shtëpinë, gërmuan oborrin pëllëmbë për pëllëmbë dhe kontrolluan qenefin, duke kërkuar kufomën e Memesë. Por asaj s'iu gjend as nam as nishan.

Doemos që doktorin do ta kishin mbërthyer, do ta kishin fyer e poshtëruar dhe me siguri që do të kish përfunduar në sheshin publik si një viktimë e re e luftës për forcimin e pushtetit. Por *Kacorri* ndërhyri, erdhi tek unë e më tha të shkonim bashkë te doktori, i sigurt se faqe meje ai do ta shkoqiste në njëfarë mënyre këtë ngatërresë.

Kur hymë nga dera e pasme, gjetëm mbeturinat e një njeriu të plandosura në hamak. S'duhet të ketë, them, gjë më të tmerrshme në këtë botë sesa mbeturinat e një njeriu. Por edhe më të tmerrshme qenë ato të këtij jabanxhiu pa atdhe e pa njeri, që u ngrit përgjysmë në hamak kur na pa të hynim dhe dukej edhe vetë i mbuluar prej pluhurit që pat veshur çdo gjësend në dhomë. Koka i qe zbardhur, por sytë e ashpër e verdhashë e kishin përsëri atë fuqinë e brendshme të çuditshme që ia pata njohur në shtëpinë time. Pata përshtypjen sikur, po ta gërvishtnim pakëz me thua, trupi do t'i shkërmoqej e do t'i shndërrohej në një tokicë tallashi njerëzor. I kishte prerë mustaqet, por nuk rruhej me brisk, vetëm i priste qimet me gërshërë, kështu që mjekra, në vend të kreshtës së ashpër e të fortë, i qe katandisur në një push të butë e të bardhë. Kur e pashë në hamak, thashë me vete: «Tani s'duket si njeri,

por si një kufomë që vetëm sytë nuk i kanë vdekur.»

Foli po me atë zë të prajshëm prej ripërtypësi, me të cilin pat ardhur në shtëpinë tonë. Tha që nuk kish ç'të thoshte. Tha (sikur të mos e dinim) se policia i kish shkallmuar dyert dhe i kish rrëmihur kopshtin pa lejen e tij. Por kjo s'qe proteste, qe vetëm një rrëfim i përvajshëm e i zymtë.

Sa për Memenë, na dha një shpjegim që mund të dukej fëmijëror, por që ai e tha me po atë ton me të cilin thoshte të vërtetën. Tha se Memeja kishte ikur, dhe vetëm kaq. Kur mbylli dyqanin, filloi të mërzitej në shtëpi. Nuk fliste me njeri, nuk kishte asnjë lidhje me jashtë. Na tregoi se një ditë e kish parë tek bënte gati valixhen dhe nuk i kish thënë asgjë. Na tregoi se nuk i kish thënë asgjë edhe kur e kish parë te dera të veshur për rrugë, me takat e larta dhe valixhen në dorë, si të rrinte ashtu me kast, për t'i thënë që po ikte. «Atëherë, — tha ai, — unë u ngrita dhe i dhashë paratë që kishin mbetur në sirtar.»

— Sa kohë ka ky muhabet, doktor? — e pyeta unë.

— Llogariteni nga flokët e mi, — tha ai. — M'i priste ajo.

Kacorri foli shumë pak gjatë asaj vizite. Qyshse hyri në dhomë, me ç'dukej, ai u prek nga pamja e të vetmit njeri që s'pat njohur gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve që kishte në Makondo. Atëherë më ra në sy (edhe më shumë se më parë, ndoshta ngaqë doktori i kish prerë mustaqet) ngjashmëria e jashtëzakonshme midis atyre dy burrave. Jo se ngjanin si dy pika uji, siç thuhet, porse dukeshin si vëllezër, njëri prej të cilëve qe disa vjet më i madh, më i hollë e më i ligur. Kishin të përbashkëta tiparet, ashtu siç i kanë dy

vëllezër, ndonëse njëri mund t'i ngjajë babës e tjetri nënës. M'u kujtua atëherë ajo nata e fundit në rruginën e brendshme të shtëpisë. Dhe i thashë:

— Ky është *Kacorri*, doktor. Dikur më patët dhënë fjalën se do të shkonit ta takonit.

Ai buzëqeshi. Vështroi priftin dhe tha:

— Vërtet, kolonel. As vetë s'e di pse s'vajta.

Vazhdoi ta këqyrte nga koka te këmbët, derisa *Kacorri* tha:

— Kurrë nuk është vonë për një fillim të mbarë. Me gjithë qejf do të zija miqësi me ju.

Atë çast vura re me çudi se para jabanxhiut *Kacorri* e kishte humbur fuqinë e tij të zakonshme. Fliste me druajtje, pa atë sigurinë e papërkulshme me të cilën gjëmonte zëri i tij prej hijerores kur lexonte me tonin e lartë e kërcënues predikimet atmosferike të buletinit «Bristol».

Ajo që hera e parë që u panë. Dhe e fundit. Megjithatë, doktori jetoi deri sot në mëngjes, që *Kacorri* të ndërhynte edhe një herë për t'i dalë krah natën kur e lutën t'u vinte në ndihmë të plagosurve dhe ai as që e hapi portën, natën kur fshati i lëshoi mallkimin e tmerrshëm, përmbushjen e të cilit kam marrë përsipër ta ndaloj unë tani.

Po bëheshim gati të iknim, kur mua më ra ndër mend diçka për të cilën kisha vite që desha ta pyesja. I thashë *Kacorrit* se unë po rrija këtu me doktorin, ndërkohë që ai do të shkonte të fliste me autoritetet. Kur mbetëm vetëm, e pyeta:

— A s'më thoni, doktor, ç'u bë foshnja?

Atij nuk i ndryshoi aspak shprehja e fytyrës.

— Cila foshnjë, kolonel? — tha.

— E juaja, — ia ktheva unë. — Memeja ishte shtatzënë kur doli prej shtëpisë sime.

Ai u përgjigj i qetë e pa u turbulluar:

— Keni të drejtë, kolonel. E kisha harruar fare.

Im atë heshti një copë herë. Pastaj tha: «*Ka*corri do t'i kishte sjellë me shqelma.» Nga sytë im atë duket se ka një acarim që e përmban. Dhe gjatë gjithë kohës që zgjat kjo pritje (nja gjysmë ore, se duhet të jetë rreth treshit) mua më shqetëson hutimi i djalit, ajo shprehje e përhumbur që duket sikur s'pyet për kurrgjë, ajo mospërfillje abstrakte dhe e ftohtë, nga e cila i ngjan tamam të atit. Ka për t'u shkrirë edhe im bir nëpër ajrin e hamullt të kësaj të mërkure, sikurse u shkri Martini këtu e nëntë vjet të shkuar, ndërsa tundte dorën në dritaren e trenit dhe zhdukej përngaherë. Të kota kanë për të qenë të gjitha përpjekjet e mia për këtë djalë, po qe se ai do të vazhdojë t'i ngjajë të atit. Më kot kam për t'iu lutur zotit që ta bëjë njeri me mish e kocka, me vëllim, peshë e ngjyrë si gjithë njerëzit e tjerë. Të kota kanë për të qenë të gjitha, për sa kohë ai do të ketë në gjak mikrobin e të atit.

Para pesë vjetësh djali s'kishte asgjë prej Martinit. Tani po fillon t'i ngjajë gjithnjë e më shumë, qyshse Henoveva Garsia erdhi në Makondo me gjashtë fëmijët e saj, mes të cilëve kishte dy çifte binjakësh. Henoveva qe shëndoshur e qe plakur. Rreth syve i kishin dalë ca damarë të mavi, që i jepnin një pamje papastërtie fytyrës së saj dikur të pastër e të kthjellët. Dukej e lumtur, ashtu gjithë pohe e bujë, si klloçkë mes zogjve të saj me këpucë të bardha e lidhka

prej organxini. Unë e dija që Henoveva kishte ikur me drejtorin e një kompanie kukullash dhe sesi m'u pështiros tek shihja ata kalamaj të veckël e tmerrësisht të ngjashëm njëri me tjetrin, të gjashtë me këpucë të njëllojta e me lidhka të njëllojta nëpër rroba, madje me ca lëvizje automatike, si të drejtuara prej një qendre të vetme. Më pikte në shpirt ajo lumturi e bujshme e Henovevës, ardhja e saj ashtu qytetarçe në një fshat të shkatërruar, të mbuluar nga pluhuri. Kishte diçka të hidhur, diçka pangushëllueshmërisht qesharake në mënyrën se si lëvizte, se si dukej e lumtur dhe se si i vinte keq për këtë jetesën tonë që ndryshonte aq shumë, sikundër thoshte, nga jeta që pat bërë ajo me kompaninë e kukullave.

E shihja e më vinin ndër mend kohët e njëhershme. «Qenke bërë alamet femre», i thashë. Asaj sikur i ra pika. «Kujtimet, siç duket, të shëndoshkan», tha. Dhe ia nguli sytë djalit me kujdes. «Po ai shtrigani me katër kopsa ç'u bë?» pyeti. Unë iu përgjigja shkurt e thatë, se e dija që ajo e dinte: «Iku». Dhe Henoveva pyeti: «Vetëm këtë të la?» Unë i thashë që po, që vetëm djalin më kishte lënë. Henoveva ia dha një të qeshure të shqepur e vulgare: «Ngordhalaq i madh duhet të josh që për pesë vjet të bësh vetëm një fëmijë», tha dhe, duke vazhduar të lëvizte e të kakariste mes zogjve të saj të hapërdarë, shtoi: «Dhe unë që luaja mendsh për të. Për besë që do të ta kisha marrë, po të mos e kishim njohur në vëngjillën e një fëmije. Isha shumë bestyte në ato kohëra.»

Para se të ndaheshim, Henoveva e pa edhe një herë djalin me kujdes dhe tha: «Me të vërtetë që është i ati në vend. Vetëm setra me katër kopsa i mungon.» Dhe që atë çast mua djali filloi

të më dukej gjallë i ati, sikur Henoveva t'i paskësh bërë magjinë e të ngjarit. E kam kapur nganjëherë në befasi me bërrylat të mbështetur në tryezë, me kokën të anuar mbi supin e majtë dhe vështrimin të mjegullt e të hallakatur. Tamam si Martini kur mbështetej pas saksive me karafila të parmakëve dhe thoshte: «Edhe sikur të mos ishe ti, unë do të rrija të jetoja në Makondo për gjithë jetën.» Dhe nganjëherë mua më duket sikur edhe im bir mund ta thotë këtë nga çasti në çast, ashtu siç mund ta thotë edhe tani që është ulur pranë meje dhe hesht e prek hundën e skuqur nga vapa. «Të dhemb?» e pyes. Ai thotë që jo, që po mendonte se nuk do të mbante dot syze. «S'ke pse bëhesh merak për këtë», i them unë dhe i zgjidh fjongon e qafës. «Kur të kthehemi në shtëpi, — shtoj, — do të çlodhesh e do të bësh një banjë.» Mandej vështroj andej nga im atë thotë: «Kataure», duke iu drejtuar më plakut të indianëve. Ky është një burrë i shkurtër e shpatullgjerë, që ka ndenjur duke pirë duhan në krevat dhe, tek dëgjon emrin e tij, ngre kryet dhe kërkon fytyrën e tim eti me sytë e vegjël e të errët. Por, sapo im atë matet të flasë përsëri, nga kthina e pasme dëgjohen hapat e alkaldit që hyn brenda marrakëmbthi.

Dita e sotme qe e tmerrshme në shtëpinë tonë. Sido që për mua s'qe gjë e papritur lajmi i vdekjes së tij, mbasi e prisja prej kohësh, s'ma merrte mendja se ai mund të shkaktonte kaq trazira në shtëpi. Dikush duhet të vinte me mua në këtë varrim dhe unë pandehja se do të vinte ime shoqe, sidomos pas sëmundjes sime këtu e tre vjet të shkuar dhe pas asaj mbrëmjeje kur ajo, duke kontrolluar sirtarët e tryezës sime të punës, gjeti bastunkën me dorezë argjendi dhe balerinën me kurdisje. Në atë kohë besoj se e kishim harruar fare lodërzën. Por asaj mbrëmjeje e kurdisëm dhe balerina vallëzoi si njëherë e një kohë, me atë muzikën që dikur pat qenë e hareshme, por që pas heshtjes së gjatë në sirtar ngjante e mbytur e e zymtë. Adelaida e shihte tek vallëzonte dhe ndillte kujtimet. Mandej u kthye nga unë, me vështrimin të njomur prej një trishtimi të çiltër.

— Kë të kujton? — e pyeta unë.

E dija ç'mendonte Adelaida, ndërkohë që lodërza përhapte qark muzikën e trishtë.

— Si do t'i ketë vajtur filli? — pyeti ajo, e kredhur në mendime, ndoshta e prekur prej kujtimit fërgëllues të atyre kohëve kur ai përhihej

te dera e dhomës në orën gjashtë të mbrëmjes dhe varte llambën në qemer.

— Te qoshja është, — i thashë unë. — Mund të vdesë me sot me nesër dhe neve do të na duhet ta varrosim.

Adelaida heshti, e hutuar pas vallëzimit të lodërzës dhe sikur ma ngjiti edhe mua zymtinë e vet.

— Gjithmonë kam qenë kureshtar ta di, — i thashë, — se me kë e ngatërrove ditën që erdhi. Ti se për kë e more, që shtrove tryezën.

Adelaida m'u përgjigj me një buzëqeshje të hirtë:

— Ti do të më tallje, po ta thosha se për kë e mora, teksa rrinte këtu në cep të kabinetit me lodërzën në dorë, — dhe tregoi me gisht vendin e zbrazët, ku e kish parë para njëzet e katër vjetësh, me çizmet e gjata dhe kostumin që dukej si uniformë ushtarake.

Pandeha se asaj mbrëmjeje ata u pajtuan në kujtime, kështu që sot i thashë sime shoqeje të vishej në të zeza e të vinte edhe ajo me mua. Porse lodërza qe futur rishtas në sirtar, muzika e kishte humbur fuqinë e vet. Adelaida po heq e po vuan. «Vetëm ty mund të të shkrepte në kokë puna e varrimit, — më tha. — Sikur të mos na mjaftonin gjithë të zezat që na ranë mbi krye, na edhe ky vit i mallkuar visek». Tani vetëm përmbytjen kemi mangut.» U mundova ta bindja, duke i thënë se kisha dhënë fjalën për këtë punë.

— Fundja, mos harro se më ka shpëtuar jetën, — i thashë.

Kurse ajo ma ktheu:

— Ia kemi shpëtuar ne atij. Kur të shpëtoi ty jetën, vetëm sa pagoi borxhin e tetë vjetëve strehë, të ngrëna, të pira e të lara.

Pastaj afroi një karrige te parmakët. Dhe ako-

ma aty duhet të jetë, me sytë të mjegulluar prej frikës e bestytnisë. Aq e pamundur m'u duk ta bindja, saqë u përpoqa ta qetësoja. «Mirë, pra, si të duash. Atëherë po shkoj me Isabelën», i thashë. Ajo nuk u përgjigj. Vazhdoi të rrinte e ulur, krejt e përhumbur në mendimet e saj, deri kur po mateshim të dilnim dhe unë i thashë, duke pandehur se asaj do t'i pëlqente: «Sa të kthehemi, ti shko e lutu për ne.» Atëherë ajo ktheu kokën nga dera dhe tha: «As që kam ndër mend. Për sa kohë ajo grua vjen të martave për të kërkuar degëzën e melisës, lutjet e mia s'pinë ujë.» Dhe kish një hakërrim të zymtë e ndjellalig në zërin e saj, kur tha:

— Unë do të rri këtu e s'kam për të lëvizur, gjer ditën e Gjyqit të Tmerrshëm. Veç në mos ma paçin ngrënë karrigen thneglat gjer atëherë.

Duke dëgjur hapat e njohur që vijnë nga kthina e pasme, im atë ndalet dhe zgjat qafën. Harron ç'deshte t'i thoshte Kataures dhe bën një përpjekje për t'u kthyer mbrapsht, i mbështetur pas bastunit, por këmba e keqe i del huq dhe mend bie me turinj, si këtu e tre vjet të shkuar, kur ra në pellgun me limonadë përmes zhurmës së kanës që rrokullisej përtokë, kërcitjes së nallaneve, karriges përkundëse dhe të qarës së fëmijës që ishte i vetmi që e pa tek binte.

Qysh atëherë ai çalon, qysh atëherë e heq zvarrë këmbën që iu zu pas asaj jave vuajtjesh të lemerishme, prej të cilave ne thamë se s'kish për të shpëtuar kurrë. Tani, tek e shoh se si mban drejtpeshimin duke u mbështetur pas al-

kaldit, më duket sikur pikërisht tek ajo këmbë e keqe ndodhet e fshehta e zotimit që ai po gatitet ta përmbushë në kundërshtim me vullnetin e fshatit.

Mbase në atë kohë e ka burimin mirënjohja e tij, qyshse ra me turinj në rruginën e brendshme të shtëpisë dhe tha se e ndiente veten sikur ta paskëshin hedhur nga maja e një kulle, ndërsa dy mjekët e fundit që patën mbetur në Makondo ia hoqën fillin dhe e këshilluan të përgatitej për në botën tjetër. E sjell ndër mend ditën e pestë të sfilitjes, sjell ndër mend trupin e tij të mpakur e të bërë grusht midis çarçafëve, të katandisur si trupi i *Kacorrit* që një vit më parë e kishin shpënë në varreza gjithë banorët e Makondos, me një vargan lulesh, të përlotur e me radhë të shtrënguara. Madhështia e tij brenda arkivolit të shkaktonte po atë ndjenjë braktisjeje të pangushëllueshme e të paprapsueshme që më ngjallte edhe fytyra e tim eti ato ditë kur dhoma e gjumit u mbush me zërin e tij, tek fliste për atë ushtarakun e çuditshëm që në luftën e tetëdhjetepesës qe shfaqur një natë në kampin e kolonel Aureliano Buendias, me sombrero e çizme të stolisura me lëkurë, dhëmbë e thonj tigri, dhe e kishin pyetur: «Kush jeni ju?» Kurse ushtaraku i çuditshëm nuk qe përgjigjur. Dhe ata prapë e kishin pyetur: «Prej nga vini?» Dhe ai prapë nuk qe përgjigjur. Dhe ata prapë e kishin pyetur: «Me kë jeni?» Dhe përsëri nuk kishin marrë kurrfarë përgjigjeje nga ushtaraku i panjohur, deri kur ordinanca kish kapur një urë zjarri, ia kish afruar në fytyrë, e kish shqyrtuar për një çast e pastaj kish thirrur i tronditur: «Punë muti! Ky qenka duka Malboro!»

Mes atij jermi të tmershëm, mjekët dhanë urdhër që t'i bënim një banjë. Dhe ne ia bëmë.

Por të nesërmen iu vu re vetëm një keqësim i mezidallueshëm në bark. Atëherë mjekët ia hoqën fillin, ikën dhe thanë se e vetmja gjë që mund të bënim ishte që ta përgatisnim për në atë botë.

Në dhomën e gjumit ra një heshtje, mes së cilës ndihej vetëm flatrimi i lehtë e i qetë i vdekjes, ai flatrim tinzar që nëpër dhomat e të sëmurëve në hjekë e sipër mban erë njeriu. Pasi at Anheli e vojoi për të fundit herë, kaluan orë të tëra e askush s'lëvizte, të gjithë rrinim e kundronim profilin qoshak të fillhequrit. Pastaj ra sahati i murit dhe ime njerkë u bë gati t'i jepte ilaçin. E ngritëm nga koka, duke u përpjekur t'i hapnim dhëmbët që njerka të fuste lugën. Pikërisht atë çast u dëgjuan hapat e ngadaltë e të vendosur në rruginën e brendshme. Ime njerkë ngriu me lugë në ajër e me uratë në buzë dhe u kthye nga dera, si e paralizuar prej një hirnosjeje të beftë. «Edhe në varr kisha për t'i njohur këta hapa», mundi të thoshte ajo, tamam në çastin kur ne kishim kthyer sytë nga dera dhe pamë doktorin. Ai po rrinte te pragu e po na vështronte.

«*Kacorri* kishte për t'i sjellë me shkelma», i them sime bije dhe shkoj drejt qivurit.

Dhe në kohë e sipër që i afrohem qivurit, tek shoh indianët e mi gjakftohtë, më duket sikur, me një të marrur frymë prej ajrit që zien mbi të vdekurin, kam thithur tërë atë fatalitet të hidhur që e bëri Makondon shesh e lëndinë. Them se alkaldi s'ka për të vonuar me lejen e

varrimit. E di që ka gra që kanë dalë nëpër dritare e mezi presin të shohin këtë shfaqje, që rri-në aty e bëjnë sehir duke harruar fare që nëpër zjarre po u ciknoset qumështi e po u digjet pilafi. Por e di gjithashtu se kjo përpjekje e fundit rebelimi del jashtë fuqive të këtij grushti njerëzish të shtypur e të shtrydhur. Ata s'kanë më pikë fuqie për të luftuar, qysh prej asaj të diele zgjedhjesh kur ngritën krye, kur kurdisën planet, u shtypën keqas dhe mbetën me bindjen se qenë vetë përgjegjës për veprimet e tyre. Por këto të gjitha dukej sikur qenë përgatitur paraprakisht për t'u lënë udhë ngjarjeve që dalngadalë, por në mënyrë të pashmangshme, do të shpinin te kjo e mërkurë.

Këtu e dhjetë vjet, kur filloi rrënimi, përpjekja e përbashkët e gjithë atyreve që deshin të rimëkëmbeshin do të kish mjaftuar për ta rindërtuar Makondon. Mjaft të kishin dalë nëpër fushat e braktisura prej kompanisë së bananeve, t'i pastronin nga barërat e këqia e t'i futeshin punës edhe një herë nga fillimi. Por gjethurinat qenë mësuar të mos kishin durim, të mos kishin besim as në të shkuarën, as në të ardhmen. Ato qenë mësuar të jetonin vetëm me të tashmen e të shuanin në të nepsin e tyre të babëzitur. Pak kohë u desh që ne ta kuptonim se gjethurinat patën ikur e se pa to qe i pamundur rindërtimi. Gjithçka e patën sjellë gjethurinat dhe gjithçka po ato e patën marrë me vete. Kishin mbetur pas tyre vetëm ajo e diel mes rrënojave të një fshati dikur të lulëzuar dhe ai ngatërrestari i përjetshëm i zgjedhjeve që natën e fundit të Makondos pat vënë në sheshin publik katër damixhana me raki për policinë dhe sigurimin.

Kur asaj nate *Kacorri* ia pat dalë t'i për-

mbante, ndonëse rebelimi pat marrë gjithë atë yrysh, sot ai kish për t'u shkuar shtëpi më shtëpi, me kamxhik në dorë, dhe kish për t'i nxjerrë me shkelma për të varrosur këtë njeri. *Kacorri* ua kish mbledhur e s'i linte të bënin as gëk as mëk. Edhe pas vdekjes së tij, këtu e katër vjet të shkuar (një vit para sëmundjes sime), u duk edhe një herë fuqia e tij, kur gjithë fshati shkuli lulet nga kopshtet dhe ia shpuri te varri *Kacorrit* për t'i bërë nderet e fundit.

Ky njeri këtu qe i vetmi që nuk i vajti në varrim. Pikërisht ky njeri, të cilit nënshtrimi i bindur i fshatit ndaj priftit i kishte shpëtuar kokën. Sepse natën kur vunë te sheshi katër damixhanat me raki dhe Makondoja u bë pré e një zhgani barbarësh të armatosur, një fshat i lemerisur që i kallte të vdekurit në gropën e përbashkët, duket që dikujt i ra ndër mend që te kjo qoshe kishte një mjek. Atëherë ia prunë tezgat te porta dhe i thirrën (sepse ai nuk e hapi, foli nga brenda) dhe i thirrën: «Doktor, bëni diçka për këta të plagosur, se mjekët e tjerë janë mbushur plot», dhe ndërkohë që porta nuk hapej (para saj qenë shtrirë të plagosurit): «Ju jeni i vetmi mjek ku mund të përplasim kokën. Vini dorën në zemër», ai u përgjigj (as atëherë nuk e hapi portën) duke qëndruar, siç e pat përfytyruar gjindja, në mes të dhomës, teksa mbante lart llambën që i ndriçonte sytë e ashpër e verdhashë: «Unë s'marr vesh më nga zanati. Shpjerini gjetiu», dhe vazhdonte ta mbante të mbyllur portën (që qysh atëherë nuk u hap kurrë më), ndërkohë që para saj hiqnin shpirt burra e gra të Makondos. Turma asaj nate qe tërbuar fare. Po matej t'i kallte zjarrin shtëpisë e ta bënte shkrumb e hi doktorin. Porse atëherë u fanit *Kacorri*. Dhe thonë se u fanit aq papritmas, sikur të paskësh

qenë këtu, i fshehur e duke bërë rojë për të shpëtuar shtëpinë dhe doktorin. «Të mos e prekë kush këtë portë», thonë se paska thënë *Kacorri*. Dhe thonë se vetëm kaq paska thënë, me krahët të hapur kryq, ndërkohë që flakërimi i tërbimit popullor i ndriçonte fytyrën e pashprehje e të ftohtë, si kafkë lope. Atëherë vrulli u ndal, ndërroi drejtim, por pati ende fuqi sa për t'i lëshuar atë mallkim që do të siguronte, në jetë të jetëve, ardhjen e kësaj të mërkure.

Duke u çapitur drejt krevatit për t'u thënë indianëve të hapin portën, them me vete: «Nga çasti në çast duhet të vijë.» Dhe mendoj se, po nuk erdhi brenda pesë minutash, kemi për ta marrë qivurin pa autorizim dhe do ta nxjerrim të vdekurin në rrugë, sikur ta dimë se do ta varrosim qoftë edhe te pragu i shtëpisë. «Kataure», them duke iu drejtuar më plakut të indianëve dhe ai sapo pati kohë të ngrinte kokën, kur unë dëgjoj hapat e alkaldit që vjen nga kthina e pasme.

E di që po vjen drejt e tek unë dhe bëj të kthehem me të shpejtë, duke u mbështetur pas bastunit, por këmba e sëmurë më shkon huq dhe iki përpara dhe e kuptoj se po bie e po thyej turinjtë pas buzës së qivurit, kur ndesh në krahun e alkaldit dhe mbahem fort pas tij, ndërkohë që dëgjoj zërin prej torollaku që më thotë: «Mos u bëni merak, kolonel. Ju siguroj se s'ka për të ndodhur asgjë.» Unë e di që kjo është e vërtetë, por e di edhe që ai e thotë për t'u mburrur. «Doemos që s'ka se ç'të ndodhë», ia kthej unë duke menduar të kundërtën, kurse ai seç dërdëllit për *seibat*[1]) e varrezave dhe më jep autori-

1 *Seibë* — pemë tropikale, me gjethe si palmë dhe lule të mëdha kuq e bardhë.

zimin. Pa e lexuar, unë e palos, e fus në xhepin e jelekut dhe i them: «Sidoqoftë, ç'kish për t'u bërë, u bë. Sikur të kish qenë e shkruar në buletin.»

Alkaldi kthehet nga indianët. U jep urdhër të mbërthejnë qivurin dhe të hapin portën. Dhe unë shoh se si ata lëvizin duke kërkuar çekiçin dhe gozhdët që do të na e zhdukin përgjithmonë prej syve pamjen e këtij njeriu, të këtij jabanxhiu të pastrehë, që kurrë s'e morëm vesh prej nga vinte dhe që e pashë për të fundit herë këtu e tre vjet të shkuar, përpara shtratit ku po lëngoja, me kokën dhe fytyrën të drobitur e të rrëgjuar para kohe. Ai sapo më kish shkëputur nga thonjtë e vdekjes. Dukej sikur ajo forcë që e pat sjellë aty, duke i dhënë lajmin e sëmundjes sime, e mbante më këmbë para shtratit tim të lëngatës teksa më thoshte:

— Vetëm se do t'ju duhet ta ushtroni pak këmbën, kolonel. Mbase do t'ju duhet të mbani bastun qysh sot e tutje.

Pas dy ditësh unë e pyeta se sa i detyrohesha dhe ai m'u përgjigj: «S'më detyroheni asgjë, kolonel. Por, po deshët të më bëni një nder, hidhmëni një grusht dhé përsipër, kur të më ketë ardhur fundi. Vetëm kjo më duhet, që të mos më hanë zhgabat.»

Në vetë zotimin që po lypte prej meje, në mënyrën se si fliste, në ngadalësinë me të cilën i hidhte hapat mbi plloçat e dyshemesë, dukej qartas se ai njeri kish filluar të vdiste ç'prej shumë kohësh, ndonëse do të duhej të kalonin edhe tre vjet derisa ajo vdekje e shtyrë dhe e pjesshme të vinte plotësisht. Dhe ajo erdhi sot. Madje mua më duket se as që qe nevoja për litarin. Një e fryrë e lehtë do të mjaftonte për ta fikur edhe shkëndijëzën e fundit të jetës që pat mbetur në

sytë e tij të ashpër e verdhashë. Të gjitha këto unë i kisha parashikuar qysh prej natës kur bisedova me të në dhomën e rrugës, para se të vinte për të banuar këtu me Memenë. Kështu që, kur më lypi zotimin që unë tani do ta përmbush, nuk u çudita asfare, vetëm se i thashë:

— As që qe nevoja të më luteshit, doktor. Ju më njihni dhe e dini që unë kisha për t'ju varrosur, pa çarë kryet për botën, edhe sikur të mos më kishit shpëtuar jetën.

Ai buzëqeshi dhe sytë e tij të ashpër e verdhashë u zbutën për të parën herë:

— Këtë e dija, kolonel. Por mos harroni se një i vdekur nuk do të më varroste dot.

Tani askush nuk e lan dot më këtë turp. Alkaldi i dha babait lejen e varrimit dhe babai i tha: «Sidoqoftë, ç'kish për t'u bërë, u bë. Sikur të kish qenë e shkruar në buletin.» Dhe e tha këtë me të njëjtën shpërfillje me të cilën iu nënshtrua fatit të Makondos, i lidhur pas bauleve të tij ku ruhen plaçkat e gjithë sojesorollopit që ka vdekur para se të lindja unë. Qysh atëherë gjithçka shkoi keq e tukeq. Madje edhe vrulli e gjallëria e sime njerke, karakteri i saj i hekurt e i papërkulshëm, u shndërruan në një brengë të hidhur. Ajo duket gjithnjë më e largët, më e nemitur, dhe aq i është mërzitur jeta, saqë sot u ul pranë parmakëve dhe tha: «Do të rri këtu e s'kam për të lëvizur gjer ditën e Gjyqit të Tmerrshëm.»

Im atë kish hequr dorë prej kohësh nga të

urdhëruarit. Vetëm sot ai u ngrit për të përmbushur këtë zotim të turpshëm, i sigurt se s'ka për të ndodhur asgjë e jashtëzakonshme. Indianët u vunë në lëvizje për të hapur portën dhe për të mbërthyer arkivolin. Unë i shoh tek afrohen, ngrihem në këmbë, marr djalin për dore dhe afroj karrigen te dritarja që të mos shihem prej fshatit kur të hapet porta.

Djali e ka humbur fare. Kur u ngrita, m'i nguli sytë në fytyrë me një shprehje të papërshkrueshme, si prej hutaqi. Por tani e ka humbur fare, këtu ngjat meje, tek sheh indianët që u bënë ujë në djersë duke u përpjekur të rrotullojnë portën nëpër çivitë. Më në fund porta hapet kanat, me një vajtim çjerrës e të mekët. Atëherë shoh anën tjetër të rrugës, pluhurin vezullues, të bardhë e zhuritës, që mbulon shtëpitë dhe që e ka bërë fshatin të duket si një orendi e mjerë e shkatarraqe. Thua se zoti e ka shpallur të panevojshme Makondon dhe e ka flakur në qoshen e fshatrave që s'hyjnë më në punë.

Djali, të cilit në çastin e parë duket se i mori sytë ndriçimi i beftë (dora e tij u drodh në timen kur u hap porta), pas një çike ngre kokën e pyet gjithë vëmendje e përqendrim: «Dëgjon?» Vetëm atëherë unë i bie në të se në një nga oborret fqinje një gatë po këndon sipas orës së saktë. «Ehë, duhet të jetë ora tre», them në të njëjtin çast kur kumbon e goditura e parë e çekiçit sipër gozhdës.

Duke u përpjekur të mos e dëgjoj atë kumbim që më gërryen shpirtin e më shtie të ngjethurat, duke u munduar që djali të mos e vërë re turbullimin tim, kthej fytyrën nga dritarja dhe në peizazhin kundruall shoh bajamet e zymta e të pluhurosura me shtëpinë tonë përfund. E tronditur prej një fërtyme të padukshme, edhe asaj

po i kanoset rrënimi i heshtur e përfundimtar. Të gjithë Makondos po i kanoset rrënimi, qyshse e shtrydhi kompania e bananeve. Shtëpitë po i pushton dredhëza, rrugët po mbushen me ferra, muret po roniten e po çahen dhe në dhomën e gjumit mund të gjesh një zhapik në mes të ditës. Gjithçka duket sikur e mori lumi, qyshse i braktisëm rozmarinin dhe lulelandrën, qyshse një dorë e padukshme theu servisin prej fajance të Krishtlindjeve në bufe dhe i mbushi me mola rrobat që askush s'i përdor më. Dyert u shkatërruan dhe s'ka kush t'i ndreqë. Im atë s'kà më takat të lëvizë, siç lëvizte para lëngatës që e la të çalë përngaherë. Senjora Rebeka, mbrapa ventilatorit të saj të përjetshëm, s'bën asnjë përpjekje për të shpëtuar prej asaj etjes për të bërë keq që ia shkakton vejania e shterpët dhe torturuese. Âgeda është zënë uloke, e ka sfilitur një sëmundje e ngadaltë religjioze, kurse at Anheli duket se e ka mendjen vetëm te kënaqësia që i shkaktojnë gjatë gjumit të zhegut qoftet me salcë që s'ia tret stomaku. Të vetmet gjëra që s'ndryshojnë janë binjakët e Shën Heronimit me këngën e tyre dhe ajo lypsarja e mistershme që duket sikur s'ka të plakur dhe qysh prej njëzet vjetësh vjen në shtëpi të martë për të martë për të kërkuar një degë melise. Vetëm fërshëllima e një treni të verdhë e të pluhurosur, që nuk sjell askënd, prish heshtjen katër herë ditës, kurse natës tum-tumi i centralit të vogël elektrik që e la kompania e bananeve kur iku prej Makondos.

Shikoj shtëpinë nga dritarja dhe përfytyroj se si njerka po rri atje në karrigen e saj, pa lëvizur, duke menduar se ndoshta, sa pa u kthyer ne, do të fryjë era e fundit që ka për ta fshirë këtë fshat nga faqja e dheut. Atëherë të gjithë kanë për t'u zhdukur, përveç nesh, se ne na lidh

me këtë tokë një dhomë e tërë me baule, ku ruhen ende enët dhe plaçkat e gjyshstërgjyshërve, bashkë me kunupjerat që përdornin kuajt e prindërve të mi kur erdhën në Makondo për të shpëtuar prej tallandive të luftës. Na lidh kujtimi i të vdekurve të qëkurshëm, të cilëve s'u gjenden më kockat as njëzet pashë nën dhé. Baulet janë në dhomë qysh ditët e para të luftës dhe aty kanë për të qenë edhe sot mbasdite, kur të kthehemi ne nga varrimi, po qe se s'do të ketë frýrë ajo era e fundit që ka për ta fshirë nga faqja e dheut Makondon, me dhomat plot zhapikë dhe njerëzit e nemitur e të shkalafitur prej kujtimeve.

Befas gjyshi ngrihet, mbështetet në bastun dhe zgjat kokën e tij si prej zogu, ku syzet rrinë aq mirë, si të ishin pjesë e fytyrës. Mua për vete më duket se s'do të mbaja dot syze. Sa herë të lëvizja kokën, bishtat do të më dilnin nga veshët. Dhe, duke menduar këtë, fërkoj hundën. Mamaja më sheh dhe më pyet: «Të dhemb?» Unë i them që jo, që vetëm po mendoj se s'do të mbaja dot syze. Ajo buzëqesh, merr frymë thellë dhe më thotë: «Duhet të jesh bërë ujë në djersë.» Dhe vërtet, kostumi i mbyllur gjer në fyt më djeg lëkurën, kadifeja e trashë jeshile më ngjitet në trupin e djersitur e më tërbon fare. «Ehë», i them. Dhe mamaja përkulet nga unë, më zgjidh fjongon dhe më bën fresk në qafë duke më thënë: «Kur të kthehemi në shtëpi, do të çlodhesh e do të bësh një banjë.» «Kataure», dëgjoj...

Në këtë mes nga dera e pasme duket përsëri burri me pisqollë. Sa hyn te dera, heq sombreron dhe ecën me kujdes, sikur të ketë frikë se mos zgjojë kufomën. Por këtë e bën për të trembur gjyshin, që pengohet nga prekja e tij, i ngatërrohen këmbët dhe mezi arrin të mbahet pas krahut të atij që deshi ta rrëzonte. Të tjerët nuk pinë më duhan dhe rrinë të ulur në krevat me radhë, si katër korba në majë të pullazit. Kur hyn ai me pisqollë, korbat përkulen dhe çuçuritin tinës. Pastaj njëri prej tyre ngrihet, shkon te tryeza dhe merr kutinë me gozhdë e çekiçin.

Gjyshi po bisedon me burrin pranë arkës. Burri thotë: «Mos u bëni merak, kolonel. Ju siguroj se s'ka për të ndodhur asgjë.» Kurse gjyshi thotë: «Doemos që s'ka se ç'të ndodhë.» Burri thotë pastaj: «Mund ta varrosni nga ana e jashtme, pas murit të majtë të varrezave, ku *seibat* janë më të larta.» Pastaj i jep gjyshit një letër, duke thënë: «Keni për ta parë se gjithçka do të vejë si jo më mirë.» Gjyshi mbështetet në bastun me një dorë, merr letrën me tjetrën dhe e fut në xhepin e jelekut, ku mban orën e vogël katrore prej floriri me qostek. Pastaj thotë: «Sidoqoftë, ç'kish për t'u bërë, u bë. Sikur të kish qenë e shkruar në buletin».

Burri i thotë: «Ka disa njerëz nëpër dritare, por e kanë nga kureshtja. Gratë s'rrinë dot pa nxjerrë kokën në dritare orë e çast». Po mua më duket se gjyshi nuk e dëgjoi, mbasi po shikonte rrugën nga dritarja. Burri atëherë lëviz nga vendi, shkon te krevati dhe, në kohë e sipër që bën fresk me sombrero, u thotë indianëve: «Mund ta mbërtheni. Dhe hapeni portën të na hyjë një çikë fresk.»

Burrat i vihen punës. Njëri prej tyre përkulet mbi arkë me çekiçin e me gozhdët, kurse të tje-

rët shkojnë te porta. Mamaja ngrihet. Është zverdhur dhe është bërë ujë në djersë. Shtyn karrigen, më kap për dore dhe më heq mënjanë për t'u bërë udhë burrave që vijnë për të hapur portën.

Në fillim ata mundohen ta rrotullojnë fletën e portës që duket si e bërë njësh me unazat e ndryshkura, por nuk e lëvizin dot. Duket sikur e mban dikush me forcë nga ana e jashtme. Por, kur njëri prej burrave mbështetet pas portës dhe i jep një të shtyrë, në dhomë ndihet një gërvimë menteshash të ndryshkura, llozesh të ngjitura nga koha dhe, me një kërkëllimë dërrasash e hekurash të zgjuar nga gjumi, porta hapet kanat, sa për të kaluar dy burra bashkë njëri mbi tjetrin. Dhe ne s'kemi kohë të marrim vesh se ç'po ndodh, kur në dhomë vërshon drita e fuqishme e verbuese: i kanë hequr pengesën që e mbante për dyqind vjet rresht me një forcë prej dyqind buajsh dhe ajo rrëzohet mbrapsht, duke tërhequr pas vetes në atë rënie të rrëmujshme hijet e sendeve. Tani indianët janë bërë plotësisht të dukshëm, si prej një vetëtime në mes të ditës. Atyre u merren këmbët dhe mua më duket se u duhet të mbahen pas njëri-tjetrit, që drita të mos i palosë përtokë.

Kur hapet porta, ia kris këngës një gatë diku në fshat. Unë tani shikoj nga rruga. Shoh pluhurin e hamullt e vezullues. Shoh disa burra të mbështetur te muri i shtëpisë përballë, me krahët kryq, duke vështruar nga ne. Dëgjoj prapë gatën dhe i them mamasë: «E dëgjon?» Dhe ajo thotë që po, që duhet të jetë ora tre. Kurse Ada më ka thënë se gatat këndojnë kur ndiejnë erë të vdekuri. Sapo dua t'ia them mamasë, kur dëgjoj goditjen e fortë të çekiçit mbi kokën e gozhdës së parë. Çekiçi godet e godet, derisa e fut

të gjithën. Pushon një çast, pastaj godet përsëri. Gjashtë plagë u hap ai njërën pas tjetrës dërrasave të përgjumura, duke i bërë të rënkojnë nga dhembja, ndërkohë që mamaja, me kokën të kthyer matanë, vështron rrugën nga dritarja.

Kur burrat mbarojnë së mbërthyeri, dëgjohet kënga e disa gatave së bashku. Gjyshi ua bën me shenjë idinanëve. Ata përkulen, e ngrenë arkën me ngadalë, kurse burri me sombrero, që rri te qoshja, i thotë gjyshit: «Mos u bëni merak, kolonel.» Atëherë gjyshi kthehet nga qoshja, i nxehur e me qafën e fryrë ngjyrëmanushaqe si të një gjeli luftarak, por nuk i thotë asgjë. Përkundrazi, flet përsëri ai burri i qoshes. Thotë: «Bile unë them se askujt në fshat s'i bie më ndër mend për këtë.»

Atë çast ndiej me të vërtetë një të prerë në bark. Tani po, tani kam qejf të iki, them me vete. Por e kuptoj që është tepër vonë. Burrat bëjnë edhe një sforcim të fundit, çapiten me zor me takat e këpucëve si të mbërthyera në dysheme dhe arka për një çast noton nëpër dritë, sikur të shpikëshin për të varrosur një anije të vdekur.

Kurse unë them me vete: «Tani gatat do ta ndiejnë erën. Dhe të gjitha së bashku do t'ia marrin këngës.»

NJË HISTORI ME PASKUINË

At Anheli u ngrit me një sforcim plot madhështi. Fërkoi qepallat me eshtrat e duarve, largoi kunupierën e punuar me grep dhe ndenji shesh në të shtruarat e rrjepura, duke u menduar një grimë herë, aq sa ç'i duhej për t'u siguruar se qe gjallë dhe për të sjellë ndër mend ç'datë ishte dhe ç'shenjt i binte. «E martë katër tetor», mendoi dhe tha me zë të ulët: «Shën Francisku i Asisit».

U vesh pa u larë e pa thënë uratat. Qe shtatmadh, me fytyrë të kuqe e të urtë prej bualli të zbutur dhe lëvizte po si një buall, me gjeste të ngathta, të mundimshme. Si shkopsiti e kopsiti për së mbari veladonin me një përkujdesje të molisur gishtërinjsh si vajtjeardhje mbi telat e një harpe, hoqi llozin dhe hapi derën e oborrit. Lulelandrat nën shi i sollën ndër mend fjalët e një kënge:

— Me lott' e mi ka për t'u mbushur deti, — psherëtiu ai.

Dhoma e gjumit punonte me kishën përmjet një rrugine të brendshme me saksi lulesh përanash dhe të shtruar me pllloça të çrregullta, në arallëqet mes të cilave kishin nisur të mugullonin barërat e tetorit. Para se të kalonte në kishë, at Anheli hyri në nevojtore. Der-

dhi ujët mirë e mirë, duke mbajtur frymën për të mos ndier taftin e fortë të amoniakut që i nxirrte lot prej sysh. Pastaj doli në rrugínë duke kujtuar me mend: «Dhe do më shpjerë kjo varkë n'ëndrrën tënde». Te dericka e ngushtë e kishës ndjeu për herë të fundit erëmimin e lulelandrave.

Brenda vinte erë e rëndë. Qe një hijerore e gjerë, e shtruar gjithë po me pllo̧a të çrregullta dhe me një portë të vetme që binte në shesh. At Anheli bëri drejt e përposh kambanares. Këqyri gurët peshorë të sahatit më se një metër mbi kryet e tij dhe tha me mend se kurdisja mjaftonte edhe për një javë. Mushkonjat iu qepën. Vrau një në zverk me një shuplakë të fortë dhe pastroi dorën në litarin e kambanës. Pastaj dëgjoi sipër kokës zhurmërimën e ingranazhit të koklavitur metalik dhe më pas pesë të rënat e mbytura e të thella të orës pesë që dilnin nga barku i sahatit.

Priti sa mbaroi edhe kumbi i fundit. Atëherë mbërtheu litarin me të dyja duart, e mbështolli pas kyçeve dhe filloi t'u binte kambanave të vjetra prej bronzi me një bindje të ngulmët. I kish mbushur të 61-tat. Të rënit e kambanave qe punë mjaft e rëndë për moshën e tij, por qe mësuar tashmë t'i thërriste besimtarët në meshë me dorën e vet dhe kjo i jepte një kënaqësi morale.

Trinidadi hapi portën e rrugës ndërkohë që binin kambanat dhe u drejtua nga qoshja ku të mbrëmëshmen kishte ngrehur çarqet për minj. Ajo çka pa, i shkaktoi në të njëjtën kohë edhe neveri edhe kënaqësi: qe bërë një kërdi e vërtetë.

Hapi çarkun e parë, kapi miun prej bishti me gishtin e madh e me treguesin dhe e hodhi

në një kuti kartoni. At Anheli sapo kish hapur portën e sheshit.

— Mirëmëngjesi, at i shenjtë, — tha Trinidadi.

Ai s'e kapi zërin e saj të bukur si prej baritoni. Sheshi i shkretuar, pemët e bajames të përgjumura nën shi, fshati i palëvizshëm në atë agim të trishtë tetori i ngjallën në shpirt një ndjenjë braktisjeje. Po kur u mësua me zhurmën e shiut, nga fundi i sheshit i zuri veshi, në mënyrë të çartë e pakëz joreale, klarinetën e Pastorit. Vetëm atëherë iu përgjigj mirëmëngjesit.

— Pastori s'qe me ata të serenatës, — tha.

— Jo, — ia ushqeu fjalën Trinidadi. Dhe u afrua me kutinë e minjve të ngordhur. — Ishte me kitarat.

— Na çanë kokën dy orë me një palo këngë budallenjsh, — tha famullitari. — «Me lott' e mi ka për t'u mbushur deti». Apo jo?

— Është kënga e re e Pastorit, — tha ajo.

I palëvizshëm ballë portës, famullitari mbeti për një çast si i magjepsur. Kish vite që e dëgjonte këtë klarinetë. Pastori, dy shtëpi më tutje, ulej e i binte përditë më ora pesë, me stolin mbështetur pas shtyllës së kafazit të pëllumbave. Fshati kishte një si mekanizëm që punonte pa të metë: së pari, pesë kambanat e orës pesë, pastaj kambana e parë për meshë, e më pas klarineta e Pastorit në oborrin e shtëpisë së tij, që me notat e saj të tejdukshme e të kthjellta sikur spastronte ajrin e ngarkuar me glasa pëllumbash.

— Muzika është e mirë, — arsyetoi famullitari, — po fjalët s'kanë pikë kuptimi. Ngado që t'i kthesh, njësoj dalin. «Do të më shpjerë kjo ëdërr n'varkën tënde».

U kthye përgjysmë, duke buzëqeshur me zbulimin që kishte bërë, dhe u nis të ndizte qirinjtë e lterit. Trinidadi e ndoqi pas. Kish veshur një dollamë të bardhë e të gjerë, me mëngë të gjata e brez prej mëndafshi të kaltër të një kongregacioni laik. Nën vetullat kaleshe kishte dy sy të zez sterrë.

— Këndej u sollën gjithë natës, — tha famullitari.

— Te Margot Ramiresi, — tha Trinidadi me shpërfillje, duke përplasur minjtë e ngordhur në kuti. — Po serenata s'qe gjë fare në krahasim me...

Famullitari u ndal dhe i nguli sytë e tij me një kaltërsi të prajshme.

— Me çfarë?

— Me paskuinët, — tha Trinidadi dhe ia dha një të qeshuri histerik.

Tri shtëpi më tutje, Sesar Monteroja shihte në ëndërr elefantë. I kishte parë të dielën në kinema. Gjysmë ore para mbarimit kishte filluar shiu dhe tani filmi vazhdonte në ëndërr.

Sesar Monteroja ktheu nga muri gjithë peshën e trupit të tij të stërmadh, ndërkohë që indigjenët sypatrembur i grahnin kopesë së elefantëve. E shoqja i dha një të shtyrë të lehtë, por asnjëri nga të dy nuk u zgjua. «Ikëm», mërmëriti ai dhe u kthye siç qe në fillim. Pikërisht atëherë i doli gjumi. Sa po binte kambana e dytë për meshë.

Qe një dhomë me dritare të mëdha me rrjetë teli. Dritarja që binte në shesh, me rrjetë teli edhe ajo, kishte një perde kretone me lule të verdha. Mbi komodinë kishte një radio portative, një llambë dhe një sahat me fushë të shndritshme. Në anën tjetër, pas murit, një dollap të madh me fletë pasqyre. Ndërkohë që mbathte çizmet e kalërimit, Sesar Monteros i zuri veshi klarinetën e Pastorit. Gjalmët prej lëkure të ashpër i qenë forcuar nga balta. I shtriu me forcë, duke i kaluar nëpër pëllëmbën e mbyllur, më të ashpër se lëkura e gjalmëve. Pastaj kërkoi shporet, por nuk i gjeti poshtë shtratit. Vazhdoi të vishej në të mugët, duke u përpjekur të mos bënte zhurmë për të mos zgjuar të shoqen. Tek kopsiste këmishën, këqyri sahatin e komodinës dhe filloi përsëri të kërkonte shporet poshtë shtratit. Në fillim i kërkoi me duar. Pas taj ra këmbadorazi dhe u fut barkas nën krevat. E shoqja u zgjua.

— Ç'kërkon?

— Shporet.

— I ke të varura prapa dollapit, — i tha ajo. — Vetë i vure atje të shtunën që shkoi.

Bëri mënjanë kunupierën dhe ndezi dritën. Ai u ngrit i turpëruar. Qe si mal i lartë, truplidhur e shpatullgjerë, por lëvizjet i kishte të zhdërvjellta, qoftë edhe me çizmet e kalërimit, shojet e të cilave ngjanin si dy copa dërrase. Kishte diçka barbare në shëndetin e tij. Nuk thoshe dot sa vjeç ishte, por nga lëkura e qafës mund të vije re se i kishte kaluar të pesëdhjetat. U ul në shtrat për të vënë shporret.

— Ende po bie shi, — tha ajo, duke ndier se si kish depërtuar në eshtrat e saj vajzërore lagështia e natës. — Më ka hyrë të lagështit në palcë.

E imët, eshtake, me hundë të gjatë e të mprehtë, kish vetinë të mos dallohej asnjëherë që sapo qe zgjuar nga gjumi. U mundua të shihte shiun nëpërmes kortinës. Sesar Monteroja mbaroi së rregulluari shporet, u ngrit në këmbë dhe përplasi disa herë takat në dysheme. U drodh tërë shtëpia.

— Në tetor majmet tigri, — tha.

Por e shoqja nuk e dëgjoi, e rrëmbyer siç qe pas melodisë së Pastorit. Kur u kthye ta shihte, ai po krihej përpara dollapit, me këmbë të çapluara e me kokë të përkulur ngaqë nuk e nxinte pasqyra.

Ajo ndiqte nën zë melodinë e Pastorit.

— Na qitën trutë e kokës me këtë këngë, — i tha i shoqi.

— Është shumë e bukur, — tha ajo.

Mori një fjongo nga kryet e krevatit, mblodhi leshrat pas zverkut dhe psherëtiu, e zgjuar plotësisht. «Do mbes në ëndrrën tënde gjersa të vdes». Ai s'ia vari. Nga një sirtar i dollapit, ku kishte disa gurë të çmuar, një orë të vogël grash e një stilograf, nxori një kuletë me para. Mori katër kartëmonedha dhe e la kuletën në vend. Pastaj vuri në xhepin e këmishës katër fishekë çifteje.

— Po vazhdoi shiu, të shtunën nuk vij, — tha.

Tek çeli portën e oborrit, ndenji një grimë te pragu duke thithur erëmimin e errët të tetorit, ndërkohë që sytë i mësoheshin me terrin. Po mbyllte derën kur në dhomën e gjumit ra zilja e orës.

E shoqja brofi nga shtrati. Ai mbeti pezull me dorën te doreza, derisa ajo e ndali zilen. Atëherë e vështroi për herë të parë, i kredhur në mendime.

— Sonte pashë në ëndërr elefantë, — i tha. Pastaj mbylli derën dhe shkoi të shalonte mushkën.

Para kambanës së tretë shiu mori vrull. Një shkulm i beftë ere u rrëmbeu bajameve të sheshit të mbramet gjethe të kalbura, dritat e rrugëve u shuan, por shtëpitë s'qenë hapur ende. Sesar Monteroja nxori mushkën në oborr dhe, pa i zbritur, i thirri së shoqes t'i sillte mushamanë. Hoqi çiften që e mbante varur në sup dhe e lidhi horizontalisht me rripat e shalës. E shoqja erdhi me mushamanë.

— Prit sa të reshtet pak, — i tha jo fort e vendosur.

Ai veshi mushamanë në heshtje. Pastaj vështroi përjashta.

— Kështu si e ka nisur, s'ka për të reshtur gjer në dhjetor.

Ajo e shoqëroi me vështrim deri në të dalë të oborrit. Shiu thërrmohej furishëm mbi llamarinat e ndryshkura të çatisë, por ai u nis pa pyetur për shiun. Duke i grahur mushkës, iu desh të përkulej mbi shalë për të mos përpjekur kryet te qemeri i portës. Pikëlat e strehës ia dhanë mbi supe si breshëri saçmash. Që nga porta thirri pa kthyer kokën:

— Mirupafshim të shtunën.

— Mirupafshim, — iu përgjigj ajo.

E vetmja portë e çelur në shesh ishte ajo e kishës. Sesar Monteroja ngriti sytë dhe pa qiellin e rrasët e të ulët, disa metra mbi kryet e tij. Bëri kryq, shpoi mushkën dhe e vërtiti disa herë mbi thundrat e pasme, derisa kafsha u mësua me truallin si sapun. Pikërisht atëherë e pa fletushkën e ngjitur në portë të shtëpisë.

E lexoi pa i zbritur mushkës. Ujët e kishte prishur ngjyrën, por fjalët e shkruara me penë, me germa trashanike shtypi, lexoheshin ende. Sesar Monteroja afroi mushkën pas murit, e shqiti fletushkën dhe e bëri copash.

Me një të tërhequr të vrullshëm të kapistrës i dha mushkës një trok të shkurtër e të lehtë, nga ato troke me të cilat mund të ecësh për orë të tëra. La sheshin dhe ia mori nëpër një rrugicë të ngushtë e lakadredhase, me shtëpi prej plitharësh, prej të cilave kur çeleshin portat dukej sikur vezullonin prushnaja ëndrrash. Një erë kafeje i ra në hundë. Vetëm tek linte pas shtëpitë e fundit të fshatit, i dha një të kthyer mushkës me të njëjtin trok të shkurtër e të lehtë, u kthye në shesh e u ndal para shtëpisë së Pastorit. Aty i zbriti, nxori çiften dhe e lidhi mushkën pas një shtylle, duke bërë gjithçka më nge, pa asnjë ngutje.

Porta qe pa lloz, mbahej vetëm me një guaskë të madhe të vënë përposh. Sesar Monteroja hyri në gjysmëterrin e tremes. I zuri veshi një notë të mprehtë, pastaj një heshtje pritjeje. Kaloi përanash katër karrigeve të renditura rreth një tryeze të shtruar me mbulesë leshi e me një vazo lulesh artificiale. Për herë të fundit u ndal para derës së brendshme, hodhi nga pas kapuçin e mushamasë, lëvizi verbtazi sigurecën e çiftes dhe me zë të ulët, të qetë, thuajse të përzemërt, thirri:

— Pastor.

Pastori doli në boshllëkun e derës duke zhvidhosur kallamin e klarinetës. Qe një djalosh i imët, i drejtë, me pushin e faqeve të prerë me gërshërë. Kur pa Sesar Monteron me takat të ngulura në truall dhe çiften në lartësinë e brezit të drejtuar atij, Pastori hapi gojën. Por

nuk tha asgjë. U zbeh dhe buzëqeshi. Sesar Monteroja shtrëngoi në fillim takat pas trupit, pastaj qytën, me bërryl, pas ijes, në fund shtrëngoi dhëmbët dhe njëkohësisht tërhoqi edhe këmbëzën. Shtëpia u trand prej gjëmimit, por Sesar Monteroja nuk e mori vesh nëse qe para apo pas trandjes që e pa Pastorin të zvarritej përdredhtazi si krimb mbi një shtrojë puplash të përgjakura.

Alkaldin sa po e zinte gjumi në çastin e së shtënës. Kish tri net që s'vinte gjumë në sy i torturuar nga një dhembje dhëmballe. Atë mëngjes, kur ra kambana e parë për meshë, mori aspirinën e tretë. Dhembja i ra. Kërcitja e shiut në çatinë prej zinku e ndihmoi të flinte, por dhëmballa, ndonëse nuk i dhimbte më, vazhdoi t'i rrihte edhe në gjumë. Kur dëgjoi të shtënën, u zgjua vrik dhe rroku gjerdanin e fishekëve me revolverin, që i linte ngaherë në një karrige pranë hamakut, në krah të majtë. Por, meqë dëgjoi vetëm brerimën e shiut të imët, tha se do të kish qenë ndonjë ëndërr e keqe dhe dhembja iu kthye sërish.

Kishte pak ethe. Në pasqyrë vuri re se faqja po i enjtej. Hapi një kuti vazeline me mentë dhe leu pjesën që i dhimbte, të tendosur e të parruar. Pas pak, nëpërmes shiut, dëgjoi një katrahurë zërash të largët. Doli në ballkon. Banorët e rrugës, disa fill në rroba të shtratit, vraponin drejt sheshit. Një djalë ktheu kokën nga ai, tundi krahët dhe i thirri pa u ndalur:

— Sesar Monteroja vrau Pastorin.

Në shesh, Sesar Monteroja sillej vërdallë me çiften drejtuar turmës. Alkaldi mezi e njohu. Nxori paksa revolverin me dorën e majtë dhe zuri të çajë drejt qendrës. Njerëzit i hapnin rrugë. Nga salla e bilardos doli një polic me pushkën të ngrehur drejtuar Sesar Monteros. «Mos shtjerë, kafshë», i tha alkaldi me zë të ulët. Rrasi revolverin në brez, i mori pushkën policit dhe vazhdoi drejt qendrës me armën gati për zjarr. Turma u rras pas mureve.

— Sesar Montero, — thirri alkaldi, — pa ma jep këtu atë çifte.

Sesar Monteroja nuk e kishte parë gjer më atëherë. Me një të brofur u kthye nga ai. Alkaldi i mëshoi këmbëzës, por nuk shtiu.

— Eja ta marrësh, — i thirri Sesar Monteroja.

Alkaldi mbante pushkën në dorën e majtë, ndërsa me të djathtën fshinte ujët që i rridhte për qepallash. Llogariste çdo hap, me gishtin e tendosur pas këmbëzës dhe sytë të ngulur Sesar Monteros. Pas pak u ndal e foli me të butë, thuajse me të mirë:

— Hidhe çiften përtokë, Sesar. Mos bëj budallallëqe të tjera.

Sesar Monteroja u zbyth. Alkaldi vazhdoi të bënte përpara me gishtin në këmbëz. Asnjë muskul i trupit nuk i lëvizi, derisa Sesar Monteroja uli çiften dhe e lëshoi përtokë. Atëherë alkaldi e kuptoi se qe vetëm në pantallona të pizhamave, se po i shkonin djersët nën shi dhe se dhëmballa nuk i dhimbte më.

Shtëpitë u hapën. Dy policë të armatosur me pushkë rendën drejt qendrës së sheshit. Turma u dynd pas tyre. Policët bënë një prapaktheu dhe thirrën me pushkët ngrehur:

— Prapa.

Alkaldi bërtiti me zërin e qetë, pa vështruar askënd.

— Hiquni nga sheshi.

Turma u shprish. Alkaldi kontrolloi Sesar Monteron pa ja hequr mushamanë. Gjeti katër fishekë në xhepin e këmishës dhe në xhepin e pasmë të pantallonave një sojak me dorezë brirë. Në xhepin tjetër gjeti një bllokth shënimesh, një rreth me çelësa dhe katër monedha nga njëqind pesos. Sesar Monteroja e la ta kontrollonte, krejt i qetë, me krahët hapur, duke lëvizur paksa trupin për t'i lehtësuar veprimet. Kur mbaroi, alkaldi thirri dy policët, u dha sendet dhe u dorëzoi Sesar Monteron.

— Shpjereni menjëherë në alkaldi, — i urdhëroi. — Përgjigjeni për të.

Sesar Monteroja hoqi mushamanë, ia dha njërit prej policëve dhe eci ndërmes tyre, pa çarë kryet për shiun dhe për njerëzit që ende s'qenë larguar nga sheshi e bënin sehir me gojë hapur. Alkaldi e këqyri tek largohej, i kredhur në mendime. Pastaj u kthye nga gjindja, bëri një gjest si për të trembur pulat dhe thirri:

— Zhdukuni.

Duke fshirë fytyrën me krahun e zhveshur, çau nëpër shesh dhe hyri në shtëpinë e Pastorit.

Plandosur në një karrige qe nëna e të vdekurit, mes një grupi grash që i bënin fresk me një zell të pamëshirshëm. Alkaldi hoqi mënjanë njërën prej grave. «Lëreni të marrë frymë», i tha. Gruaja u kthye nga ai.

— Sapo kishte dalë për meshë, — i tha ajo.

— Mirë, mirë, — tha alkaldi, — po tani lëreni të marrë frymë.

Pastori qe në korridor, i shakullepsur përmbys rrëzë kafazit të pëllumbave, mbi një shtrat puplash të përgjakura. Binte një erë e rëndë fëlliqësie pëllumbash. Një grup burrash po jepnin e merrnin për të ngritur trupin, kur alkaldi u dha te pragu.

— Pa hiqmuni këtej, — u tha.

Burrat e lanë përsëri kufomën në puplat, në të njëjtin pozicion siç e kishin gjetur, dhe u zmbrapsën në heshtje. Si këqyri trupin, alkaldi e ktheu së mbari. Qe veshur krejt në pupla. Në lartësinë e brezit puplat i qenë ngjitur pas gjakut ende të ngrohtë e të pampiksur. I largoi me duar. Këmisha qe grisur dhe tokëza e rripit të mesit qe dërrmuar. Përposh këmishës pa zorrët e derdhura jashtë. Nga plaga s'dilte më gjak.

— Me çifte që vrasin tigrat, — tha njëri prej burrave.

Alkaldi u ngrit. Pastroi duart prej puplave të përgjakura te shtylla e kafazit, pa ia hequr sytë kufomës. Më së fundi i fshiu duart pas pantallonave të pizhamave dhe i tha grupit:

— Mos e lëvizni prej këndej.

— Dashka ta lërë të shtrirë, — tha njëri prej burrave.

— Duhet bërë procesverbali i ngritjes së trupit, — sqaroi alkaldi.

Në shtëpi krisi vaji i grave. Alkaldi çau udhë mes klithmave dhe erërave të rënda që të merrnin frymën. Te porta e rrugës hasi at Anhelin.

— Ka vdekur, — thirri famullitari ndërdyshas.

— Në vend, — iu gjegj alkaldi.

Shtëpitë rreth e qark sheshit qenë hapur.

Shiu kishte pushuar, por qielli i rrasët, pa një të çarëz për diellin, pluskonte mbi çatitë. At Anheli e kapi alkaldin për krahu.

— Sesar Monteroja është burrë i mirë, — i tha, — kushedi se si i janë errur sytë.

— E di, — ia priti alkaldi durimhumbur. — Mos u bëj merak, at i shenjtë, se s'ka për t'i ndodhur gjë. Hyrë brenda, se aty kanë nevojë për ty.

U largua disi përdhunshëm dhe u dha urdhër policëve të mos bënin më rojë. Turma, që gjer atëherë pat qëndruar larg, vërshoi drejt shtëpisë së Pastorit. Alkaldi hyri në sallën e bilardos, ku një polic e priste me një bohçë rrobash të pastra: uniformën e togerit.

Zakonisht lokali nuk qe hapur në atë orë. Por atë ditë, qysh para gjashtës, qe mbushur dëng. Rreth tryezave pesëvendëshe, ose të mbështetur pas banakut, disa burra pinin kafe. Të shumët qenë ende në pizhama e pantofla.

Alkaldi u zhvesh para të gjithëve, u fshi si mundi me pantallonat e pizhamave, duke mbajtur vesh bisedat që vlonin. Kur doli nga salla i kishte marrë vesh fije e për pe hollësitë e ngjarjes.

— Dhe hapni sytë, — thirri nga dera, — se ia mora shpirtin atij që më shkakton trazira.

Mori teposhtë rrugës me kalldrëm, pa i folur askujt, por duke e vënë re se si ziente fshati. Që i ri, me gjeste e të sjella të lehta, dhe në çdo hap që hidhte ia kuptoje dëshirën për t'u dukur.

Më ora gjashtë, motobarkat që bënin trafikun e mallrave e të pasagjerëve tri herë javën, lëshuan një fërshëllimë e u shkëputën prej skelës, por askush s'e kishte mendjen te to si ditët

e tjera. Alkaldi zbriti nëpër rrugicën ku tregtarët sirianë sa po nxirrnin mallrat e tyre ngjyra-ngjyra. Doktor Oktavio Hiraldoja, një mjek pa moshë e me kokën gjithë kokorithka të lyrësuara, po shihte nisjen e motobarkave nga dera e konsultores së tij. Edhe ai qe në pizhama e në pantofla.

— Doktor, — i tha alkaldi, — vishu që të shkosh të bësh autopsinë.

Mjeku ia nguli sytë i kureshtur. Zbuloi një sërë të gjatë dhëmbësh të bardhë e të fuqishëm. «Paskemi filluar nga autopsitë tani», tha dhe shtoi:

— Përparime, jo shaka.

Alkaldi bëri të buzëqeshte, por s'e la faqja që i dhimbte. Zuri gojën me dorë.

— Ç'patët?

— Një dhëmballë, që i...

Doktor Hiraldoja dukej i gatshëm për muhabet. Por alkaldi s'ia kish ngenë.

Në të dalë të portit trokiti në një shtëpi me mure prej kallamash të pambushura me baltë, çatia prej palme e së cilës zbriste gati deri në nivelin e ujit. Ia çeli një grua lëkurëverdheme, me barrë në muajin e shtatë. Qe zbathur. Alkaldi e bëri mënjanë dhe hyri në tremen e mugët.

— Gjykatës, — thirri.

Gjykatës Arkadioja doli te dera e brendshme duke tërhequr zvarrë nallanet. Kishte një palë pantallona shajaku, pa ushkur, të varura përposh kërthizës, dhe qe lakuriq nga gjoksi.

— Bëhu gati për ngritjen e kufomës, — i tha alkaldi.

Gjykatës Arkadioja lëshoi një fërshëllimë habie.

— Nga na paskan dalë këto rregulla të reja?

Alkaldi çau deri në dhomën e gjumit. «Ky është rast i veçantë», tha duke çelur dritaren për të pastruar ajrin e rënduar nga gjumi. «Ato punë që bëjmë, t'i bëjmë siç duhet». Fshiu pluhurin e duarve pas pantallonave të hekurosura dhe pyeti pa të keq:

— E di procedurën e ngritjes së një kufome?

— S'do mend që e di, — u gjegj gjykatësi.

Alkaldi këqyri duart para dritares. «Thirr sekretarin për ato që duhen shkruar», i tha, përsëri pa të keq. Pastaj, me pëllëmbët të shtrira, u kthye nga gruaja. I kishin mbetur gjumnë gjaku.

— Ku mund t'i laj pak duart?

— Në muslluk, — iu përgjigj ajo.

Alkaldi doli në oborr. Gruaja kërkoi në sepet një peshqir të pastër dhe mbështolli në të një sapun të mermë.

Doli në oborr në çastin kur alkaldi po kthehej për në dhomën e gjumit, duke shkundur duart.

— Po ju sillja sapunin, — tha ajo.

— S'ka gjë, — tha alkaldi. Këqyri edhe një herë pranë dritares pëllëmbët. Mori peshqirin dhe u fshi, i menduar, duke vështruar gjykatës Arkadion.

— Qe gjithë pupla pëllumbash, — tha.

I ulur në shtrat, duke rrufitur me gërrqe të gjata kafenë, priti derisa gjykatës Arkadioja mbaroi së veshuri. Gruaja u erdhi pas nëpër treme.

— Po nuk e hoqët dhëmballën, nuk do t'ju ulet e enjtura, — i tha alkaldit.

Ai shtyu gjykatës Arkadion në rrugë, u kthye

të shihte gruan dhe i preku me gishtin tregues barkun e gufuar.

— Po ty kur do të të ulet ky?

— Së shpejti, — iu gjegj ajo.

At Anheli nuk e bëri shëtitjen e tij të zakonshme të ndajnatës. Pas varrimit, u ndal me muhabet në një shtëpi të lagjeve të poshtme dhe ndenji aty gjer ndaj të ngrysur. E ndiente veten mirë, ndonëse shirat e gjatë zakonisht i jepnin dhembje në kryqet. Kur u kthye për në shtëpi, qenë ndeuzur fenerët e rrugëve.

Trinidadi po ujiste lulet e korridorit. Famullitari e pyeti për ostet e pashuguruara dhe ajo iu përgjigj se i kish vënë te kryelteri. Një luzmë mushkonjash e mbështolli me të ndezur dritën. Para se të mbyllte portën, e bëri hijeroren me insekticid, shpejt e shpejt, duke teshtitur prej erës mbytëse. Kur mbaroi, po i shkonin djersë. Zhveshi veladonin e zi dhe veshi veladonin e bardhë të qepur e të arnuar, që e përdorte kur qe vetëm, dhe shkoi të jepte engjulloren.

Kur u kthye në dhomë, vuri një tigan në zjarr dhe hodhi një copë mish për ta skuqur, ndërkohë që grinte një qepë. Pastaj i vuri të gjitha në një pjatë ku kishte një copë *manioke*[1] të zier dhe pak pilaf të ftohtë, të mbetura nga dreka. E shpuri pjatën në tryezë dhe u ul të hante.

1 Shkurre e viseve tropikale, rrënja e së cilës jep një niseshte ushqyese, *tapiokën.*

Hëngri nga të gjitha njëherësh, duke i prerë copëza e duke i shtypur me thikë e me pirun. Përtypte ngadalë e i përqendruar, duke grimcuar me dhëmballët me këllëfë metalikë edhe kokrrizën e fundit, por me buzë të shtrënguara. Në këtë kohë e sipër, linte pirunin dhe thikën në anë të pjatës dhe shqyrtonte dhomën me një vështrim të ngultë e të vëmendshëm. Përkundruall qe dollapi me librat e trashë të arkivit të famullisë. Në qosh një karrige përkundëse prej xunkthi me shpinëz të lartë, me një nënkresë të qepur në lartësinë e kokës. Pas karriges qe dericka e rrëfyesores, me një kryq të varur pranë një kalendari reklame të një shurupi për kollë. Në krahun tjetër të rrëfyesores qe dhoma e gjumit.

Kur mbaroi së ngrëni, at Anheli ndjeu se po i merrej fryma. Shpështotli një ëmbëlsirë *guajave*,[1] mbushi gotën me ujë buzë për buzë dhe e hëngri ëmbëlsirën duke vështruar kalendarin e duke pirë nga një gllënjkë ujë pas çdo kafshate. Tekefundit, gromësiu dhe fshiu buzët me mëngë. Kish nëntëmbëdhjetë vjet që hante kësisoj, fill i vetëm në kthinën e tij, duke përsëritur çdo lëvizje me një rregullsi të përpiktë. Asnjëherë s'i pat ardhur turp prej vetmitarisë.

Pas rruzares, Trinidadi i kërkoi të hollla për të blerë arsenik. At Anheli për të tretën herë nuk i dha, duke i thënë se mjaftonin çarqet. Trinidadi nguli këmbë:

— Minjtë më të vegjël e marrin djathin me vete dhe s'bien në çark. Prandaj është më mirë t'i vëmë pak helm djathit.

---

1 Pemë që rritet në Amerikën Latine, bën fryte të ngjashme me dardhat.

At Anheli e pranoi që Trinidadi kishte të drejtë. Por s'pati kohë ta thoshte këtë me gojë, se heshtjen e kishës e prishi atë çast altoparlanti i kinemasë përballë rrugës. Në fillim u ndie një gërhimë e shurdhët, pastaj gërvima e gjilpërës pas diskut e më në fund një mambo që filloi me një trompetë piskatëse.

— Ka film? — pyeti ai.

Trinidadi iu përgjigj se po.

— Ç'film është?

— «Tarzani dhe perëndesha e bletë», — u përgjigj Trinidadi. — Atë që të dielën nuk e mbaruan dot prej shiut. Bën për të gjithë.

At Anheli vajti përposh kambanares dhe i ra kambanës dymbëdhjetë herë, duke i ndarë mirë të rënat nga njëra-tjetra. Trinidadi mbeti pa mend.

— E keni gabim, at i shenjtë, — i tha duke lëvizur duart me një vezullim trazimi në sy. — Është film që bën për të gjithë. Të dielën nuk i ratë as një herë.

— Është mungesë respekti ndaj fshatit, — tha famullitari, duke fshirë djersën e zverkut. Dhe përsëriti frymëmarrur: — Është mungesë respekti.

Trinidadi e kuptoi.

— T'i shihje sot në varrim, — tha ai. — Gjithë burrat ziheshin kush e kush ta mbante arkivolin.

Pastaj i tha vajzës se mund të shkonte, mbylli portën e sheshit të shkretuar dhe fiku qirinjtë e lutësores. Në rruginë, tek kthehej për në dhomën e gjumit, i ra ballit me dorë kur iu kujtua se kishte harruar t'i jepte Trinidadit të hollat për arsenikun. Por, sa pa hyrë në dhomë, e kishte harruar përsëri.

Pak më vonë, i ulur në tryezën e punës, po bëhej gati të përfundonte një letër që e kishte filluar të mbrëmshmen. Kishte shkopsitur veladonin deri në lukth dhe po rregullonte në tryezë tokicën e letrave, shishen e bojës dhe letërthithësen, ndërkohë që kërkonte syzat duke rrëmuar nëpër xhepa. Pastaj i ra ndër mend se i pat lënë në veladonin që kish pasur në varrim dhe u çua t'i merrte. Lexoi edhe një herë ç'pat shkruar të mbrëmshmen dhe kishte filluar një paragraf të ri, kur trokitën tri herë në derë.

— Hyrë.

Ishte sipërmarrësi i kinemasë. Shtatimët, i zbehtë, i rruar paq, kishte në fytyrë një shprehje sikur kushedi ç'pat bërë vaki. Qe veshur me një kostum linoje të bardhë, të pastër xixë, dhe këpucët i kishte dyngjyrëshe. At Anheli i bëri me shenjë të ulej në karrigen prej xunkthi. Por ai nxori një shami nga xhepi i pantallonave, e shpalosi me shumë kujdes, fshiu pluhurin nga bankoja dhe u ul aty me këmbët të hapura. At Anheli atëherë vuri re se ajo çka mbante në brez nuk qe revolver, por elektrik dore me pila.

— Urdhëroni, — tha at Anheli.

— At i shenjtë, — tha atëherë sipërmarrësi, thuajse pa frymë, — më ndjeni që ju ndërhyj në punët tuaja, por sonte duhet të ketë ndodhur ndonjë gabim.

Famullitari pohoi me kokë dhe priti.

— «Tarzani dhe perëndesha e blertë» është film që bën për të gjithë, — vazhdoi sipërmarrësi. — Ju vetë e pranuat të dielën.

Famullitari u mat ta ndërpriste, por sipërmarrësi ngriti dorën për të treguar se ende s'kishte mbaruar.

— Unë e kam pranuar punën e kambanave, — tha ai, — se vërtet ka filma të pamoraltë. Por ky film s'ka kurrgjë të tillë. Ne kishim plan ta jepnim të shtunën për kalamajtë.

At Anheli i shpjegoi atëherë se në të vërtetë filmi nuk kishte asgjë të keqe nga ana e moralit sipas listës që merrte me postë muaj për muaj.

— Por të shfaqësh film sot, — vazhdoi, — kur në fshat kemi një të vdekur, kjo është mungesë respekti. Edhe kjo ka lidhje me moralin.

Sipërmarrësi ia nguli sytë.

— Vjet vetë policia vrau njërin brenda në kinema dhe, me ta nxjerrë të vdekurin, filmi vazhdoi si të mos kish ndodhur gjë, — thirri ai.

— Tani ndryshon puna, — tha famullitari, — s'kemi më atë alkald që patëm.

— Kur të bëhen zgjedhjet e reja, do të vejë gjaku deri në gju, — u hodh sipërmarrësi i acaruar. — Gjithmonë, qysh kur fshati është fshat, kështu ka ndodhur.

— Atë do ta shohim, — tha famullitari.

Sipërmarrësi i nguli një vështrim të pikur. Kur zu të fliste përsëri, duke tundur këmishën për t'i bërë fresk gjoksit, zëri i kish marrë një nuancë lutjeje.

— Është i treti film që «bën për të gjithë» që na vjen gjatë këtij viti, — tha. — Të dielën mbetën tri bobina pa u shfaqur për shkak të shiut dhe ka shumë njerëz që duan të dinë si mbaron.

— Kambanat s'kthehen më mbrapsht, — tha famullitari.

Sipërmarrësi lëshoi një psherëtimë dëshpërimi. Priti pakëz duke e vështruar ballazi famu-

llitarin, ndërkohë që mendja i punonte te vapa e tmerrshme e dhomës.

— Atëherë, s'bëhet gjë.

At Anheli lëvizi kokën.

Sipërmarrësi u ra me pëllëmbë gjunjëve dhe u ngrit.

— E po mirë, — tha. — Ç't'i bëjmë!

Palosi shaminë, fshiu djersët e zverkut dhe e shqyrtoi dhomën me një qortim të hidhur.

— Këtu plas edhe dreqi, — tha.

Famullitari e shoqëroi deri te porta. I shkoi llozin dhe u vu të mbaronte letrën. Si e lexoi edhe një herë nga fillimi, përfundoi paragrafin e ndërprerë dhe u ndal të mendohej. Atë çast pushoi muzika e altoparlantit. «Njoftojmë publikun e nderuar, — tha një zë i ftohtë, — se shfaqja e sotme anullohet, mbasi edhe kjo sipërmarrje do të marrë pjesë në zi». At Anheli njohu zërin e sipërmarrësit dhe buzëqeshi.

Zabullima qe bërë e padurueshme. Famullitari vazhdoi të shkruante, duke u ndalur kur e kur për të fshirë djersët e për të lexuar edhe një herë ç'pat shkruar, derisa mbushi dy fletë. Sa po i vinte firmën, kur shiu ia dha pa asnjë paralajmërim. Një afsh dheu të vlagët hyri në dhomë. At Anheli shkroi zarfin, i vuri tapën shishes së bojës dhe u mat të paloste letrën. Por ndërroi mendje dhe e lexoi edhe një herë paragrafin e fundit. Atëherë hapi prapë shishen e bojës dhe shkroi një shtesë: *Përsëri po bie shi. Me këtë dimër e me ato çka më sipër ju tregova, besoj se ditë të hidhura na presin.*

E premtja gdhiu e ngrohtë dhe e thatë. Gjykatës Arkadioja, bashkë me gruan dolën krejt lakuriq që poshtë kunupierës të pështjelluar si mjegullinë. Gjykatësi vajti drejt e te sepeti për të kërkuar një palë të mbathura të pastra. Kur u kthye, gruaja qe veshur e po rregullonte kunupierën. Ai i bëri bisht, pa ia hedhur sytë, dhe u ul të mbathte këpucët në anën tjetër të shtratit, me frymëmarrjen ende të çrregulluar prej dashurisë. Ajo i vajti pas. I mbështeti barkun e rrumbullët pas krahut dhe i kërkoi veshin me dhëmbë. Ai e largoi me të butë.

— Më lër rehat, — i tha.

Ajo buzëqeshi gjithë shend. Iu qep burrit deri në cepin tjetër të dhomës duke i gudulisur ijet me gisht. «Hyyy, kërriç», i thoshte. Ai kërceu përpjetë dhe ia hoqi duart. Më në fund, ajo e la të qetë dhe buzëqeshi përsëri, por befas gazi iu meh në buzë:

— O zot i madh! — thirri.

— Ç'pate? — e pyeti ai.

— Dera paska qenë hapur kanat, — thirri ajo. — Na ka plasur cipa fare.

Dhe hyri në banjë duke u shqyer gazit.

Gjykatës Arkadioja nuk priti kafenë. Menjëherë e pastës së dhëmbëve sikur e solli në të dhe ai doli nga shtëpia. Qe një diell i bronztë. Sirianet e ulur te dyert e dyqaneve kundronin lumin e prajshëm. Tek kalonte para konsultores së doktor Hiraldos, gërrici me thua rrjetën metalike të derës dhe thirri pa u ndalur:

— Doktor, cili është ilaçi më i mirë për dhembjen e kokës?

Mjeku iu përgjigj nga brenda:

— Të mos kesh pirë një natë më parë.

Në port një tufë grash komentonin me zë të lartë një paskuin të ri që qe vënë atë natë. Dita kish gdhirë e kthjellët e pa shi, kështu që gratë që kishin kaluar për meshën e orës pesë e kishin lexuar dhe tani e pat marrë vesh të-rë fshati. Gjykatës Arkadioja nuk u ndal. Iu duk vetja si një buall i tërhequr për hunde drejt sallës së bilardos. Atje kërkoi një birrë të ftohtë dhe një aspirinë për dhembjen e kokës. Sapo kish vajtur ora nëntë, por lokali ishte plot.

— Gjithë fshatit i dhimbka koka sot, — tha gjykatës Arkadioja.

E shpuri shishen te një tryezë ku tre burra kishin mbetur si të shushatur para gotave të birrës. U ul në vendin e lirë.

— Vazhdon avazi? — pyeti.

— Sot kishin vënë katër.

— Po ajo që e lexuan të gjithë, — tha një nga burrat, — qe për Rakel Kontrerasin.

Gjykatës Arkadioja përtypi aspirinën dhe ktheu gotën e birrës. Gllënjka e parë sikur s'i ngjiti, por pastaj stomaku iu mësua dhe për një çast e ndjeu veten qiqër.

— Po hë, ç'thoshte?

— Dokrra, — tha burri. — Se sivjet s'paska vajtur në qytet për të mbushur dhëmbët,

siç thotë ajo, por për të nxjerrë një këlysh.

— Shumë qenkan lodhur për ta zbuluar e për ta shkruar, — tha gjykatës Arkadioja. — Këtë e di dhe bufi.

Ndonëse dielli i nxehtë i ra në sy dhe e verboi kur doli nga lokali, s'e kishte më atë zaifllëkun e mëngjesit. Vajti drejt e në gjykatore. Sekretari, një plakush i terur që po shpuplonte një pulë, e priti me një vështrim mosbesimi sipër skeletit të syzeve.

— Ç'paska bërë vaki?

— Duhen vënë në vijë punët, — tha gjykatësi.

Sekretari doli në oborr duke hequr zvarrë pantoflat dhe, që sipër gardhit, ia dha pulën gjysmë të rrjepur kuzhinieres së bujtinës. Njëmbëdhjetë muaj pas marrjes së detyrës, gjykatës Arkadioja u ul për herë të parë në tryezën e tij.

Zyra e shtrembët dhe e çrregullt ndahej në dy pjesë prej një çatmaje. Në pjesën e jashtme kishte një banko prej druri nën tablonë e drejtësisë sylidhur me një peshore në dorë. Brenda — dy tryeza të vjetra ballë për ballë, një raft librash të pluhurosur dhe një makinë shkrimi. Në murin mbi tryezën e gjykatësit një kryq të bakërt me Jezukrisht. Në murin kundruall një pikturë të futur në suazë: një burrë buzagaz, i bëshëm e i shogët, me një shirit presidencial tërthor kraharorit, ndërsa përposh një legjendë e praruar: «Paqë e Drejtësi». Piktura qe e vetmja gjë e re në atë dhomë.

Sekretari zuri hundët me shami dhe filloi të fshijë pluhurin e tryezave me një pendël gjeli. «Po të mos zësh hundët, të shuan flama», tha. Gjykatësi nuk e dëgjoi këshillën. U hodh prap-

tas në poltronën rrotulluese për të provuar sustat.

— Mban? — pyeti.

Sekretari ia bëri po me kokë. «Kur vranë gjykatës Vitelën, — tha, — i dolën sustat, por tani e kanë rregulluar». Pa hequr shaminë nga hundët, shtoi:

— Vetë alkaldi dha urdhër ta rregullonin kur ndërroi Qeveria dhe filluan të dalin inspektorë të posaçëm gjithandej.

— Alkaldi do që zyra të punojë, — tha gjykatësi.

Hapi sirtarin e mesit, nxori një tufë çelësash dhe vazhdoi të hapte një nga një sirtarët e tjerë. Qenë plot me letra. U hodhi një sy, duke i ngritur paksa me gisht për t'u siguruar se s'kishte gjë që t'i interesonte, pastaj i mbylli sirtarët dhe rregulloi takëmin e shkrimit: një kallamar kristali me një shishez të kuqe dhe një blu, si dhe një penë për çdo shishez, me të njëjtat ngjyra. Boja qe tharë.

— Pati fat alkaldi që erdhët ju, — tha sekretari.

Duke u kalamendur në poltronë, gjykatësi e ndoqi me një vështrim të ngrysur ndërkohë që ai fshinte parmakët. Sekretari e kundroi si t'i jepej rasti për të mos e harruar kurrë nën atë dritë, në atë grimë dhe në atë pozicion, pastaj tha duke treguar me gisht:

— Ashtu siç po rrini ju tani, tamam ashtu, po rrimte gjykatës Vitela kur e grinë me plumba.

Gjykatësi preku në tëmbla dejet e kërcyera. Po fillonte t'i dhimbte koka përsëri.

— Kurse unë isha këtu, — vazhdoi sekretari, duke treguar nga makina e shkrimit, ndërkohë që kalonte nga ana e jashtme e parma-

këve. Pa e ndërprerë të treguarit, mbështeti pas parmakëve pendlën e ngrehur si pushkë kundër gjykatës Arkadios. Dukej si një bandit që sulmon karroca poste në një film me kauboj.

— Tre policët zunë vend kështu, — tha. — Gjykatës Vitela, me t'i parë, ngriti krahët dhe tha shumë ngadalë: «Mos më vrisni». Por atë çast poltrona fluturoi nga një anë dhe ai vetë nga ana tjetër, i bërë shoshë.

Gjykatës Arkadioja shtrëngoi rrashtën me duar. Ndiente trurin t'i regëtinte. Sekretari hoqi shaminë nga hundët dhe vari pendlën prapa derës. «Dhe e gjitha kjo vetëm ngaqë pat thënë në dehje e sipër se ai qe këtu për të garantuar pastërtinë e zgjedhjeve», tha. Mbeti pezull një çast, duke vështruar gjykatës Arkadion që u përkul mbi tryezë me duart në stomak.

— Nuk jeni mirë?

Gjykatësi pohoi me kokë. I tregoi për të mbrëmëshmen dhe e nisi për në sallën e bilardos që t'i silte një aspirinë dhe dy birra të ftohta. Kur mbaroi birrën e parë, s'ndjeu asnjë farë brejtjeje në ndërgjegje. Që bërë përsëri qiqër.

Sekretari u ul para makinës.

— Po tani ç'do të bëjmë? — pyeti.

— Asgjë, — tha gjykatësi.

— A mund të vete t'i ndihmoj pak Maries për të rrjepur pulat?

Gjykatësi nuk e lejoi. «Kjo është zyrë për punë drejtësie e jo për rrjepje pulash», i tha. E këqyri vartësin nga lart poshtë me një pamje keqardhjeje dhe shtoi:

— Edhe mos më eja më në zyrë me këto pantofla, po mbath një palë këpucë.

Vapa u bë edhe më e padurueshme me afrimin e drekës. Kur ra ora dymbëdhjetë, gjykatës Arkadioja kishte pirë nja dhjetë gota birrë. Me një angushti të përgjumshme flisTe për një të shkuar kur s'mungonte asgjë, me të diela të gjata në det dhe mulate të pangopshme që bënin dashuri më këmbë prapa derës së nevojtoreve. «E di si qe jeta atëherë?» pyeste dhe si përgjigje përplaste gishtin e madh pas treguesit, ndërkohë që sekretari vështronte me gojë hapur, pa folur gjysmë fjale, vetëm duke tundur kokën. Gjykatës Arkadioja e ndiente që po i binte pija në kokë, porse kujtimet po i bëheshin gjithë e më të gjalla.

Kur në kullën e sahatit ra ora një, sekretari dha shenja padurimi.

— Po ftohet supa, — tha.

Gjykatësi nuk e la të ngrihet. «Njerëz të aftë s'gjenden kollaj nëpër këto fshatra», tha. Sekretari e falënderoi, i këputur prej vapës, dhe ndërroi pozicionin në karrige. S'po kishte fund ajo e premte. Nën llamarinat e përvëluara të çatisë ata u fjalosën edhe një gjysmë ore, ndërkohë që fshati piqej në zhegun e pasdrekës. Kur sfilitja kish arritur tek s'mbante më, sekretari e hodhi fjalën te paskuinët. Gjykatës Arkadioja mblodhi supet.

— Edhe ti u vë veshin këtyre dokrrave, — tha duke i folur me ti për herë të parë.

Sekretari s'kishte ndonjë qejf të vazhdonte bisedën, i rraskapitur siç qe prej urisë e prej të nxehtit, porse nuk qe i mendimit se paskuinët qenkëshin budallallëqe. «I pari u vra, — tha ai. — Po vazhdoi kështu, nuk i kemi mirë punët». Dhe rrëfeu historinë e një fshati që qe bërë shesh e lëndinë brenda pesë ditëve për shkak të paskuinëve. Banorët kishin vrarë njëri-tjetrin. Ata që kishin mbetur gjallë patën zhvarrosur kockat e

të vdekurve për të qenë të sigurt që s'ktheheshin kurrë më.

Gjykatës Arkadioja e mbajti vesh me shpoti, duke shkopsitur këmishën ngadalë ndërsa tjetri fliste. Mendoi se sekretari duhej të qe mjaft i dhënë pas tregimeve me tmerre.

— Kjo është një nga ato historitë e rëndomta të romaneve policore, — tha.

Vartësi ia bëri jo me kokë. Gjykatës Arkadioja tregoi se në universitet kishte bërë pjesë në një organizatë që merrej me deshifrimin e enigmave policore. Çdonjëri nga anëtarët lexonte një roman me mistere deri në një vend të caktuar, pastaj mblidheshin të shtunave për ta deshifruar enigmën. «Unë e gjeja gjithmonë», tha. «S'do mend, sepse i njihja mirë klasikët, që kishin zbuluar një logjikë jete të aftë për të depërtuar në çdo mister». Dha një enigmë si shembull: një njeri regjistrohet në një hotel në orën dhjetë të natës, ngjitet në dhomën e tij dhe të nesërmen në mëngjes kamerierja që i shpie kafenë e gjen në shtrat të vdekur e të kalbur. Autopsia tregon se i ardhuri një natë më parë ka tefë ditë që ka vdekur.

Sekretari brofi përpjetë sa i kërcitën kyçet.

— Mos doni të thoni se kur erdhi në hotel kishte shtatë ditë që pat vdekur? — tha.

— Tregimi qe shkruar këtu e dymbëdhjetë vjet të shkuar, — vazhdoi gjykatësi pa i vënë rëndësi ndërprerjes, — por çelësin e ka dhënë Heraklit pesë shekuj para Jezukrishtit.

U mat ta tregonte të fshehtën, por sekretari s'mbahej dot më në këmbë. «Qysh kur bota është botë, s'e ka zbuluar dot njeri se kush i vë paskuinët», tha ai prerazi, me njëfarë agresiviteti. Gjykatës Arkadioja e vështroi vëngër.

— E vëmë bast që unë kam për ta zbuluar, — i tha.

— E vëmë.

Rebeka de Asisit po i merrej fryma në dhomën e nxehtë të gjumit të shtëpisë kundruall, me kokën e zhytur në nënkresë, duke u përpjekur më kot të merrte një sy gjumë asaj pasdreke. Tëmblat i kishte të pllakosura me gjethe të thata.

— Roberto, — tha duke iu drejtuar të shoqit, — po s'e hape dritaren do të vdesim vapë.

Roberto Asisi hapi dritaren në çastin kur gjykatës Arkadioja po dilte prej zyre.

— Përpiqu të flesh, — iu lut gruas së vaposur që shtrihej me krahët hapur nën mbulesën e punuar me grep, krejt lakuriq nën një këmishë të hollë nailoni. — Të jap fjalën se nuk kam për ta zënë më në gojë.

Ajo psherëtiu.

Roberto Asisi, që e kish kaluar natën me ecejake nëpër dhomën e gjumit, duke ndezur cigare pas cigareje pa vënë dot gjumë në sy, për pak sa s'e kish kapur atë mëngjes autorin e paskuinëve. Kishte dëgjuar prej shtëpisë fëshfëritjen e letrës dhe zhurmën e duarve që mundoheshin ta ngjisnin në mur. Por e kuptoi me vonesë dhe paskuini qe vënë. Kur çeli dritaren, sheshi ishte i shkretë.

Qysh nga ai çast gjer më dy pasdreke, kur i dha fjalën së shoqes se nuk kishte për ta zënë më në gojë paskuinin, ajo pat bërë çmos e çnuk për

ta qetësuar. Më në fund kish arritur deri sa ti propozonte si provë të mbrame të pafajësisë së saj që të rrëfehej tek at Anheli me zë të lartë dhe në prani të tij. Vetëm ky propozim, që qe një poshtërim i vërtetë për gruan, sikur ia pat mbushur mendjen. Ndonëse qe bërë tym, nuk ia mbajti ta hidhte këtë hap dhe u detyrua të dorëzohej.

— Gjithnjë më mirë kur thuhen gjërat, — foli ajo pa i hapur sytë. — Ç'fatkeqësi e madhe do të kish qenë po ta kishe mbajtur përbrenda.

Ai puthiti derën mirë tek dilte nga dhoma. Në shtëpinë e madhe, të kredhur në mugëtirë, me dyer e dritare të mbyllura, i kapi veshi zukamën e ventilatorit elektrik të së ëmës, e cila bënte gjumin e pasdrekës në shtëpinë ngjitur. Mori një gotë limonadë në frigorifer, nën vështrimin e përgjumur të kuzhinieres zezake.

Nga qoshja e freskët ku kish zënë vend, ajo e pyeti nëse deshte të hante drekë. Ai ngriti kapakun e kusisë. Një breshkë e plotë pluskonte këmbëpërpjetë në ujët e valuar. Për herë të parë nuk e shqetësoi mendimi se kafsha qe hedhur e gjallë në kusi dhe se zemra e saj do të vazhdonte të rrihte edhe kur ta shpinin të prerë copash në tryezë.

— S'kam uri, — tha duke mbyllur kusinë. Dhe shtoi që nga dera: — As zonja nuk do të hajë. I ka dhembur koka gjithë ditës.

Dy shtëpitë punonin përmjet një rrugine të brendshme të shtruar me pllaka jeshile, prej nga mund të shihej koteci i thurur me tel në fund të oborrit të përbashkët. Në pjesën e rruginës që i takonte shtëpisë së nënës kishte disa kafazë me zogj të varur nën strehë dhe gjithatë saksi lulesh me ngjyra të ndezura.

Nga shezlongu ku kish bërë gjumin e pasdre-

kës, e bija shtatëvjeçare e priti me një përshëndetje hundë e buzë. Kishte ende në faqe gjurmën e cohës së nënkresës.

— Ora po vete tre, — i tha ai me zë shumë të ulët. Pastaj shtoi me një mërzi të dukshme: — Tani je e madhe dhe duhet t'i kuptosh vetë këto gjëra.

— Pashë në ëndërr një maçok prej qelqi, — i tha e vogla.

Ai s'mundi ta përmbante një të rrëqethur të lehtë.

— Si ishte?

— Qelq i tërë, — tha e vogla duke u përpjekur të bënte me duar formën e kafshës që kish parë në ëndërr; — tamam si zog prej qelqi, vetëm se qe maçok.

Atij iu duk vetja si i humbur në një qytet të huaj, nën diellin saç. «Harroje, — i pëshpëriti, — janë budallallëqe». Atë cast pa të ëmën te dera e dhomës së gjumit dhe e ndjeu veten të çliruar.

— Qenke më mirë, — i tha.

Vejusha De Asis ia ktheu me një shprehje të hidhur. «Cdo ditë bëhem më mirë që t'ia arrij përsëri ditës së votimeve», u qa duke lidhur nga prapa flokët e bollshëm ngjyrë hekuri. Doli në rruginë për t'u ndërruar ujët kafazëve.

Roberto Asisi u lëshua në shezlongun ku kish fjetur e bija. Me zverkun mbështetur në duar ndoqi me sy të perënduar gruan eshtake të veshur në të zeza, që kuvendonte ultas me zogjtë. Ata pllaquriteshin në ujët e freskët duke i stërpikur asaj fytyrën me krahërrahjet e tyre të hareshme. Kur mbaroi me kafazët, vejusha De Asis i hodhi të birit një vështrim gjithë dyshim.

— Unë të pandehja në mal, — tha.

— Nuk vajta, — ia ktheu ai. — Kisha ca punë.

— Nuk ke për të vajtur deri të hënën.

Ai ia bëri jo me sy. Një shërbëtore zezake, zbathur, kaloi nëpër dhomë me çupëzën për ta shpënë në shkollë. Vejusha De Asis ndenji në rruginë deri kur ato dolën. Pastaj i bëri me shenjë të birit dhe ky i ra pas deri në dhomën e madhe të gjumit ku zukaste ventilatori elektrik. Ajo u lëshua në një karrige përkundëse shkatarraqe prej xunkthi përballë ventilatorit, me një pamje rraskapitjeje të plotë. Në muret e lyera me gëlqere të bardhë vareshin fotografi fëmijësh të dikurshëm të futura në suaza bakri. Roberto Asisi u shtri në shtratin madhështor ku patën vdekur, ose më sakt patën dhënë shpirt me zor, disa nga fëmijët e fotografive, duke përfshirë edhe të atin, dhjetorin e shkuar.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti vejusha.

— Ti i beson fjalët e botës? — ia ktheu ai pyetjen me pyetje.

— Në moshën time njeriu ç'nuk beson, — ia priti vejusha. Pastaj e pyeti plogësht: — Ç'thonë bota?

— Se Isabel de Asisi s'është ime bijë.

Vejusha zuri të përkundej ngadalë. «Ajo ka tamam hundën e Asisëve, — tha. Dhe, si u mendua një grimë, pyeti si me shkujdesje: — Kush e thotë?»

Roberto Asisi kafshoi thonjtë.

— Vunë një paskuin.

Vetëm atëherë e kuptoi vejusha se rrathët e zinj të syve të të birit s'kishin asnjë lidhje me pagjumësinë.

— Paskuinët s'janë bota, — tha ajo prerë.

— Por ama thonë atë që thotë bota, — tha

Roberto Asisi; — sado që ti vetë mund të mos e dish.

Ajo, megjithëkëtë, i dinte gjithë ç'pat folur fshati për familjen e saj vite e vite të tëra. Në një shtëpi si e saja, me një qerre hallajkash e lloj-lloj çupash të bëra bija për shpirt, veç të zije veshët me duar për të mos dëgjuar fjalët e botës. Asisët e paqetë, themelues të fshatit qysh kur patën qenë ca derrarritës të thjeshtë, e paskëshin pasur gjakun të ëmbël për thashethemet.

— Jo të gjitha ç'fliten janë të vërteta, — tha ajo; — sado që ti vetë mund ta dish.

— Të gjithë e dinin që Rosario de Monteroja e kish mpleksur me Pastorin, — tha ai. — Ai edhe këngën e fundit për të e kish bërë.

— Kështu thoshin bota, por asnjeri s'e mori vesh me siguri, — u gjegj vejusha. — Sa për këngën, tani u mor vesh se paskësh qenë për Margot Ramiresin. Do të martoheshin dhe vetëm ata dhe e ëma e Pastorit e dinin. Po ai i ziu do të kish bërë mirë të mos e kish ruajtur me kaq xhelozi këtë të vetmin sekret që mundi të ruante në këtë fshat.

Roberto Asisi ia nguli sytë së ëmës me një pamje dramatike. «Sot në mëngjes për një çast sa s'më ra pika», tha. Vejushës këto fjalë s'i bënë ndonjë përshtypje kushedi se çfarë.

— Asisët janë xhelozë, — tha. — Ky ka qenë mallkimi i kësaj shtëpie.

Një copë herë të madhe qëndruan në heshtje. Po shkonte ora katër dhe vapa kish filluar të binte. Kur Roberto Asisi fiku ventilatorin, shtëpia e tërë sikur u zgjua plot zëra grash e këngëzime zogjsh.

— Ma jep pak atë shishezën mbi komodinë, — tha vejusha.

Mori dy kokrra të hirta si dy perla artificiale dhe ia ktheu shishezën të birit, duke i thënë: «Merr edhe ti dy, të bëjnë mirë për gjumë». Ai mori dy, piu ujin që kish lënë e ëma në gotë dhe mbështeti sërish kokën në nënkresë.

Vejusha psherëtiu. U bë një heshtje që ndillte mendime. Pastaj duke bërë siç kishte zakon, një përgjithësim të të gjithë fshatit me ato pesë-gjashtë familje të sërës së saj, tha:

— E keqja e këtij fshati është se grave u duhet të rrinë vetëm në shtëpi, ndërkohë që burrat venë në mal.

Roberto Asisin po e zinte gjumi. Vejusha kundroi mjekrën e parruar, hundën e gjatë me kërce qoshake dhe i shkoi mendja tek i ndjeri burri i saj. Edhe Adalberto Asisi i pat provuar këto vuajtje. Kish qenë një malësor shtatvigan që pat vënë jakë celuloidi vetëm për pesë minuta gjatë jetës së tij, për të bërë atë fotografi që qe ende aty mbi komodinë. Thoshin për të se pat vrarë në po atë dhomë gjumi një burrë që e kish gjetur në shtrat me të shoqen dhe se e kish varrosur në oborr. E vërteta qe ndryshe: Adalberto Asisi kish vrarë me një të shtënë çifteje një djalurçinë që e kishte zënë duke i rënë me dorë prapa derës së dhomës së gjumit, me sytë ngulur mbi gruan e tij ndërkohë që ajo ndërrohej. Vdiq mbas dyzet vjetësh, por legjenda i mbeti që i mbeti.

At Anheli ngjiti shkallën e thiktë me shkallare larg njëra-tjetrës. Në katin e dytë, përfund një korridori me pushkë e gjerdanë fishekësh

të varura në mur, një polic lexonte i shtrirë përmbys në një krevat fushimi. Që aq i kredhur në lexim, saqë e vuri re famullitarin vetëm kur dëgjoi përshëndetjen e tij. E bëri revistën rul dhe u ul shesh në krevat.

— Ç'është ajo që po lëçit?

Polici i tregoi revistën.

— «Terri dhe piratët».

Famullitari këqyri me një vështrim të vëmendshëm tri qelitë prej betonarmeje, pa frëngji, të mbyllura nga ana e korridorit me shufra të trasha hekuri. Në qelinë e mesit një polic flinte fill në të mbathura, i zdërgjuar sa gjatë gjerë në një hamak. Qelitë e tjera qenë bosh. At Anheli pyeti për Sesar Monteron.

— Është këtu, — tha polici duke ia bërë me kokë nga një derë e mbyllur. — Në dhomën e komandantit.

— Mund të flas pak me të?

— Është në izolim, — tha polici.

At Anheli nuk nguli këmbë. Pyeti në ishte mirë i arrestuari. Polici iu përgjigj se e kishin vënë në dhomën më të mirë të alkaldisë, me dritë e me ujë brenda, por se kishte njëzet e katër orë pa ngrënë. Nuk i kishte pranuar ushqimet që alkaldi pat dhënë urdhër t'i sillnin nga bujtina.

— Ka frikë se mos e helmojnë, — përfundoi polici.

— Duhet t'i kishin sjellë për të ngrënë nga shtëpia, — tha famullitari.

— Nuk do që ta shqetësojnë të shoqen.

Si duke folur me vete, famullitari mërmëriti: «Duhet ta bisedoj me alkaldin». U mat të shkonte nga fundi i korridorit, ku alkaldi kishte ndërtuar zyrën e tij të blinduar.

— S'është aty, — i tha polici. — Ka dy ditë që është në shtëpi, i dhemb dhëmballa.

At Anheli i vajti në shtëpi. Alkaldi qe shtrirë në hamak, pranë një karrigeje ku kishte një broke me ujë të kripur, një pako me aspirina dhe gjerdanin e fishekëve me revolverin. Faqen vazhdonte ta kishte të buhavitur. At Anheli afroi një karrige pranë hamakut.

— Shkoni ta nxirrni, — i tha.

Alkaldi zbrazi në legen gllënjkën e ujit të kripur. «Një fjalë goje është ajo», tha me kokën ende të varur mbi legen. At Anheli e kuptoi. I tha me zë shumë të ulët:

— Po deshët, flas unë me dentistin, — mori një herë frymë thellë dhe pastaj shtoi: — Është burrë që merresh vesh.

— Është një kokëmushkë që s'e ka shokun, — tha alkaldi. — E di unë si e do ai...

At Anheli e ndoqi me vështrim te lavamani. Alkaldi futi fytyrën në ujë të ftohtë dhe e mbajti aty një çast, me një shprehje dallëe. Pastaj mbllaçiti një aspirinë dhe piu ujë të ftohtë duke e hedhur në gojë me duar.

— E kam me tërë mend, — tha famullitari, — flas unë me dentistin.

Alkaldi bëri një lëvizje padurimi.

— Bëni ç'të doni, at i shenjtë.

U shtri përmbys në hamak me sytë të mbyllur, me duart në zverk, duke marrë frymë thellë gjithë mllef e pezm. Dhembja filloi t'i bjerë. Kur hapi sytë përsëri, at Anheli e kundronte në heshtje, i ulur pranë hamakut.

— Po ju ç'ju pruri këtej? — e pyeti alkaldi.

— Sesar Monteroja, — tha famullitari duke i rënë drejt. — Ka nevojë për t'u rrëfyer.

— Është në izolim, — tha alkaldi. — Nesër, pasi të bëhen veprimet paraprake, mund ta merrni për t'u rrëfyer. Të hënën duhet nisur.

— U bënë dyzet e tetë orë, — tha famullitari.

— Kurse mua m'u bënë dy javë me këtë dhëmballë, — tha alkaldi.

Në dhomën e errët po fillonin të zukatnin mushkonjat. At Anheli vështroi nga dritarja dhe pa një re ngjyrë trëndafili të ndezur tek pluskonte sipër lumit.

— Po puna e të ngrënit? — pyeti.

Alkaldi u ngrit nga hamaku për të mbyllur derën e ballkonit. «Unë e bëra detyrën time, — tha. — Ai nuk do që ta shqetësojnë të shoqen e as t'i sjellin për të ngrënë prej bujtinës». Dhe filloi të bëjë dhomën me insekticid. At Anheli kërkoi një shami në xhep që të mos teshtinte, por në vend të shamisë gjeti një letër të bërë shuk. «Ah», thirri duke u përpjekur ta shtrinte letrën me gishtrinj. Alkaldi mbaroi me insekticidin. Famullitari zuri hundët, por tashmë qe vonë: teshtiu dy herë. «Teshtini, teshtini, at i shenjtë», i tha alkaldi. Pastaj me buzë në gaz shtoi:

— Kemi apo s'kemi demokraci?

Edhe at Anheli vuri buzën në gaz. Duke treguar zarfin e mbyllur, tha: «Harrova ta shtie këtë letër në postë». Gjeti shaminë në mëngën e veladonit dhe fshiu hundët e acaruara prej insekticidit. Mendjen e kishte te Sesar Monteroja.

— Kjo do të thotë t'i thash zorrën tjetrit.

— Përderisa i pëlqen, — tha alkaldi, — ne s'mund ta detyrojmë të hajë me zor.

— E kam hallin më tepër te ndërgjegjja e tij, — tha famullitari.

Pa hequr shaminë nga hundët, alkaldi i dha dhomës edhe një dorë tjetër insekticid. «Ndër-

gjegjen duhet ta ketë mjaft të qetë, përderisa ka frikë se mos e helmojnë», tha. Pastaj la pompën përtokë

— Ai e di që Pastorin e donin të gjithë, — tha.

— Edhe Sesar Monteron e duan, — ia priti famullitari.

— Po ja që ai që vdiq ishte Pastori.

Famullitari vështroi letrën. Drita u bë ngjyrë mëllage. «I gjori Pastor, — mërmëriti, — s'pati kohë të rrëfehej.» Alkaldi ndezi dritën para se të binte në hamak.

— Nesër do të jem më mirë, — tha. — Pas formaliteteve, mund ta merrni për t'u rrëfyer. Thatë gjë?

At Anheli s'kishte ç'të thoshte. «E kam hallin vetëm te ndërgjegjja», përsëriti. Dhe u ngrit në këmbë me një lëvizje madhështore. E porositi alkaldin të mos pinte shumë aspirina, ndërsa alkaldi nga ana e tij e porositi të mos harronte letrën.

— Edhe një gjë, at i shenjtë, — i tha alkaldi. — Bëni si të bëni dhe flisni një herë me atë xherahun e dhëmballëve. — Këqyri famullitarin që filloi të zbriste shkallët dhe shtoi me buzë në gaz: — Jo po, përpiqemi apo s'përpiqemi për konsolidimin e paqes?

I ulur te dera e zyrës së tij, përgjegjësi i postës sodiste diellin ndaj të perënduar. Kur at Anheli i dha letrën, ai hyri brenda, lagu me gjuhë një pullë prej pesëmbëdhjetë sentavosh për linjë ajrore si dhe mbitaksën e ndërtimeve. Pastaj filloi të kërkonte në sirtarin e tryezës. Kur u ndezën fenerët e rrugës, famullitari la disa të holla në banak dhe doli pa u përshëndetur.

Përgjegjësi vazhdoi të kërkonte në sirtar. Pas

një çasti, si u lodh së bëri rrëmujë letrurinat, shkroi me bojë në një cep të zarfit: *Pulla peseshe nuk ka.* Firmosi dhe i vuri vulën e zyrës.

Atë natë, pasi tha rruzaren, at Anheli gjeti një mi të ngordhur që pluskonte në enën e ujit të bekuar. Trinidadi po vinte çarqet në pagëzimtore. Famullitari e mbërtheu kafshëzën nga maja e bishtit.

— Do të na marrësh më qafë, — i tha Trinidadit duke i tundur para syve miun e ngordhur. — S'e di ti që ka besimtarë që mbushin shishet me ujë të bekuar për t'ua dhënë të sëmurëve ta pinë?

— E çë pastaj?

— Si çë pastaj? — ia priti famullitari. — Domethënë që të sëmurët të pijnë ujë të bekuar me arsenik.

Trinidadi i kujtoi se ende nuk ia pat dhënë të hollat për arsenikun. «Është allçi», i tha dhe i zbuloi të fshehtën. Kishte vënë allçi nëpër qoshet e kishës. Miu e kishte ngrënë dhe, një grimë më vonë, i tërbuar nga etja, kish vajtur për të pirë në enë. Uji ia kish ngrirë allçinë në stomak.

— Sidoqoftë, — tha famullitari, — më mirë përdor arsenikun. S'dua më minj të ngordhur në ujët e bekuar.

Në kthinë e priste një komision zonjash katolike, i kryesuar nga Rebeka de Asisi. Si i dha Trinidadit të hollat për arsenikun, famullitari tha nja dy fjalë për vapën që bënte aty brenda dhe zuri vend në tryezën e punës, përballë tri zonjave që prisnin në heshtje.

— Urdhëroni, zonja të nderuara.

Ato vështruan njëra-tjetrën. Rebeka de Asisi

hapi atëherë një erashkë me një peizazh japonez dhe i ra drejt:

— E kemi fjalën për paskuinët, at i shenjtë.

Me një zë të spërdredhur, si të tregonte ndonjë përrallë kalamajsh, parashtroi shqetësimin e fshatit. Tha se, ndonëse vdekja e Pastorit mund të quhej si «diçka krejtësisht personale», familjet e nderuara e ndienin për detyrë të shqetësoheshin për paskuinët.

E mbështetur në dorezën e ombrellëzës së saj, Adalhisa Montoja, më e madhja e të trejave, foli më troç:

— Ne zonjat katolike kemi vendosur të vëmë dorë në këtë punë.

At Anheli u mendua disa çaste. Rebeka de Asisi mori një herë frymë thellë dhe at Anheli tha me vete se si kish mundësi që ajo grua të nxirrte një afsh aq të nxehtë. Qe si një lulë në shpërthim, me një bardhësi të marrtë dhe shëndet të harlisur. Famullitari foli me vështrimin të ngulur në një pikë të papërcaktuar.

— Mendimi im, — tha ai, — është se nuk i duhet vënë veshi zërit të shkandullit. Ne duhet të ngrihemi mbi të e të vazhdojmë të ruajmë ligjin e zotit si deri më sot.

Adalhisa Montoja miratoi me një të tundur të kokës. Por të tjerat nuk qenë të një mendimi: u dukej se «kjo fatkeqësi me kalimin e kohës mund të sillte pasoja të kobshme». Atë çast gërviu altoparlanti i kinemasë. At Anheli i ra ballit me pëllëmbë. «Më ndjeni», tha, teksa kërkonte në sirtarin e tryezës listën e censurës katolike.

— Ç'film është sot?

— «Piratët e hapësirës», — tha Rebeka de Asisi. — Film me luftë.

At Anheli kërkoi sipas radhës alfabetike, duke

mërmëritur nëpër dhëmbë copëra titujsh, ndërkohë që përshkonte me gisht listën. U ndal sa ktheu faqen.

— «Piratët e hapësirës».

Lëvizi gishtin horizontalisht për të kërkuar klasifikimin moral, në çastin kur, në vend të diskut të pritur, dëgjoi zërin e sipërmarrësit. Lajmëronte pezullimin e filmit për shkak të kohës së keqe. Një nga gratë shpjegoi se sipërmarrësi po e merrte këtë vendim ngaqë publiku kërkonte t'i kthcheshin paratë në rast se shiu e ndërpriste filmin përpara gjysmës.

— Mëkat, — tha at Anheli: — bënte për të gjithë.

Mbylli fletoren dhe vazhdoi:

— Ku e kisha fjalën? Po. Ky është një fshat që e respekton fenë. Këtu e nëntëmbëdhjetë vjet, kur më dhanë famullinë, kishte njëmbëdhjetë kurora ilegale në familje të rëndësishme. Sot ka mbetur vetëm një dhe shpresoj se së shpejti edhe ajo do të legalizohet.

— Ne s'e kemi hallin për vete, — tha Rebeka de Asisi. — Po këta njerëz të gjorë...

— Kështu që s'kemi pse shqetësohemi fare, — vazhdoi famullitari, pa ia vënë veshin ndërprerjes. — Mjafton të shihni ndryshimet që ka pësuar fshati. Një herë e një kohë, një balerinë ruse dha në rrethakun e ndeshjes së gjelave një shfaqje vetëm për burra dhe në mbarim nxori në mezat gjithë ç'kish në trup.

Adalhisa Montoja e ndërpreu:

— Ashtu është, — tha.

Në të vërtetë asaj i kujtohej skandali ashtu siç ia patën treguar: kur balerina kishte mbetur dac fare, një plak nga galeria ia kish dhënë ulërimës, kish kërcyer mbi parmakë dhe kish derdhur ujët e hollë mbi spektatorët. I patën treguar

se edhe burrat e tjerë i kishin dhënë fund shfaqjes duke derdhur ujët mbi njëri-tjetrin mes një zallamahie të papërshkrueshme.

— Kurse tani, — vazhdoi famullitari, — provat tregojnë se në gjithë Prefekturën Apostolike ky është fshati që i respekton më tepër rregullat fetare.

Dhe nguli këmbë në tezën e vet. Përmendi disa çaste të vështira nga lufta e tij me dobësitë dhe luhatjet e gjenit njerëzor, derisa zonjat katolike s'po ia vinin më veshin dhe filluan të kishin hallin e vapës. Rebeka de Asisi hapi përsëri erashkën. Atëherë e zbuloi at Anheli se ku qe burimi i erëmimit. Era e *sandalit*[1] u ndie edhe më e fortë nëpër topitjen e dhomës. Famullitari nxori shaminë nga mënga dhe zuri hundët që të mos teshtinte.

— Në të njëjtën kohë, — vazhdoi, — kisha jonë është më e varfëra në gjithë Prefekturën Apostolike. Kambanat janë thyer dhe hijerorja është plot me minj, ngaqë mua më shkoi tërë jeta duke edukuar popullin me moralin e doket e mira.

Shkopsiti jakën. «Materien mund ta përpunojë edhe një çunak, — tha duke u ngritur në këmbë. — Kurse për të përpunuar moralin lipset punë e madhe dhe përvojë shumëvjeçare». Rebeka de Asisi ngriti dorën e saj të tejdukshme me unazën martesore e me një unazë të smeraldtë përsipër.

— Pikërisht, — foli. — Edhe ne thamë se me këta paskuinë gjithë mundi juaj vete dëm.

E vetmja grua që deri më atëherë s'e kish hapur gojën përfitoi nga heshtja për të ndërhyrë:

1 *Sandal* (santalum album) — bimë indomaleze, prej së cilës nxirret një vaj erëmirë. Gratë e përdorin esencën e tij si parfumeri dhe si antiseptik.

— Veç kësaj, duke pasur parasysh se vendi tani po rimëkëmbet, kjo fatkeqësi mund të prishë shumë punë.

At Anheli kërkoi një erashkë në dollap dhe filloi të bëjë fresk në mënyrë të matur.

— Këto janë dy gjëra që s'kanë lidhje njëra me tjetrën, — tha. — Kaluam një moment të vështirë politik, por morali i familjes mbeti i pacenuar.

Zuri vend para tre grave. «Edhe disa vjet dhe unë do të vete t'i them prefektit apostolik: ja ku e keni këtë fshat shembullor. Tani dërgoni një djalë të ri e energjik t'ju ndërtojë kishën më të mirë të Prefekturës.»

Bëri një të përkulur të pafuqi dhe thirri:

— Atëherë do të shkoj të vdes i qetë në shtëpinë e prindërve të mi.

Zonjat kundërshtuan. Adalhisa Montoja shpreh mendimin e përgjithshëm:

— Ju këtë fshat e keni si tuajin, at i shenjtë. Dhe ne duam të na rrini këtu për jetë e mot.

— Po qe nevoja për të ngritur kishë të re, — tha Rebeka de Asisi, — mund ta fillojmë fushatën qysh tani.

— Çdo send ka kohën e vet, — u gjegj at Anheli.

Pastaj, me tjetër ton, shtoi: «S'dua të qëndroj në krye të famullisë edhe kur të plakem. S'dua të më ngjasë si të gjorit Antonio Isabel të Sakramentit të Shumëshenjtë të Altarit Kastanjeda e Montero, i cili njoftoi ipeshkvin se në famullinë e tij po binte një shi zogjsh të ngordhur. Inspektori që u dërgua prej ipeshkvit e gjeti në sheshin e fshatit duke luajtur me kalamajtë «polici e hajduti.»

Zonjat shprehën habinë e tyre të madhe.

— Kush qe ky?

— Famullitari që vajti pas meje në Makondo, — tha at Anheli. — I kishte mbushur të njëqindtat.

Dimri, që qysh ditët e fundit të shtatorit i pat dhënë shenjat se do të bënte i fortë, shtrëngoi shumë atë fund jave. Alkaldi e kaloi të dielën duke mbllaçitur aspirina në hamak, ndërkohë që lumi i dalë nga shtrati bënte kërdinë në lagjet e ulëta.

Kur të hënën ndaj të gdhirë shiu reshti pak, fshatit iu deshën disa orë të merrte veten. U hapën herët salla e bilardos dhe rrojtorja, por shumica e shtëpive qëndruan mbyllur deri në orën njëmbëdhjetë. I pari që pati rastin të trondítej para tablosë së njerëzve që mbartnin shtëpitë e tyre drejt tokash më të larta, qe senjor Karmiçaeli. Grupe të zhurmshme kishin shkulur trarë e pajandra dhe kishin ngritur krejt kasollet prej kallami e balte me gjithë çatitë prej degësh palme.

Strukur nën strehën e rrojtores, me çadrën të hapur, senjor Karmiçaeli kundronte se si hiqnin ata njerëz, kur berberi e solli në vete.

— Të kishin pritur sa të pushojë, — tha berberi.

— S'ka për të pushuar për dy ditë, — tha senjor Karmiçaeli dhe mbylli çadrën. — Ma thonë kallot mua.

Njerëzit që bartnin shtëpitë, të zhytur deri te nyejt në baltë, kaluan duke u përplasur pas mureve të rrojtores. Senjor Karmiçaeli pa nga dritarja pjesën e brendshme të një dhome gjumi të zhveshur nga të gjitha dhe u ul i pushtuar nga një ndjesi mynxyre.

Dukej sikur qe ora gjashtë e mëngjesit, por stomaku i tregonte se pas pak do të binte dymbëdhjeta. Siriani Moises e ftoi të hynte në dyqanin e tij derisa të pushonte shiu. Senjor Karmiçaeli e përsëriti parashikimin dhe tha se shiu as të nesërmen s'kishte për të pushuar. Ngurroi pak sa të hidhte rrugën për në shtëpinë kundruall. Një tufë çunash që luanin luftash ia veshën me një top balte që u përplas te muri disa metra larg pantallonave të tij të sapohekurosura. Siriani Elias doli nga dyqani me një fshesë në dorë, duke iu kanosur çunave me një shtrapa-shtrupa arabisht e spanjisht.

Çunat kërcyen përpjetë nga gëzimi:

— Koqe turku! Koqe turku!

Senjor Karmiçaeli u sigurua që kostumi nuk i qe spërkatur. Atëherë shtrëngoi çadrën, hyri në rrojtore dhe u ul drejt e në karrige.

— Gjithmonë e kam thënë që ju jeni njeri i matur, — tha berberi.

I lidhi një pecetë rreth qafës. Senjor Karmiçaeli thithi erën e ujit të livandës që i shkaktonte të njëjtën bezdi si dhe avujt e akullt të dentisterisë. Berberi zuri t'i merrte pas zverkut flokët e shkurtër. I paduruar, senjor Karmiçaeli kërkoi me sy diçka për të lexuar.

— S'paska gazeta?

Berberi iu përgjigj pa ndaluar punën:

— Në gjithë vendin kanë mbetur vetëm gazetat zyrtare dhe ato nuk hyjnë këtu sa të jem unë gjallë.

Senjor Karmiçaeli pa ç'pa dhe filloi të këqyrte këpucët e veta me gjysma faqesh deri kur berberi e pyeti për vejushën De Montiel. Senjor Karmiçaeli vinte prej shtëpisë së saj. Qe administrator i shtëpisë së saj qysh kur pat vdekur don Çepe Montieli, tek i cili kish punuar llogaritar për shumë vjet.

— Këtu është, — iu përgjigj.

— Tjetri vritet dhe së bijës së botës i mbeten toka që s'i përshkon dot me kalë as për pesë ditë. Duhet t'i ketë nja dhjetë çifligje.

— Tre, — tha senjor Karmiçaeli. — S'bën nëna grua si ajo.

Berberi u kthye nga dollapi i tualetit për të pastruar krehërin. Senjor Karmiçaeli pa në pasqyrë fytyrën e tij prej cjapi dhe e kuptoi edhe një herë përse nuk kishte pikë respekti për të. Berberi foli duke vështruar fytyrën e vet.

— Ama tregti e bukur! Vjen në fuqi partia ime, policia kërcënon me vdekje kundërshtarët e mi politikë dhe unë ua ble toka e bagëti me sa ma ka qejfi mua.

Senjor Karmiçaeli uli kryet. Berberi filloi prapë t'i shkurtonte flokët. «Kështu që, kur mbarojnë zgjedhjet, — përfundoi ai, — ja ku dal me tre çifligje në dorë, konkurrues nuk kam e s'dua t'ia di në bie a s'bie Qeveria.»

— Hosé Montieli qe i pasur qysh para se të fillonin avazet politike, — tha senjor Karmiçaeli.

— Posi, qysh kur ulej me brekë te dera e një mulliri orizi, — tha berberi. — Gjithë fshati e di që ai mbathi këpucë për herë të parë vetëm para nëntë vjetësh.

— Edhe në qoftë ashtu, — pranoi senjor Karmiçaeli, — vejusha s'pati asnjë lidhje me tregtinë e Montielit.

— Sepse u hoq sikur s'merrte vesh.

Senjor Karmiçaeli ngriti supet. Liroi pak pecetën nga fyti se po i zinte frymën. «Pranduj është më mirë kur të qeth gruaja, — tha, — se jo vetëm s'i paguan gjë, por edhe s'të çan veshët duke llapur për politikë». Berberi i shtyu kokën përpara dhe vazhdoi punën në heshtje. Nganjëherë qethte ajrin me gërshërë si për të shkarkuar një virtuozitet që nuk e përmbante dot. Senjor Karmiçaeli dëgjoi britma nga rruga. Vështroi nga pasqyra: fëmijë dhe gra kalonin para portës me orenditë dhe enët e shtëpive mbi shpinë. Komentoi gjithë mllef:

— Ne po na hanë shpirtin fatkeqësitë e natyrës, kurse ti s'hoqe që s'hoqe dorë nga pasionet politike. Ka një vit që kanë mbaruar persekutimet e akoma s'pushojnë fjalët.

— Edhe ta lësh tjetrin pasdore persekutim është, — tha berberi.

— Por ama nga druri kemi shpëtuar, — tha senjor Karmiçaeli.

— Ta lësh tjetrin në mëshirë të zotit është njësoj si t'i japësh dru.

Senjor Karmiçaelit i hipën xhindet.

— Kjo është propagandë gazetash, — tha.

Berberi s'foli. Bëri shkumë në një taskë dhe ngjeu me furçë zverkun e senjor Karmiçaelit. «Plas njeriu po s'foli, — u justifikua. — Rrallë e tek të vjen në derë një njeri i paanshëm».

— Po të ketë njëmbëdhjetë kokë kalamaj për të ushqyer, çdo njeri bëhet i paanshëm, — tha senjor Karmiçaeli.

— Afërmendsh.

Pasi e bëri briskun të këndonte mbi pëllëmbë, ia rroi zverkun në heshtje, duke ia fshirë shkumën me gishta dhe duke i fshirë pastaj gishtat pas pantallonave. Në fund ia bëri zverkun me shap. Derisa mbaroi nuk foli më asnjë fjalë.

Teksa kopsiste jakën, senjor Karmiçaeli pa lajmërimin e mbërthyer në murin përballë: «Ndalohen bisedat politike». Shkundi qimet e flokëve nga supet dhe pyeti duke treguar lajmërimin:

— Pse nuk e heq?

— S'është për ju, — ia ktheu berberi. — E thamë që ju jeni i paanshëm.

Senjor Karmiçaeli nuk ngurroi më për të kaptuar rrugën. Berberi e kundroi derisa mori kthesën, pastaj u shkri e u magjeps pas lumit të turbullt që kish marrë një pamje kërcënuese. Shiu kishte pushuar, por një re e errët që varur mbi fshat. Pak para se të shkonte ora një, hyri siriani Moises, duke u qarë se po i binin flokët e çaçkës, ndërkohë që ato të zverkut po i rriteshin me shpejtësi të jashtëzakonshme.

Siriani qethej të hënë për të hënë. Zakonisht përkulte kokën me njëfarë fatalizmi, gërrhinte duke mërmëritur arabisht, ndërsa berberi fliste me vete me zë të lartë. Sidoqoftë, atë të hënë kërceu përpjetë që me pyetjen e parë:

— E di kush qe këtu?

— Karmiçaeli, — tha siriani.

— I ziu Karmiçael, — pohoi berberi, duke i shqiptuar germat një nga një. — S'i duroj dot këta lloj njerëzish.

— Karmiçaeli nuk është njeri, — tha siriani Moises. — Ai ka tre vjet që s'ble një palë këpucë. Por ama vetëm për një gjë nuk ia ha qeni shkopin: di t'i vërtisë hesapet e së zonjës me sy mbyllur.

Vari kryet në kraharor për të gërrhitur sërish, por berberi i doli përpara me krahët të kryqëzuar e i tha: «A s'më thua, o turk i mutit: me kë je ti, që ta marrim vesh njëherë?» Siriani iu përgjigj pa e prishur terezinë:

— Me veten time.

— E pra dije që s'e ke mirë, — i tha berberi. — I paske harruar shpejt ato katër brinjët që i thyen të birt të patriotit tënd, Eliasit, për hesap të don Çepe Montielit.

— Eliasin e gjorë e ka gjetur belaja që i biri i merret me politikë, — tha siriani. — Por tani djali po bën pallë në Brazil, kurse Çepe Montielit i ka mbirë bari.

Para se të dilte prej dhomës së bërë rrëmujë nga netët e gjata të sfilitjes, alkaldi rroi anën e djathtë, kurse në të majtën e la mjekrën tetëditëshe. Pastaj veshi uniformën e pastër, mbathi çizmet lustrafin dhe zbriti të hante drekë në bujtinë duke përfituar nga reshtja e shiut.

Në sallën e ngrënies nuk kishte asnjeri. Alkaldi çau mes tryezave katërshe dhe zuri vendin më të mënjanuar.

— Ej, horra, — thirri.

Erdhi me vrap një vajzë e re, me një fustan të shkurtër e të qepur pas trupit dhe gjinj si gurë. Alkaldi porositi për të ngrënë pa ia shtënë sytë. Ndërsa kthehej në kuzhinë, vajza ndezi radion e vendosur në një raft në mur në fund të korridorit. U dëgjua një buletin lajmesh, me citate nga një fjalim i mbajtur të mbrëmëshmen prej presidentit të republikës, pastaj një listë e artikujve të rinj, importimi i të cilëve ndalohej. Bashkë me zërin e folësit që mbushte mjedisin, u shtua edhe vapa. Kur vajza erdhi me supën, alkaldi po përpiqej të mbante djersët duke bërë fresk me kapelen.

— Edhe mua radioja më bën të djersij, — tha vajza.

Alkaldi filloi të hante supën. Gjithmonë kish menduar se ajo bujtinë vetmitare, ku ndaleshin udhëtarë që u binte udha, ndryshonte krejt prej pjesës tjetër të fshatit. Në të vërtetë, ajo kish qenë përpara fshatit. Në verandën e saj shkatarraqe prej druri tregtarët që vinin nga brenda vendit për të blerë orizin që sapo korrej, e shkonin natën duke luajtur letrash e duke pritur freskinë mëngjesore për të bërë një sy gjumë. Vetë koloneli Aureliano Buendia, që shkonte në Makondo për të vendosur kushtet e kapitullimit të luftës së fundit civile, kishte fjetur një natë në atë verandë, në një kohë kur shumë lega përreth nuk kishte asnjë fshat. Atëherë pat qenë po kjo shtëpi prej dhogash e me çati prej zinku, me të njëjtën sallë ngrënieje dhe të njëjtat ndarje prej kartoni të dhomave, vetëm se pa dritë elektrike, pa ujë brenda e pa nevojtore. Një komisioner shëtitës tregonte se deri në fillim të shekullit kish patur një koleksion maskash të varura në murin e sallës së ngrënies dhe klientët me maskë në fytyrë kryenin nevojat në oborr, në sytë e gjithë botës.

Alkaldit iu desh të shkopsiste jakën për të mbaruar supën. Pas buletinit të lajmeve vazhdoi një disk me reklama nga një anë dhe me një bolero sentimentale nga tjetra. Një burrë me zë shumë të njohur, i vdekur dashurie, kish vendosur t'i binte botës qark pas gjurmëve të një gruaje. Alkaldi ua vuri veshin fjalëve, ndërkohë që priste pjatat e tjera, derisa pa të kalonin para bujtinës dy fëmijë me dy karrige dhe një tryezë. Pas tyre, dy gra dhe një burrë me kusi e enë të tjera.

Doli te dera duke thirrur:

— Ku i keni vjedhur ato plaçka?

Gratë u ndalën. Burri i shpjegoi se po barteshin në toka më të larta. Alkaldi i pyeti se ku dhe burri i tregoi me sombrero në drejtim të jugut:

— Andej përpjetë, te një truall që na e ka dhënë me qira don Sabasi për tridhjetë pesos.

Alkaldi u hodhi një sy orendive. Një tryezë shkatarraqe, ca kusi të deformuara: plaçka varfanjakësh. U mendua një grimë. Pastaj tha:

— Shpjerini rraqet te trualli që është bosh pranë varrezave.

Burri u turbullua.

— Janë toka të bashkisë, — tha alkaldi. — Bashkia i fal.

Pastaj, duke iu drejtuar dy grave, shtoi: «Dhe thuajini don Sabasit që të dërgon fjalë alkaldi të heqësh dorë nga hajdutllëqet».

Të ngrënët nuk i shijoi fare. Kur mbaroi, ndezi një cigare. Ndezi edhe një tjetër me bishtin e së parës dhe ndenji një copë herë i menduar, me bërrylat të mbështetur në tryezë, ndërsa radioja vazhdonte me bolerot sentimentale.

— Ku e keni mendjen? — e pyeti vajza, duke hequr pjatat e zbrazëta.

Alkaldi s'lojti qepallë.

— Tek ata njerëz të varfër, — tha.

Vuri kapelen dhe çau nëpër sallë. Duke bërë një gjysmëkthim, tha nga dera:

— Duhet bërë një fshat për të qenë, ky fshat i gjorë.

Një përleshje e përgjakshme qensh i preu rrugën në një kthesë. Pa një lëmsh shpinash dhe putrash mes një pështjellimi kujisjesh, pastaj disa dhëmbë që zbardhnin dhe një qen duke hequr zvarrë një këmbë me bisht ndër shalë. Alkaldi bëri mënjanë dhe vazhdoi rrugën deri në alkaldi. Një grua çirrej në qeli, ndërsa roja

bënte gjumin e drekës i shtrirë përmbys në një krevat. Alkaldi i dha një shkelm me këmbë krevatit. Roja u zgjua broftas.

— Kush është kjo?

Roja qëndroi gatitu.

— Është ajo që vinte paskuinët.

Alkaldi shpërtheu në të shara kundër vartësve. Deshte të dinte kush e kish arrestuar dhe me urdhër të kujt e kishin rrasur në qeli. Policët s'dinin gjë të saktë.

— Kur e kanë futur?

E kishin futur të shtunën mbrëma.

— Të dalë ajo e të futet njëri nga ju, — thirri alkaldi. — Ndërsa kjo grua ka fjetur në qeli, fshati prapë u gdhi me fletushka.

Me t'u çelur dera e rëndë prej hekuri, një grua e shkuar në moshë, koskëdalë dhe me një topuz të stërmadh flokësh të mbajtur me një krehër, doli nga qelia duke shfryrë e duke sharë.

— Ikë në djall, — i tha alkaldi.

Gruaja zgjidhi topuzin, ua dha disa herë leshrave të gjata e të bollshme dhe zbriti shkallët me vrap, duke thurrur: «Këlyshët e kurvës!» Alkaldi u përkul mbi parmakët e verandës dhe thirri me sa i hante fyti, si për ta dëgjuar jo vetëm gruaja dhe rojet e tij, por krejt fshati:

— E mos më hani mut më me ato letrurinat!

Ndonëse shiu i hollë vazhdonte, at Anbeli doli të bëte shëtitjen e tij të ndajnatës. Qe ende herët për takimin me alkaldin, kështu që ia mbajti një herë nga zona e përmbytjeve. Gjeti vetëm kufomën e një maçoku që pluskonte mes luleve.

Tek kthehej, mbrëmja filloi të thahej, ngjyrat

u ndezën e u bënë më të forta. Një anije e mbuluar me mushama zbriste tepshtë lumit të trashë e të palëvizshëm. Nga një shtëpi gjysmë e shembur doli një fëmijë duke thirrur se kish gjetur detin brenda në një guaskë. At Anheli afroi guaskën te veshi. Deti vërtet qe aty.

Gruaja e gjykatës Arkadios qe ulur te porta e shtëpisë, si e pushtuar prej një dalldie, me krahët kryq mbi bark e me sytë ngulur pas anijes. Tri shtëpi më tej fillonin magazet, dyqanet e lirësirave dhe sirianët që s'e bënin qejfin qeder e rrinin ulur nëpër pragje. Muzgu po jepte shpirt në retë ngjyrëtrëndafil të ndezur dhe në zhurmërimat e papagajve e të majmunëve të bregut kundruall.

Shtëpitë po fillonin të hapeshin. Nën bajamet e ndotura të sheshit, përqark karrocave me pije freskuese ose nëpër ndenjëset e gurta vrima-vrima pranë sopeve, burrat po mblidheshin për të kuvenduar. At Anheli po mendonte se mbrëmje për mbrëmje, në këtë çast, në fshat ndodhte ajo mrekulli që quhej shpërfytyrim.

— Të kujtohen robërit e kampeve të përqendrimit, at i shenjtë?

At Anheli nuk e pa doktor Hiraldon, por e përfytyroi duke buzëqeshur pas dritares me rrjetë teli. Me thënë të drejtën, nuk i kujtoheshin fotografitë, por qe i sigurt që diku i kish parë.

— Kalo pak nga dhoma e pritjes, — i tha mjeku.

At Anheli shtyu derën me tel. Shtrirë në krevat ndodhej një krijesë që s'merrej vesh në qe mashkull a femër: vetëm koska të veshura me një lëkurë të verdhë. Dy burra dhe një grua prisnin të ulur pas perdes. Famullitari nuk ndjeu ndonjë erë, por e mori me mend se ajo qenie duhej të lëshonte një duhmë kutërbuese.

— Kush është ky?

— Im bir, — u gjegj gruaja. Dhe shtoi, si për t'u shfajësuar: — Ka dy vjet që e heq barku me gjak.

I sëmuri ktheu sytë nga dera pa lëvizur kryet. Famullitari ndjeu një mëshirë të përzier me tmerr.

— E ç'i keni bërë? — pyeti.

— Mbetëm duke i dhënë banane të pabëra, — tha gruaja — por s'po i bëjnë gjë, sido që thonë se ato ta mbledhin barkun.

— Duhet ta sillni për t'u rrëfyer, — tha famullitari.

Por e tha pa ndonjë bindje. Mbylli derën me kujdes dhe gërrici me thua rrjetën e dritares, duke afruar fytyrën për të parë mjekun brenda.

— Ç'ka? — e pyeti famullitari.

— Ende s'e kam parë, — iu gjegj doktori dhe shtoi i menduar: — gjëra që bëjnë vaki, at i shenjtë. Vullneti i zotit i ka në dorë.

At Anheli bëri sikur nuk e dëgjoi rromuzin.

— Nga gjithë të vdekurit që më kanë parë sytë në jetën time, asnjë s'më është dukur më i vdekur se ai djalë i gjorë, — tha.

I la lamtumirën doktorit. Në port nuk kishte asnjë lundër. Po errej. At Anheli e kuptoi se gjendja shpirtërore i pat ndryshuar pasi kish parë të sëmurin. Si e kuptoi se qe vonuar për në takim, shpejtoi hapin drejt alkaldisë.

Alkaldi qe kruspullosur në një shezlong, me kokën ndër duar.

— Mirëmbrëma, — tha famullitari shumë ngadalë.

Alkaldi ngriti kokën dhe famullitari u trondit tek pa sytë e tij të skuqur nga dëshpërimi. Një faqe e kishte të freskët e të rruar tërë, kurse tjetra qe një lëmsh i moçalepsur në një melhem

nglyrë hiri. Lëshoi një britmë të mbytur e të përvajshme:

— At i shenjtë, do t'ia heq vetes.

At Anheli u shtang.

— Ju po farmakoseni me gjithë këto aspirina, — i tha.

Alkaldi ia veshi me shkelm murit dhe, duke shkulur flokët me të dyja duart, u plandos për dysheme. Dhembje të tillë famullitarit s'i kishin parë sytë kurrë.

— Fundja, pini edhe dy aspirina, — i tha i ndërgjegjishëm që propozonte më tepër një ilaç për turbullimin e vet sesa për dhembjen e tjetrit. — S'keni për të vdekur edhe me dy copë.

Ishte krejt i pazoti para dhembjes njerëzore dhe këtë dobësi të vetes e dinte. Kërkoi me sy aspirinat nëpër sallën e zhveshur. Mbështetur pas mureve kishte nja pesë a gjashtë stola të veshur me lëkurë, një dollap xhamash me ca shkresa të pluhurosura dhe një portret të presidentit të republikës të varur në një gozhdë. E vetmja gjurmë e aspirinave ishin paketat prej celofani të flakura përtokë.

— Ku i keni? — pyeti famullitari.

— S'më bëjnë asgjë, — tha alkaldi.

Famullitari iu qas pranë, duke i përsëritur: «Ku i keni, flisni.» Alkaldi bëri një të brofur të furishëm dhe at Anheli pa një fytyrë të stërmadhe e të përçudnuar disa gishta larg syve të tij.

— Dreqi e mori, — thirri alkaldi. — Thashë që të mos më çajë bythën njeri.

Ngriti një stol sipër kokës dhe e përplasi me sa i hante krahu pas dollapit me xhama. At Anheli e kuptoi ç'pat ndodhur vetëm një grimë pasi xhami qe bërë copë e thërrime, kur alkaldi

fílloi t'i fanitej si një përhitje mes mjegullës së pluhurit. Heshtja që pasoi qe e plotë.

— Toger, — mërmëriti famullitari.

Te dera e korridorit kishin çatisur policët me pushkët ngrehur. Alkaldi u hodhi një sy pa i parë, duke marrë frymë si maçok, dhe ata i ulën pushkët, por vazhduan të qëndronin aty te dera. At Anheli e shpuri alkaldin për krahu deri te shezlongu.

— Ku janë aspirinat? — nguli këmbë.

Alkaldi mbylli sytë dhe hodhi kryet pas. «M'u bë barku farmaci me ato ndyrësira, — tha. — Më zukasin veshët dhe më është qepur gjumi në rrashtë të kresë.» Në atë copë herë të shkurtër që dhembja i kish pushuar, ktheu kryet nga famullitari dhe e pyeti:

— Folët me atë shkulësin e dhëmballëve?

Famullitari pohoi në heshtje. Nga shprehja e fytyrës së famullitarit pas përgjigjes, alkaldi e kuptoi përfundimin e bisedimeve.

— Pse nuk i thoni një herë doktor Hiraldos? — propozoi famullitari. — Ka edhe mjekë që nxjerrin dhëmballë.

Alkaldi e vonoi përgjigjen. «Ka për të thënë që s'ka darë», tha. Dhe shtoi:

— E kanë bërë me fjalë.

Përfitoi nga pushimi i dhembjes për të gjetur një grimë qetësi asaj mbrëmjeje të pamëshirshme. Kur hapi sytë, në dhomë qe gjysmerrësirë. Tha, pa i kthyer sytë nga at Anheli:

— Ju erdhët për Sesar Monteron.

S'u dëgjua përgjigje. «Me këtë dhembje nuk bëra dot asgjë», vazhdoi. U ngrit për të ndezur dritën dhe vala e parë e mushkonjave vërshoi nga ballkoni. At Anheli u çudit kur pa sa qe ora.

— Paska vajtur vonë, — tha.

— Sidoqoftë, të mërkurën duhet ta nisim, —

tha alkaldi. — Nesër bëjmë ç'kemi për të bërë dhe merreni për t'u rrëfyer aty nga mbasditja.

— Në ç'orë?

— Në katër.

— Edhe po të bjerë shi?

Me një vështrim alkaldi zbrazi gjithë paduri-min që kish ndrydhur përbrenda gjatë dy ja-vësh sfilitjeje.

— Edhe sikur të bëhet kiameti, at i shenjtë.

Aspirinat nuk i bënin më dot asgjë dhembjes. Alkaldi vari hamakun në ballkonin e dhomës së tij dhe u përpoq të flinte në freskinë e mbrë-mjes. Por para tetës ra përsëri në kthetrat e dëshpërimit dhe zbriti në plazhin e përgjumur prej një vale të rëndë vape.

Si u end nëpër rrethinat pa gjetur frymëzi-min që i duhej për të mposhtur dhembjen, hyri në kinema. Dhe bëri gabim. Zukama e avionëve të luftës ia shtoi dhembjen. Para pushimit doli nga kinemaja dhe kaloi nga farmacia në çastin kur don Lalo Moskoti sa po mbyllte dyert.

— Nëm ç'ke më të fortë për dhembjen e dhëmballëve.

Farmacisti ia këqyri faqen me sy të zgurdu-lluar. Pastaj vajti deri në fund të dyqanit, mes dy radhë dollapësh me kanata xhami të mbushur plot me vazo majolike, çdonjëra prej të cilave me emrin e produktit shkruar me germa bojë-qielli. Tek e këqyrte nga shpina, alkaldit i tha mendja se ai burrë me zverk të ngjallmë e të kuqërremë mbase jetonte tani një nga çastet më të lumtura të jetës së tij. E njihte. Banonte në dy dhoma në fund të farmacisë, dhe e shoqja,

një grua e bëshme, qe e paralizuar prej shumë vitesh.

Don Lalo Moskoti u kthye në banak me një vazo majolike pa etiketë. Kur e hapi, ajo lëshoi një erëmim barnash ëmbëlcakë.

— Ç'është kjo?

Farmacisti futi gishtrinjtë nëpër farërat e thata të vazos. «Nasturc, — i tha. — Mbllaçitini mirë dhe thitheni lëngun pak e nga pak: është dorë me një për dhembjen e dhëmballëve». Hodhi disa farëra në pëllëmbë dhe tha duke e vështruar alkaldin sipër syzeve.

— Hapeni gojën.

Alkaldi u shmang. E vërtiti një herë vazon për t'u bindur se s'kishte gjë të shkruar dhe ia mbërtheu sërish vështrimin farmacistit.

— Nëm ndonjë gjë të jashtme, — tha.

— Kjo është më e mirë se çdo gjë e jashtme, — tha don Lalo Moskoti. — Ka për garanci tremijë vjet përvojë popullore.

Filloi t'i mbështillte farërat me një copë gazetë. Nuk dukej si baba familjeje. Dukej si një dajo që mbështjell nasturcin me po atë kujdes e dashuri që bën një zogth letre për kalamajtë. Kur ngriti kryet, kishte filluar të buzëqeshte.

— Pse nuk e shkulni?

Alkaldi s'ktheu përgjigje. Pagoi dhe doli nga farmacia pa pritur kusurin.

Mesnata kish kaluar dhe ai vazhdonte të përpëlitej në hamak pa ia mbajtur të përtypte farërat. Aty nga njëmbëdhjeta, në piskun e vapës, ia kish dhënë një rrebesh që qe shndërruar në një shi të shtruar. Duke fërgëlluar nga ethet e duke u dredhur nga djersët e ftohta që i ngjiteshin për trup, u kthye përmbys në hamak dhe filloi të thoshte me mend një uratë. E tha uratën deri në fund, me kofshët të tendosura në një ngërç

të mbramë, por i vetëdijshëm se, sa më tepër përpiqej të hynte në lidhje me zotin, aq më e fortë i bëhej dhembja. Atëherë mbathi çizmet, hodhi mushamanë sipër pizhamave dhe vajti në alkaldi.

Hyri vrikthi duke ulërirë. Të kapur në beft midis realitetit dhe ankthit, policët u përplasën në rruginat mes shtretërve duke kërkuar armët në të errët. Kur u ndezën dritat, ata ishin gjysmë të veshur, në pritje të urdhërave

— Gonsales, Rovira, Peralta, — thirri alkaldi.

Tre policët që dëgjuan emrin dolën nga grupi dhe qarkuan togerin. As vetë alkaldi nuk mund ta thoshte pse kishte zgjedhur pikërisht ata: ishin tre metisë të rëndomtë. Njëri syresh, me tipare prej fëmije, i qethur zero, ishte vetëm në këmishën prej fanellate. Dy të tjerëve u dukej po ajo këmishë nën xhaketën ushtarake të pambërthyer.

Ndonjë urdhër të saktë nuk morën. Duke kapërcyer shkallinat katër nga katër pas alkaldit, dolën nga alkaldia në njëshkolonë, kaluan nëpër rrugë pa pyetur për shiun dhe u ndalën para shtëpisë së dentistit. Me nga dy të goditura të shpejta e thyen portën me kondakë. Kishin hyrë brenda kur u ndezën dritat e tremes. Një burrë shtatimët e i shogët, me pejzat të dukshme mbi lëkurë, doli në të mbathura te dera përkundruall, duke u përpjekur të vishte dollamën. Për një çast mbeti si i paralizuar me një krah përpjetë e me gojë të hapur, si në shkrepjen e një blici fotografik. Pastaj u hodh praptas dhe u përplas me të shoqen që sa po dilte nga dhoma e gjumit në këmishë nate.

— Mos lëvizni, — thirri togeri.

Gruaja ia bëri «ah», vuri duart në gojë dhe u kthye në dhomë. Dentisti bëri përpara nëpër

treme duke lidhur rripin e dollamës dhe vetëm atëherë i njohu tre policët që e kishin vënë në shenjë dhe alkaldin që kullonte ujë nga koka te këmbët, të qetë, me duart në xhepat e mushamasë.

— Në qoftë se zonja del nga dhoma e gjumit, keni urdhër ta qëlloni, — tha togeri.

Dentisti shtrëngoi dorezën e derës dhe i foli gruas brenda: «Dëgjove, shpirtkë?». Dhe mbylli me një kujdes të përpiktë derën e dhomës. Pastaj bëri drejt kabinetit, përmes orendive të çngjyrosura prej xunkthi, i vigjëluar prej syve të përturbullt të tytave. Dy policë hynë para tij në kabinet. Njëri ndezi dritën, tjetri vajti drejt e te tryeza e punës dhe nxori një revolver nga sirtari.

— Duhet të ketë edhe tjetër, — tha alkaldi.

Ai kish hyrë i fundit, pas dentistit. Dy policët bënë një bastisje të shpejtë e të zellshme, ndërkohë që i treti ruante te dera. Përmbysën kutinë e instrumentave mbi tryezën e punës, hapërdanë përtokë modelet prej allçie, proteza dhëmbësh të panumërta, dhëmbë të shkoqur e këllëfë ari. Zbrazën vazot majolike të dollapit me xham dhe shqyen me të goditura të shpejta bajonete jastëkun prej mushamaje të karriges dentale si dhe jastëçkën me susta të karriges rrotulluese.

— Një «38-sh» i madh me tytë të gjatë, — saktësoi alkaldi.

Dhe ia nguli sytë dentistit. «Më mirë tregoi vetë ku i ke, — i tha. — Se s'kemi ardhur të kthejmë përmbys shtëpinë». Pas syzeve me skelet ari sytë e ngushtë e të fikur të dentistit nuk tregonin asgjë.

— Unë me nge jam, — ia ktheu qetshëm, — ju po patët qejf ta ktheni përmbys, kthejeni.

Alkaldi u mendua. Pasi shqyrtoi edhe një he-

rë dhomën prej dërrasash të palatuara, bëri drejt karriges duke u lëshuar urdhëra të prerë policëve të tij. Njërin e vendosi te porta e rrugës, tjetrin në hyrje të kabinetit, kurse të tretin pranë dritares. Vetëm kur u ul në karrige dhe shkopsiti mushamanë e lagur, e ndjeu vetën të rrethuar prej metalit të ftohtë. Mori frymë thellë duke thithur ajrin e rralluar nga kreosoti dhe mbështeti rrashtën pas nënkresës së karriges duke u përpjekur të qetësonte frymëmarrjen. Dentisti mori që përdhe disa instrumenta dhe i vuri të ziejnë në një kusi.

Ndenji me shpinë nga alkaldi, duke kundruar zjarrin e kaltër të furnelës me vajguri, ashtu siç do të kish ndenjur edhe po të kish qenë vetëm në kabinet. Kur ujët valoi, e mbështolli dorezën e kusisë me një letër dhe e mori për ta shpënë drejt karriges. Rrugën ia pengonte polici. Dentisti uli kusinë për të vështruar alkaldin që sipër avullit dhe tha:

— Jepi urdhër këtij krimineli të mos më rrijë nëpër këmbë.

Me një shenjë të alkaldit polici u largua nga dritarja për ta lënë të lirë rrugën drejt karriges. Afroi një stol pranë murit dhe u ul me këmbë të hapura dhe pushkën tërthor mbi kofshët, pa e bjerrur vigjilencën. Alkaldi mbylli sytë e verbuar nga drita e ndezur befasisht dhe hapi gojën. Dhembja kishte pushuar.

Dentisti gjeti dhëmballën e sëmurë, duke mënjanuar me gishtin tregues faqen e enjtur dhe duke drejtuar llampën e lëvizshme me dorën tjetër, pa u merakosur për frymëmarrjen e shqetësuar të pacientit. Pastaj përveshi mëngën deri në bërryl dhe u bë gati ta shkulte.

Alkaldi e mbërtheu për kyçi të dorës.

— Anestezi, — i tha.

Vështrimet e tyre u takuan për herë të parë.

— Ju të vrisni pa anestezi, — i tha me ëmbëlsi dentisti.

Në dorën që shtrëngonte darët alkaldi nuk vuri re asnjë përpjekje për t'u çliruar. «Sill ampulat», tha. Polici, që kish zënë vend në qoshe, lëvizi tytën e pushkës drejt tyre dhe që prej karriges të dy dëgjuan zhurmën e mbushjes.

— Zëre se s'ka, — tha dentisti.

Alkaldi lëshoi kyçin. «Duhet të ketë», ia ktheu, duke shqyrtuar me vëmendje të dëshpëruar sendet e hapërdara përtokë. Dentisti e vështroi me keqardhje. Pastaj e shtyri pas nënkresës së karriges dhe, duke e humbur durimin për herë të parë, i tha:

— Mjaft u spërdrodhe si kurvat, toger. Me këtë abces që ke ti, s'ka anestezi që të bën dobi.

Si kaloi çasti më i tmerrshëm i jetës së tij, alkaldi i lëshoi muskujt e tendosur dhe qëndroi në karrige pa pikë fuqie, ndërkohë që shenjat e errëta të pikturuara prej vranësirës në kanavacën e qiellit të lëmuar po i ngulitheshin në kujtesë deri në vdekje. Dëgjoi dentistin që jepte e merrte te muslluku. E dëgjoi tek vinte në vend sirtarët e tryezës dhe tek mblidhte në heshtje prej dyshemesë disa nga instrumentat.

— Rovira, — thirri alkaldi. — Thuaji edhe Gonsalesit të vijë dhe mblidhini gjërat përtokë e i vini siç i gjetët.

Policët zbatuan urdhërin. Dentisti ngjeshi pak pambuk me pinca, e ngjeu në një lëng ngjyrë hekuri dhe zuri plagën. Alkaldi ndjeu një përcëllim të sipërfaqshëm. Pasi dentisti i mbylli gojën, vazhdoi t'i mbante sytë të mbërthyer në qiellin e lëmuar, me veshin te zhurmat e policëve që përpiqeshin të rindërtonin përmendsh rregullin e përkryer të kabinetit. Në fullë ra ora

dy. Një gatë, me një minutë vonesë, përsëriti orën mes zhurmërimit të shiut. Pas një grime, kur e kuptoi që kishin mbaruar, alkaldi ua bëri me shenjë policëve të ktheheshin në alkaldi.

Dentisti gjatë gjithë kohës kishte qëndruar pranë karriges. Kur dolën policët, i hoqi pambukun nga plaga, i shikoi mirë e mirë me dritë gojën brenda, pastaj i mbylli nofullat dhe skajoi dritën. Gjithçka kishte mbaruar. Në dhomën e ngrohtë kish mbetur ajo gjendje amështie që e njohin vetëm pastruesit e teatrit pasi ka dalë edhe aktori i fundit.

— Mosmirënjohës, — tha alkaldi.

Dentisti rrasi duart në xhepat e dollamës dhe bëri një hap mbrapa për t'i hapur udhë. «Kam pasur urdhër të të bastis shtëpinë, — vazhdoi alkaldi, duke e kërkuar me vështrim prapa orbitës së dritës. — Kisha udhëzime të sakta për *të gjetur* armë, municione dhe dokumenta me hollësitë e një komploti në rang kombëtar». I ngulì dentistit sytë ende të lagët dhe shtoi: «Unë pandehja se bëja mirë duke mos e zbatuar urdhërin, por qenkam gabuar. Tani punët s'janë më siç kanë qenë, opozita ka garanci dhe të gjithë jetojnë në paqe, kurse ju vazhdoni në qëndrimin tuaj prej komplotisti». Dentisti fshiu me mëngë jastëkun e karriges dhe e ktheu nga ana e pashqyer.

— Qëndrimi juaj përbën një rrezik për popullin, — vazhdoi alkaldi, duke treguar me gisht jastëkun, pa u merakosur për vështrimin që i hodhi dentisti faqes së tij. — Tani bashkisë i duhet të paguajë edhe gjithë këto zullume, plus portën e rrugës. Gjithato pará vetëm e vetëm për kokëfortësinë tuaj.

— Shpëlajeni gojën me ujë e bar grek, — tha dentisti.

Gjykatës Arkadioja hapi fjalorin e telegrafës te fjala «paskuin», mbasi fjalorit të tij i mungonin disa faqe. S'nxori asgjë në dritë. *Emër i një këpucari nga Roma, i famshëm për satirat që bënte kundër të gjithëve,* dhe sqarime të tjera pa rëndësi. Po t'u bëkësh kështu historia, mendoi ai, atëherë një sharje anonime e ngjitur te porta e një shtëpie mund t'u quajtkësh me plot të drejtë *marforio.* S'qe i zhgënjyer. Gjatë dy minutave që u mor me këtë studim, për herë të parë e ndjeu veten të lehtësuar, si pas një detyre të kryer.

Telegrafisti e pa tek linte fjalorin në raft mes fletë-telegrameve të harruara dhe urdhëresave mbi postëtelegrafat, ndërpreu transmetimin e një mesazhi dhe i bëri gjykatësit një shenjë. U afrua duke shkartisur letrat e bixhozit, i gatshëm për të përsëritur marifetin në modë: gjetjen e tri letrave. Por gjykatës Arkadioja nuk ia vuri veshin. «Tani s'kam nge», i tha dhe doli në rrugën e nxehtë i ndjekur prej sigurisë së turbullt se sapo kish vajtur ora njëmbëdhjetë dhe ajo e martë kishte ende edhe shumë orë që ai duhej t'i mbushte.

Në zyrën e tij e priste alkaldi, të cilit i kish dalë një problem moral. Në prag të zgjedhjeve

të fundit policia kishte sekuestruar dhe shkatërruar certifikatat e votimit të partisë së opozitës. Shumica e banorëve të fshatit tani nuk kishin fare letërnjoftime.

— Këta njerëz që po mbartin shtëpitë, — përfundoi alkaldi me krahët e hapur, — nuk dinë as emrin e vet.

Gjykatës Arkadioja e kuptoi se pas atyre krahëve të hapur fshihej një pikëllim i çiltër. Por ky qe një problem i thjeshtë: mjaftonte të kërkonin emërimin e një nëpunësi të gjendjes civile. Sekretari e thjeshtoi edhe më problemin.

— Mjafton vetëm ta urdhëroni të vijë, — tha.

— Ka një vit që është emëruar.

Alkaldit i ra ndër mend. Muaj më parë, kur i njoftuan emërimin e një nëpunësi të gjendjes civile, ai kish pyetur aty ku duhej se si lipsej ta priste dhe i qenë përgjigjur: «Vëri drunë». Tani ndryshonte puna. U kthye nga sekretari me duar në xhepa dhe i tha:

— Bëje shkresën.

Trokëllitja e makinës së shkrimit i dha zyrës një gjallëri që sikur e shkundi gjykatës Arkadion. E ndjeu veten bosh. Nxori nga xhepi i këmishës një gjysmë cigareje dhe e fërkoi mes pëllëmbëve para se ta ndizte. Pastaj hodhi karrigen pas deri ku mbanin sustat dhe në atë pozicion e pushtoi siguria përfundimtare se po jetonte një minutë të jetës së tij.

E përgatiti mirë fjalinë para se ta nxirrte:

— Po të isha unë, do të emëroja edhe një nëpunës të punëve botore.

Në kundërshtim me ç'priste, alkaldi nuk u përgjigj menjëherë. I hodhi një sy sahatit, por nuk pa orën. E kuptoi se duhej të duronte edhe më: ora e drekës s'kish ardhur ende. Kur hapi gojën, foli pa gjallëri: s'e dinte se si duhej ve-

pruar për të emëruar nëpunësin e punëve botore.

— Dikur emërohej nga këshilli bashkiak, — shpjegoi gjykatës Arkadioja. — Meqë tani këshilli nuk ka, regjimi i shtetrrethimit ju autorizon juve ta emëroni. — Alkaldi dëgjoi, ndërkohë që firmoste shkresën pa e lexuar. Pastaj tha se ai ishte gati ta emëronte, po të qe në dorë të tij, por sekretari pati një vërejtje me karakter etik lidhur me procedimin e rekomanduar nga eprori i tij. Gjykatës Arkadioja nguli këmbë: qe një procedim i jashtëzakonshëm nën një regjim të jashtëzakonshëm.

— Edhe unë ashtu them, — tha alkaldi.

Hoqi kapelen për të bërë fresk dhe gjykatës Arkadioja vërejti mbresën e rrethit të kapeles në ballë. Nga mënyra se si bënte fresk e kuptoi që alkaldi po vazhdonte të mendohej. Shkundi hirin e cigares me thuan e gjatë e të përkulur të gishtit të vogël dhe priti.

— Duhet një kandidat? — pyeti alkaldi.

Kuptohej që e kishte me sekretarin.

— Një kandidat, — përsëriti gjykatësi duke mbyllur sytë.

— Po të isha unë, do të emëroja një njeri të ndershëm, — tha sekretari.

Gjykatësi u mundua ta ndreqte ndërhyrjen e pavend të vartësit të tij. «Kjo s'do mend e kalem», tha dhe këqyri herë njërin herë tjetrin.

— Për shembull, — tha alkaldi.

— Tani s'më punon truri, — tha gjykatësi mendueshëm.

Alkaldi bëri për nga dera. «Mendohu, — i tha. — Kur të mbarojnë telashet e përmbytjeve, merremi edhe me nëpunësin e punëve botore». Sekretari vazhdoi të rrinte i përkulur mbi makinën e shkrimit deri kur zhurma e takave të alkaldit nuk u dëgjua më.

— Ka shkalluar, — tha atëherë. — Ka një vit e gjysmë që nëpunësit ia thyen kokën me kondakë, kurse tani kërkon një kandidat të ri.

Gjykatës Arkadioja u ngrit me një të brofur.

— Ika unë, — tha. — Në mos po ke për të ma nxjerrë për hundësh drekën me këto tregimet e tua të lemerishme.

Doli nga zyra. Mesdita se ç'kishte diçka ndjellaligë. Sekretari e vuri re, siç qe i prirur ndaj bestytnive. Kur i hodhi drynin derës, iu duk sikur po bënte një veprim të ndaluar. Iku edhe ai. Te dera e telegrafës arriti gjykatës Arkadion që po interesohej të merrte vesh nëse marifeti për letrat e bixhozit mund të pinte ujë edhe për poker. Telegrafisti s'pranoi që s'pranoi t'ia tregonte të fshehtën. Përsëriste pa pushim marifetin, në mënyrë që gjykatës Arkadioja të mund t'ia zbulonte kyçin. Edhe sekretari e pa si e bëntë dhe iu duk se e kuptoi të fshehtën. Mirëpo gjykatës Arkadioja as që ua hodhi sytë letrave. E dinte që qenë po ato që i kish zgjedhur siç ia pat zënë dora dhe që telegrafisti i kthente pa i parë.

— Punë magjie, — tha telegrafisti.

Gjykatës Arkadioja e kishte mendjen vetëm të kalonte rrugën. Kur vendosi të çapej, mbërtheu sekretarin për krahu dhe e detyroi të turrej tok me të nëpër ajrin që përvëlonte si qelq i shkrirë. Arritën te trotuari me hije. Atëherë sekretari i shpjegoi çelësin e marifetit. Ishte aq i thjeshtë sa gjykatës Arkadioja e ndjeu veten të fyer.

Bënë një copë udhë në heshtje.

— S'besoj se i verifikove të dhënat, — i tha pas pak gjykatësi po me inatin e qëparshëm.

Sekretari mbeti një çast duke kërkuar kuptimin e frazës.

— Është shumë e vështirë, — tha më në fund. — Shumicën e paskuinëve i heqin para se të zbardhë.

— Ja, këtë marifet ec e zbuloje po qe i zoti, — tha gjykatës Arkadioja. — Pse të çaj kokën unë për një paskuin që s'e lexon askush?

— Këtu është gjithë puna, — tha sekretari duke u ndalur, se kishte arritur para shtëpisë. — Njerëzit nuk shqetësohen prej paskuinëve, por prej frikës nga paskuinët.

Megjithëse nuk qenë të plota, gjykatës Arkadioja deshi t'i shihte të dhënat që kish mbledhur sekretari. Mbajti shënim rastet, me emra dhe data: njëmbëdhjetë në shtatë ditë. Mes të njëmbëdhjetëve s'kishte asnjë lidhje. Ata që i kishin parë paskuinët puqeshin në mendimin se qenë shkruar me penë, me bojëqielli dhe germa shtypi, përzier të mëdha e të vogla, si prej dorës së një fëmije. Shkrimi qe gjithë gabime. Nuk thoshin ndonjë gjë të fshehtë: gjithë ç'thuhej në ta fshati e dinte prej kohësh. Kishte bërë gjithë hamendimet e mundshme, kur siriani Moises e thirri nga dyqani:

— A keni ndonjë grosh në xhep?

Gjykatës Arkadioja nuk kuptoi. Por i ktheu xhepat mbrapsht: njëzetepesë qindarka dhe një monedhë amerikane që e mbante si hajmali qysh në kohën e Universitetit. Siriani Moises mori njëzetepesë qindarkat.

— Merrni ç'të doni dhe m'i paguani kur të doni, — tha duke vërvitur monedhat në sirtarin e zbrazët. — S'dua të më zërë dreka pa bërë sefte.

Kur ra dymbëdhjeta, gjykatës Arkadioja hyri në shtëpi i ngarkuar me dhurata për të shoqen. U ul në shtrat të zbathte këpucët, ndërkohë që ajo pështillte rreth trupit një copë mëndafshi të

stampuar. Përfytyroi si do të dukej, pas lindjes, me fustanin e ri. I dha një të puthur të shoqit në hundë. Ai u përpoq t'i bënte bisht, por ajo iu hodh përsipër që nga ana tjetër e krevatit. Qëndroi pa lëvizur. Gjykatës Arkadioja i shkoi dorën nëpër shpinë, duke ndier ngrohtësinë e barkut të gufuar, derisa kapi fërgëllimën e veshklave.

Ajo ngriti kokën. Pështëriti me dhëmbët të shtrënguar:

— Prit sa të mbyll derën.

Alkaldi priti deri kur vendosën edhe shtëpinë e fundit. Për njëzet orë kishin ndërtuar një rrugë të gjerë e të qëruar që mbaronte papritmas te muri i varrezave. Si ndihmoi për të vendosur orenditë, duke punuar sup më sup me të zotët, alkaldi hyri duke dihatur në kuzhinën më të afërt. Supa valonte në një vatër prej gurësh të sajuar drejt e në tokë. I ngriti kapakun vorbës dhe nuhati avullin për një copë herë. Nga ana tjetër e oxhakut një grua e thatë me sy të mëdhenj e të qetë e këqyri në heshtje.

— Tani të hamë drekë, — tha alkaldi.

Gruaja nuk u përgjigj. Pa e ftuar kush, alkaldi mbushi një pjatë me supë. Atëherë gruaja vajti matanë për të kërkuar një karrige dhe ia vuri para tryezës që alkaldi të ulej. Ndërkohë që hante supën, vështroi oborrin me një si frikësim të përvuajtur. Dje ai pat qenë një yrt i shkretë. Tani qenë ndërur rroba për t'u tharë dhe dy derrkucë shkarrëzeheshin në baltë.

— Bile edhe mund të mbillni, — tha alkaldi.

Gruaja u përgjigj pa ngritur kokën. «Posi, që

t'i hanë derrat.» Pastaj shtiri në një pjatë një copë mish të skuqur, dy feta manioke, gjysmë bananeje jeshile dhe e shpuri në tryezë. E bëri këtë gjest bujarie me një mospërfillje që binte qartas në sy. Alkaldi, duke buzëqeshur, kërkoi me sytë e tij sytë e gruas.

— Ka për të gjithë, — tha.

— T'u zëntë në fyt, o zot, — tha gruaja pa e vështruar.

Ai bëri sikur s'e dëgjoi mallkimin. U vu të hante pa e pasur mendjen te djersët që i vinin çurgë tatëpjetë qafës. Kur mbaroi, gruaja hoqi pjatën e zbrazët, gjithë pa ia hedhur sytë.

— Deri kur do të vazhdoni kështu? — pyeti alkaldi.

Gruaja foli pa e prishur qetësinë:

— Deri kur të na i ngjallin përsëri të vdekurit që na kanë vrarë.

— Tani kanë ndryshuar punët, — shpjegoi alkaldi — Qeveria e re preokupohet për mirëqenien e shtetasve, kurse ju...

Gruaja ia preu:

— Avazi i vjetër.

— Një lagje si kjo, e ndërtuar për njëzet e katër orë, nuk mund të bëhej në asnjë regjim tjetër, — ngulmoi alkaldi. — Ne po përpiqemi të bëjmë një fshat për të qenë.

Gruaja mblodhi rrobat nga teli dhe i shpuri në të ndarën matanë. Alkaldi e ndoqi me vështrim deri kur dëgjoi përgjigjen:

— Ky qe fshat për të qenë para se të vinit ju.

Nuk priti kafenë. «Bukëshkalë që jini, — tha. — Ne po ju japim tokë, kurse ju të pakënaqur që të pakënaqur mbetët.» Gruaja nuk u përgjigj.

— Më keq do të jetë këtu. Me të vdekurit te pragu, ditë e natë do ta kemi mendjen te ju.

Alkaldi u përpoq të bënte gjumin e drekës ndërkohë që vinin motobarkat. Por s'e duroi dot vapën. Të enjturit e faqes kish filluar t'i binte. Megjithëkëtë, nuk e ndjeu veten mirë. Ndoqi me sy rrjedhën e padallueshme të lumit për dy orë, duke dëgjuar zukamën e një gjinkalle brenda dhomës. S'mendonte për asgjë.

Kur dëgjoi motorin e lundrave, u zhvesh, fshiu djersët me një peshqir dhe veshi uniformën tjetër. Pastaj kërkoi gjinkallën, e mbërtheu me gishtin e madh dhe treguesin dhe doli në rrugë. Nga turma që priste lundrat u shkëput një fëmijë i pastër, i veshur mirë, që i preu rrugën me një mitraloz plastik. Alkaldi i dha gjinkallën.

Një çast më pas, i ulur në dyqanin e siriani Moises bënte sehir lëvizjet e lundrave. Për dhjetë minuta rresht porti gëloi. Alkaldi ndjeu dicka të rëndë në stomak dhe një të therur në kokë. Atëherë iu kujtua mallkimi i gruas. Pastaj u qetësua duke këqyrur udhëtarët që kalonin nëpër sheshqëndrimin prej dërrasash dhe shkrythnin muskujt pas tetë orë palëvizjeje.

— Po ai avaz, — tha.

Siriani Moises i bëri të ditur një laim të ri: po vinte një cirk. Alkaldi e kuptoi që kjo qe e vërtetë, ndonëse nuk mund të thoshte nga se. Ndoshta nga një pirg shkopinjsh dhe plackash të ngjyrshme të ngrehur mbi çatinë e një lundre dhe nga dy gra të ngjashme si dy pika uji, të veshura me fustane të njëllojta lule-lule, si një njeri i përsëdytur.

— S'thua shyqyr. — mërmëriti.

Siriani Moises foli për kafshë e për numra xhonglerësh. Por alkaldi e shihte punën në një tjetër këndvështrim. Me këmbët të shtriqura, kundroi majat e çizmeve.

— Përparon fshati, — tha.

Siriani Moises la erashkën. «E di sa kam bërë sot?» pyeti. Alkaldi s'mori mundimin të bënte llogari, por priti përgjigjen.

— Njëzet e pesë qindarka, — tha siriani.

Atë çast alkaldi pa telegrafistin tek hapte thesin e postës për t'i dhënë letrat doktor Hiraldos. E thirri. Posta zyrtare vinte në një zarf të posaçëm. Prishi vulat dhe e kuptoi që qenë njoftime të rëndomta e fletushka propagandistike të regjimit. Kur mbaroi së lexuari, skela kish marrë një pamje krejt tjetër, qe mbushur me togje mallrash, me kafazë pulash dhe me mjetet e çuditshme të cirkut. Qe ndaj të ngrysur. U ngrit duke psherëtirë.

— Njëzet e pesë qindarka.

— Njëzet e pesë qindarka, — përsëriti siriani me zërin e tij të fortë, thuajse pa marrë frymë.

Doktor Hiraldoja e ndoqi deri në fund shkarkimin e mallrave. Ai i tregoi alkaldit një grua të fuqishme, si priftëreshë nga të pamit, me lloj-lloj xhinglash në kyçet e të dy krahëve. Dukej sikur priste Mesian nën një ombrellë ngjyra-ngjyra.

— Duhet të jetë zbutësja, — tha alkaldi.

— Në njëfarë mënyre keni të drejtë, — tha doktor Hiraldoja duke i kafshuar fjalët me dy sërët e dhëmbëve si gurë të mprehtë. — Është vjehrra e Sesar Monteros.

Alkaldi vazhdoi rrugën. Pa sahatin: ora ishte katër pa njëzet e pesë. Te porta e alkaldisë roja e njoftoi se at Anheli e kishte pritur gjysmë ore dhe do të vinte përsëri më katër.

Vazhdoi rrugën, pa ditur c'të bënte. Pa dentistin në dritaren e kabinetit dhe u afrua të kërkonte zjarr. Dentisti ia ndezi duke i vëzhguar faqen ende të enjtur.

— Tani e kam mirë, — tha alkaldi.

Hapi gojën dhe dentisti ia pa.

— Keni disa dhëmbë për të mbushur.

Alkaldi rregulloi revolverin në brez. «Do të shihemi prapë», i tha. Dentistit nuk i ndryshoi shprehja e fytyrës.

— Kur të doni. Unë mezi pres të vijë ajo ditë që të ngordhni këtu në karrigen time.

Alkaldi i ra me pëllëmbë supit. «Kot pret», ia ktheu shend e verë. Dhe shtoi duke hapur krahët:

— Dhëmballët e mia qëndrojnë mbi partitë politike.

— Pra, nuk do t'u martoke?

Gruaja e gjykatës Arkadios hapi këmbët. «As që kam ndër mend, at i shenjtë, — iu përgjigj. — Sidomos tani që do t'i bëj edhe një djalë.» At Anheli i ktheu sytë nga lumi. Një lopë e mbytur, shumë e madhe, zbriste teposhtë rrjedhës, me një trumë zhgabash që i qenë qepur përsipër.

— Porse ka për të qenë një fëmijë i paligjshëm, — i tha.

— Punë e madhe, — ia ktheu ajo. — Tani Arkadioja sillet mirë me mua. Po ta shtrëngoj të martohet, mund t'i mërzitet martesa dhe i ha unë të gjitha në kurriz.

Kish hequr nallanet dhe fliste me gjunjë të ndarë, me gishtërinjtë e këmbëve të mbërthyer pas tërthorcës së stolit. Erashkën e mbante mbi prehër dhe krahët të kryqëzuar mbi barkun e gufuar. «As mos e shkoni ndër mend, at i shenjtë, — i tha edhe një herë, ngaqë at Anheli s'po fliste. — Don Sabasi më bleu për dyqind grosh, më shtrydhi tre muaj rresht e pastaj më flaku në rrugë pa një dyshkë në xhep. Po të mos më kish

marrë Arkadioja, do të kisha vdekur urie.» Ia ngulli sytë famullitarit për herë të parë.

— Ose do të isha bërë rrospi.

At Anheli kishte gjashtë muaj që ngulte këmbë.

— Duhet t'ia mbushësh mendjen që të martohet dhe të ngrini vatrën tuaj familjare, — tha ai. — Kështu si jetoni tani jo vetëm që s'keni asnjë siguri, por bëheni shembull i keq edhe për fshatin.

— Është më mirë kur i ke sahanët pa kapak, — ia ktheu ajo. — Edhe të tjerët bëjnë si ne, veçse me dritë të fikur. S'i paskeni lexuar paskuinët?

— Ato janë shpifje, — tha famullitari. — Ti bën mirë të rregullosh punët e tua dhe njëkohësisht t'u vësh fre gojëve të liga.

— Unë? — tha ajo. — Unë s'kam pse t'i vë fre askujt, se i bëj punët e mia në dritë të diellit. Provë është që asnjeri s'merr mundimin të më vërë paskuin, kurse të gjitha zonjat e nderuara e kanë të shkruar në kartë.

— Ti ke dalë nga rruga e zotit, — tha famullitari, — por zoti deshi të bije në dorën e një burri që të çmon. Prandaj edhe duhet të martohesh e të ngresh vatrën familjare.

— Unë s'marr vesh nga këto gjëra, — tha ajo, — por sidoqoftë, kështu siç jam, kam ku të fus kokën e ku të mbush barkun.

— Po në të braktistë?

Ajo kafshoi buzët. Buzëqeshi në mënyrë enigmatike, ndërsa përgjigjej:

— S'ka për të më braktisur, at i shenjtë. Për këtë ju siguroj.

Edhe kësaj here at Anheli u detyrua të dorëzohej. E porositi që së paku të vinte në meshë. Ajo iu përgjigj se do të vinte «ndonjë nga këto ditë». Pastaj famullitari vazhdoi shëtitjen duke

pritur të vinte ora e takimit me alkaldin. Një nga sirianët i tha se ç'mot i mirë që, por ai nuk ia vuri veshin. U interesua të merrte vesh hollësi për cirkun që shkarkonte kafshët e shqetësuara në buzëmbrëmjen e shndritshme. Ndenji aty deri më katër.

Alkaldi po ndahej me dentistin kur pa at Anhelin të afrohej. «I përpiktë, — tha dhe i shtrëngoi dorën. — I përpiktë, ndonëse s'po bie shi.» Ndërsa matej të ngjiste shkallët e thikta të alkaldisë, at Anheli ia ktheu:

— Dhe as po bëhet kiameti.

Pas dy minutash e futën në dhomën e Sesar Monteros.

Sa kohë që vazhdoi të rrëfyerit, alkaldi ndenji i ulur në korridor. Solli ndër mend cirkun, një grua të mbërthyer me dhëmbë pas një gremçi, pesë metra mbi tokë, dhe një burrë me kostum të kaltër të qëdisur me gjymysh, duke i rënë daulles. Pas gjysmë ore at Anheli doli nga dhoma e Sesar Monteros.

— Në rregull? — pyeti alkaldi.

At Anheli e këqyri gjithë mllef.

— Po bëni një krim, — i tha. — Ai i gjori ka më se pesë ditë pa ngrënë. Vetëm në sajë të trupit të fuqishëm është ende gjallë.

— Vetë ka dashur, — i tha alkaldi qetësisht.

— S'është e vërtetë, — ia ktheu famullitari me një vendosmëri të qartë në zë. — Keni dhënë ju urdhër të mos i japin për të ngrënë.

Alkaldi i drejtoi gishtin tregues.

— Kujdes, at i shenjtë, se po shkelni sekretin e të rrëfyerit.

— Kjo nuk bën pjesë në rrëfim, — tha famullitari.

Alkaldi u ngrit me një të brofur. «Mos e merrni me të përpjekur, — tha duke qeshur aty

për aty. — Po e patët kaq merak, e rregullojmë që tani.» Thirri një polic dhe i dha urdhër që t'i shpinin për të ngrënë Sesar Monteros nga burgu. «Porositni një gjel deti të madh, një pjatë me patate dhe një pjatancë me sallatë», tha dhe shtoi duke iu drejtuar famullitarit:

— Të gjitha me shpenzimet e bashkisë, at i shenjtë. Që ta shihni se si kanë ndryshuar punët.

At Anheli uli kryet.

— Kur do ta nisni?

— Motobarkat nisen në mëngjes, — tha alkaldi. — Po i erdhën mendtë sonte, e nisim qysh nesër. Vetëm duhet ta kuptojë se po i bëj një nder.

— Nder që kushton shtrenjtë, — tha famullitari.

— Për ata që e kanë qesen plot, nderi gjithmonë shtrenjtë kushton, — tha alkaldi. Nguli sytë në sytë e rimtë e të tejdukshëm të at Anhelit dhe shtoi:

— Besoj se ju ia bëtë të qartë të gjitha këto.

At Anheli s'ktheu përgjigje. Zbriti shkallët dhe që nga rruga i la lamtumirën alkaldit me një si bulërimë të shurdhët. Atëherë alkaldi kaloi korridorin dhe hyri pa trokitur në dhomën e Sesar Monteros.

Qe një kthinë e thjeshtë: një takëm të larë dhe një krevat hekuri. Sesar Monteroja, i parruar, i veshur po me ato rroba me të cilat pat dalë prej shtëpisë të martën e javës së shkuar, kish rënë në shtrat. Nuk lëvizi as sytë kur dëgjoi alkaldin. «Tani që i rregullove hesapet me zotin, — i tha ky, — duhet t'i rregullosh edhe me mua.» Ktheu një karrige nga krevati dhe u ul kaluarthi, me gjoksin pas shpinëzës prej xunkthi. Sesar Monteroja e përqendroi vëmendjen te trarët e çatisë. S'ngjante i shqetësuar, ndonëse në shtjekāt e buzëve dukeshin gjurmët e një bisede të gjatë me vetveten.

«S'kemi pse t'i biem rrotull, — dëgjoi alkaldin t'i thoshte. — Nesër nisesh. Po pate fat, për dy ose tre muaj do të vijë një hetues i posaçëm. Ne kemi për detyrë ta informojmë. Pas një jave, kthehesh përsëri me motobarkë, i bindur edhe vetë se ke bërë një gomarllëk.»

Heshti një copë herë, por Sesar Monteroja vazhdoi të mos e prishte terezinë.

— Pastaj, me gjyqe e avoketër do të të zhvatin të paktën nja njëzet mijë pesos. Ose edhe më shumë, po qe se hetuesit të posaçëm i shkrepet t'u thotë se je milioner.

Sesar Monteroja ktheu kokën nga ai. Qe një lëvizje thuajse e padallueshme, por që, megjithëkëtë, i bëri të kërcasin sustat e krevatit.

— Gjithsej, — vazhdoi alkaldi me një zë ndihmëtari shpirtëror, — me sorollatje e shkresurina, do t'i hash nja dy vjet, po s'pate kundërshtim.

Ndjeu që tjetri po e vështronte duke filluar nga majat e çizmeve. Kur vështrimi i arriti te sytë, ende s'kish mbaruar së foluri. Porse kish ndërruar tonin.

— Për të gjitha duhet të më jesh mua borxhli, — po thoshte. — Kisha urdhër të të zhdukja, të të vrisja në një pusi dhe të të konfiskoja gjithë mallin e gjënë, që edhe Qeveria të ketë me se t'u bëjë ballë shpenzimeve të mëdha në gjithë qarkun. Ti e di që alkaldët e tjerë i zbatojnë këto urdhëra. Kurse unë nuk e zbatova.

Atë çast dalloi të parën shenjë që Sesar Monteroja po mendohej. Hapi këmbët. Me krahë të mbështetur pas shpinëzës së karriges iu përgjigj një akuze që bashkëbiseduesi nuk e kishte bërë me zë.

— Asnjë grosh nga çka pagove për jetën tënde nuk vajti në xhepin tim, — tha. — Të gjitha u shpenzuan për organizimin e zgjedhjeve. Tani Qe-

veria e re ka vendosur që të ketë paqe e siguri për të gjithë dhe unë po kavërdisem me rrogën time, ndërkohë që ti je krimbur në para. Të eci mbarë tregtia.

Sesar Monteroja filloi procesin e mundimshëm të të ngriturit. Kur më në fund qe më këmbë, alkaldi këqyri vetvetën: vocërrak dhe i mjerë para një shtaze monumentale. Pati një përndezje në vështrimin me të cilin e shoqëroi deri te dritarja.

— Jo po thuaj që s'të eci, — mërmëriti.

Dritarja binte mbi lumë. Sesar Monteroja nuk e njohu pamjen. Iu duk vetja në një fshat tjetër, përballë një lumi vegimtar. «Unë po përpiqem të të ndihmoj, — dëgjoi zërin pas shpine. — Të gjithë e dinë që qe çështje nderi, por ec e vërtetoje, po munde. Bëre budallallëk që e grise paskuinin.» Atë çast një kutërbim i rëndë mbushi dhomën.

— Lopa, — tha alkaldi, — do të ketë ngecur gjëkundi.

Sesar Monteroja vazhdoi të qëndronte te dritarja, pa u shqetësuar prej kutërbimit. Në rrugë s'kishte asnjeri. Në skelë kishte tre lundra me hekur të hedhur, ekipazhi i të cilave po varte hamakët për të fjetur. Të nesërmen më shtatë të mëngjesit pamja do të qe krejt ndryshe: për gjysmë ore rresht porti do të ziente, duke pritur që të hipnin në lundër të arrestuarin. Sesar Monteroja psherëtiu. Futi duart në xhepa dhe me ton të vendosur, ndonëse pa u ngutur, e përmblodhi në një fjalë mendimin:

— Sa?

Përgjigjen e mori aty për aty.

— Pesë mijë pesos me viça motakë.

— Edhe pesë viça të tjerë, — tha Sesar Monteroja, — që të më nisësh sonte, pas kinemasë, me një motobarkë të posaçme.

Motobarka lëshoi një fërshëllimë, mori kthesën në mes të lumit dhe turma e mbledhur në skelë e gratë nëpër dritare panë për të fundit herë Rosario de Monteron, së toku me të ëmën, të ulur në po atë baule prej llamarine me të cilën pat zbritur në fshat shtatë vjet më parë. Duke u rruar në dritaren e konsultores, doktor Oktavio Hiraldoja pati një përshtypje se ky udhëtim që në njëfarë mënyre një kthim drejt realitetit.

Doktor Hiraldoja e kishte parë asaj ndajnate kur kish ardhur, me një uniformë të ndotur normalisteje e një palë këpucë burrash, duke kërkuar nëpër port se kush i merrte më pak për t'i shpënë valixhen deri në shkollë. Dukej sikur e kish bërë mend të plakej ashtu thjeshtësisht në atë fshat, emrin e të cilit e kish parë për të parën herë — sikundër tregonte vetë — në copëzën e letrës që nxori nga një kapele kur njëmbëdhjetë kandidatë patën hedhur në short gjashtë vende pune. Zuri vend në një kthinë të shkollës, me një krevat hekuri dhe një takëm të larë dhe i kalonte orët e lira duke qëndisur sofrabezë, ndërkohë që ziente mëmëligën në furnelën me vajguri. Po atë vit, për kërshëndella, u njoh me Sesar Monteron në një festë të shkollës. Ai qe një be-

qar egërshan, me prejardhje që s'i dihej mirë, i pasuruar me nxjerrjen e qeresteve, që jetonte në pyllin e virgjër, mes qenve të stanit dhe kalonte në fshat vetëm kur e sillte hera, gjithmonë i parruar, me një palë çizme me taka me proka dhe një çifte në krah. Qe si të nxirrte për së dyti prej kapeles copëzën e letrës me vrimë, mendonte doktor Hiraldoja me mjekrën të shkumuar, kur një kutërbim i rëndë e shkëputi nga kujtimet.

Një trumë zhgabash u hapërda tej bregut kundruall, e trembur nga valëzimi që shkaktoi motobarka. Kutërbimi u mvar për një çast sipër skelës, u përzie me puhinë mëngjesore dhe hyri deri brenda shtëpive.

— Dreqi e mori! — thirri alkaldi në ballkonin e dhomës së tij të gjumit, duke kundruar hapërdarjen e zhgabave. — Prapë ajo lopë e mutit.

Zuri hundët me një shami, hyri në dhomë dhe mbylli derën e ballkonit. Era e keqe ndihej edhe brenda. Pa hequr kapelen, vari pasqyrën në gozhdë dhe iu fut një pune të kujdesshme për të rruar faqen ende pakëz të enjtur. Pas një çasti sipërmarrësi i cirkut trokiti në derë.

Alkaldi e ftoi të ulej duke e vështruar nga pasqyra ndërkohë që rruhej. Kishte një këmishë me kuti të zeza, qillota me dollakë dhe një fshikull me të cilin godiste gjurin ritmikisht.

— Më erdhi ankesa e parë për ju, — tha alkaldi duke mbaruar së hequri me brisk qimet e dendura të dy javëve vuajtje. — Sonte.

— Për çfarë?

— Se po dërgoni çunat të vjedhin mace.

— S'është e vërtetë, — tha sipërmarrësi, — ne blemë me para në dorë çdo mace që na sjellin, pa pyetur ku e kanë gjetur, për të ushqyer kafshët.

— Ua hidhni të gjalla?

— Ah, jo, — kundërshtoi sipërmarrësi; — kjo do t'u ngjallte instinktin e bishës.

Pasi u la, alkaldi u kthye nga ai duke fërkuar fytyrën me peshqir. Deri atëherë s'i kishte vënë re unazat me gurë të ngjyrshëm thuajse në të gjitha gishtat e tij.

— Se ç'do të bëni, atë e dini ju, — tha. — Në daçi zini krokodilë në lumë ose përfitoni nga peshku që vete dëm në këtë kohë. Por për mace e maçokë s'dua të dëgjoj më.

Sipërmarrësi ngriti supet e ndoqi alkaldin deri në rrugë. Grupe burrash kuvendonin në port, pa u shqetësuar aspak nga era e keqe e lopës së ngecur në baltak mes shkurreve të bregut kundruall.

Shkërdhata që jini, — thirri alkaldi. — Në vend që të rini aty e të çaprashitni si gratë, duhet të kishit organizuar qysh mbrëmë një komision për të nxjerrë lopën.

Disa burra i erdhën rreth.

— Pesëdhjetë pesos, — propozoi alkaldi, — atij që më sjell në zyrë brenda orës brirët e asaj lope.

Një gurgule zërash shpërtheu në të dalë të portit. Disa nga ata që kishin dëgjuar propozimin e alkaldit kërcyen nëpër arka duke gërgarë njëri-tjetrin ndërsa zgjidhnin litarët. «Njëqind pesos, — e dyfishoi alkaldi i ngazëllyer. — Pesëdhjetë për çdo bri.» E shpuri sipërmarrësin deri në të dalë të skelës. Pritën të dy derisa arkat e para arritën në ranishten e bregut tjetër. Atëherë alkaldi, duke buzëqeshur, u kthye nga sipërmarrësi.

— Është fshat i lumtur ky, — i tha.

Sipërmarrësi ia bëri po me kokë. «Vetëm një të keqe kemi, — vazhdoi alkaldi. — Ka ca njerëz që merren akoma me dokrra, ngaqë s'kanë me

se të merren.» Pak nga pak, një tufë fëmijësh u qe mbledhur qark.

— Këtu e kemi cirkun, — tha sipërmarrësi. Alkaldi e hiqte për krahu drejt plazhit.

— Çfarë bëni?

— Ç'nuk bëjmë, — tha sipërmarrësi, — ç'të duash: kemi një shfaqje të plotë, për të vegjël e për të rritur.

— Vetëm kjo s'mjafton, — ia priti alkaldi. — Duhet të krijoni kushtet që ta shohin të gjithë.

— Edhe këtë e kemi parasysh, — tha sipërmarrësi.

Shkuan të dy deri te një yrt i shkretë prapa kinemasë, ku kishin filluar të ngrinin tendën. Burra e gra me pamje të heshtur nxirrnin dekore të vjetëruara nga baulet e mëdha të veshura me teneqe ngjyra-ngjyra. Ndërsa i binte pas sipërmarrësit nëpërmes atij mishmashi, duke e tokur me të gjithë, alkaldit iu duk vetja sikur ndodhej në një breg pas mbytjes së anijes. Një grua e fuqishme, me të sjella të prera dhe me dhëmbët thuajse të gjithë të veshur me ar, i këqyri dorën pas të tokurit.

— Diçka të rrallë keni në të ardhmen, — i tha.

Alkaldi tërhoqi dorën, pa e fshehur dot një ligshtim të çastit. Sipërmarrësi i ra lehtas gruas në krah me fshikull. «Lëre rehat togerin», i tha pa u ndalur, duke e shtyrë alkaldin kah fundi i djerrinës, ku ndodheshin kafshët.

— U besoni këtyre gjërave?

— Varet, — tha alkaldi.

— Mua për vete s'ma mbushin mendjen, — tha sipërmarrësi. — Në fund të fundit, është vullneti i njeriut ai që ka rëndësi.

Alkaldi soditi kafshët e përgjumura nga vapa. Prej kafazeve vinte një erë e athët dhe e hamullt

dhe në frymëmarrjen e ngadaltë të kafshëve ndi-
nej një si angushti e pashpresë. Sipërmarrësi le-
shatoi me fshikull feçkën e një leopardi që u
përdrodh si më të qarë.

— Si e ka emrin? — pyeti alkaldi.

— Aristotel.

— Për gruan e kam fjalën, — sqaroi alkaldi.

— Ehë, — ia bëri sipërmarrësi, — Kasandra
themi, pasqyrë e së ardhmes.

— Të kish ta merrja një herë në shtrat, —
ha alkaldi.

— Gjë që bëhet, — ia ktheu sipërmarrësi.

Vejusha De Montiel ngriti kortinat e dhomës
së saj të gjumit duke mërmëritur: «Të gjorët
njerëz». Rregulloi komodinën, futi në sirtar rru-
zaret dhe librin e uratave dhe pastroi shojet e
pantoflave ngjyrë jargavani në lëkurën e tigrit të
shtruar para krevatit. Pastaj i ra një herë qark
dhomës për të kyçur tryezën e tualetit, tri dyert
e gardërobës dhe një dollap katror mbi të cilin
kishte një Shën Rafael prej allçie. Në fund i vuri
perdesin dhomës.

Ndërsa zbriste nëpër shkallët e gjera prej plla-
kash me figura të gdhendura, i punonte mendja
se fati i rrallë i Rosario de Monteros. Kur e pa
të merrte kthesën në skaj të portit, me atë qën-
drimin e bindur të shkollarit të cilin e kanë më-
suar të mos e kthejë kryet pas, vejusha de Mon-
tiel, siç kish nxjerrë kryet nga ballkoni, pati pa-
randjesinë se diçka që kishte filluar të mbaronte
përprej shumë kohësh, më në fund kish mbaruar.

Te sheshqëndrimi i shkallëve i doli para syve

rrëmuja e oborrit që ngjante me një panair fshati. Nga njëra anë e verandës ishin pirgjet me djathë të mbështjellë me gjethe të njoma. Më përtej, në një çardak anësor ishin thasët me kripë të sërenditur dhe rrëshekët me mjaltë, kurse në fund një stallë me mushka, kuaj dhe shala nëpër tërthoret. Shtëpia mbante vazhdimisht një erë kafshësh barre të përzier me erën e regjjes së lëkurëve dhe bluarjes së kallamit.

Në zyrë vejusha i tha mirëmëngjes senjor Karmiçaelit që po numëronte në tryezë tufat e kartëmonedhave, ndërkohë që kontrollonte shifrat në librin e llogarive. Kur hapi dritaren që binte nga lumi, drita e orës nëntë hyri në dhomën e mbushur me zbukurime të lira, me kolltukë të mëdhenj të veshur me këllëfë të hirtë dhe një portret të zmadhuar të Hosé Montielit me një shirit zie në suazë. Vejusha e ndjeu kutërbimin e rëndë para se të shihte barkat te cekëtina e bregut kundruall.

— Ç'ka ngjarë në bregun tjetër? — pyeti.

— Po përpiqen të nxjerrin një lopë të ngordhur, — u përgjegj senjor Karmiçaeli.

— Kjo paska qenë atëherë, — tha vejusha. — Gjithë natën e pashë në ëndërr këtë kutërbim. — vështroi senjor Karmiçaelin të zhytur në punët e tij dhe shtoi: — Tani vetëm përmbytja duhet, që të bëhet me të vërtetë kiameti.

Senjor Karmiçaeli foli pa ngritur kokën:

— Përmbytja ka pesëmbëdhjetë ditë që ka filluar.

— Ashtu është, — pranoi vejusha, — po na vjen fundi dhe s'na mbetet veçse të shtrihemi në varr e të presim vdekjen me duar kryq. — Senjor Karmiçaeli e dëgjonte pa i ndërprerë llogaritë. «Ka vite që qaheshim se s'po ndodhte gjë në fshat, — vazhdoi vejusha. — Dhe ja ku filloi

tragjedia, sikur zoti të paskësh bërë emër që të ndodhin përnjëherësh gjithë ato gjëra që për vite me radhë s'po ndodhnin.»

Që nga kasaforta senjor Karmiçaeli u kthye ta shihte dhe e pa me bërrylat në pezul të dritares, me sytë të ngulur në bregun kundruall. Kish veshur një fustan të zi me mëngë të gjata dhe kafshonte thonjtë.

— Kur të reshtin shirat, do të përmirësohet gjendja, — tha senjor Karmiçaeli.

— As që kanë për të reshtur, — parashikoi vejusha. — Kur vijnë të ligat, hapu derën. E patë Rosario de Monteron?

Senjor Karmiçaeli e kishte parë. «Shumë zhurmë për asgjë, — tha. — Po t'u vërë veshin paskuinëve, njeriu duhet të shkallojë nga mendtë e kokës.»

— Eh, paskuinët, — psherëtiu vejusha.

— Edhe mua ma vunë timin, — tha senjor Karmiçaeli.

Ajo iu afrua tryezës e topitur nga habia.

— Juve?

— Po, mua, — e siguroi senjor Karmiçaeli. — Ma vunë e ma ngopën mirë të shtunën e kaluar. Sa një reklamë kinemaje.

Vejusha afroi një karrige pranë tryezës. «Kjo është poshtërsi, — thirri. — Askush s'ka gojë të flasë për një familje shembullore si juaja.» Senjor Karmiçaeli s'e prishte terezinë.

— Meqë ime shoqe është e bardhë, fëmijët na kanë dalë ngjyra-ngjyra, — shpjegoi. — Përfytyroni: njëmbëdhjetë kokë.

— Doemos, — tha vejusha.

— Kurse paskuini thoshte se vetëm fëmijët e zinj qenkan të mitë. Dhe jepte listën e baballarëve të të tjerëve. Kishin futur edhe don Çepe Montielin, ndjesë pastë.

— Burrin tim!

— Burrin tuaj dhe burrat e katër zonjave të tjera, — tha senjor Karmiçaeli.

Vejusha filloi të dëneste. «Shyqyr që i kam çupat larg, — tha. — Thonë se s'duan ta shohin me sy këtë vend të egër ku vrasin studentë rrugës dhe unë u jap të drejtë, të rrinë aty në Paris e të mos lëvizin.» Senjor Karmiçaeli u kthye përgjysmë në karrige, duke e kuptuar se skena e sikletshme e çdo dite kishte filluar përsëri.

— Ju s'keni pse bëheni merak, — tha ai.

— Përkundrazi, — u dënes vejusha. — Unë jam e para që duhej t'i kisha mbledhur leckat e t'ia kisha mbathur nga ky fshat, pa në dreq të venin tokat e këto punët e përditshme që orë e çast më kujtojnë gjëmën që më gjeti. Jo, senjor Karmiçael, s'kam ç'i dua oturakët e florinjtë për të pështyrë gjak.

Senjor Karmiçaeli u mundua ta qetësonte.

— Ju duhet t'i bëni ballë punës, — i tha. — Duhet ruajtur e gjithë kjo pasuri.

— Sikter me gjithë pasurinë! — tha vejusha.

— Po kjo pasuri është edhe rezultati i punës së mundimshme të don Çepe Montielit.

Vejusha kafshoi gishtërinjtë.

— Ju e dini që s'është e vërtetë, — ia ktheu. — Paraja harram s'bëhet kurrë hallall dhe i pari që e pagoi me kokë qe Hosé Montieli.

Nuk ishte hera e parë që e thoshte.

— S'do mend që fajin e ka ai krimineli, — thirri dhe ia bëri me shenjë nga alkaldi, që po kalonte në trotuarin kundruall, duke mbajtur për krahu sipërmarrësin e cirkut. — Por ama më bie mua të laj gjynahet.

Senjor Karmiçaeli nuk e ngau më. Futi në një kuti kartoni tufat e kartëmonedhave të lidhura

me rripa llastiku dhe që nga dera e oborrit thirri argatët sipas radhës alfabetike.

Ndërsa burrat merrnin pagën e së mërkurës, vejusha De Montiel i dëgjonte t'i shkonin pranë pa iu gjegjur përshëndetjeve. Jetonte fill e vetme në shtëpinë e errët prej nëntë dhomash ku pat vdekur Nënëmadhja dhe që Hose Montieli e pat blerë pa i shkuar ndër mend se vejushës së tij do t'i duhej të mbartte mbi shpinë nëpër të vetmin e vet derisa të vdiste. Natën, ndërsa endej me bombolën e insekticidit kthinave të zbrazëta, ndeshej me Nënëmadhen që vriste morrat nëpër korridoret dhe e pyeste: «Kur do të vdes, kur?» Porse ai komunikim i lumë me të përtejmen vetëm sa ia kishte shtuar pasigurinë, mbasi përgjigjet, si gjithë përgjigjet e të vdekurve, ishin pa lidhje e pa kuptim.

Pak pas njëmbëdhjetës, vejusha pa përmes lotëve at Anhelin tek kalonte nëpër shesh. «At, o at i shenjtë», e thirri duke e ndier se me atë thirrje po hidhte një hap të fundit. Por at Anheli nuk e dëgjoi. Kishte trokitur në shtëpinë e vejushës De Asis, në trotuarin përballë, dhe porta qe çelur pak, në mënyrë të fshehtë, sa për të kaluar ai.

Në rruginën ku të merreshin mendtë prej këngës së zogjve, vejusha De Asis qe shtrirë në një shezlong prej cohe, me fytyrën të mbuluar me një shami të njomur në *agua de Florida*[1]. Nga mënyra e të trokiturit e mori vesh që ishte at Anheli, por e zgjati prehjen e çastit deri kur dëgjoi përshëndetjen. Atëherë zbuloi fytyrën e shkalafitur nga të pagjumët.

— Më falni, at i shenjtë, — tha, — nuk ju prisja kaq herët.

At Anheli nuk e dinte që e kishin thirrur për

1 Lloj uji me parfum, karakteristik për vendet e Amerikës së Veriut e të Amerikës Latine.

drekë. Lypi ndjesë, pakëz i turbulluar e duke thënë se edhe ai e kish kaluar mëngjesin me dhimbje koke e kish dashur ta kaptonte sheshin sa pa filluar pisku i vapës.

— Nejse, — tha vejusha, — vetëm desha të them se më gjetët si mos o zot.

Famullitari nxori nga xhepi një libër uratash të shqepur. «Po deshët, mund të preheni edhe një copë herë ndërkohë që unë po lëçis», tha. Vejusha nuk pranoi.

— Tani jam më mirë, — tha.

Eci me sy mbyllur deri në fund të rruginës dhe, si u kthye, e nderi shaminë me kujdes të madh mbi krahun e shezlongut. Kur u ul përballë at Anhelit dukej disa vjet më e re.

— At i shenjtë, — tha atëherë pa dramatizëm, — kam nevojë për ndihmën tuaj.

At Anheli futi librin e uratave në xhep.

— Urdhëroni.

— Përsëri për Roberto Asisin.

Në kundërshtim me premtimin që kish dhënë për ta harruar paskuinin, Roberto Asisi ishte nisur të nesërmen për të qëndruar në mal deri të shtunën dhe qe kthyer në shtëpi krejt papritur e pakujtuar qysh atë natë. Kish ndenjur ulur në të errët, duke pritur dashnorin e hamenduar të së shoqes deri në mëngjes, kur më në fund e kish mposhtur lodhja.

At Anheli e dëgjoi i habitur.

— Kjo s'ka pikë kuptimi, — tha.

— Ju nuk i njihni Asisët, at i shenjtë, — ia ktheu vejusha. — Ç'nuk u punon mendja.

— Rebeka e di pikëpamjen time mbi paskuinët, — tha. — Por, po deshët ju, unë mund të bisedoj edhe me Roberto Asisin.

— Në asnjë mënyrë, — tha vejusha. — Kjo do të thosh t'i hidhnim benzinë zjarrit. Përkundrazi,

po të flisnit për paskuinët në predikimin e së dielës, jam e sigurt që Roberto Asisi do t'i thërriste mendjes.

At Anheli hapi krahët.

— E pamundur, — thirri. — Kjo do të thosh t'i frynim gjërat me zor.

— Ta quash krimin krim nuk do të thotë t'i frysh gjërat.

— Pandehni se gjer aty ka arritur puna?

— Jo vetëm që pandeh, — tha vejusha, — por jam e sigurt që nuk kam aq fuqi sa ta ndaloj.

Pas pak zunë vend në tryezë. Një shërbëtore e zbathur u solli pilaf me fasule, zarzavate të ziera dhe një pjatë të madhe me qofte të mbuluara me një salcë të errët e të trashë. Piperi i fortë, heshtimi i thellë i shtëpisë dhe ndjesia e pështjellimit që i kish pushtuar zemrën atë çast, e çuan përsëri at Anhelin në dhomëzën e tij të zhveshur të rishtarit, në mesditën e nxehtë të Makondos. Në një ditë si ajo, të pluhurosur e të hamullt, ai kish refuzuar t'i jepte varr prej të krishteri një të varuri, të cilin banorët e ashpër të Makondos donin ta linin të vdekur e të pakallur. Zbërtheu jakën e veladonit për t'u lënë udhë të lirë djersëve.

— Mirë, pra, — i tha vejushës. — Atëherë rregullojeni që Roberto Asisi të mos mungojë në meshën e së dielës.

Vejusha De Asis i dha fjalën se do ta rregullonte.

Doktor Hiraldoja dhe e shoqja, që asnjëherë nuk flinin pasdrekave, e kaluan mbasditen duke

lexuar një tregim të Dikensit. Ndenjën në tarracën e brendshme: ai në hamak, duke dëgjuar me gishtërinjtë të pleksur pas zverkut; ajo me librin në pëqi, duke lexuar me shpinë nga rombet që formonin rrezet e diellit mes luleve të idërshahut. Kishte lexuar pa qejf, me një lloj pompoziteti profesional, pa ndryshuar qëndrim në karrige. Nuk e ngriti kokën deri në fund, madje edhe atëherë ndenji me librin e hapur mbi gjunjë, ndërsa i shoqi lahej në muslluk. Zagushia paralajmëronte shtërgatë.

— Tregim i gjatë ishte ky? — pyeti ajo, pasi e mendoi sa e mendoi.

Me lëvizjet e kujdesshme të mësuara në sallën e operacionit, mjeku ngriti kokën nga legeni. «Thonë se është novelë, — tha para pasqyrës, duke hapur brilantinë në pëllëmbë. — Kurse unë do të thosha se është një tregim i gjatë.» Shtroi brilantinën në çaçkë të kokës dhe përfundoi:

— Kritikët do të thoshin se është një tregim i shkurtër si gjini, por i gjatë si gjatësi.

Veshi kostumin prej linoje, ndërsa ajo e ndihmonte. Mund ta merrje fare lehtë për një motër të madhe, jo vetëm nga përkushtimi i qetë me të cilin kujdesej për të, por edhe prej ftohtësisë së syve që e bënin të dukej më e madhe nga ç'ishte. Para se të dilte, doktor Hiraldoja i tregoi listën dhe radhën e vizitave ku do të shkonte, për në qoftë se paraqitej ndonjë rast urgjent, dhe në xhamin e derës së sallës së pritjes vendosi kartelën: *Doktori kthehet në orën pesë.*

Në rrugë të merrej fryma nga vapa. Doktor Hiraldoja eci nga trotuari në hije i ndjekur prej parandjenjës se, me gjithë havanë e rëndë, atë mbrëmje s'kishte për të rënë shi. Zukama e gjinkallave e bënte edhe më të ndjeshme shkretinë e sheshit. Lopa që lëvizur nga vendi, por kutër-

jumi i kalbësisë pat lënë në ajër një boshllëk të madh.

Telegrafisti i thirri që nga bujtina.

— E morët një telegram?

Doktor Hiraldoja nuk e kishte marrë.

— *Lajmëroni gjendjen telegram, firmosur Arkofan,* — përsëriti përmendsh telegrafisti.

Vajtën të dy në telegrafë. Ndërsa mjeku shkruante përgjigjen, nëpunësit filloi t'i varej koka.

— E ke nga acidi klorhidrik, — shpjegoi mjeku pa ndonjë bindje të madhe shkencore. Dhe, më gjithë parandjenjën e tij, kur mbaroi së shkruari, shtoi si për ta ngushëlluar: «Mbase sonte bie shi.»

Telegrafisti numëroi fjalët. Mjeku nuk ia vari. I tërhoqi vëmendjen një libër i trashë i hapur pranë tastos së transmetimit. Pyeti mos qe roman.

— «Të mjerët» i Viktor Hygoit, — u përgjigj telegrafisti duke dhënë telegramin.

Pastaj vulosi kopjen dhe u kthye në verandë me librin.

— Them se me këtë mund ta shtyjmë gjer nga dhjetori.

Doktor Hiraldoja e dinte prej vitesh që telegrafisti i kalonte orët e lira duke i transmetuar poezi telegrafistes së San Bernardos del Vientos. Por nuk e dinte që lexonte edhe romane.

— Kjo është vepër serioze, — i tha duke shfletuar librin e trashë të vjetëruar nga përdorimi, i cili i zgjoi në kujtesë emocionet e vagullta të rinisë. — Aleksandër Dymai do të ishte më i përshtatshëm.

— Ky i pëlqen asaj, — shpjegoi telegrafisti.

— E njeh?

Telegrafisti ia bëri jo me kokë.

— Po njësoj është, — tha, — kisha për ta njo-

hur në çdo cep të botës vetëm nga të kërciturit e rr-së.

Edhe asaj mbrëmjeje doktor Hiraldoja i kushtoi një orë don Sabasit. E gjeti në shtrat krejt të shkrehur, të mbështjellë me një peshqir nga mesi e poshtë.

— Qenë të mira karamelet? — e pyeti mjeku.

— Vdiqa nga vapa, — u qa don Sabasi duke bërë nga dera me trupin e tij të stërmadh si prej gjysheje. — E bëra gjilpërën pas drekës.

Doktor Hiraldoja hapi çantën në një tryezë të përgatitur pranë dritares. Në oborr zukatnin gjinkallat dhe dhoma kishte një temperaturë serre të mbyllur. I ulur në oborr, don Sabasi derdhi ujët e hollë me një çurgë të ngathët. Kur mjeku mori në tubin e qelqtë mostrën e lëngut ngjyrëqehlibar, i sëmuri u ul e u rehatua. Duke vështruar analizën, tha:

— Aman, doktor, kujdes, se s'dua të vdes pa e marrë vesh si përfundon ky roman.

Doktor Hiraldoja hodhi një tabletë të kaltër në provëz.

— Cili roman?

— Paskuinët.

Don Sabasi e ndoqi doktorin me një vështrim të urtë deri kur ky mbaroi së ngrohuri tubin në llambën me alkool. Në sytë e çngjyrosur të të sëmurit kishte pyetje.

— Mirë, — tha mjeku ndërsa derdhte mostrën në oborr. Pastaj ia nguli sytë don Sabasit. — Edhe ju u merrkeni me këtë mesele?

— Unë jo, — ia ktheu i sëmuri. — Porse kënaqem kur shoh të tjerët qysh u hyn lepuri në bark.

Doktor Hiraldoja po përgatiste shiringën.

— Le që, — vazhdoi don Sabasi, — mua për vete ka dhjetë ditë që ma ngopën. Po ato dokrra: avazet e djemve dhe historia e gomerëve.

Mjeku i shtrëngoi arterien me një rrip llastiku. I sëmuri nguli këmbë në historinë e gomerëve, porse iu desh ta tregonte mbasi doktorit iu duk se nuk e dinte.

— Një dava gomerësh që më ka bërë vaki këtu e njëzet vjet të shkuar, — tha. — Qëllonte që gjithë gomerët që shisja unë gdhiheshin të ngordhur pas dy ditësh, pa asnjë shenjë plage.

I zgjati krahun me mishra të flashkët që mjeku t'i merrte gjakun. Kur doktori i vulosi shpuarjen me pambuk, don Sabasi përtheu krahun.

— Dhe e dini ç'i polli mendja miletit?

Mjeku lëvizi kokën.

— U hap fjala sikur hyja unë vetë natën nëpër kopshtet dhe i qëlloja gomerët duke ua futur revolverin në prapanicë.

Doktori futi në xhepin e çantës tubin e qelqtë me mostrën e gjakut.

— S'duket dhe aq e pabesueshme.

— S'qe punë revolveri, qe punë gjarpërinjsh, — tha don Sabasi i ulur shesh në shtrat si një idhull oriental. — Por, sidoqoftë, duhet të jesh trap fare që të shkruash në paskuin atë çka e di gjithë bota.

— Kjo ka qenë gjithmonë karakteristikë e paskuinëve, — tha mjeku. — Ata thonë atë çka di gjithë bota e që në fakt thuajse gjithmonë është e vërtetë.

Don Sabasin e mbërtheu për një çast kriza. «Ashtu është», mërmëriti duke fshirë me çarçaf djersët e qepallave të mbufatura. Pastaj ia ktheu menjëherë:

— E vërteta është se në këtë fshat pas çdo pasurie fshihet një gomar i ngordhur.

Mjeku e kapi frazën ndërsa qe përkulur te muslluku. Pa të pasqyruar në ujë shprehjen e fytyrës së vet: një sistem dhëmbor aq i rregullt sa s'ngjante si natyror. Duke vështruar pacientin që sipër supit, tha:

— Gjithmonë kam qenë i mendimit, i dashur don Sabas, se virtyti juaj i vetëm është ndjenja e turpit.

I sëmuri u ngazëllye. Kunjat që i fuste mjeku sikur e përtërinin. «Pikërisht, si edhe potenca ime seksuale», tha, duke i shoqëruar fjalët me një përthyerje të krahut që mbase për qarkullimin e gjakut mund t'i bënte mirë, por që mjekut iu duk një paturpësi e hapët. Don Sabasi bëri një të hedhur mbi të ndenjura.

— Prandaj shqyhem gazit nga paskuinët, — vazhdoi. — Thonë se djemtë e mi s'lënkan çupulinë më këmbë këtyre anëve. E po, dardha nën dardhë do të bjerë.

Para se të largohej, doktor Hiraldos iu desh të dëgjonte një përmbledhje plot ngjyra të aventurave seksuale të don Sabasit.

— Eh rini, rini, — thirri më në fund i sëmuri. — kohë e lume kur një çupëz gjashtëmbëdhjetëvjeçare kushtonte më pak se një mëshqerrë.

— Këto kujtime kanë për t'ju shtuar përqendrimin e sheqerit në gjak, — i tha mjeku.

— Përkundrazi, — ia ktheu i sëmuri. — Më bëjnë njëqind herë më mirë se ato injeksionet tuaja të mallkuara me insulinë.

Kur doli në rrugë, mjeku pati përshtypjen se nëpër dejet e don Sabasit kish filluar të rridhte një lëng i trashë e i ëmbël si sherbet. Por tjetërkund e kishte mendjen tani: te paskuinët. Kishte ditë që në konsultore i vinin thashethemet. Atë mbrëmje, pasi kish vizituar don Sabasin, e kup-

toi papritmas se po bëhej një javë që vetëm këtë bisedë dëgjonte.

Bëri edhe disa vizita të tjera edhe ndo një orë dhe kudo i folën vetëm për paskuinët. I dëgjoi historitë pa bërë komente, me një buzëqeshje të shtirur mospërfillëse, por në të vërtetë përpiqej me mend të nxirrte një përfundim. Po kthehej në konsultore, kur at Anheli, që dilte nga vejusha De Montiel, e shkrodhi nga mendimet.

— Si i keni të sëmurët, doktor? — e pyeti at Anheli.

— Unë mirë i kam të mitë, at i shenjtë, — ia ktheu mjeku. — Ju si i keni tuajtë?

At Anheli kafshoi buzën. E kapi mjekun për krahu.

— Pse ma bëni këtë pyetje?

— S'e di, — u gjegj mjeku. — Kam të dhëna se një epidemi e madhe i ka rënë klientelës suaj.

At Anheli i bishtnoi muhabetit me qëllim, siç iu duk mjekut.

— Sapo fola me vejushën De Montiel, — tha. — I janë shkatërruar nervat fare asaj gruaje të gjorë.

— Kushedi se ç'ka në shpirt, — e diagnostikoi mjeku.

— Ka frikë nga vdekja.

Ndonëse banonin në drejtime të kundërta, at Anheli po e përcillte në konsultore.

— E kam me tërë mend, at i shenjtë, — u kthye përsëri mjeku te biseda e parë. — Ç'mendoni ju për paskuinët?

— S'mendoj asgjë, — tha famullitari. — Por, po më detyruat ju që të mendoj, unë do t'ju thosha se janë çështje zilie të një fshati shembullor.

— Diagnoza të tilla s'vinim ne mjekët as në mesjetë, — ia ktheu doktor Hiraldoja.

U ndalën para konsultores. Duke bërë fresk ngadalë, at Anheli përsëriti për herë të dytë asaj dite: «S'duhen fryrë gjërat me zor». Doktor Hiraldon e pushtoi një dëshpërim i thellë.

— Nga e dini ju, at i shenjtë, se s'paska asgjë të vërtetë në ato çka thonë paskuinët?

— Sepse do ta dija nga të rrëfyerit.

Mjeku e vështroi ftohtas në sy.

— Aq më keq në qoftë se nuk e dini nga të rrëfyerit, — i tha.

Asaj mbrëmjeje at Anheli vuri re se edhe në shtëpitë e të varfërve flitej për paskuinët, por në një mënyrë të ndryshme, madje me një kënaqësi të hareshme. Hëngri pa oreks, pasi qe lutur me një të dhembur koke si thikë, për të cilën ua vuri fajin qofteve të drekës. Pastaj kërkoi cilësimin moral të filmit dhe për të parën herë në jetën e tij provoi një ndjesi të errët krenarie, kur u ra kambanave fiks dymbëdhjetë herë për ndalim të plotë. Tekefundit nxori një stol te porta e rrugës, ndërkohë që koka mend po i pëlciste nga dhembja, dhe ndenji të kundronte botërisht se kush qenë ata që hynin në kinema duke shkelur urdhërin e tij.

Hyri alkaldi. Zuri vend në një qoshe të platesë dhe piu dy cigare para se të fillonte filmi. Mishi i qe çenjtur, por në trup i kishin mbetur gjurmat e vuajtjeve të dy netve të shkuara dhe të dëmit të aspirinave, ndaj dhe cigaret i sollën të përzier.

Salla e kinemasë ishte një oborr i rrethuar me një mur çimentoje, i mbuluar me fletë llamarine

deri në gjysmë të platesë dhe me një bar që dukej sikur përtëritej mëngjes për mëngjes i pleheruar prej copërash çamçakëzi e bishtra cigaresh. Për një çast alkaldi ndjeu t'i tallaziteshin bangot prej druri të palatuar, rrjeta e telit që ndante platenë nga galeria dhe muri përballë i lyer në të bardhë, ku projektohej filmi.

E ndjeu veten më mirë kur u fikën dritat. Atëherë pushoi muzika piskatëse e altoparlantit, por filloi të dëgjohej më qartas rrapëllima e motorit elektrik të vendosur në një kuti dërrase ngjitur me aparatin e projeksionit.

Para filmit pati disa reklama. Një gurgulë pështërimash të mbytura, hapash të përturbullt dhe kukurisjesh të këputura u ndien për disa minuta në gjysmëterrin e sallës. Duke brofur për një çast, alkaldi tha me mend se ajo hyrje ilegale i ngjante një subversioni kundër rregullave të rrepta të at Anhelit.

Edhe vetëm prej markës së kolonjës do ta kishte njohur pronarin e kinemasë që i kaloi në krah.

— Ore bandit, — i pështëriti dhe e mbërtheu për krahu. — E di që ti duhet të paguash një taksë të posaçme?

Duke qeshur mes dhëmbëve, pronari iu ul në vendin pranë.

— Është film i mirë, — tha.

— Për mua, — tha alkaldi, — a s'janë të gjithë të këqinj. S'i duroj dot filmat me moral.

Vite më parë askush s'do ta kish marrë seriozisht censurën e kambanave. Por për çdo të diel, në meshën e madhe, at Anheli i tregonte me gisht e i nxirrte jashtë nga kisha gratë që gjatë javës kishin shkelur urdhrin e tij.

— Shyqyr që kemi deriçkën e pasme, — tha pronari.

Alkaldi kishte filluar të ndiqte dokumentarin e vjetëruar. Foli duke bërë nga një pushim sa herë gjente në ekran ndonjë gjë që i interesonte.

— Kudo njësoj, — tha. — Famullitari s'u jep kungimin grave që mbajnë mëngë të shkurtëra dhe ato vazhdojnë të mbajnë mëngë të shkurtëra, vetëm se vënë mëngë të rreme para se të hyjnë në meshë.

Pas dokumentarit u erdhi radha anonseve të filmit të javës së ardhshme. I ndoqën në heshtje. Kur mbaruan, pronari u përkul nga alkaldi.

— Toger, — i çuçuriti. — A s'ma ble këtë mizerje?

Alkaldi nuk e largoi vështrimin nga ekrani.

— Se mos del gjë.

— Për mua s'del, — tha pronari, — kurse për ju del që ç'ke me të. Juve s'jua hedh dot prifti me atë përrallën e kambanave.

Alkaldi u mendua para se të përgjigjej.

— Ta shohim, — i tha.

Por nuk e zgjati më bisedën. Ngriti këmbët mbi bankon përpara dhe u krodh në spërdredhimet e një drame të koklavitur që, në fund të fundit, as katër kambana s'i kish hak.

Kur doli nga kinemaja u ndal në sallën e bilardos ku luanin kumar. Bënte të nxehtë dhe muzika e radios të çante veshët. Si ktheu një shishe me ujë mineral, vajti të flinte.

Eci i shkujdesur përgjatë bregut, duke ndier në të errët zhurmërimën e rropullive të lumit të fryrë dhe kutërbimin e tij prej shtaze vigane. Para portës së shtëpisë, duke u zbythur vrik nxori revolverin.

— Dil në dritë, — thirri me zë të nderë, — se e hëngre.

Një zë shumë i ëmbël erdhi nga errësira.

— Mbajini nervat, toger.

Ndenji me revolverin ngrehur deri kur njeriu doli në dritë. Ishte Kasandra.

— Shpëtove për qime, — i tha alkaldi.

E ngjiti në dhomën e gjumit. Një copë herë të madhe ajo griu mbarë e prapë. Qe ulur në hamak dhe ndërkohë hoqi këpucët e këqyri me njëfarë padjallëzie thonjtë e këmbëve të veta të lyera me një të kuqe all.

I ulur përballë saj, duke bërë fresk me kapelë, alkaldi e vazhdoi bisedën me një korrektesë sa për të thënë. Kishte ndezur përsëri një duhan. Kur ra ora dymbëdhjetë, ajo u shtri përmbys në hamak, zgjati drejt tij krahun e stolisur me një xhingël tringëllitëse dhe e kapi për hunde.

— U bë vonë, kolopuç, — i tha. — Fike dritën.

— S'të thirra për atë punë, — i tha ai.

Ajo s'kuptoi.

— Di të shtiesh fall? — e pyeti alkaldi.

Kasandra u kthye e u ul për së mbari në hamak. «S'do mend», tha. Pastaj, kur e kuptoi si qe puna, mbathi këpucët.

— Po nuk kam letrat, — tha.

— Kush bën vorbën, — buzëqeshi alkaldi, — i vë dhe vegjën.

Nxori një palë letra të stërpërdorura nga fundi i valixhes. Ajo i shqyrtoi një nga një, para e mbrapa, gjithë seriozitet. «Të miat janë më të mira, — tha. — Por, sidoqoftë, rëndësi ka komunikimi.» Alkaldi afroi një tryezë, u ul përpara saj dhe Kasandra hodhi letrat.

— Dashuri apo tregti? — pyeti.

Alkaldi fshiu djersët e duarve.

— Tregti, — tha.

Një gomar pa zot u struk për t'u mbrojtur nga shiu nën strehën e famullisë dhe gjithë natën e natës i ra me shkelma murit të dhomës së gjumit. At Anheli asaj nate nuk gjeti rehat. Mezi mundi të merrte një sy gjumë aty nga mëngjesi dhe, kur u zgjua, iu duk vetja i mbuluar me pluhur. Lulelandrat e përgjumura nën shiun e hollë, kutërbimi i qenefit dhe pastaj hijerorja e zymtë e kishës pasi u fik kumbi i kambanave të orës pesë, gjithçka dukej si e sajuar enkas për t'ia nxjerrë për hundësh atë mëngjes.

Që prej sakristisë, ku u vesh për të thënë meshën, dëgjoi Trinidadin tek mblidhte minjtë e ngordhur, ndërkohë që hynin në kishë gratë kokunjura të ditëve të zakonshme. Gjatë meshës vuri re me një pezmatim gjithnjë më të madh lajthitjet e xhakonit, latinishten e tij prej maloku, dhe kur më në fund mesha mbaroi, e ndjeu veten të mashtruar keqas, siç e ndiente rëndom në orët e liga të jetës së tij.

Po shkonte për të ngrënë mëngjesin, kur Trinidadi i doli përpara me një fytyrë rrezëllitëse. «Sot kanë rënë edhe gjashtë», tha duke tundur minjtë e ngordhur në kuti. At Anheli u përpoq ta mposhtte ligështimin.

— Mrekulli, — tha. — Tani të kish t'u gjenim edhe foletë që t'i shfarosnim me gjithsej.

Trinidadi ua kish gjetur foletë. Tregoi se i kish diktuar vrimat në vende të ndryshme të kishës, sidomos në kambanore e në pagëzimtore, dhe si i kish zënë me peshkve. Atë mëngjes kishte gjetur një mi të hardallosur tek përplasej pas mureve, pasi kish kërkuar më kot tërë natën e natës hyrjen e folesë.

Dolën në oborrin e vogël të shtruar me gurë, ku kërcejtë e parë të lulelandrave kishin filluar të ngrinin shtatin. Trinidadi u ndal të hidhte minjtë e ngordhur në qenef. Kur hyri në dhomë, at Anheli po gatitej për të ngrënë, pasi kish ngritur mësallën, poshtë së cilës i shfaqej mëngjes për mëngjes, si në ndonjë numër prestidigjatori, silla që i dërgonte vejusha De Asis.

— Harrova t'ju them se nuk e bleva dot arsenikun, — tha Trinidadi kur hyri. — Don Lalo Moskoti thotë se s'jepet pa recetë mjeku.

— S'ka nevojë, — tha at Anheli. — Do të ngordhin të gjithë të mbyllur nëpër vrima.

Afroi karrigen te tryeza dhe filloi të vendoste filxhanin, pjatën me kulaçin e prerë në rriska dhe ibrikun e kafesë me një dragua japonez të gdhendur, ndërkohë që Trinidadi hapte dritaren. «Sidoqoftë, më mirë t'i marrim të gjitha masat», tha ajo. At Anheli shtiri kafe dhe u ndal e ia nguli sytë Trinidadit me atë bluzën pa formë e me një palë potina prej invalideje tek i afrohej tryezës.

— Shumë po merakosesh për minjtë, — tha.

At Anheli nuk kish zbuluar, as atëherë e as më parë, ndonjë shenjëz shqetësimi në gëmushën e vetullave të Trinidadit. Pa e përmbajtur dot një të dridhur të lehtë të gishtërinjve, i ho-

dhi kafesë dy lugëza sheqer dhe filloi ta përziente me vështrimin te kryqi i varur në mur.

— Qysh kur ke që s'je rrëfyer?

— Qysh të premten, — u përgjigj Trinidadi.

— Pa më thuaj, — foli at Anheli. — Mos më ke fshehur ndonjë mëkat?

Trinidadi ia bëri jo me kokë.

At Anheli mbylli sytë. Pastaj e la prapë kafenë, vendosi lugëzën në pjatë dhe e kapi Trinidadin për krahu.

— Bjer në gjunjë, — e urdhëroi.

E hutuar, Trinidadi la kutinë e kartonit përtokë dhe ra në gjunjë pranë saj. «Fillo: Unë Mëkatnorja», tha at Anheli që më së fundi mundi ta bënte zërin atësor, siç i kish hije rrëfyestarit. Trinidadi shtrëngoi grushtet pas gjoksit dhe filloi të lutej me një mërmërimë të pakuptueshme, deri kur famullitari i vuri dorën në sup e i tha.

— Mirë.

— Kam thënë gënjeshtra, — tha Trinidadi.

— Tjetër.

— Kam pasur mendime të mbrapshta.

Kështu e bënte gjithmonë rrëfimin. Numëronte po ato mëkate në mënyrë të përgjithshme e kurdoherë me po atë radhë. Kësaj here famullitari e quajti të domosdoshme të ngulmonte edhe më.

— Për shembull, — tha.

— Nuk e di, — u lëkund Trinidadi. — I vijnë nganjëherë njëriut mendime të mbrapshta.

At Anheli drejtoi trupin.

— S'të ka shkuar ndonjëherë nëpër mend t'i heqësh jetën vetes?

— Shën Mëri e shenjtë, — thirri Trinidadi pa ngritur kokën, duke goditur njëkohësisht me

kyçet këmbën e tryezës. Pastaj u përgjigj: — Jo, at i shenjtë.

At Anheli e shtrëngoi të ngrinte kokën dhe vuri re me dëshpërim se sytë e vajzës po mbushesheshin me lot.

— Domethënë se arsenikun e do vërtet për minjtë.

— Po, at i shenjtë.

— Pse qan atëherë?

Trinidadi bëri të ulte kokën, por ai e mbajti për mjekre me vendosmëri. Ajo shpërtheu në lot. At Anheli i ndjeu t'i rridhnin nëpër gishtërinj si uthull e vakët.

— Mbaje veten, — i tha. — Nuk e ke mbaruar ende rrëfimin.

E la të shkrehej në një vajtim të heshtur. Kur ndjeu se kishte mbaruar, i tha ëmbëlsisht:

— Pa rrëfemë tani.

Trinidadi fshiu hundët me bluzë dhe përcolli pështymën e trashë e të kripur prej lotëve. Kur filloi të fliste përsëri, i qe kthyer ai zëri i rrallë prej baritoni.

— Im ungj Ambrosio më bie në qafë, — tha.

— Si të bie në qafë?

— Do që ta lë të flerë një natë në shtratin tim, — tha Trinidadi.

— Vazhdo.

— Kaq. S'ka gjë tjetër, — tha Trinidadi. — Për at' zot që s'ka gjë tjetër.

— Mos bëj be në zot, — e qortoi famullitari. Pastaj pyeti me zërin e qetë të rrëfyestarit: — Pa më thuaj: ti me kë fle?

— Me mëmën dhe motrat, — tha Trinidadi. — Gjashtë vetë në një dhomë.

— Po ai?

—Në dhomën tjetër me burrat, — tha Trinidadi.

— S'ka kaluar asnjëherë në dhomën tënde? Trinidadi ia bëri jo me kokë.

— Thuamë të vërtetën, — ngulmoi at Anheli. — Hajde, mos ki frikë: nuk është orvatur asnjëherë të kalojë në dhomën tënde?

— Një herë.

— Si ndodhi?

— Nuk e di, — tha Trinidadi. — Kur u zgjova e ndjeva që më qe futur nën çarçaf, s'pipëtinte fare dhe më thoshte se s'donte të më bënte asgjë, vetëm të flinte me mua, se kishte frikë nga gjelat.

— Ç'gjela?

— Ku di unë, — u përgjigj Trinidadi. — Kështu më tha.

— Po ti ç'i the?

— Që po të mos ikte, do të bërtisja që të ngriheshin të gjithë.

— Dhe ai ç'bëri?

— U zgjua Kastula dhe më pyeti ç'kisha. Unë i thashë se asgjë, se do të kisha parë ndonjë ëndërr dhe atëherë ai s'u ndie më, si të kish vdekur. Pothuajse s'e ndjeva fare kur doli nga shtrati.

— Ishte i veshur, — tha at Anheli në mënyrë pohuese.

— Ishte siç fle, — tha Trinidadi. — Vetëm në benevrekë.

— Nuk u orvat të të prekte.

— Jo, at i shenjtë.

— Thuamë të vërtetën.

— Të vërtetën them, at i shenjtë, — ngulmoi Trinidadi. — Për at' zot!

At Anheli i ngriti sërish kokën dhe ndeshi në sytë e saj të njomur prej një vezullimi të trishtë.

— Pse s'ma kishe treguar?

— Kisha frikë.
— Frikë nga se?
— Nuk e di, at i shenjtë.

I vuri dorën në sup dhe e këshilloi për një copë herë të gjatë. Trinidadi ia bënte po me kokë. Kur po mbaronin, filloi të lutej bashkë me të, me zë shumë të ulët: «Zoti ynë Jezukrisht, Perëndi e Njeri i vërtetë...» Lutej për së thelli, me një si frikë të brendshme, duke sjellë sërish ndër mend gjatë të luturit jetën e tij deri atje ku e lejonte kujtesa. Në çastin kur po i falte mëkatin, qe bërë përsëri pikë e vrer.

Alkaldi shtyu portën duke thirrur: «Gjykatës». Gruaja e gjykatës Arkadios doli nga dhoma e gjumit duke fshirë duart pas fundit.

— Ka dy net që s'ka ardhur, — tha.

— Ç'mizerje, — tha alkaldi. — Dje s'doli në zyrë. S'lashë vend pa e kërkuar, se kisha një punë urgjente, dhe s'e gjeta dot. Ku dreqin do të ketë vajtur?

— Te ndonjë rrospi, ku tjetër.

Alkaldi doli pa e mbyllur portën. Hyri në sallën e bilardos. Nga gramafoni automatik i ngritur me gjithë volumin ushtonte një këngë sentimentale. Vajti drejt e te ndarja në fund të sallës duke thirrur: «Gjykatës». Don Rokeja, pronari, që po toçiste rumin e shisheve në një damixhanë, u ndal. «Nuk është aty, toger», thirri. Alkaldi kaloi përtej çatmasë ndarëse. Grupe burrash luanin me letra. Asnjëri s'e kishte parë gjykatës Arkadion.

— Punë dreqi, — tha alkaldi. — Në këtë

fshat njeriu s'bën dot as një hap pa e marrë vesh të tjerët dhe ja, tani që më duhet gjykatësi, askush nuk e ditka se ku është.

— Pyesni atë që vë paskuinët, — tha don Rokeja.

— Ç'më çan bythën me gjithë ato paçavure, — ia ktheu alkaldi.

Gjykatës Arkadioja nuk qe as në zyrën e vet. Ishte ora nëntë, por sekretari i gjykatësit ia kish këputur kokrrës së gjumit në korridor. Alkaldi vajti në alkaldi, u dha urdhër tre policëve të vishesin dhe ta kërkonin gjykatësin në sallën e vallëzimit dhe në dhomat e grave ilegale që njiheshin botërisht. Pastaj doli në rrugë dhe ia mbajti nga e shpinin këmbët. Në rrojtore, të zdërgjuar në karrige e me fytyrën të mbështjellë me një peshqir të ngrohtë, gjeti gjykatës Arkadion.

— Dreqi të mori, gjykatës, — thirri, — kam dy ditë që më ranë këmbët duke të kërkuar.

Berberi hoqi peshqirin dhe alkaldi pa një palë sy të prerë dhe një mjekër të nxirë tri ditë pa rruar.

— Jot shoqe po pjell, kurse ti s'e bën qejfin qeder, — i tha.

Gjykatës Arkadioja kërceu përpjetë.

— Punë muti.

Alkaldi ia plasi gazit me zhurmë, duke e shtyrë në karrige. «Mos u bëj trap, — i tha. — Po të kërkoj për tjetër punë.» Gjykatës Arkadioja u shtri përsëri me sytë të mbyllur.

— Mbaro dhe eja nga zyra, — i tha alkaldi.

— Po të pres.

U ul në banko.

— Ku dreqin ke qenë?

— Këndej rrotull, — tha gjykatësi.

Alkaldi s'para vinte në rrojtore. E kish parë

njëherë njoftimin e mbërthyer në mur: *Ndalohen bisedat politike,* por s'i kishte bërë ndonjë përshtypje. Kurse kësaj radhe i tërhoqi vëmendjen.

— Guardiola, — thirri.

Berberi pastroi briskun e rrojës pas pantallonave dhe priti.

— Ç'patët, toger?

— Kush të dha leje ta vësh këtë? — pyeti alkaldi duke treguar njoftimin.

— Nga përvoja, — tha berberi.

Alkaldi afroi një stol në fund të sallonit dhe hipi të shkulte njoftimin.

— Këtu vetëm Qeveria e ka në dorë të ndalojë gjëkafshë, — tha ai. — Kemi apo s'kemi demokraci?

Berberi iu vu përsëri punës. «Askush nuk mund ta ndalojë tjetrin të shprehë haptas mendimet e veta», vazhdoi alkaldi duke grisur kartonin. I hodhi copërat në koshin e plehrave dhe vajti te lavamani për të larë duart.

— E sheh, Guardiola, — foli gjykatës Arkadioja si të jepte ndonjë vendim, — ku përfundon kur bën pas kokës sate?

Alkaldi kërkoi berberin në pasqyrë dhe e gjeti të zhytur në punë. Nuk ia shqiti sytë në kohë e sipër që fshinte duart.

— Ndryshimi nga përpara dhe tani, — tha, — është se përpara urdhëronin politikanët, kurse tani urdhëron Qeveria.

— More vesh, Guardiola, — tha gjykatës Arkadioja me fytyrën të shkumuar.

— Mora, posi, — tha berberi.

Tek dilnin, alkaldi e shtyu gjykatës Arkadion drejt zyrës. Nën shiun e hollë, por të ngulmët, rrugët dukeshin si të veshura me sapun të njomë.

— Gjithmonë kam qenë i mendimit se kjo është një çerdhe komplotistësh, — tha alkaldi.

— Vetëm sa llapin, — tha gjykatës Arkadioja. — Më tutje s'ua mban.

— Pikërisht kjo më shqetëson, — ia kthen alkaldi, — fakti që duken sikur s'ua mban.

— Në historinë e njerëzimit, — tha gjykatësi si të jepte ndonjë leksion, — nuk ka patur qoftë edhe një berber komplotist. Kurse gjithë rrobaqepësit, për shembull, komplotistë kanë qenë.

Nuk ia lëshoi krahun gjykatës Arkadios derisa e uli në karrigen rrotulluese. Sekretari hyri në zyrë duke gogësirë, me një copë letre të shkruar në makinë. «Urdhëroni, — i tha alkaldit, — gati për punë.» Ai hodhi kapelen prapa dhe mori fletën.

— Ç'është kjo?

— Është për gjykatësin, — tha sekretari. — Lista e atyre që s'u kanë vënë paskuinë.

Alkaldi u kthye nga gjykatës Arkadioja me habi në fytyrë.

— Pa shih, — thirri. — Edhe ti u merrke me këto gjepura!

— Është njësoj si të lexosh romane policore, — u justifikua gjykatësi.

Alkaldi lexoi listën.

— Është një e dhënë me interes, — shpjegoi sekretari: — autori duhet të jetë njëri prej këtyre.

Gjykatës Arkadioja ia mori fletën alkaldit. «Ky i ziu është koqe fare, — tha duke u kthyer nga alkaldi. Pastaj iu drejtua sekretarit: — Po t'i vija unë paskuinët, gjëja e parë që do të bëja, do të vija një te porta e shtëpisë sime për të larguar çdo dyshim prej vetes.» Dhe pyeti alkaldin.

— Apo jo, toger?

— Ata që merren me këto punë, — tha alkaldi, — ata ua dinë edhe marifetin. Ne s'kemi pse të lodhim kokën.

Gjykatës Arkadioja e grisi letrën, e bëri shuk dhe e flakëroi në oborr.

—S'do mend, — tha.

Që para përgjigjes, alkaldi e kishte harruar këtë ndodhi. Mbështeti pëllëmbët në tryezë dhe tha:

— Mirë, tani dua të më ftillosh nëpër ata librat e tu një gjë: për shkak të përmbytjeve njerëzit e lagjeve të poshtme i mbartën shtëpitë e tyre në trojet prapa varrezave, të cilat janë pronë e imja. Ç'lipset të bëj unë në këtë rast?

Gjykatës Arkadioja buzëqeshi.

— Për këtë s'qe nevoja të vinim deri në zyrë, — tha. — Gjë më të thjeshtë se kjo nuk ka: bashkia ua jep trojet ardhacakëve dhe i paguan zhdëmtimin përkatës atij që dëshmon juridikisht pronësinë e vet mbi këto troje.

— Unë kam dokumentet, — tha alkaldi.

— Atëherë s'mbetet veçse të caktohen specialistët që të bëjnë vlerësimin, — tha gjykatësi. — Bashkia paguan.

— Kush duhet t'i caktojë?

— Mund t'i caktoni ju vetë.

Alkaldi u çapit drejt derës duke ujdisur këllëfin e revolverit. Tek e shihte të largohej, gjykatës Arkadioja tha me mend se jeta s'qenkësh veçse një vazhdim i pandërprerë rastesh për të mbajtur frymën gjallë.

— S'keni pse prishni nervat për një problem kaq të thjeshtë.

— S'jam me nerva, — tha alkaldi seriozisht. — Por e kam shumë bezdi.

— Doemos, duhen caktuar specialistët në fillim, — ndërhyri sekretari.

Alkaldi iu drejtua gjykatësit.

— Duhen patjetër?

— Në gjendje shtetrrethimi nuk është e domosdoshme, — tha gjykatësi, — por, natyrisht, për ju do të ishte më e hijshme që në këtë mes të ndërhynte një grup specialistësh, meqë e sjell rasti që të jeni ju pronar i trojeve në fjalë.

— Atëherë duhet t'i caktojmë, — tha alkaldi.

Senjor Benhamini ndërroi këmbën në kuti pa i hequr sytë nga zhgabat që zireshin për një copë rropulli në mes të rrugës. Vëzhgoi lëvizjet e mundimshme të shpendëve të ngrehur e të krekosur, si të kërcekëshin ndonjë valle të lashtë, edhe u mahnit me besnikërinë me të cilën i riprodhonin këto lëvizje burrat që visheshin si zhgaba të dielën e *kuinkuagesimës*[1]. Çunaku ulur te këmbët e tij i hodhi oksid zinku këpucës tjetër dhe i ra përsëri kutisë për ta lajmëruar ta ndërronte këmbën.

Senjor Benhamini, që njëherë e një kohë pat jetuar duke shkruar memoriale, nuk ngutej për kurrgjë. Koha rridhte me një shpejtësi të padallueshme brenda atij dyqani që ai i pat rënë dhe e pat ngrënë, gjersa e kish katandisur në një bidon vajguri e një vandak qirinjsh prej dhjami.

— Megjithëse bie shi, prapëseprapë është vapë, — tha çunaku.

Senjor Benhamini nuk qe i këtij mendimi. Kishte këmishë dhe pantallona linoje të pastra xixë. Kurse çunaku i kishte supat të lagur.

---

1 «Dita e pesëmbëdhjetë» — në kalendarin liturgjik, e diela e fundit e karnavaleve, 50 ditë para Pashkës.

— Vapa është çështje mendore, — tha senjor Benhamini. — Gjithë puna është të mos e kesh mendjen tek ajo.

Çunaku nuk e zgjati. I ra edhe një herë kutisë dhe pas një minute puna kishte marrë fund. Brenda dyqanit të tij të zymtë me rafte bosh, senjor Benhamini veshi xhaketën. Pastaj vuri një sombrero kashte, kaptoi rrugën duke u mbrojtur nga shiu me çadër dhe thirri te dritarja e shtëpisë kundruall. Nga dritarja pak e hapur nxori kokën një vajzë me flokë pisë të zez dhe lëkurë shumë të zbehtë.

— Mirëmëngjes, Mina, — tha senjor Benhamini. — Ende s'paske ngrënë mëngjes?

Ajo i tha se jo dhe hapi dritaren fare. Që ulur para një kanistre të madhe plot me copëra telash dhe lule të ngjyrshme. Në prehër kishte një lëmsh spangoje, një palë gërshërë dhe një degëz' lulesh artificiale të pambaruar. Nga gramafoni dëgjohej një disk.

— A m'i hidh një sy dyqanit derisa të kthehem unë, — i tha senjor Benhamini.

— Do të vonoheni?

Senjor Benhamini e kishte mendjen te disku.

— Deri te dentisti, — i tha. — S'vonohem as gjysmë ore.

— Mirë, — i tha Mina, — se e verbëta nuk do që të rri në dritare.

Senjor Benhamini e hoqi mendjen nga disku. «Të tëra njësoj janë këto këngët e sotme», tha. Mina ngriti një lule të mbaruar në majë të një teli të veshur me letër të gjelbër. E vërtiti me gishtërinj, e mahnitur nga ngjashmëria e madhe midis diskut dhe lules.

— Ju jeni armik i muzikës, — tha.

Por senjor Benhamini qe larguar, duke ecur në majë të gishtërinjve për të mos trembur zhga-

bat. Mina u përkul të vazhdonte punën vetëm kur e pa të trokiste te dera e dentistit.

— Për mendimin tim, — tha dentisti duke hapur derën, — kameleoni e ka ndjeshmërinë te syte.

— Mundet, — pranoi senjor Benhamini. — Po ç'lidhje ka kjo?

— Sapo dëgjova në radio se kameleonët e verbër nuk ndërrokan ngjyrë, — tha dentisti.

Si la çadrën e hapur në qoshe, Senjor Benhamini vari në të njëjtën gozhdë xhaketën dhe kapelen dhe zuri vend në karrige. Dentisti po rrihte në havan një pastë ngjyrë trëndafili.

— Ç'nuk flitet, — tha senjor Benhamini.

Jo vetëm në atë çast, por kurdoherë që fliste, e eptonte zërin në mënyrë të mistershme.

— Për kameleonët?

— Për kameleonët e për kë nuk.

Dentisti iu afrua karriges me pastën e përfunduar për të nxjerrë kallëpin. Senjor Benhamini hoqi protezën e çatalluar, e mbështolli me një shami dhe e vendosi në tryezkën prej xhami pranë karriges. Ashtu pa dhëmbë, me supat e ngushtë dhe gjymtyrët e holla, seç kishte diçka prej shenjtori. Si i rregulloi pastën pas qiellzës, dentisti i mbylli gojën.

— Ashtu është, — tha duke e vështruar në sy. — Frikacak kam qenë gjithmonë.

Senjor Benhaminit desh i shpërtheu një kundërshtim i vetvetishëm, por dentisti ia mbajti gojën të mbyllur. «Jo, — ia ktheu duke folur së brendshmi. — S'është ashtu.» E dinte, si të gjithë, se dentisti pat qenë i vetmi i dënuar me vdekje që s'kishte lëvizur prej shtëpisë. Ia kishin bërë muret shoshë me plumba, i kishin dhënë një afat 24-orësh që të largohej nga fshati, por nuk e kishin thyer dot. E kishte zhvendosur kabinetin në

një dhomë të brendshme dhe kish punuar me revolver në brez duke qëndruar si burrë, derisa kaluan muajt e gjatë të terrorit.

Sa kohë zgjati procesi, dentisti pa disa herë radhazi në sytë e senjor Benhaminit të njëjtën përgjigje të përsëritur kur me më pak e kur me më shumë shqetësim. Por ia mbajti gojën të mbyllur, duke pritur të thahej pasta. Pastaj nxori kallëpin.

— S'e kisha fjalën aty, — mundi të fliste më në fund senjor Benhamini. — E kisha për paskuinët.

— Ah, — ia bëri dentisti. — Edhe ty t'i paskan marrë mendtë paskuinët?

— Është një simptomë e dekompozimit social, — tha senjor Benhamini.

Kish vënë përsëri protezën dhe po fillonte procesin e shumëkujdesshëm të veshjes së xhaketës.

— Është një simptomë që tregon se, herët a vonë, e vërteta del në shesh, — tha dentisti me shpërfillje. Vështroi qiellin e turbullt nga dritarja dhe i tha: — Po deshe, prit sa të pushojë.

Senjor Benhamini vari çadrën në krah. «Kam dyqanin vetëm», tha duke vështruar edhe ai retë e zeza të ngarkuara me shi. E ngjatjetoi me sombrero.

— Dhe hiqi ato mendime nga koka, Aurelio, — tha që nga dera. — S'ka gojë njeri të thotë se ti qenke frikacak, vetëm ngaqë i hoqe një dhëmballë alkaldit.

Dentisti vajti te dera dhe i dha senjor Benhaminit një fletë të palosur.

— Lexoje dhe shpërndaje.

Senjor Benhamini s'pati kohë ta hapte për ta marrë vesh se ç'qe. E vështroi gojë hapur.

— Prapë?

Dentisti ia bëri po me kokë dhe ndenji te dera kur senjor Benhamini doli në rrugë.

Në orën dymbëdhjetë e shoqja e thirri për të ngrënë drekë. Anhela, e bija 20-vjeçare, po arnonte një palë çorape në dhomën e bukës, të mobiluar thjesht e varfërisht, me orendi që dukeshin sikur patën qenë të vjetra qysh në fillim fare. Mbi prevazin prej druri të parmakëve që shkonin drejt oborrit kishte një sërë saksish me bimë mjekësore të lyera në të kuqe.

— I gjori Benhamin, — tha dentisti ndërsa ulej në vendin e tij para tryezës së rrumbullakët, — ia kanë marrë mendjen paskuinët.

— E kujt s'ia kanë marrë mendjen, — tha e shoqja, — të gjithëve.

— Tovarët po ikin nga fshati, — ndërhyri Anhela.

Nëna mori pjatat për të shtënë supën. «Po i shesin në rrugë me laçka e plaçka», tha. Tek thithte aromën e ngrohtë të supës, dentisti e ndjeu veten larg shqetësimeve të së shoqes.

— Do të kthehen përsëri, — tha. — Do ta hanë turpin me bukë dhe do të kthehen.

Duke i fryrë supës para se të fillonte të hante, priti se mos jepte ndonjë mendim e bija, një vajzë me pamje disi të thatë, si ai vetë, por me një shkëlqim gjithë flakë e zjarr në sy. Ajo nuk iu përgjigj fjalëve të tij. Foli për cirkun. Tha se ishte njëri që e priste të shoqen përgjysmë me sharrë, një xhuxh që këndonte me kokën të futur në gojë të luanit dhe një pehlivan që bënte një salt mortal të trifishtë mbi një shesh të shtruar me thika. Dentisti e dëgjoi duke ngrënë në heshtje. Në fund u premtoi se atë natë, po të mos binte shi, do të shkonin të gjithë në cirk.

Në dhomën e fjetjes, ndërsa varte hamakun për të marrë një sy gjumë, e kuptoi se premti-

mi nuk e kish ndryshuar sadopak gjendjen shpirtërore të së shoqes. Edhe ajo qe gati të iknin nga fshati, po t'u vinin një paskuin.

Dentisti e dëgjoi pa u çuditur. «Do të ishte e lezetshme, — tha, — që nuk na nxorën dot me plumb e të na nxjerrin me një copëz fletushkë të ngjitur te porta.» Zbathi këpucët dhe ra në hamak për t'u prehur, pa i hequr çorapet.

— Mos u bëj merak, se ne s'na vë njeri.

— S'kanë respekt për askënd, — tha gruaja.

— Varet, — tha dentisti, — me mua e dinë që s'ia dalin dot.

Gruaja ra në shtrat si e vdekur.

— Sikur ta dija se kush i vë.

— Ai që i vë e di vetë, — tha dentisti.

Alkaldit i qëllonte shpesh të kalonte ditë të tëra pa ngrënë. Thjesht ngaqë harronte. Siç qe nganjëherë i zënë me punë deri në grykë, po ashtu i ndodhte edhe të mos kish ç'të bënte e ta shkonte kohën duke u hallavitur nëpër fshat, ose duke u mbyllur në zyrën e blinduar pa e marrë vesh aspak se si kalonin orët, ditët, javët. Gjithmonë i vetëm, gjithmonë keq e tukeq, s'qe i dhënë pas asgjëje në mënyrë të veçantë dhe s'mbante mend të kish bërë ndonjëherë jetë të rregullt. Vetëm kur nuk duronte dot më, çatiste në bujtinë në çfarëdo ore dhe hante ç't'i vinin përpara.

Atë ditë hëngri drekë me gjykatës Arkadion. E kaluan së toku gjithë paraditen, deri kur u legalizua shitja e trojeve. Specialistët e caktuar *ad interim* e kryen detyrën e tyre dhe për këtë

iu deshën dy orë. Pak pas katrës, tek hynin në sallën e bilardos, ngjanin të dy sikur ktheheshin nga një inkursion i mundimshëm në të ardhmen.

— Domethënë, e hoqëm qafe edhe këtë punë, — tha alkaldi duke fërkuar duart.

Gjykatës Arkadioja nuk e kishte mendjen tek ai. Alkaldi e pa të kërkonte verbtazi një stol te banaku dhe i dha menjëherë një aspirinë.

— Një gotë ujë, — urdhëroi don Roken.

— Një birrë të ftohtë, — e korrigjoi gjykatës Arkadioja me ballin të mbështetur në banak.

— Ose një birrë të ftohtë, — e ndreqi edhe alkaldi, duke vënë paratë mbi banak. — Sot e ke hak, e ke fituar me djersë.

Si piu birrën, gjykatës Arkadioja futi gishtërinjtë nëpër flokë. Lokali ziente si për festë, duke pritur parakalimin e cirkut.

Alkaldi e pa nga salla e bilardos. Duke brofur sipas ritmit të bakërishteve e të teneqeve të bandës, shkoi e para një vajzë me një fustan ngjyrargjendi, kaluar mbi një elefant xhuxhmaxhuxh me veshët llapushë. Pas saj shkuan palaçot dhe pehlivanët. Shiu kishte reshtur krejt dhe rrezet e fundit të diellit kishin filluar të ngrohnin mbasditen e lagur. Kur muzika pushoi, që një burrë me këmbalka të lexonte njoftimin, fshati i tërë u duk sikur u ngrit prej dheut mes një heshtimi magjiplotë.

At Anheli, që e ndoqi parakalimin nga qela e tij, vazhdoi ta përsëriste me mend ritmin e bandës. Ajo rehati e lume, si e shkëputur nga fëmijëria, s'iu nda as gjatë të ngrënit, as gjatë gjithë mbrëmjes, deri kur mbaroi së kontrolluari hyrjen në kinema dhe u gjend sërishmi fill i vetëm në dhomën e gjumit. Si tha rruzaren, ndenji në një ekstazë të përvajshme, në karrigen prej xunkthi, pa e kuptuar si vajti ora nëntë, si

pushoi altoparlanti i kinemasë e në vend të tij mbetën vetëm kuakitjet e një bretkose. U ngrit dhe shkoi te tryeza e punës për t'i shkruar një thirrje alkaldit.

Në një nga vendet e nderit të cirkut, ku qe ulur me ftesë të sipërmarrësit, alkaldi ndoqi numrin e fillimit të pehlivanëve dhe një numër të palaçove. Pastaj doli Kasandra, e veshur në kadife të zezë e me sytë të lidhur, duke shpreh gatishmërinë t'u gjente mendimet të pranishmëve. Alkaldi iku. I ra një herë qark fshatit sa për të thënë dhe në orën dhjetë ishte në alkaldi. Atje e priste thirrja e at Anhelit, në letër fletoreje e me shkrim fort të kujdesur. E shqetësoi formalizmi i kërkesës.

At Anheli po fillonte të zhvishej kur trokiti alkaldi. «Pa shih, — tha famullitari. — S'ju prisja kaq shpejt.» Alkaldi hoqi kapelen para se të hynte.

— Më pëlqen të mos i vonoj përgjigjet, — buzëqeshi.

Flaku kapelen duke e vërvitur si disk në karrigen prej xunkthi. Te legeni i musllukut kishte disa shishe gazozi të vëna në ujë për t'u ftohur. At Anheli tërhoqi njërën.

— Doni një limonatë?

Alkaldi pranoi.

— Ju bezdisa, — tha famullitari, duke i rënë drejt, — për t'ju shfaqur shqetësimin tim lidhur me moskokëçarjen tuaj ndaj paskuinëve.

E tha në një mënyrë që mund të merrej edhe si shaka, por alkaldi e kuptoi ashtu si duhej. Pyeti veten i çuditur se si kish mundësi që shqetësimi për paskuinët ta kish tërhequr at Anhelin gjer në këtë pikë.

— Më vjen çudi, at i shenjtë, që edhe ju u vikeni mend paskuinëve.

At Anheli po kërkonte nëpër sirtarët e tryezës tapahapësin.

— Unë nuk shqetësohem për paskuinët në vetvete, — tha ai pakëz i turbulluar, pa ditur ç'të bënte me shishen. — Shqetësohem, si me thënë, për njëfarë fryme padrejtësie që ndihet në këtë mes.

Alkaldi i mori shishen dhe ia hoqi tapën pas paftës së çizmes, me një shkathtësi të dorës së majtë që i bëri përshtypje at Anhelit. Fshiu nga gryka e shishes shkumën që u derdh.

— Këto janë çështje intime, — tha pa arritur dot në një përfundim. — S'e kuptoj se si mund të ndërhyjmë ne në to.

Alkaldi zuri vend në tryezën e punës. «Ju duhet ta dini, — tha. — Se në fund të fundit për ju s'janë gjëra të panjohura.» Hodhi një vështrim të papërcaktuar nëpër dhomë dhe shtoi me tjetër ton:

— Mundësisht të bëhej diçka deri para së dielës.

— Sot është e enjte, — e kujtoi alkaldi.

— E di se ç'është, — ia ktheu famullitari. Dhe shtoi me një shtytje të brendshme të fshehtë: — Por ndoshta s'është tepër vonë që ju të kryeni detyrën.

Alkaldi bëri një përpjekje si për t'i spërdredhur grykën shishes. At Anheli e pa tek çapitej nga një cep i dhomës në tjetrin, të përmbajtur e të zhdërvjellët, me trupin si të një çunaku, dhe një ndjenjë e qartë inferioriteti e pushtoi.

— Siç e shihni, — përsëriti, — s'është fjala për ndonjë gjë të jashtëzakonshme.

Në kullë ra ora njëmbëdhjetë. Alkaldi priti sa u shua edhe kumbi i fundit dhe atëherë u përkul përballë famullitarit me duart të mbështetura në tryezë. Në fytyrë i dallohej po ai shqe-

tësima i përmbajtur që do t'i ndihej edhe në zë.

— Shiko këtu, at i shenjtë, — filloi: — fshati është i qetë, njerëzit po fillojnë të kenë besim te Qeveria. Çdo ushtrim dhune në këto çaste do të ishte një rrezik tepër i madh për një çështje që nuk ia vlen barra qiranë.

At Anheli miratoi me kokë. U mundua të shpjegohej.

— Unë e kam fjalën, përgjithësisht, për disa masa administrative.

— Sidoqoftë, — vazhdoi alkaldi pa ndryshuar qëndrim, — unë gjithmonë kam parasysh rrethanat. Ju e dini se në alkaldi kam gjashtë policë që e marrin rrogën zhaba. S'po i ndërroj që s'po i ndërroj dot.

— E di, — tha at Anheli, — s'ju vë faj.

— Tani, — alkaldi vazhdonte me vrull, pa pyetur për ndërprerjet, — të gjithë e dinë që tre prej tyre janë kriminelë ordinerë, të nxjerrë nga burgjet e të veshur policë. Siç janë punët, unë s'mund të kuturis e t'i lëshoj rrugës për të ndjekur një fantazmë.

At Anheli hapi krahët.

— Doemos, doemos, — pranoi me vendosmëri. — Kjo as që duhet shkuar nëpër mend. Po pse të mos mbështeteni, fjala vjen, te qytetarët e ndershëm?

Alkaldi u shtri në karrige, duke kthyer nga shishja ca gërrqe si me zor. Gjoksin dhe shpinën i kishte ujë në djersë. Tha:

— Qytetarët e ndershëm, siç thoni ju, shqyhen gazit me paskuinët.

— Jo të gjithë.

— Le që nuk është e drejtë të alarmosh miletin për diçka që, në fund të fundit, as që ia vlen barra qiranë. Me të vërtetë, at i shenjtë, — përfundoi duke qeshur, — gjer më sot as që ma

merrte mendja se do të vinte dita që ju dhe unë të merreshim me këtë mesele.

At Anheli mori një qëndrim atësor. «Gjer në njëfarë pike, po», ia ktheu duke iu futur një justifikimi të mundimshëm, ku kishte paragrafe të tëra të gatshme nga predikimi që pat filluar të përgatiste me mend qysh të djeshmen në drekën e vejushës De Asis.

— Është fjala, në mund të shprehem kësisoj, — e mbylli ligjëratën e tij, — për një rast terrorizmi në fushën e moralit.

Alkaldi qeshi çiltas. «Mirë, mirë, — pothuajse e ndërpreu. — Po s'mbeti filozofia te fletushkat, at i shenjtë.» La në tryezë shishen e pambaruar dhe i dha fund bisedës duke u munduar të hiqej sa më shpërfillshëm.

— Po qe se ju i jepni kaq rëndësi, atëherë do ta shohim këtë punë.

At Anheli e falënderoi. Nuk qe aspak e hijshme, i tha, të ngjitej në lutësore të dielën me shqetësime të tilla. Alkaldi qe përpjekur ta kuptonte. Por e pa se ishte mjaft vonë dhe po e linte famullitarin pa gjumë.

Dauntja e madhe e tellallisjes u shfaq përsëri si një i vdekur i ngritur lugat. Ia krisi përballë sallës së bilardos, në ora dhjetë të mëngjesit, dhe e mbajti fshatin pezull deri kur kumbuan tri të rënat e forta të mbarimit dhe pllakosi rishtas angushtia.

— Vdekja, — klithi vejusha De Montiel, tek shihte si hapeshin dyer e dritare dhe si njerëzit prej çdo ane dyndeshin drejt sheshit. — Sosi vdekja!

Si e mori veten njëfarësoj, hapi kortinat e ballkonit dhe përgjoi tollovinë rreth policit që po matej të lexonte urdhëresën. Në shesh mbretëronte një heshtje më e madhe nga ç'duhej për zërin e tellallit. Megjithëse u mundua të dëgjonte me vëmendje, duke vënë edhe dorën pas veshit, vejusha De Montiel kapi a s'kapi dot dy fjalë.

Askush në shtëpi nuk i jepte dot ndonjë sqarim. Urdhëresa qe lexuar me të njëjtin ritual autoritar të përhershëm, një rregull i ri qe vendosur në botë dhe ajo s'gjente asnjeri që ta kish dëgjuar. Kuzhinieren e trembi të verdhët e saj.

— Për se qe urdhëresa?

— Këtë po përpiqem të marr vesh dhe unë,

por asnjeri s'e ditka. Po s'do mend, — shtoi vejusha, — qysh kur bota është botë urdhëresat s'kanë sjellë kurrë gjë të mirë.

Atëherë kuzhinierja doli në rrugë dhe u kthye me hollësirat. Qysh prej asaj nate e për sa kohë do të vazhdonin shkaqet, vendosej përsëri ndalimqarkullimi. Askush s'mund të dilte në rrugë pas orës tetë deri në pesë të mëngjesit pa lejekalim të firmosur e të vulosur prej alkaldit. Policia kish urdhër t'i thërriste tri herë «ndal» cdokuit që takonte rrugës dhe, në rast mosbindjeje, kish urdhër të shtinte. Alkaldi do të organizonte patrulla me civilë, të caktuar prej atij vetë për të bashkëpunuar me policinë gjatë rojës së natës.

Duke kafshuar thonjtë, vejusha De Montiel pyeti se cilat qenë shkaqet e kësaj mase.

— Në urdhëresë nuk thuhet, — u gjegj kuzhinierja, — por të gjithë e dinë që janë paskuinët.

— Ma thoshte zemra, — thirri vejusha e lemerisur. — Ia mbërriti vdekja në këtë fshat.

Dërgoi t'i thërrisnin senjor Karmiçaelin. Duke iu bindur një force më të vietër e më të pjekur sesa shtytja e çastit, dha urdhër të nxirrnin nga depoja e t'i shpinin në dhomën e gjumit baulen prej lëkure me çelësa prej bakri që pat blerë Hosé Montieli për udhëtimin e tij të vetëm, një vit para se të vdiste. Nxori nga dollapi disapak rroba, të brendshme dhe këpucë, dhe i sërenditi të tëra në fund të baules. Tek bënte këtë punë, zu të provonte atë ndjesinë e prehjes së pakufishme që e pat ëndërruar kushedi sa herë, duke e përfytyruar veten larg këtij fshati e kësaj shtëpie, në një dhomë me një oxhak e me një ballkon për të rritur manxuranë, ku vetëm ajo të kishte të drejtë të sillte ndër mend Hosé Montielin dhe

i vetmi shqetësim që të kishte të qe pritja e ditës së shtunë për të lexuar letrat e vajzave.

Kish marrë vetëm plaçkat më të domosdoshme, këllëfin e lëkurtë me gërshërët, leukoplastin, shishezën e jodit dhe sendet e punëdores, kutinë e këpucëve me rruzaret dhe librin e uralave, e megjithëkëtë e torturonte mendimi se po merrte gjëra më tepër nga ç'mund t'i falte zoti. Atëherë futi Shën Rafaelin e allçinjtë në një çorape, e rregulloi me kujdes mes plaçkave dhe i hodhi çelësin baules.

Kur erdhi senjor Karmiçaeli e gjeti të veshur me rrobat më të thjeshta. Atë ditë, si për shenjë ndjellamirë, senjor Karmiçaeli s'e kishte çadrën. Por vejusha nuk e vuri re. Nxori nga xhepi të gjitha çelësat e shtëpisë, çdonjëri me një copëz karton ku qe shkruar me makinë tregues, e ia dha duke i thënë:

— Po lë në duart tuaja botën mëkatnore të Hosé Montielit. Bëni ç'të doni me të.

Senjor Karmiçaeli prej shumë kohësh ia kish pasur frikën këtij çasti.

— Mos doni të thoni, — u mundua të hetonte ai, — se po shkoni gjëkund sa të mbarojnë këto trazira?

Vejusha iu përgjigj me një zë të prajshëm, por në mënyrë të qartë e të prerë:

— Po iki përgjithmonë.

Senjor Karmiçaeli, pa e shfaqur shqetësimin e madh, i bëri një përmbledhje të shkurtër të gjendjes. Kalimi i trashëgimisë së Hosé Montielit s'qe bërë ende. Një pjesë e madhe e mallit dhe e gjësë së fituar me rrugë të ndryshme e pa pasur kohë për të bërë formalitete, ndodhej në një gjendje juridike të papërcaktuar. Sa pa u vënë rregulli në atë pasuri kaotike, për të cilën

as vetë Hosé Montieli vitet e fundit s'kish pasu
një ide të përafërt, qe e pamundur të bëhej kali
mi i trashëgimisë. Djali i madh, konsull në Gjer
mani, dhe dy vajzat që ua kishin marrë mendt
tregjet fantastike të mishit në Paris, lipsej t
ktheheshin ose të emëronin mandatarë për t
mbrojtur të drejtat e tyre. Përndryshe asgjë nul
mund të shitej.

Ndriçimi i çastshëm i atij labirinti ku ajo q
kredhur ç'prej dy vjetësh, nuk e tronditi kësa
radhe vejushën De Montiel.

— S'prish punë, — ngulmoi. — Fëmijët e
mi janë të lumtur në Evropë dhe s'duan ta sho-
hin me sy këtë vend egërsirash, siç thonë. S'e
ka marrë akoma lumi gjithë pasurinë!

Senjor Karmiçaeli nuk e kundërshtoi. Me se-
bepin se, sidoqoftë, duhej të përgatiste ca gjëra
për udhëtimin, doli në kërkim të mjekut.

— Tani të shohim, Guardiola, sa vlen ai pa-
triotizmi yt.

Berberi dhe grupi i burrave që kuvendonin
në rrojtore e njohën alkaldin para se të hynte
te dera. «Si edhe juaji, — vazhdoi alkaldi duke
bërë me shenjë nga dy më të rinjtë. — Sonte
do t'jua japim pushkën që e keni dëshiruar aq
shumë dhe të shohim në do të keni sy e faqe ta
ktheni kundër nesh.» Assesi nuk mund të vihej
në dyshim toni i përzemërt i fjalëve të tij.

— Më mirë një fshesë, — tha berberi. — Për
gjahun e shtrigave s'ka si fshesa.

As që ia hodhi sytë alkaldit. Po rruante zver-

kun e klientit të parë të mëngjesit dhe nuk i mori me tërë mend fjalët e alkaldit. Vetëm kur e pa të verifikonte se cilët prej grupit qenë rezervistë, pra të aftë për të përdorur pushkë, e kuptoi berberi se vërtet qe edhe ai një nga të zgjedhurit.

— Me tërë mend e keni, toger, që doni të na fusni në këtë valle?

— Dreqi e mori, — ia priti alkaldi. — Ju shkoi jeta duke çuçuritur vesh më vesh për një copë pushkë dhe, tani që e keni, s'doni të besoni.

U ndal para berberit, prej nga mund të zotëronte në pasqyrë krejt grupin. «Me tërë mend e kam, — tha duke kaluar në një ton autoritar. — Sonte, në ora gjashtë, rezervistët e kategorisë së parë të paraqiten në alkaldi.» Berberi i bëri ballë nga pasqyra.

— Po sikur të marr ndonjë të ftohtë? — pyeti.

— Ta shërojmë në birucë, — ia ktheu alkaldi.

Në gramafonin e sallës së bilardos vazhdonte një *bolero*[1] sentimentale. Salla qe e zbrazët, por në disa tryeza kishte shishe dhe gota të pira përgjysmë.

— Tani po, — tha don Rokeja tek pa alkaldin të hynte, — tani mori fund ky avaz. Më shtatë duhet mbyllur.

Alkaldi bëri drejt e në fund të sallës, ku edhe tryezat e bixhozit qenë të zbrazëta. Hapi derën e nevojtores, hodhi një vështrim në qenef dhe u kthye te banaku. Ndërsa kalonte pranë tryezës së bilardos, ngriti papritmas mbulesën dhe tha:

— Hajdeni tani, mjaft u dhjetë në brekë.

---

1 Muzikë vallëzimi spanjolle.

Dy djem dolën që poshtë tryezës duke fshi pluhurin nga pantallonat. Njëri qe i zbehtë. Tj tri, më i ri, i kishte veshët të përflakur. Alkal i shtyu me të butë drejt tryezave të hyrjes.

— Pra, e paskeni marrë vesh, — u tha: sonte në ora gjashtë në alkaldi.

Don Rokeja vazhdonte të rrinte prapa ban kut.

— Kështu si u bë puna, — tha, — s'na mb tet veçse të merremi me kontrabandë.

— Punë dy-tri ditësh është, — tha alkald

Pronari i kinemasë e kapi te kthesa. «Un edhe këtë kisha mangut, — thirri. — S'mjaft nin dymbëdhjetë të rënat e kambanës, po na dh një e rënë daulleje.» Alkaldi i ra një pëllëmb supit dhe u përpoq të kalonte pa u ndalur.

— Do t'ju shpronësoj fare, — i tha.

— S'më shpronësoni dot, — ia ktheu pronar — Kinemaja nuk është shërbim publik.

— Në këtë gjendje shtetrrethimi, — tha a kaldi, — edhe kinemaja mund të shpallet shër bim publik.

Vetëm atëherë pushoi së buzëqeshuri. I kap toi dy nga dy shkallët e alkaldisë dhe, kur arri në katin e parë, përsëri ia dha gazit.

— Pa shih, — thirri. — Edhe ju!

I ulur në një shezlong, me shpërfilljen e nj sulltani, rrinte sipërmarrësi i cirkut. I kredhu në një botë tjetër, pinte duhan me një llull piratësh. I bëri shenjë alkaldit të ulej, si të isht ai zot shtëpie.

— Bëjmë një pazar të vogël, toger.

Alkaldi afroi një stol dhe u ul përballë tij Duke mbajtur llullën me dorën gjithë gurë t ngjyrshëm, sipërmarrësi bëri një nojmë enig matike.

— A mund të flasim zgjeshur?

Alkaldi bëri një shenjë që mundej.

— E kuptova qyshse ju pashë duke u rruar, — tha sipërmarrësi. — E pra, unë që di t'i njoh njerëzit, e kuptoj që ky ndalimqarkullimi për ju...

Alkaldi e shqyrtoi me një shprehje të qartë zbavitjeje.

—... kurse për mua, që tashmë kam bërë shpenzimet e instalimit dhe kam për të ushqyer 17 njerëz e 9 kafshë, është një shkatërrim i vërtetë.

— E pastaj?

— Ju propozoj, — u gjegj sipërmarrësi, — ta vendosni më njëmbëdhjetë ndalimqarkullimin dhe t'i ndajmë për gjysmë fitimet e shfaqjes së natës.

Alkaldi vazhdoi të buzëqeshte pa ndërruar pozicion në stol.

—Besoj, — tha, — se s'hoqët keq për të gjetur në fshat njerëz që t'ju thonë se unë jam hajdut me çizme.

— Kjo është tregti e pastër, — kundërshtoi sipërmarrësi.

Nuk e kuptoi se në ç'çast pikërisht alkaldi mori hije të rëndë.

— Flasim të hënën, — tha në një mënyrë të papërcaktuar.

— Deri të dielën mua më ka marrë lumi, — ia priti sipërmarrësi. — Jemi teneqe.

Alkaldi e shpuri deri te shkallët duke i rënë supeve me ëmbëlsi. «Mos m'i shit mua ato, — i tha. — Jam regjur me këto pazarllëqe.» Te shkallët i tha me një ton ngushëllues:

— Dërgoma Kasandrën sonte.

Sipërmarrësi u mat të kthehej, por dora pas supeve e shtynte me vendosmëri.

— As mos e diskuto, — i tha. — S'e vëmë në hesap.

— Dërgoma, — përsëriti alkaldi, — pa flasim nesër.

Senjor Benhamini shtyu me maja të gishtërinjve derën me tel, por nuk hyri në shtëpi. Thirri me një pezm të fshehtë:

— Nora, dritaret.

Nora de Hakobi, një grua e pjekur dhe trupmadhe, me flokët të prerë si burrë, qe shtirë përpara ventilatorit elektrik në mugëtirën e dhomës së ndenjies. Priste senjor Benhaminin për të ngrënë drekë. Me të dëgjuar thirrjen, u çua me mundim dhe çeli katër dritaret që binin në rrugë. Një valë të nxehti hyri në dhomën e shtruar me pllaka me palloj që përsëriteshin pambarimisht dhe me mobilje të veshura me këllëfë me lule. Një luks i varfër vihej re në çdo hollësi.

— Ç'kemi ndonjë gjë, — pyeti ajo, — nga ato që fliten?

— Ç'nuk flitet.

— Për vejushën De Montiel, — saktësoi Nora. — Po thonë sikur qenka çmendur.

— Për mua ajo është çmendur qyshkur, — tha senjor Benhamini. Dhe shtoi me njëfarë zhgënjimi: — Ashtu është. Sot desh u hodh nga ballkoni.

Tryeza, që dukej e tëra nga rruga, qe shtruar me nga një servis në të dyja skajet. «E gjeti nga perëndia», tha Nora de Hakobi duke përplasur shuplakat që të sillnin drekën. Shpuri ventilatorin në dhomën e bukës.

— Shtëpia që në mëngjes është mbushur me njerëz, — tha senjor Benhamini.

— Njerëzit shyqyr që po kanë rast ta shohin nga brenda, — ia ktheu Nora de Hakobi.

Një vajzë e zezë, me kokën gjithë lidhka ngjyra-ngjyra, solli në tryezë supën e nxehtë. Aroma e gjelit mbushi dhomën e bukës dhe temperatura u bë e padurueshme. Senjor Benhamini rregulloi pecetën në qafë duke thënë: «Na bëftë mirë» dhe u orvat të rrufiste lugën e nxehtë.

— Fryji e mos u bëj torollak, — i tha ajo durimhumbur. — Le që duhet të heqësh edhe xhaketën. Me këtë mantinë tënde për të mos hyrë në shtëpi kur janë dritaret të mbyllura, do të vdesim vapë.

— Tani është më e domosdoshme se kurrë, — tha ai. — Të mos ketë gojë njeri e të thotë se nuk i ka parë të gjitha lëvizjet e mia kur hyj në shtëpinë tënde.

Ajo zbuloi buzëqeshjen e saj të mrekullueshme prej dhëmbësh artificialë, me mishra si dyllë i kuq për të vulosur dokumentet. «Mos u bëj qesharak, — i tha. — Për mua le të thonë ç'të duan.» Kur supa u ftoh dhe ajo filloi të hante, vazhdoi të fliste gjatë ndërprerjeve.

— Mund të bëhesha merak, po, sikur të thoshin gjësend për Monikën, — përfundoi, duke patur ndër mend të bijën 15-vjeçare që s'kishte ardhur për pushime qyshse pat vajtur për herë të parë në kolegj. — Por për mua s'kanë ç'thonë më tepër nga ç'di gjithë bota.

Senjor Karmiçaeli nuk ia hodhi kësaj radhe vështrimin e tij të zakonshëm të mosmiratimit. Hanin supën në heshtje, dy metra larg njëri-tjetrit, sa ç'ishte e gjatë tryeza dhe kjo qe afëria më e madhe që pat lejuar ndonjëherë mes tyre

senjor Karmiçaeli, sidomos në sy të botës. Njëzet vjet më parë, kur ajo kish qenë në kolegj, ai i shkruante ca letra të gjata e të shtirura dashurie, të cilave ajo u përgjigjej me pusullëza plot afsh. Njëherë për pushime, gjatë një pikniku, Nestor Hakobi, i dehur tapë, e kish mbërthyer për flokësh në një cep oborri dhe ia kish prerë: «Ta këpus kokën, po s'u martove me mua.» U martuan në mbarim të pushimeve. Pas dhjetë vjetësh u ndanë.

— Sidoqoftë, — tha senjor Benhamini, — dyert e mbyllura ia shtojnë kureshtjen njerëzisë.

U ngrit në këmbë me të mbaruar kafenë. «Ika, — tha. — Mina duhet të jetë mërzitur së prituri.» Nga dera, duke vënë sombreron, thirri:

— Kësaj shtëpie sikur i ka rënë zjarri.

— Po unë ç'të thashë, — ia ktheu ajo.

Si t'i jepte udhën e mbarë me vete, priti deri kur e pa të largohej nga dritarja e fundit. Pastaj shpuri ventilatorin në dhomën e gjumit, mbylli derën dhe u zhvesh lakuriq. Në fund, si përditë pas drekës, hyri në banjën ngjitur dhe u ul në nevojtore, fill e vetme me të fshehtën e vet.

Katër herë në ditë shihte Nestor Hakobin t'i kalonte para shtëpisë. Të gjithë e dinin se qe rregulluar me një grua tjetër, se kishte katër fëmijë me të dhe se e mbanin për baba shembullor. Disa herë vitet e fundit i kishte kaluar para shtëpisë me fëmijët, por asnjëherë me të shoqen. Ajo e kish parë të flashkej, të plakej e të tretej, të shndërrohej në një të huaj, lidhja e dikurshme me të cilin tani i dukej si çudia më e madhe. Kur e kur, gjatë pasdrekave vetmitare, ajo kish filluar ta dëshironte sërish në një mënyrë të ngutshme e të ngulmshme, jo siç e shihte t'i kalonte para shtëpisë, por

siç pat qenë në kohën para se të lindej Monika, kur dashuria e tij e shkurtër dhe e rëndomtë ende s'i qe bërë e padurueshme.

Gjykatës Arkadioja fjeti deri në drekë. Kështu që lajmin e tellalit e mori vesh vetëm kur vajti në zyrë. Sekretari, përkundrazi, ishte me mendje të ngritur qysh prej orës tetë, kur alkaldi i kish kërkuar të hartonte dekretin.

— Sidoqoftë, — u shpreh gjykatës Arkadioja, pasi mësoi holiësirat, — është bërë me terma shumë të ashpër. S'qe e nevojshme.

— Është po ai i përhershmi.

— Ashtu është, — pranoi gjykatësi. — Por punët kanë ndryshuar dhe lipset të ndryshojnë edhe termat. Njerëzit duhet të jenë trembur.

Megjithëkëtë, siç e provoi vetë më vonë duke luajtur letrash në sallën e bilardos, s'qe ndjenja e frikës ajo që zotëronte, por një ndjesi ngadhënjimi kolektiv nëpërmjet vërtetimit të asaj që të gjithë e dinin fare mirë: punët nuk kishin ndryshuar. Gjykatësi s'mundi t'i shmangej alkaldit kur po dilte nga salla e bilardos.

— S'ia vlente barra qiranë për paskuinët, — i tha. — Populli është i lumtur.

Alkaldi e zuri përkrahu. «S'po bëhet asgjë kundër popullit, — i tha. — Por kështu e do puna.» Gjykatës Arkadioja s'i duronte dot këto biseda në ecje e sipër. Alkaldi ecte me hap të vendosur, si të kishte ndonjë ngut të madh, dhe vetëm si pat ecur kushedi se sa, e kuptonte që s'po shkonte askund.

— Se mos ka për të zgjatur gjithë jetën, —

vazhdoi. — Gjer të dielën them se do ta kemi shtënë në dorë bukuroshen e fletushkave. S'e di pse më është tiposur që është grua.

Gjykatës Arkadioja nuk e besonte. Ndonëse s'para u jepte rëndësi informatave të sekretarit të tij, gjithësesi kishte arritur në një përfundim; paskuinët nuk i vinte vetëm një njeri. S'dukej të kishin një plan konkret. Bile ditët e fundit kishin dalë edhe paskuinë të një lloji tjetër: me vizatime.

— Mbase nuk është as një burrë dhe as një grua, — tha gjykatës Arkadioja. — Por janë disa burra e disa gra, që veprojnë sikush për hesap të vet.

— Mos m'i bëj lëmsh hesapet, gjykatës, — tha alkaldi. — Ti e di se në çdo ngatërresë, sado që të përzihen shumë vetë, gjithmonë ka një fajtor.

— Këtë e ka thënë Aristoteli, toger, — ia ktheu gjykatës Arkadioja. Dhe shtoi me bindje: — Sidoqoftë, mua kjo masë më duket pa vend. Sepse ata që i vënë, do të presin derisa të hiqet ndalimqarkullimi dhe avazi do të fillojë përsëri.

— S'prish punë, — tha alkaldi; — në fund të fundit, duhet ruajtur autoriteti.

Rekrutët kishin filluar të mblidheshin në alkaldi. Oborri i vogël me mure të larta prej betoni, të larushitura me gjak të tharë e të bëra shoshë nga plumbat, të sillte ndër mend kohët kur s'mjaftonin qelitë dhe të arrestuarit i vinin nën qiell të hapët. Atë mbrëmje policët e paarmatosur hallaviteshin më brekë nëpër korridore.

— Rovira, — thirri alkaldi që nga porta, — Nxirru çunave ndonjë gjë për të pirë.

Polici filloi të vishet.

— Rum? — pyeti.

— M'i lër numrat tani, — i thirri alkaldi tek shkonte për në zyrën e blinduar. — Ndonjë gjë të ftohtë.

Rekrutët pinin duhan të ulur qark oborrit. Gjykatës Arkadioja i vëzhgoi prej ballkonit të katit të dytë.

— Vullnetarë janë?

— Lëre mos e pyet, — tha alkaldi. — M'u desh t'i nxirrja që poshtë krevateve, sikur t'i merrja për në ushtri.

Gjykatësi i kishte të njohura të gjitha fytyrat.

— Sikur paske rekrutuar gjithë opozitën, — tha.

Tek hapeshin, dyert e rënda prej çeliku të zyrës lëshuan një afsh akull të ftohtë. «Kjo do të thotë se dinë t'ia bëjnë bam», buzëqeshi alkaldi. pasi ndezi dritat e kështjellës private. Në një cep kishte një krevat fushimi, një broke qelqi me një gotë sipër një pjate dhe një legen poshtë krevatit. Të mbështetura pas mureve prej betoni kishte pushkë dhe mitralozë dore. Kthina ajrosej vetëm nga frëngjitë e ngushta e të larta prej ku shihej porti dhe dy rrugët kryesore. Në cepin tjetër qe tryeza e punës pranë kasafortës.

Alkaldi bëri planin e patrullimit.

— Jo vetëm kaq, — tha, — por dua t'u jap edhe armë gjithësecilit.

Pas tyre hyri polici. Alkaldi i dha disa kartëmonedha e i tha: «Merr edhe nga dy paketa cigare për çdonjërin.» Kur mbetën vetëm, iu kthye përsëri gjykatës Arkadios:

— Hë, si po të duket?

Gjykatësi u gjegj i menduar:

— Më duket se po vëmë kokën në rrezik kotmësëkoti.

— Njerëzit do të mbeten me gojë hapur, —

tha alkaldi. — Le që këta çunakë të gjorë më duket se as që dinë ta shkrepin.

— Mbase hëpërhë e kanë humbur, — pranoi gjykatësi, — por kjo s'ka për të zgjatur shumë.

Bëri një përpjekje për ta frenuar ndjesinë e boshllëkut në stomak. «Hap sytë, toger, — i tha. — Mos na merr në qafë me gjithsej.» Alkaldi e nxori nga zyra me një lëvizje të mistershme.

— Mos u bëj trap, — i çuçuriti në vesh. — Vetëm qorrfishekë do t'u jap.

Kur zbritën në oborr, dritat qenë ndezur. Rekrutët po pinin gazoza nën llambat e pista elektrike. pas të cilave përplaseshin mizat e mëdha. Duke u çapur cep më cep të oborrit, ku kishin mbetur ende disa llogace me ujë të ndeniur shiu, alkaldi u shpjegoi me një ton atëror ku konsistonte misioni i asaj nate: do të zinin vend çifte-çifte nëpër qoshet krvesore me urdhër që të shtinin ndaj kuitdogoftë, burrë apo grua, që nuk do t'u bindej tri thirrieve me zë të lartë. I porositi të ishin të guximshëm e të matur. Pas mesnate do t'u shpinte për të ngrënë. Alkaldi shprehu besimin se, me hir të zotit, gjithçka do të vinte mbarë dhe populli do ta merrte vesh edhe një herë se si përpiqeshin autoritetet për qetësinë e tij.

At Anheli po ngrihej nga tryeza kur në kullë filloi të binte ora tetë. Fiku dritën e oborrit, i hodhi llozin portës dhe bëri kryqin mbi librin e uratave. «Në emër të Zotit». Diku në një oborr ia dha këngës një gatë.

E përgjumur në freskinë e korridorit pranë kafazëve të mbuluar me rroba të errëta, vejusha De Asis dëgjoi kambanën e dytë dhe pyeti pa hapur sytë: «Roberti erdhi?» Një shërbëtore e strukur prapa direkut të portës iu përgjigj se ai kish rënë qysh më shtatë.

Pak më përpara, Nora de Hakobi kishte ulur volumin e radios dhe po shkrihej e tëra pas një muzike të ëmbëlth që dukej sikur vinte prej një vendi të rehatshëm e të pastër. Një zë, tepër i largët për t'u dukur i vërtetë, thirri një emër në horizont dhe filluan të lehin qentë.

Dentisti s'kishte mbaruar ende së dëgjuari lajmet. Duke u kujtuar se Anhela po zgjidhte një fjalëkryq nën dritën e oborrit, i dha urdhër pa kthyer kokën: «Mbylle portën dhe shko e mbaroje në dhomë.» E shoqja u zgjua broftas.

Roberto Asisi, që vërtet kishte rënë në orën shtatë, u ngrit për të vështruar sheshin nga dritarja gjysmë e hapur dhe pa vetëm bajamet e errëta dhe dritën e fundit që fikej në ballkonin e vejushës De Montiel. E shoqja ndezi dritëzën e natës dhe me një çuçurimë të mbytur e detyroi të shtrihej. Një qen vetmitar vazhdoi të cafullonte pas kambanës së pestë.

Në kthinën e mbushur me kuti të zbrazëta e shishe të pluhurosura, don Lalo Moskoti gërrhiste me gazetën të shtrirë mbi bark dhe syzat në ballë. E shoqja paralitike, duke u rrëqethur tek kujtonte sa e sa net të tjera si ajo, largonte mushkonjat me një rreckë, ndërkohë që llogariste orën me mend. Pas thirrmave të largëta, lehjes së qenve dhe hapave të fshehtë, fillonte heshtja.

— Mos harro koraminën, — porositi doktor Hiraldoja të shoqen që po i fuste barnat e urgjencës në çantë para se të binin. Të dy e kishin mendjen te vejusha De Montiel, e shtrirë

dhe e ngrirë si e vdekur nën dozën e fundit të luminalit.

Vetëm don Sabasi, pas një kuvendimi të gjatë me senjor Karmiçaelin, e kish humbur fillin e kohës. Qe ende në zyrë duke peshuar në kandar sillën e mëngjesit të së nesërmes, kur ra kambana e shtatë dhe e shoqja doli nga dhoma e gjumit me flokët të shpupurisur.

Lumi u ndal në vend. «Në një natë si kjo», pëshpëriti dikush në t'errët, në çastin kur po binte kambana e tetë, e thellë, e paprapsueshme, dhe diçka që pat filluar të kërciste para pesëmbëdhjetë sekondash u fik krejtësisht.

Doktor Hiraldoja mbylli librin derisa pushoi edhe drithërima e fundit e daulles së sinjalit. E shoqja la çantën mbi komodinë, ra në shtrat me fytyrë nga muri dhe fiku abazhurin e saj. Mjeku hapi librin, por nuk lexoi. Të dy merrnin frymë qetësisht, fill të vetëm në një fshat që heshtja e pafund e kish katandisur sa një shtrat.

— Ç'mendon?

— Asgjë, — u përgjigj mjeku.

S'u përqendrua më deri më njëmbëdhjetë, kur u kthye në të njëjtën faqe ku pat qenë kur filloi të binte ora tetë. Palosi qoshen e faqes dhe e la librin në komodinë. E shoqja flinte. Një herë e një kohë të dy s'vinin gjumë në sy gjer ndaj të gdhirë, duke u përpjekur të gjenin me mend se ku dhe përse ushtonin të shtënat. Shpesh zhurma e çizmeve dhe e armëve pat ardhur deri te porta e shtëpisë së tyre dhe të dy kishin pritur të ulur në shtrat breshërinë e plumbave që do të shkallmonte portën. Sa e sa net, kur qenë mësuar t'i dallonin nuancat e pafundme të terrorit, e patën gdhirë me kokën mbështetur në një nënkresë të mbushur me

trakte që duheshin shpërndarë. Një mëngjes dëgjuan para derës së konsultores pëshpërimat e fëshfërimat e fshehta që zakonisht paralajmërojnë serenatat, pastaj zërin e lodhur të alkaldit: «Këtë jo. S'përzihet në këso punësh ky.» Doktor Hiraldoja fiku llambën dhe u përpoq të flinte.

Shiu filloi pas mesnate. Berberi dhe rekruti tjetër, që kishin zënë vend te qoshja e portit, lanë vendrojën e u futën në strehën e dyqanit të senjor Benhaminit. Berberi ndezi një cigare dhe këqyri pushkën nën flakën e shkrepses. Qe një armë e re.

— *Made in USA,* — tha.

Shoku i tij ndezi disa shkrepse duke kërkuar markën e karabinës, por nuk e gjeti dot. Një curril nga streha ra drejt e mbi qytën e armës. «Edhe kjo s'kish bërë vaki, — tha duke fshirë qytën me mëngë. — Të rrimë si hunj me një pushkë në dorë mu në mes të shiut.» Në fshatin e rënë fashë s'ndihej zhurmë tjetër veç asaj të ujit që rridhte nëpër strehë.

— Ne jemi nëntë, — tha berberi. — Kurse ata shtatë, duke llogaritur edhe alkaldin, po tre janë të mbyllur në alkaldi.

— Edhe unë këtë po mendoja pak më parë, — tha tjetri.

Elektriku i dorës i alkaldit i ndriçoi befasisht, ashtu të strukur pas murit, duke u përpjekur të mbronin armët nga pikat e shiut që u kërcenin si thëllëzëza rreth këpucëve. E njohën kur fiku elektrikun dhe hyri nën strehë. Kishte një mushama fushimi dhe një mitraloz dore krahaqafë. E shoqëronte një polic. Si pa orën, që e mbante në kyçin e djathtë, i dha urdhër policit:

— Shko në alkaldi dhe shih ç'bëhet me ushqimet.

Me të njëjtën energji mund të kish dhënë edhe një urdhër lufte. Polici u zhduk nën shi. Atëherë alkaldi u ul më bisht pranë rekrutëve.

— Ç'kemi ndonjë gjë? — pyeti.

— Hiçasgjë, — ia ktheu berberi.

Tjetri i zgjati një cigare para se të ndizte të tijën. Alkaldi s'e pranoi.

— Sa do të vazhdojë ky avaz, toger?

— S'e di, — tha alkaldi. — Tani për tani, sa të mbarojë ndalimqarkullimi. Nesër ditë e re, kësmet i ri.

— Domethënë gjer më ora pesë, — thirri berberi.

— Përfytyro, — tha tjetri. — Unë kam qysh në katër të mëngjesit më këmbë.

Një gurgule qensh u erdhi në vesh përmes brerimës së shiut të hollë. Alkaldi priti sa potera mbaroi dhe mbeti veç një angullimë vetmitare. U kthye nga rekruti me një pamje të ligështuar.

— Ma trego mua, që më shkoi gjysma e jetës me këtë punë, — tha. — Unë vdiqa vetë për gjumë.

— Kotmësëkoti, — tha berberi. — Kjo s'ka bythë ku të rrijë. Muhabet grash.

— Edhe mua ashtu po më duket, — psherëtiu alkaldi.

Polici u kthye dhe informoi se po prisnin që të pushonte shiu për të shpërndarë ushqimin. Pastaj një lajm tjetër: një grua që e kishin kapur pa lejekalim po e priste alkaldin në alkaldi.

Ishte Kasandra. E kishte zënë gjumi në shezlong, të mbuluar me një fletë çadre, në sallën e ndriçuar nga dritëza e zymtë e ballkonit. Alka-

ldi e kapi për hundësh me gishtin e madh dhe treguesin. Ajo nxori një ankim, u shkund në fillim prej bezdisë, pastaj hapi sytë.

— Po shihja ëndërr, — tha.

Alkaldi ndezi dritën e sallës. Duke mbrojtur sytë me duar, gruaja u shtriq ankueshëm dhe ai pati një vuajtje të çastit tek i pa thonjtë e lyer me varak dhe sqetullat e rruara.

— Ti s'e çan kokën fare, — tha ajo. — Kam që në ora njëmbëdhjetë.

— Thashë se do të të gjeja në dhomë, — u justifikua alkaldi.

— S'kisha leje kalimi.

Flokët, që dy net më parë i kish patur ngjyrë bakri, tani i kishte ngjyrë gri-argjendi. «Harrova fare», buzëqeshi alkaldi dhe, pasi vari mushamanë, u ul në një karrige pranë saj. «Do të të kenë marrë për atë që vë paskuinët.» Gruaja kishte filluar përsëri nga spërdredhjet.

— S'thua shyqyr, — ia ktheu. — Mua më pëlqejnë emocionet e forta.

Pas një copë here alkaldi e ndjeu veten krejt të përhumbur në atë sallë. Me një pamje të pambrojtur, duke kërcitur kyçet e gishtërinjve, i pëshpëriti: «Dua të më bësh një nder.» Ajo e zhbiroi me sy.

— Por këtu e thamë, këtu ta lëmë, — vazhdoi alkaldi. — Dua të më shohësh me letra se kush na i bën këto marifete.

Ajo ktheu fytyrën nga ana tjetër. «E mora vesh», tha pas një heshtjeje të shkurtër. Alkaldi e nxiti.

— Për ju, më shumë se sa për vete.

Ajo ia bëri po me kokë.

— E kam bërë edhe pa më thënë ti, — ia ktheu.

Alkaldi nuk e fshehu dot ankthin që e kish pushtuar. «Gjë e tillë s'më ka bërë vaki ndonjëherë, — vazhdoi Kasandra me një melodramatizëm të përllogaritur. — Por letrat flisnin aq açik, saqë pata frikë t'i mbaja edhe më mbi tryezë.» Edhe frymëmarrjen po e shpeshtonte qëllimisht.

— Kush i vë?

— Të gjithë dhe askush.

Djemtë e vejushës De Asis erdhën në meshën e së dielës. Ishin shtatë, përveç Roberto Asisit. Të gjithë të prerë pas një kallëpi: të bëshëm e të ashpër, kokëngjeshur si mushkë për punët e rënda dhe të urtë e të butë si dele ndaj së ëmës. Roberto Asisi, më i vogli dhe i vetmi që qe martuar, kish të përbashkët me të vëllezërit vetëm një nyje në kockën e hundës. Me shëndetin e dobët dhe të sjellat disi të veçanta, qe si njëfarë ngushëllimi për vajzën që vejusha De Asis e pat pritur më kot.

Në kuzhinën ku shtatë Asisët kishin shkarkuar kafshët me zahire, vejusha vejevinte mes një vargu zogash të lidhura, zarzavateve, shakujve me djathë, peksimadheve të zeza dhe copërave të pastërmasë, duke u dhënë udhëzime shërbëtoreve më të djathtë e më të mëngjër. Me t'u spastruar kuzhina, dha urdhër që ballët e çdo gjëje t'ia shpinin at Anhelit.

Famullitari po rruhej. Kur e kur zgjaste dorën nga oborri për të njomur mjekrën me ujë shiu. Po i jepte fund, kur dy çupëza të zbathura shtynë portën pa trokitur dhe zbrazën përpara tij fruta të ndryshme, banane të sapopjekura, peksimadhe, djathë dhe një kanistër me zarzavate e vezë të freskëta

At Anheli u luajti syrin. «Na paska pjellë lopa», u tha. Më e vogla e çupëzave, duke zgurdulluar sytë, e tregoi me gisht:

— Edhe priftërinjtë u rruakan!

T'jetra e shtyu drejt derës. «Ç'kujtove ti, — buzëqeshi famullitari dhe shtoi me seriozitet: — Edhe ne njerëz jemi.» Pastaj kundroi zahiretë e hapërdara përtokë dhe e kuptoi se vetëm prej shtëpisë së Asisëve mund të vinte një shkapërderdhje e tillë.

— Thuajuni djemve, — gati thirri, — se zoti do t'ua bëjë shëndet.

At Anheli, që edhe pas dyzet vjet priftërie s'qe mësuar dot t'i përmbante emocionet që e pushtonin para akteve solemne, këqyri veglat në çastin kur kish mbaruar së rruari. Pastaj sërenditi zahiretë në raftin e poshtëm të dollapit dhe hyri në sakristi duke fshirë duart pas veladonit.

Kisha ishte plot. Në dy banko, të dhuruara prej tyre dhe po me emrat e tyre të gdhendur në pllakëza bakri, qenë ulur Asisët me nënën dhe kunatën. Kur hynë në kishë, së bashku, për herë të parë pas shumë muajsh, të krijohej përshtypja sikur qenë kaluar. Kristobal Asisi, më i madhi, që qe kthyer nga stani para gjysmë ore dhe s'kish patur kohë të rruhej, ishte me çizme kalërimi e me shpore. Tek e shihje atë egërshan bojalli, vigan, s'kish qysh mos t'u zije besë fjalëve që qarkullonin poshtë e lart se Sesar Monteroja qenkësh bir i fshehtë i plakut Adalberto Asis.

Në sakristi at Anhelin e priste një tersllëk: ornamentet liturgjike nuk qenë në vend. Xhakoni e gjeti të shastisur, duke kthyer përmbys sirtarët ndërkohë që grindej me veten.

— Thirr Trinidadin, — i dha urdhër famullitari, — dhe pyete ku e ka vënë stolën.

Kishte harruar që Trinidadi qe sëmurë qysh të shtunën. Xhakoni qe i mendimit se Trinidadi me siguri që do të kish marrë ndonjë send me vete për ta rregulluar. At Anheli veshi atëherë ornamentet e shërbesave të përmortshme. Por s'u përqendrua që s'u përqendrua dot. Tek ngjitej në lutësore, gjithë ngut e me frymën që i merrej si ngaherë, e kuptoi se arsyetimet e peshuara që kish përgatitur gjatë tërë atyre ditëve nuk kishin më atë fuqi bindëse që kishin patur në vetminë e dhomës.

Foli dhjetë minuta rresht. Duke u ngatërruar me fjalët e veta, ndërkohë që ia mësynin trurin mizëri mendimesh që s'hynin nëpër kallëpet e parapërgatitura, dalloi vejushën De Asis të qarkuar nga të bijtë. Qe si t'i shihte përsëri pas disa shekujsh në një fotografi të turbullt familjare. Vetëm Rebeka de Asisi, tek fashiste afshet e gjirit të saj të mrekullueshëm me erashkën prej *sandali*, iu duk njeri i vërtetë. At Anheli i dha fund predikimit pa e cekur konkretisht problemin e paskuinëve.

Vejusha De Asis mbeti si e ngrirë për një copë herë, hiq e vër unazën e martesës me një mllef të përbrendshëm, ndërkohë që mesha vazhdonte. Pastaj bëri kryq, u çua në këmbë dhe doli duke çarë mes për mes hijerores e ndjekur pas gjithë zhurmë e bujë prej djemve.

Një mëngjesi si ai, doktor Hiraldoja kish zbuluar mekanizmin e brendshëm të vetëvrasjes. Binte shi i hollë pa zhurmë, në shtëpinë

ngjitur ia thoshte një beng dhe e shoqja fliste në kohë e sipër që ai lante dhëmbët.

— Të dielat po na bëhen gjithë e më të rralla, — tha ajo duke shtruar tryezën për mëngjes. — Thua se i var njeri për këmbësh si mish të therur.

Mjeku përgati makinën dhe filloi të rruhej. Sytë i kishte të lagët dhe qepallat të fryra. «Po bën gjumë të keq, — i tha e shoqja. Dhe shtoi me një pikëllim të ëmbëlth: — Prit kur të hapësh sytë një të diel e të shohësh që je plakur.» Kishte veshur një bluzë me vija dhe kokën e kishte gjithë bigudi.

— E di ç'ke ti, — i tha ai. — A s'e qep më mirë.

Ajo vajti në kuzhinë, vuri xhezven e kafesë në zjarr dhe priti sa të vlonte, duke mbajtur vesh në fillim këngën e bengut, pastaj zhurmën e dushit. Atëherë vajti në dhomë që i shoqi t'i gjente rrobat gati kur të delte nga banja. Tek shpinte mëngjesin në tryezë, e pa të bërë gati për të dalë dhe iu duk diçka më i ri me ato pantallonat kaki dhe këmishën sportive.

Hëngrën në heshtje. Nga fundi ai e vështroi me dhembshuri. Ajo pinte kafenë me krye ulur, duke u dridhur paksa ngaqë qe prekur.

— E kam nga mëlçia e zezë, — shprehu keqardhjen ai.

— Sa para bën justifikimi, — ia ktheu ajo pa ngritur kryet.

— Duhet të kem ndonjë intoksikim, — tha ai. — S'i bëjnë mirë mëlçisë këto shira.

— Kështu thua gjithmonë, — tha ajo. — Po s'e çan kokën fare. Hap sytë, — shtoi pastaj, — se do të marrësh veten më qafë.

Ai u duk sikur u bind. «Në dhjetor, — tha, — do të shkojmë pesëmbëdhjetë ditë në plazh.»

Vështroi shiun nëpërmes rombeve të kangjellave prej dërrase që ndanin dhomën e bukës nga oborri i pikëlluar prej atij tetori që s'po kish të mbaruar, dhe shtoi: «Atëherë, të paktën për nja katër muaj, do të shpëtojmë prej këtyre të dielave.» Ajo mblodhi pjatat para se t'i shpinte në kuzhinë. Kur u kthye në dhomën e bukës, e gjeti të shoqin me sombreron prej kashte, duke përgatitur çantën.

— Pra vejusha De Asis paska dalë nga kisha, — tha ai.

E shoqja ia kish treguar para se të fillonte të lante dhëmbët, por ai s'i kishte kushtuar rëndësi.

— Po bëhen nja tri herë gjatë këtij viti, — pohoi ajo. — S'paska punë tjetër, siç duket.

Mjeku zbuloi sistemin e tij të rregullt dhëmbor.

— Kanë shkalluar fare këta pasunarët.

Disa gra, kur dolën nga kisha, kishin kaluar nga vejusha De Montiel për ta parë. Mjeku përshëndeti grupin që ndodhej ende në sallon. Një kukurisje e mbytur e ndoqi deri në dhomën e të sëmurës. Para se të trokiste në derë, e kuptoi se në dhomë kishte edhe gra të tjera. Dikush i tha të hynte.

Vejusha De Montiel rrinte shesh në shtrat, me leshrat të lëshuara, duke mbajtur me duar pas gjoksit buzën e çarçafit. Në prehër kishte një pasqyrë dhe një krehër briri.

— Pra edhe ju po u gatitkeni për festë, — i tha mjeku.

— Ka ditëlindjen, — tha njëra nga gratë. — Mbush pesëmbëdhjetë vjeç.

— Tetëmbëdhjetë, — e korrigjoi vejusha De Montiel me një buzëqeshje të trishtme. Ra përsëri në shtrat e u mbulua deri në fyt. — Naty-

risht, — shtoi gjithë qejf, — s'është ftuar asnjë burrë. Ndjell zi.

Mjeku la sombreron e lagur mbi komodinë. «Mirë ju ka vajtur mendja, — tha duke këqyrur të sëmurën mendueshëm, me një ndjenjë midis dashamirësisë dhe keqardhjes. — Edhe unë vetë po e shoh që jam i tepërt.» Pastaj, duke u kthyer nga gratë, u tha:

— A ka mundësi?

Kur mbeti vetëm me të, vejusha De Montiel mori sërish një pamje të pikur prej të sëmure. Por mjeku u hoq sikur s'e vuri re. Vazhdoi të fliste me të njëjtin ton gazmor, ndërsa vinte mbi komodinë sendet që nxirrte prej cantës.

— Aman, doktor, — u lut vejusha, — mos më bëni më gjilpëra. U bëra shoshë.

— Po të mos ishin gjilpërat, — buzëqeshi ai, — mjekët do të mbesnin pa bukë.

Edhe ajo buzëqeshi.

— E kam me tërë mend, — tha duke fërkuar tulet që sipër çarçafit. — I kam copë. S'i prek dot me dorë.

— Mos i prekni, — tha mjeku.

Atëherë ajo buzëqeshi çiltas.

— Flisni një herë seriozisht, doktor, pa çka se është e diel.

Mjeku i zbuloi krahun për t'i matur tensionin.

— Ma ka ndaluar mjeku, — i tha ai. — Më bën keq për mëlçinë e zezë.

Ndërkohë që i maste tensionin, vejusha hetoi fushën e aparatit me një kureshtje fëmijërore. «S'kam parë ndonjëherë sahat më të bukur se ky», tha. Doktori e pati mendien te treguesi deri kur mbaroi së shtypuri dardhën prej llastiku.

— S'e ka shokun për të treguar me saktësi orën e zgjimit, — tha.

Kur mbaroi, ndërsa pështillte tubin e aparatit të tensionit, vëzhgoi me kujdes fytyrën e të sëmurës. La mbi komodinë një shishez me kokrra të bardha dhe e porositi të pinte një në çdo dymbëdhjetë orë. «Po s'ju pëlqyen gjilpërat, — tha, — nuk ju bëj më. Ju jeni më mirë se unë me shëndet.» Vejusha bëri një lëvizje padurimi.

— Unë as që kam pasur gjë.

— E di, — ia ktheu mjeku, — po duhej shpikur diçka për të justifikuar pagesën time.

Duke i bishtnuar bisedës, vejusha pyeti:

— Të rri edhe më në shtrat?

— Përkundrazi, — i tha mjeku, — jua ndaloj rreptësisht. Zbrisni në sallon dhe prisni vizitat siç e do radha. Le që, — shtoi me dinakëri, — keni gjithato probleme për të zgjidhur.

— Aman, doktor, — thirri ajo, — mos u bëni kaq llapaqen. Më duket se ju i vini paskuinët.

Doktor Hiraldoja e mbajti kunjën. Tek dilte, i hodhi tinës një sy baules prej lëkure me çelësa bakri të bërë gati për udhëtim në një cep të dhomës së gjumit. «Dhe më sillni ndonjë gjë, — thirri që nga dera, — kur të ktheheni nga udhëtimi rreth botës.» Vejusha i qe futur punës së mudimshme të rregullimit të leshrave.

— Mos kini merak, doktor.

Nuk zbriti në sallon. Ndenji në të shtruara deri kur ikën edhe vizitoret e fundit. Atëherë u vesh. Senjor Karmicaeli e gjeti duke ngrënë para derës së ballkonit gjysmë të hapur.

Ajo iu përgjigj përshëndetjes pa i hequr sytë nga ballkoni. «Thuaj ç'të duash, — foli, — po mua më pëlqen ajo grua: trime, jo shaka.» Edhe senjor Karmicaeli vështroi nga shtëpia e vejushës De Asis, dyert dhe dritaret e së cilës nuk qenë hapur në ora njëmbëdhjetë.

— Ajo ashtu është prerë, — tha ai. — Ç'pret tjetër nga një grua që veç meshkuj di të pjellë. — Pastaj, duke u kthyer nga vejusha De Montiel, shtoi: — Po edhe ju sot paskeni lulëzuar.

Ajo sikur ia miratoi fjalët me freskinë e buzëqeshjes. «E dini si është puna?» pyeti. Dhe tek pa senjor Karmiçaelin që u step, vazhdoi pa e zgjatur:

— Doktor Hiraldos i është mbushur mendja që unë kam shkalluar.

— Si jua nxë goja atë fjalë!

Vejusha ia bëri po me kokë. «Dhe ma thotë mendja, — vazhdoi, — se ka biseduar me ju si e qysh të më shtini në çmendinë.» Senjor Karmiçaeli s'diti si të dilte prej pështjellimit që e kapi.

— Unë gjithë mëngjesit s'kam dalë nga shtëpia.

U plandos në kolltukun e butë prej lëkure të vendosur pranë shtratit. Vejushës De Montiel iu kujtua Hosé Montieli në atë kolltuk, kur i kish rënë pika pesëmbëdhjetë minuta para se të vdiste. «Atëherë, — tha duke u shkundur prej kujtimit të lig, — ndoshta ju thërret sot mbasdite.» Dhe ndërroi bisedë me një buzëqeshje të kthjellët:

— Folët me kumbarën tim don Sabas?

Senjor Karmiçaeli ia bëri po me kokë.

Ç'ishte e vërteta, të premten dhe të shtunën ia kish sjellë rrotull e rrotull don Sabasit për të nuhatur se si e kishte syrin në rast se vihej në shitje trashëgimia e Hosé Montielit. Senjor Karmiçaeli ishte i mendimit se don Sabasi qe i gatshëm për të blerë. Vejusha e dëgjoi me durim. Në mos kësaj të mërkure, të mërkurën

tjetër, tha jo me vete me një vendosmëri të qetë. Sido që të ish, e kisnte bërë mend që të ikte prej fshatit pa dalë ende tetori.

Alkaldi nxori revolverin me një lëvizje të vetëtimtë të dorës së majtë. Edhe muskuli i fundit i trupit të tij qe gati për të shtënë, kur u zgjua krejt dhe njohu gjykatës Arkadion.

— Të dhjefsha...

Gjykatës Arkadioja kishte shtangur.

— Mos ma bëj më këtë numër, — tha alkaldi duke futur revolverin. U lëshua sërish në shezlongun prej cohe. — Veshi më punon më mirë kur fle.

— Dera ishte e hapur, — tha gjykatës Arkadioja.

Alkaldi kishte harruar ta mbyllte në mëngjes. Pat qenë aq i lodhur, sa qe kumbisur në shezlong dhe e kish zënë gjumi në çast.

— Sa vajti ora?

— Po vete dymbëdhjetë,— tha gjykatës Arkadioja.

Ende i dridhej një telëz në zë.

— Jam i vdekur për gjumë, — tha alkaldi.

Duke u shtriqur me një gogësimë të gjatë, pati përshtypjen se koha qe ndalur në vend. Me gjithë masat që kishte marrë, me gjithë netët pa gjumë që kishte kaluar, paskuinët vazhdonin. Ndaj të gdhirë kish gjetur një fletushkë të ngjitur në derën e dhomës së gjumit: «Mos harxho barot për laraska, toger.» Rrugësh flitej mbarë e prapë se vetë ruajtësit vinin paskuinë për të

kaluar kohën gjatë patrullimit. Fshati, kish thënë me vete alkaldi, me siguri që po shqyhet gazit.

— Çohu lani, — i tha gjykatës Arkadioja, — dhe shkojmë të hamë ndonjë gjë.

Por ai s'kishte uri. Deshte të flinte edhe një orë e të bënte një banjë para se të dilte. Kurse gjykatës Arkadioja, i rruar e i kruar, kthehej në shtëpi për të ngrënë drekë. Ndërsa kalonte para dhomës së gjumit, siç qe dera e hapur, kishte hyrë t'i kërkonte alkaldit një lejekalim për të qarkulluar pas ndalimqarkullimit.

Togeri tha vetëm: «Jo». Pastaj, me një dredhi atësore, u justifikua:

— Ç'po të duhet të dalësh nga shtëpia!

Gjykatës Arkadioja ndezi një cigare. Soditi flakën e shkrepses, duke pritur që t'i binte inati, por nuk tha dot asgjë.

— Mos ma merr për keq, — shtoi alkaldi. — Sa do të desha unë të isha në vendin tënd, t'ia këpusja gjumit më ora tetë e të ngrihesha kur të më tekej.

— Posi, — tha gjykatësi. Dhe shtoi me qesëndi të hapët: — Edhe një baba kisha mangut në moshën trëdhjetepesëvjeçare.

I kishte kthyer shpinën dhe dukej sikur kundronte nga ballkoni qiellin e ngarkuar me shi. Alkaldi heshti një copë herë të madhe. Pastaj i tha prerë:

— Gjykatës!

Gjykatës Arkadioja u kthye nga ai dhe të dy u vështruan ndër sy.

— Nuk të jap lejekalim. More vesh?

Gjykatësi kafshoi cigaren dhe filloi të thoshte diçka, por u përmbajt. Alkaldi e dëgjoi tek zbriste ngadalë shkallët. Pas pak, duke u përkulur, thirri:

— Gjykatës!

S'mori përgjigje.

— Të mos e prishim miqësinë.

As kësaj radhe nuk mori përgjigje.

Qëndroi i përkulur, duke mbajtur vesh lëvizjet e gjyaktës Arkadios, deri kur u mbyll porta e mbeti edhe një herë fill i vetëm me kujtimet e tij. S'u përpoq më të flinte. Qe i zgjuar në mes të ditës, i ngecur si në ballak në këtë fshat që për të vazhdonte të mbetej i largët e i pashpjegueshëm, shumë vite pasi ai pat marrë mbi shpinë fatin e tij. Mëngjesit kur zbriti tinëzisht me një valixhe të vjetër prej kartoni të lidhur me rrip dhe me urdhër që ta bënte zap atë fshat me çdo kusht, i pat hyrë lemeria atij vetë. Kishte në dorë vetëm një letër për një partizan të panjohur të Qeverisë, të cilin kishte për ta takuar të nesërmen të ulur më brekë te dera e një mulliri orizi. Me udhëzimet e tij dhe me trimërinë e pashoqe të tre kriminelëve rrogëtarë që e shoqëronin, e kishte kryer detyrën. Por asaj pasditeje, ndonëse nuk e vinte re emagën që i kish endur koha rreth e qark, i mjaftoi një shkrepëtimë e beftë syçeltësie për të pyetur veten se kush qe bërë zap në të vërtetë.

Ëndërroi me sy hapur para ballkonit të rrahur nga shiu i imët, derisa ora katër erdhi e kaloi. Pastaj bëri banjë, veshi uniformën e fushimit dhe zbriti në bujtinë për të ngrënë. Më vonë bëri një insepktim në alkaldi, më tepër ngaqë i qe bërë zakon, dhe pas pak u ndodh i ndalur në një qoshe me duart në xhepa, pa ditur ç'të bënte.

Pronari i sallës së bilardos e pa tek hynte ndaj të ngrysur, ende me duart në xhepa. E ngjatjetoi që nga fundi i lokalit të zbrazët, por alkaldi s'ia ktheu.

— Një shishe ujë mineral, — tha.

Shishet kërcitën fort kur levizën në kasën e akullit.

— Një ditë prej ditësh, — tha pronari, — do t'ju çajnë e do t'jua gjejnë mëlçinë gjithë flluska.

Alkaldi vështroi gotën. Piu një gllënjkë, gromësiu, ndenji me bërrylat të mbështetur në banak dhe vështrim të ngulur te gota e gromësiu përsëri. Sheshi ishte i shkretë.

— Hë, — tha alkaldi, — ç'ka bërë vaki?

— E diel, — tha pronari.

— Aha.

Hodhi një monedhë në banak dhe doli pa ngjatjetuar. Te kthesa e sheshit, dikush që çapitej si të tërhiqte pas vetes një bisht të stërmadh, i tha diçka që ai s'e mori vesh. Pas një grime u shkund. Turbullt e kuptoi se diçka po ndodhte dhe ia mbajti nga alkaldia. Ngjiti me të kapërcyer shkallët, pa ua varur grupeve që po grumbulloheshin te porta. Një polic i doli ndesh. I dha një copë letër dhe për të mjaftoi t'i hidhte një sy që ta merrte vesh për se qe fjala.

— Po i shpërndante te rrethaku i ndeshjes së gjelave, — tha polici.

Alkaldi u turr nëpër korridor. Hapi qelinë e parë dhe qëndroi me dorë te doreza, duke shqyrtuar gjysmerrësirën derisa mundi të shihte: qe një djalosh si nja njëzet vjeç, me fytyrë të mprehtë ngjyrë limoni e të vrarë lije. Kishte një kapele beisbollisti dhe syze me xhama të errët.

— Si e ke emrin?

— Pepe.

— Pepe kush?

— Pepe Amador.

Alkaldi e vështroi për një çast dhe bëri një përpjekje për të sjellë ndër mend diçka. Djaloshi qe ulur në bllokun prej betoni që u shërbente

të arrestuarve për shtrat. Dukej i qetë. Hoqi syzet, i fshiu me cepin e këmishës dhe e vështroi alkaldin me vetulla të ngërthyera.

— Ku jemi parë bashkë? — pyeti alkaldi.

— Në ndonjë vend, — ia ktheu Pepe Amadori.

Alkaldi s'bëri hap brenda qelisë. Vazhdoi ta vështronte të arrestuarin mendueshëm, pastaj filloi të mbyllte derën.

— Kështu pra, Pepe, — tha, — tani e gjete të sat ëme.

I shkoi shulin, hodhi çelësin në xhep dhe vajti në sallë për të lexuar e rilexuar disa herë traktin.

U ul përpara ballkonit të hapur, duke vrarë mushica me shuplakë, ndërkohë që nëpër rrugët e shkreta ndizeshin dritat. E njihte këtë qetësi muzgu. Një herë e një kohë, në një ndajnatë si kjo, kishte provuar për herë të parë se ç'do të thotë të kesh pushtetin në dorë.

— Pra filluan përsëri, — foli me vete me zë të lartë.

Kishin filluar përsëri. Si më parë, qenë të shtypura me shaptilograf nga të dyja anët dhe mund t'i njihje në çdo kohë e në çdo vend nga ajo gjurma e pakuptueshme që lë gjithmonë puna në ankth e ilegalitetit.

U mendua gjatë në të errët, duke palosur e shpalosur copën e letrës, para se të merrte një vendim. Së fundi, e futi në xhep dhe preku me gishta çelësin e qelisë.

— Rovira, — thirri.

Polici i tij i besuar u faneps nga mesi i errësirës. Alkaldi i dha çelësat.

— Merru ti me këtë djalë, — i tha. — Përpiqu t'ia mbushësh mendjen të kallëzojë emrat e atyre që sjellin në fshat propagandën ilegale. Po s'ia mbushe dot me të mirë, — foli duke i

ndarë fjalët qartë, — mbushja me çfarëdolloj mënyre.

Polici i kujtoi se atë natë kishte shërbim.

— Lëre shërbimin, — i tha alkaldi. — Mos u merr me tjetër punë deri në një urdhër të dytë. Edhe një gjë, — shtoi si t'i vinte aty për aty një frymëzim: — m'i hiq sysh ata të oborrit. Sonte s'ka patrullim.

Thirri në zyrën e blinduar tre policët që me urdhër të tij rrinin në alkaldi të zhveshur e të çarmatosur. U dha uniformat që i mbante me çelës në dollap. Në kohë e sipër që ata visheshin, hoqi nga tryeza qorrfishekët që u kishte shpërndarë netve të shkuara patrulluesve dhe nxori nga kasaforta një grusht fishekësh luftarakë.

— Sonte patrullimin do ta bëni ju, — u tha duke kontrolluar pushkët për t'u dhënë ato më të mirat. — S'ka nevojë të bëni asgjë, mjaft që njerëzit t'ju shohin se keni dalë nëpër rrugë.

Pasi u veshën të gjithë, u dha municionin. Pastaj zuri vend para tyre.

— Tani dëgjoni këtu, — i paralajmëroi: — të parin që shtie, do ta shkoi në plumb aty te muri i oborrit. — Priti ndonjë kundërshtim, por kundërshtim s'pati. — Morët vesh?

Tre burrat — dy me pamje indianësh të rëndomtë dhe njëri leshverdhë, me prirje për gjigantizëm dhe sy tejdukshmërisht të kaltër — i kishin dëgjuar fjalët e fundit duke futur fishekët në karikator. Ndenjën të tre gatitu.

— Siurdhëroni, zoti toger.

— Edhe një gjë, — tha, duke u kthyer tani në një ton informues: — Asisët janë në fshat dhe s'është aspak çudi që të ndeshni sonte ndonjërin prej tyre, të dehur tapë e gati për sherr.

Sido që të jetë puna, mos u ngatërroni me të, — edhe kësaj radhe s'pati ndonjë kundërshtim, siç priste ai. — Morët vesh?

— Si urdhëroni, zoti loger.

— Pra morët, — i dha fund alkaldi. — Hapini mirë sytë e bëjini katër.

Tek mbyllte kishën pas rruzares, që e kish kaluar një orë më përpara për shkak të ndalimqarkullimit, at' Anheli ndjeu një erë kalbësire. Që një kutërbim i çastit, që s'e bëri kureshtar. Më vonë kur po fërgonte ca thela bananeje e po ngrohte qumështin për darkë, e gjeti shkakun e erës së rëndë: Trinidadi, e sëmurë qysh të shtunën, nuk i kishte hequr minjtë e ngordhur. Atëherë vajti përsëri në hijerore, hapi çarçet, i pastroi, pastaj u nis për në shtëpinë e Minës, dyqind metra larg kishës.

Ja çeli portën vetë Toto Visbali. Në mugëlirën e sallonit të vogël ku kishte disa pufe prej lëkure të hapërdara andej-këtej dhe ca fotografi të varura nëpër mure, nëna e Minës dhe gjyshja e verbër po pinin me filxhanë një pije të erandshme e të nxehtë. Mina bënte lule artificiale.

— Ka pesëmbëdhjetë vjet, — tha e verbëta, — që s'kishit shkelur në këtë shtëpi, at i shenjtë.

Që e vërtetë. Mbasdite për mbasdite ai kalonte para dritares ku Mina ulej për të bërë lule prej letre, por asnjëherë nuk kthehej të hynte.

— Kalon koha pa u vënë re, — tha famullitari. Pastaj, duke u dhënë të kuptonin se që me ngut, iu drejtua Toto Visbalit: — Erdha/t'ju

lutem ta linï Minën, duke filluar qysh nesër, të shkojë të merret me çarqet. Trinidadi, — i shpjegoi Minës, — ka që të shtunën që është sëmurë.

Toto Visbali e dha pëlqimin.

— Kot rrihni ujë në havan, — ndërhyri e verbëta. — Brenda këtij viti botës i ka ardhur fundi.

Nëna e Minës i vuri një dorë në gju si shenjë që të heshtte. E verbëta e largoi dorën.

— Zoti i dënon bestytnitë, — tha famullitari.

— Kjo është e shkruar, — tha e verbëta: — gjaku do të teptisë rrugëve edhe askush s'do të mund ta ndalë.

At Anheli i hodhi një vështrim përdëllestar: qe shumë plakë, e zbehtë si meit dhe sytë e saj të fikur dukej sikur depërtonin çdo gjë të fshehtë.

— Do të vejë gjaku deri në gju, — u tall Mina.

Atëherë at Anheli u kthye nga ajo. E pa t'i fanitej, me flokët pisë të zez dhe e zbehtë si plaka, nga mesi i një mjegulline rripthash e letrash ngjyra-ngjyra. Dukej si një portret alegorik në një mbrëmje shkollore.

— Po ti, — i tha, — të dielën zë punë me dorë.

— I kam thënë unë, — ndërhyri e verbëta. — Hi i zjarrtë ka për t'i rënë mbi krye.

— Nevoja të bën ta hash turpin me bukë, — buzëqeshi Mina.

Meqënëse famullitari po vazhdonte të rrinte më këmbë, Toto Visbali i afroi një karrige dhe e ftoi të ulej. Qe një burrë i brishtë, me tipare të kërcyera prej druajtjes.

— Falemnderit, — kundërshtoi at Anheli. — Do të më zerë ndalimqarkullimi në rrugë. — Mbajti vesh heshtjen e thellë të fshatit dhe tha: — Më duket se paska kaluar teta.

Atëherë e mori vesh: pas gati dy vjetësh me qeli të zbrazëta, kishin plasur në burg Pepe Amadorin dhe fshati kish mbetur në dorë të tre kriminelëve. Njerëzit qenë mbledhur nëpër shtëpi qysh në orën gjashtë.

— Çudi e madhe, — at Anheli u duk sikur foli vetmevete. — Ja kam lajthitur unë, ja...

— Qe e thënë që kështu do të ngjante, — tha Toto Visbali. — Në cergë të merimangës është mbledhur vendi mbarë.

I ra pas famullitarit deri te porta.

— Nuk i paskët parë traktet?

At Anheli mbeti si i shastisur.

— Prapë?

— Në gusht, — ndërhyri e verbëta, — do të nisin tri ditët e territ.

Mina shtriu krahun për t'i dhënë një lule të pambaruar. «Pusho, — i tha, — se na mërzite.» E verbëta e njohu lulen me të prekur.

— Pra, filluan prapë, — tha famullitari.

— Ka një javë, — tha Toto Visbali. — Edhe ne na ra një në dorë, pa e marrë vesh askush se kush na e futi. Ju e dini si janë këto punë.

At Anheli ia bëri po me kokë.

— Thonë se çdo gjë është njësoj si më parë, — vazhdoi Toto Visbali. — Ndërroi Qeveria, bëri premtime për paqe, dha garancira, dhe në krye të tërë e besuan. Por në pushtet mbetën po ata që qenë.

— Dhe është e vërtetë, — ndërhyri nëna e Minës. — Ja ku filluan prapë avazet. Nga një anë ndalimqarkullimi, nga ana tjetër këta tre kriminelë nëpër rrugë.

— Por ka edhe diçka të re, — tha Toto Visbali: — tani thonë se po u organizokan çeta me guerrilje kundër Qeverisë në brendësi të vendit.

— Janë të shkruara të gjitha, — tha e verbëta.

— Kjo s'ka kuptim, — tha famullitari mendueshëm. — Duhet ta pranojmë se qëndrimi ka ndryshuar. Ose të paktën, — korrigjoi veten, — kishte ndryshuar deri sonte.

Disa orë më vonë, kur u zgjua prej vapës nën kunupierë, pyeti veten nëse pat rrjedhur me të vërtetë koha gjatë dymbëdhjetë vjetëve që kish ai në këtë famulli. Dëgjoi mu përpara shtëpisë së tij zhurmën e çizmeve e të armëve, pas të cilave një herë e një kohë vinin të shtënat e pushkatimit. Vetëm se kësaj radhe çizmet u larguan, kaluan përsëri një orë më vonë e përsëri u larguan, dhe të shtëna s'pati. Pas pak, i rraskapitur nga të pagjumët dhe nga vapa, e kuptoi se kishte një copë herë që po këndonin gjelat.

Mateo Asisi u mundua të llogariste orën sipas vendit nga këndonin gjelat. Më së fundi u shkrodh dhe doli në sipërfaqe të realitetit.

— Sa është ora?

Nora de Hakobi zgjati krahun në gjysmerrësirë dhe mori nga komodina sahatin me numra fosfori. Përgjigjja që ende s'e kish dhënë e zgjoi plotësisht.

— Katër e gjysmë, — tha.

— I dhjefsha...

Mateo Asisi kërceu nga shtrati. Por dhimbja e kokës dhe shija e llurbës minerale në gojë e detyruan të mos e merrte me aq vrull. Kërkoi këpucët me këmbë në të errët.

— Do të më kish zënë dita, — tha.

— Unë ku ta gjeja, — tha ajo. Ndezi dritën e natës dhe i shqoi shpinën me nyje dhe mollaqet e zbehta. — Do të kishe ndenjur i mbyllur këtu deri nesër.

Ajo qe krejt lakuriq, vetëm seksin e kish mbuluar me një cep të çarçafit. Kur u ndez drita, edhe zëri sikur e humbi atë paturpësinë e vakët.

Mateo Asisi mbathi këpucët. Qe i gjatë e i madh. Nora de Hakobi kishte dy vjet që e qaste

në shtrat herë pas here. Shpirti ia dinte ç'hiqte ngaqë qe e detyruar ta mbante fshehurazi një burrë që asaj i dukej se pat lindur vetëm për ta patur në dorë një grua.

— Mos e lër veten pasdore, se do të vësh dhjamë, — i tha.

— Nga të mirat, — ia ktheu ai, duke u përpjekur ta fshihte bezdinë. Dhe shtoi buzagaz: — Mos kushedi jam me barrë.

— Ishalla, — tha ajo. — Po të pillnin burrat, s'do të ishin edhe aq të përçmuar.

Mateo Asisi u la, duke u kujdesur të mos merrte frymë fort: çdo erë, në mëngjes, qe erë e saj. Kur u kthye në dhomë e gjeti të ulur në shtrat.

— Një ditë prej ditësh, — tha Nora de Hakobi, — s'do t'i duroj dot më këto të fshehura edhe do t'ia tregoj gjithë botës.

Mateo Asisi nuk ia hodhi sytë sa pa u veshur krejt. Ajo e kuptoi se gjinjtë kishin filluar t'i binin tashmë dhe, pa pushuar së foluri, u mbulua deri në fyt me çarçaf.

— Mezi ç'pres, — vazhdoi, — të vijë një ditë që të hamë mëngjesin në shtrat e të rrimë këtu deri në mbrëmje. Jam gati t'i vë vetes një paskuin.

Ai qeshi çiltas.

— Të vdesë plakaruqi Benhamin, — tha, — pastaj shohim e bëjmë.

— Përfytyro, — i tha ajo, — që ai pret të vdesë njëherë Nestor Hakobi.

Ajo e pa tek ia bëri me dorë nga dera. «Përpiqu të vish natën e kërshëndellave», i tha. Ai i dha fjalën. Kaptoi oborrin në majë të gishtërinjve dhe doli në rrugë nga porta e madhe. Bin-

te një vesë e ngrirë që veç sa ia njomte lëkurën. Një thirrje i preu rrugën me të dalë në shesh:

— Ndal!

Një elektrik dore iu ndez para syve. Ai largoi fytyrën.

— Ej dreq, — shfryu alkaldi, që s'dukej prapa dritës. — Pa shihni kush na qenka. Po shkon a po vjen?

Fiku elektrikun dhe Mateo Asisi e pa, të shoqëruar me tre policë. Kishte fytyrë të freskët e të sapolarë dhe mitralozin e mbante krahaqafë.

— Po vij, — u gjegj Mateo Asisi.

Alkaldi u afrua të shihte orën në dritën e shtyllës. Deshte edhe dhjetë minuta të shkonte pesë. Me një shenjë që u bëri policëve u dha urdhër t'i jepnin fund ndalimqarkullimit. Qëndroi pezull deri sa mbaroi sinjali i daulles që i dha një notë të trishtme agut. Pastaj i la të lirë policët dhe përcolli Mateo Asisin nëpër shesh.

— Tani, — i tha, — mori fund meseleja e paçavureve.

Më tepër sesa kënaqësi, në zë i ndihej lodhje.

— E zutë kush qe?

— Ende jo, — tha alkaldi. — Por sapo bëra patrullimin e fundit dhe të siguroj që sot, për herë të parë, fshati u gdhi pa asnjë fletushkë. I duhej bërë tetë me dy, këtu qe puna.

Kur mbërritën te porta e shtëpisë, Mateo Asisi bëri përpara për të lidhur qentë. Shërbëtoret po shkrytheshin në kuzhinë. Kur alkaldi hyri, e priti një zallmahi qensh të lidhur me zinxhirë, e cila pas një çasti u shndërrua në hapa e ofshamje kafshësh paqësore. Vejusha De Asis

i gjeti duke pirë kafenë të ulur te parmakët e kuzhinës. Dita kishte zbardhur.

— Më je bërë zog nate, — tha vejusha, — qan krevati **për ty.**

Megjithëse dukej në qejf, në fytyrë i dalloheshin gjurmët e sfilitjes së një nate pa gjumë. Alkaldi iu përgjigj përshëndetjes. Mori mitralozin nga toka dhe e hodhi në sup.

— Kafe pini sa të doni, toger, — tha vejusha, — po pushkëra mos më sillni në shtëpi.

— Përkundrazi, — buzëqeshi Mateo Asisi, — të të japë edhe ty një hua për të vajtur në meshë. Apo jo?

— S'kam nevojë për këto marifete unë për të mbrojtur veten, — ia priti vejusha. — Më mbron Providenca e Shenjtë. Ne Asisët, — shtoi me seriozitet, — i jemi falur zotit qysh kur s'kishte famullitar shumë lega rreth e qark.

Alkaldi u ngrit të ikte. «Duhet të fle, — tha. — Mos e bëftë njeri këtë jetë qeni që bëj unë.» Çau mes pulave, rosave dhe misërokëve që po pushtonin shtëpinë. Vejusha i trembi. Mateo Asisi vajti në dhomën e gjumit, bëri banjë, u ndërrua dhe doli sërish për të shaluar mushkën. Të vëllezërit kishin ikur qysh pa gdhirë.

Vejusha De Asis po merrej me kafazët, kur i biri doli në oborr.

— Dhe mos harro, — i tha, — se lëkurën njeriu duhet ta ruajë, por duhet të ruajë edhe faqen.

— Hyri sa të pinte një kafe, — tha Mateo Asisi. — Po vinim duke biseduar, thuajse pa e kuptuar.

Ndodhej në fund të korridorit, duke vështruar të ëmën, por ajo s'qe kthyer kur kishte folur. Dukej sikur u fliste zogjve. «Unë një gjë po të

them, — ia priti ajo; — kriminelë s'dua të më sjellësh në shtëpi.»

Kur mbaroi me kafazët, atëherë iu përvesh të birit:

— Po ti, ku ishe?

Atë mëngjes gjykatës Arkadios iu duk se zbuloi shenja ogurliga në ndodhitë e imta që përbëjnë jetën e përditshme. «E kam nga dhembja e kokës», tha duke u përpjekur t'i shpjegonte së shoqes atë gjendje pafuqie. Qe një mëngjes me diell. Lumi, për herë të parë pas disa javësh, nuk dukej më kërcënues dhe nuk binte më erë shtaze. Gjykatës Arkadioja vajti në rrojtore.

— Drejtësia, — ia pat berberi, — mënon, por nuk harron.

Dyshemeja qe lustruar me naftë dhe pasqyrat qenë veshur me një shtresë të bardhe plumbi. Berberi filloi t'i fshinte me një leckë, ndërkohë që gjykatës Arkadioja zinte vend në karrige.

— Të mos kish fare të hëna, — tha gjykatësi.

Berberi kishte filluar ta qethte.

— Fajin e kanë të dielat, — tha. — Po të mos ishin të dielat, — sqaroi, — s'do të kishte as të hëna.

Gjykatës Arkadioja mbylli sytë. Kësaj radhe, pas dhjetë orësh gjumi, një akti të rrëmbyeshëm dashurie dhe një banje të gjatë, për asgjë s'kish pse t'i binte në qafë së dielës. E hëna qe një e hënë e ngrydhët. Kur sahati i kullës ra nëntë herë dhe të rënat e kambanës i pasoi kërkëllitja e një makine qepëse në shtë-

pinë ngjitur, një tjetër shenjë e shqetësoi gjykatësin: heshtja e rrugëve.

— Ky është fshat fantazmë.

— Deshët ju, pa e bërë, — tha berberi. — Më parë, një të hënë në mëngjes kisha bërë të paktën katër të qethura në këtë orë. Sot po e bëj sefte me ju.

Gjykatës Arkadioja çeli sytë dhe për një çast pa lumin në pasqyrë. «Ju», përsëriti. Dhe pyeti:

— E kush jemi ne?

— Ju, — tha berberi. — Para se të vinit ju, ky qe një fshat i dhjerë, si gjithë fshatrat e tjerë. Kurse tani është më zi se të tjerët.

— Ti m'i thua këto gjëra, — ia ktheu gjykatësi, — ngase e di që unë s'kam pasur fare gisht në to. Do të ta mbante, — e pyeti qetshëm, — t'ia thoshe edhe togerit?

Berberi pranoi që jo.

— Ju nuk e keni provuar, — tha ai, — se ç'do të thotë të ngrihesh çdo mëngjes me siguri në që do të të vrasin, edhe të kalojnë dhjetë vjet e mos të të kenë vrarë.

— Nuk e kam provuar, — pranoi gjykatës Arkadioja, — dhe as dua ta provoj.

— Edhe bëri çmos, — tha berberi, — që kurrë të mos e provoni.

Gjykatësi përkuli kokën. Pas një heshtjeje të gjatë pyeti: «E di si është puna, Guardiola?» Pa pritur përgjigje, vazhdoi më tej: «Togeri po hedh rrënjë në këtë fshat. Dhe hedh rrënjë çdo ditë e më thellë, sepse po ia ndien lezetin zanatit: pak e nga pak, pa zhurmë e pa bujë, po vë pasuri.» Meqenëse berberi e mbante vesh në heshtje, përfundoi:

— Unë pres kokën, po u vra qoftë edhe një njeri me urdhër të tij.

— Kaq i sigurt qenkeni?

— I sigurt që ç'ke me të, — ngulmoi gjykatës Arkadioja. — Në këto çaste atij i heq kandari vetëm nga paqja.

Berberi mbaroi së qethuri, hodhi karrigen mbrapa dhe ndërroi pecetën pa folur. Kur më në fund foli, në zë se ç'kish një turbullim.

— Çudi që e thoni ju këtë, — tha, — dhe që ma thoni mua.

— Unë këtë e kam thënë dhe e përsëris, — sqaroi.

— E pra, jeni miq për kokë, — tha berberi. Kishte ulur zërin, një zë të tendosur dhe tinzar. I përqendruar në punën e tij, kishte shprehjen e atij njeriut që hedh firmën pa e pasur zakon të shkruarit.

— A s'më thua, Guardiola, — pyeti gjykatës Arkadioja me njëfarë madhështite. — Ç'mendim ke për mua?

Berberi kishte filluar ta rruante. U mendua një grimë para se të përgjigjej.

— Gjer më tani, — tha, — ma thosh mendja se ju jeni nga ata njerëz që e dinë se rruga është e hapur dhe mezi ç'presin sa të çajnë ferrën.

— Dhe mos e ndrysho këtë mendim.

Ia kish lënë fytyrën në dorë për t'ia rruar me të njëjtën plogështi siç do t'ia kish lënë për t'i prerë kokën. I mbajti sytë të mbyllur, ndërsa berberi i fërkonte mjekrën me shap, e pudroste e i fshinte pudrën me një furçe me qime derri shumë të buta. Kur i hoqi pecetën nga gryka, i futi një copë letër në xhepin e këmishës.

— Vetëm një gjë e ke gabim, gjykatës, — i tha: — do të kemi avaze në këtë fshat.

Gjykatës Arkadioja u sigurua nëse qenë ende vetëm në rrojtore. Dielli i nxehtë, kërkëllitja e makinës qepëse në heshtjen e orës nëntë e gjys-

më dhe e hëna e pashmangshme i krijonin edhe një përshtypje tjetër: dukej sikur qenë vetëm në fshat. Atëherë nxori letrën nga xhepi dhe e lexoi. Berberi i ktheu shpinën për të rregulluar veglat në tryezën e tualetit. «Dy vjet fjalime, — lexoi me mend. — Dhe përsëri po ajo gjendje rrethimi, po ajo censurë e shtypit, po ata funksionarë.» Kur pa në pasqyrë se gjykatës Arkadioja kishte mbaruar së lexuari, berberi i tha:

— Shpërndajeni.

Gjykatësi e futi përsëri letrën në xhep.

— Trim je, — i tha.

— Sikur të kisha gabuar njëherë me ndokënd, — tha berberi, — do ta kisha ngrënë plumbin prej vitesh. — Pastaj shtoi me zë serioz: — Dhe mos harroni një gjë, gjykatës: këtë që ka filluar të lëvizë nuk e ndal dot askush.

Tek dilte nga rrojtorja, gjykatës Arkadioja e ndiente qiellzën të përtharë. Porositi dy dopio në sallën e bilardos dhe, para se t'i kthente njërën pas tjetrës, e kuptoi se desh akoma edhe shumë kohë derisa t'i vinte sosja. Në Universitet, një të Shtune të Shenjtë, qe orvatur t'i jepte fund asaj gjendjeje pasigurie me një ilaç gomerësh: ishte futur në shurrëtoren e një pijetoreje, i dehur tapë, kish hedhur barot në ulcerë dhe i kish vënë zjarrin.

Pas gotës së katërt, don Rokeja filloi të mos ia mbushte më plot. «Kështu si vajti puna, — buzëqeshi, — do t'ju nxjerrin mbi supe si torerot.» Edhe gjykatësi vuri buzën në gaz, por sytë i mbetën të fikur. Pas gjysmë ore vajti në shurrëtore, derdhi ujët dhe, para se të dilte, e hodhi traktin në qenef.

Kur u kthye në banak gjeti pranë gotës edhe shishen, me një vijëz në etiketë që shënonte nivelin. «Ju e kini të gjithë», i tha don Rokeja,

duke bërë fresk ngadalë. Gjykatës Arkadioja mbushi një gjysmë gote dhe zuri ta pinte më nge. «E di si është puna?» pyeti. Dhe meqë don Rokeja s'dha ndonjë shenjë se e kish dëgjuar, i tha:

— Do të kemi avaze.

Don Sabasi po peshonte në kandar drekën e tij prej trumcaku, kur e njoftuan se kishte ardhur përsëri senjor Karmiçaeli. «Thuaji që jam duke fjetur», i pëshpëriti në vesh së shoqes. Dhe, përnjëmend, pas dhjetë minutash e kishte zënë gjumi. Kur u zgjua, ajri qe terur dhe shtëpia qe si e paralizuar prej vapës. Kishte kaluar dymbëdhjeta.

— Ç'ëndërr pe? — e pyeti e shoqja.

— Asnjë ëndërr.

Kishte pritur që i shoqi të zgjohej vetë. Pas një grime, zjeu shiringën dhe don Sabasi bëri një injeksion me insulinë në kofshë.

— Ke tre vjet që s'sheh asnjë ëndërr, — i tha gruaja me një zhgënjim të vonët.

— Dreq o punë, — thirri ai. — Çfarë do, që ta marim vesh. Ëndrra me zor nuk mund të shoh.

Vite më parë, gjatë gjumit të shkurtër të pasdrekës, don Sabasi kish parë në ëndërr një dushk që në vend të gjetheve bënte brisqe rroje. E shoqja e kish shpjeguar ëndrrën dhe kish fituar një biletë lotarie.

— Në mos sot, nesër, — tha ajo.

— As sot as mot, — ia ktheu durimhumbur

don Sabasi. — S'do të shoh ëndrra une që të me çash kokën ti.

Ra përsëri në shtrat, në kohë e sipër që e shoqja mataronte dhomën. Lloj-lloj veglash, për të prerë e për të shpuar, qenë nxjerrë nga dhoma. Pas gjysmë ore, don Sabasi u ngrit mengadalë, duke u përpjekur të mos bënte shumë lëvizje, dhe filloi të vishej.

— Pa hë, — pyeti atëherë: — ç'tha Karmiçaeli?

— Tha se do të vijë prapë më vonë.

Nuk folën më deri sa u ulën në tryezë. Don Sabasi ngjëronte nga pak djetën e tij të thjeshtë prej të sëmuri. E shoqja u dend mirë, në pamje të parë ca si tepër për trupin e saj të hajthëm dhe çehren si prej të sëmure.

— Ç'kërkon senjor Karmiçaeli?

— Ç'të kërkojë tjetër? Para.

— E mora me mend, — ofshau e shoqja. Dhe vazhdoi gjithë dhembshuri: — I gjori Karmiçael, sa para kalon nëpër duar për vite e vite dhe për vete rron me mëshirën e botës.

Në kohën që fliste, po i ikte qejfi i drekës.

— Jepi, Sabas, — iu lut. — Zoti do të ta shpërblejë. — Kryqëzoi mbi pjatë lugë e pirun dhe pyeti kureshtare: — Sa i lipsen?

— Dyqind pesos, — ia ktheu don Sabasi qetë-qetë.

— Dyqind pesos!

— Hënde, folë!

Në ndryshim nga e diela, kur kishte punë më shumë se kurrë, të hënave don Sabasi e kalonte mbasditen rehat-rehat. Mund të rrinte sa të donte në zyrë, duke dremitur përpara ventilatorit, ndërkohë që gjëja e gjallë i rritej, i majmej e i shtohej nëpër tufa. Megjithëkëtë, asaj mbasditeje nuk u preh dot një çast.

— Nga vapa e ke, — i tha e shoqja.

Don Sabasi pa t'i ndizej e t'i fikej një shkëndijëzë dëshpërimi në bebëzat e pangjyra. Në zyrën e ngushtë, me një tryezë të vjetër druri, katër kolltukë lëkure dhe takëme kuajsh të vëna cip mbi cip nëpër qoshe, perdet qenë të mbyllura dhe ajri që i vakët e i trashë.

— Mbase, — tha. — Kurrë s'ka bërë kaq vapë në tetor.

— Këtu e pesëmbëdhjetë vjet, me një vapë si kjo, ra tërmet, — tha e shoqja. — Të kujtohet?

— Nuk më kujtohet, — tha don Sabasi pa e pasur mendjen aty. — Le që, — shtoi pa qejf, — sot s'dua të flas për fatkeqësira.

Duke mbyllur sytë, me krahët e kryqëzuar sipër barkut, bëri sikur e kish zënë gjumi. «Po të vijë Karmiçaeli, — mërmëriti, — thuaji që s'jam këtu.» Fytyra e së shoqes mori një shprehje përgjërimi.

— Sa i lig që je, — i tha.

Por ai nuk e zgjati bisedën. Ajo doli nga zyra, pa bërë as zhurmën më të vogël tek mbyllte derën me tel. Aty ndaj të ngrysur, pasi kish fjetur përnjëmend, don Sabasi hapi sytë dhe pa përpara tij, si një vazhdim të ëndrrës që po shihte, alkaldin të ulur, duke e pritur të zgjohej.

— Një njeri si puna juaj, — buzëqeshi togeri, — s'duhet të flerë me derë hapur.

Don Sabasi s'dha asnjë shenjë hutimi. «Për ju, — tha, — dyert e shtëpisë sime janë gjithmonë të hapura.» Zgjati krahun për t'i rënë zileS, por alkaldi e ndali me një gjest.

— S'doni një kafe?

— Tani jo, — tha alkaldi duke i hedhur një vështrim të përmallshëm krejt dhomës. — Isha

mjaft mirë këtu, kur ju flinit. Më dukej vetja sikur isha në një fshat tjetër.

Don Sabasi fërkoi kapakët e syve me trinën e dorës.

— Sa është ora?

Alkaldi pa orën. «Pesë po shkon», tha. Pastaj, duke ndërruar vend në kolltuk, e hapi bisedën me ëmbëlsi:

— A bisedojmë pakëz?

— Unë tani, — tha don Sabasi, — vetëm për biseda kam fuqi.

— S'ka gjë, — tha alkaldi. — Le që këtë tani kush nuk e di.

Dhe me po atë rrjedhshmëri të qetë, pa e tepruar kurrnjëherë, as në gjeste as në fjalë, shtoi:

— A s'më thoni, don Sabas, sa krerë dhen nga të vejushës De Montiel keni nxjerrë dhe u kini vënë damkën tuaj qysh kur ajo ju propozoi për shitje?

Don Sabasi mblodhi supet.

— As që e kam idenë.

— Ju e dini, — tha alkaldi, — se kjo punë ka një emër.

— Abigjeat, — shqiptoi qartas don Sabasi.

— Domethënë vjedhje e gjësë së gjallë, — ia përforcoi alkaldi. — Ja ta zëmë, për shembull, — vazhdoi pa ndryshuar qëndrim, — se keni bërë dyqind krerë për tri ditë.

— S'është çudi, — tha don Sabasi.

— Pra dyqind, — tha alkaldi. — Ju i dini kushtet: pesëdhjetë pesos taksë bashkiake për çdo kokë.

— Dyzet.

— Pesëdhjetë.

Don Sabasi heshti për të treguar se qe dorëzuar. Ishte kumbisur në poltronën me susta dhe vërtiste në gisht unazën me një gur të zi e të

kulluar, me sytë të ngulur në një lojë shahu të përfytyruar.

Alkaldi e vëzhgonte me një vëmendje ku s'dukej pikë mëshire. «Sidoqoftë, kësaj here punët s'marrin fund me kaq, — vazhdoi. — Qysh prej këtij momenti, në çdo vend që të ndodhet, krejt trashëgimia e Hosé Montielit është nën mbrojtjen e Bashkisë.» Si priti më kot ndonjë përgjigje, shtoi:

— Ajo grua e gjorë, siç e dini, është çmendur fare.

— Po Karmiçaeli?

— Karmiçaeli, — tha Alkaldi, — ka dy orë që është nën mbikëqyrje.

Don Sabasi ia nguli atëherë sytë me një shprehje që mund të merrej edhe si mahnitje, edhe si topitje. Pa asnjë paralajmërim, lëshoi mbi tryezë trupin e tij avdall, që shkundej i tëri prej një të qeshure të brendshme të papërmbajtur.

— Ç'më kënaqët, toger, — tha. — Më duket vetja si në ëndërr.

Atë mbasdite doktor Hiraldoja pati një ndjenjë sigurie sikur pati bërë shumë përpara në të shkuarën. Bajamet e sheshit qenë pluhurosur rishmës. Një dimër i ri po kalonte, por me hapin e tij tinzar ai linte një vragë të thellë në kujtesën e njerëzve.

At Anheli po kthehej nga shëtitja e tij e ndajnatës, kur hasi mjekun tek përpiqej të fuste çelësin në bravën e konsultores.

— E shihni, doktor, — buzëqeshi. — Edhe për të çelur një derë lipset ndihma e zotit.

— Ose elektriku i dorës, — ia ktheu mjeku po me të buzëqeshur.

Vërtiti çelësin në bravë dhe pastaj u mor kryekëput me at Anhelin. E pa e iu duk i ngrydhët e i manushaqtë në dritën e dobët të muzgut. «Pa prisni një minutë, at i shenjtë, — i tha. — Më duket se s'jeni mirë nga mëlçia.» E mbajti për krahu.

— Ashtu thoni?

Mjeku ndezi dritën e hyrjes dhe e këqyri fytyrën e famullitarit me një kujdes më fort njerëzor sesa profesional. Pastaj hapi derën me tel dhe ndezi dritën e konsultores.

— S'do të bënit keq t'i kushtonit pesë minuta edhe trupit tuaj, at i shenjtë, — i tha. — Pa t'jua shohim një herë tensionin.

At Anheli qe me ngut. Por, i detyruar nga ngulmimi i mjekut, hyri në konsultore dhe përgatiti krahun për matjen e tensionit.

— Në kohët e mia, — tha, — s'kish gjëra të tilla.

Doktor Hiraldoja vuri një karrige përballë tij dhe u ul t'i vinte aparatin.

— Kohët tuaja janë këto kohë që po jetojmë, at i shenjtë, — buzëqeshi. — Trupi s'ka ndonjë kohë veçan të tjerëve.

Ndërsa mjeku e kishte mendjen te fusha e aparatit, famullitari kundroi dhomën me atë kureshtjen budallore që të ngjallin rëndom sallat e pritjes. Në mure qenë varur një diplomë e zverdhur, litografitë e një bebëze të kuqe all dhe të një faqeje të kaltër të brerë nga krimbat, si dhe fotografia e mjekut duke luftuar për të shpëtuar nga vdekja një grua të lakuriquar. Në fund, prapa shtratit prej hekuri të lyer me të bardhë, kishte një dollap me shisheza pa etiketa. Pranë dritares një raft xhamash me instrumente

dhe dy të tjera të mbushura citë me libra. E vetmja erë që dallohej ç'qe, ishte ajo e alkoolit të papijshëm.

Nga fytyra e doktor Hiraldos, kur mbaroi së maturi tensionin, nuk merrej vesh asgjë.

— Kjo dhomë ka nevojë për një shenjt që ta mbrojë, — mërmëriti at Anheli.

Mjeku u hodhi një sy mureve. «Jo vetëm kjo dhomë, — tha, — por edhe fshati.» Futi aparatin e tensionit në një këllëf lëkure që e mbylli me një tërheqje të vrullshme të zinxhirit dhe tha:

— E dini si është puna, at i shenjtë: tensionin e keni shumë mirë.

— E merrja me mend, — tha famullitari. Dhe shtoi me një ngurrim të pafuqishëm: — Kurrë s'e kam pasë ndier veten më mirë se në tetor.

Filloi të shpërvishte mëngën ngadalë. Me veladonin me kinde të arnuara, këpucët e ngrëna dhe duart e ashpra me thonj si prej briri të përzhitur, dukej në atë çast tamam ai që ishte në të vërtetë: një njeri tej mase i varfër.

— Megjithatë, — ia ktheu mjeku, — më futët në merak: duhet pranuar se regjimi juaj i të jetuarit nuk është edhe aq i përshtatshëm për një tetor si ky.

— Zoti ynë Jezukrisht ka kërkesa të rrepta, — tha famullitari.

Mjeku i ktheu shpinën për të vështruar nga dritarja lumin e errët. «Ngaherë kam thënë me vete, — foli, — se ç'kuptim ka ky të përpjekur vite e vite me radhë për të mveshur me një korracë instinktet njerëzore, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se përposh gjithçka vazhdon po njëlloj».

Pastaj, pas një heshtjeje të gjatë, pyeti:

— A nuk keni pasur përshtypjen, këto ditët e fundit, se puna juaj e paepur po bëhet pluhur e hi?

— Natë për natë, gjatë gjithë jetës sime, e kam pasur këtë përshtypje, — tha at Anheli. — Kjo më bën që të nesërmen t'i vihem punës edhe më me vrull.

Qe ngritur në këmbë. «Po vete gjashtë», tha duke u bërë gati të dilte. Pa lëvizur nga dritarja, mjeku u duk sikur zgjati një krah për ta ndalur e për t'i thënë:

— At i shenjtë: një nga këto net vini dorën në zemër e pyesni veten se mos po përpiqeni t'i vini pulla leukoplasti moralit.

At Anheli nuk e fshehu dot një gulç të tmerrshëm që mend e la pa frymë. «Natën e varrit, — tha, — do ta kuptoni se sa të rënda janë këto fjalë, doktor.» Tha natënemirë dhe mbylli mengadalë derën kur doli.

Gjatë lutjes nuk e mblodhi dot veten. Kur po mbyllte kishën, Mina erdhi t'i thoshte se vetëm një mi pat rënë gjatë dy ditëve. Ai kishte përshtypjen se gjatë mungesës së Trinidadit minjtë qenë shtuar e shumuar sa rrezik të gërryenin hijeroren. Sidoqoftë, Mina i kishte ngritur çarqet, kish vënë helm në djathët, u kish rënë pas gjurmëve dhe ua kish zënë me peshkve foletë e reja që ai vetë e ndihmonte për t'i zbuluar.

— Ki pak besim në punën tënde, — i kishte thënë ai, — dhe minjtë do të të vijnë nëpër çarqe si manarë.

Para se ta zinte gjumi, u vërtit në shtrojet e rrjepura sa në njërën anë në tjetrën. Në atë cingrisje nervash nga të pagjumët e kuptoi fare qartë ndjesinë e errët të dështimit që i pat derdhur në zemër mjeku. Ky shqetësim, pastaj reshperimi i minjve nëpër kishë dhe paraliza

e llahtarshme e ndalimqarkullimit, të gjitha sikur u morën vesh së toku që, me një forcë të verbër, ta shpinin zvarrë-zvarrë deri në shtjellën e atij kujtimi që ai e kish më tepër frikë.

Në kohën kur sapo kish ardhur në fshat, e zgjuan një mesnatë që t'i jepte ndihmën e fundit Nora de Hakobit. Dëgjoi një rrëfim dramatik, të bërë në mënyrë të qetë, të prerë dhe të hollësishme, në një shtrat të gatitur për të pritur vdekjen: mungonin vetëm kryqi mbi kokë dhe karriget përanash mureve. Lehona që po hiqte shpirt i tregoi se i shoqi nuk qe ati i fëmijës që porsa kish lerë. At Anheli pat pranuar t'i jepte faljen, me kusht që rrëfimi të përsëritej dhe akti i pendesës të kryhej në prani të bashkëshortit.

Duke iu bindur komandave ritmike të sipërmarrësit, trupa shkuli hunjtë dhe çadra e madhe ra si pllakosje mynxyre, me bujë e vizhgëllimë si ajo e erës mes pemëve. Në mëngjes ajo qe palosur dhe gratë e fëmijët hanin bukë sipër bauleve, ndërkohë që burrat ngjisnin kafshët në motobarka. Kur motobarkat fërshëllyen herën e parë, gjurmët e zjarreve në yrtin e shkretë qenë e vetmja shenjë që tregonte se një kafshë parahistorike pat kaluar nëpër fshat.

Alkaldi s'kishte fjetur. Si këqyri nga ballkoni hipjen e cirkut nëpër motobarka, u përzie me rrëmujën e portit, ende me uniformën e fushimit, me sytë të acaruar nga të pagjumët dhe me fytyrën të ashpërsuar nga mjekra dyditore. Sipërmarrësi e diktoi nga çatia e motobarkës.

— Ngjatjeta, toger, — i gërthiti. — Jua lashë mbretërinë.

Qe futur i tëri në një gozhup të gjerë e të ngrënë, që i jepte fytyrës së tij të rrumbullt një pamje priftërore. Fshikullin e kishte mbështjellë rreth grushtit.

Alkaldi iu afrua bregut. «Më vjen keq, gjeneral, — ia ktheu edhe ai me humor, duke hapur krahët. — Besoj se do të keni nderin të na thoni

përse po ikni.» U kthye nga kallaballëku dhe shpjegoi me zë të lartë:

— Ia preva lejen, mbasi nuk deshte të jepte një shfaqje falas për kalamajtë.

Sirena e fundit e motobarkës dhe zhaurima e motorëve e mbytën përgjigjen e sipërmarrësit. Nga ujët shpërtheu një dihatje prej balte të lëvizur vendit. Sipërmarrësi priti sa motobarkat të merrnin kthesën te mesi i lumit. Atëherë u mbështet pas parmakut dhe, duke i bërë duart hinkë, gërthiti me sa i hanin mushkëritë:

— Lamtumirë, polic-bir-kurve.

Alkaldi s'e prishi terezinë. Priti me duar në xhepa derisa u tret zhaurima e motorëve. Pastaj çau rrugën mes kallaballëkut, buzagaz, dhe hyri në dyqanin e sirianit Moises.

Ora qe pothuaj tetë. Siriani kish filluar të fuste mallin e nxjerrë te dera.

— Domethënë, edhe ju po ikni, — tha alkaldi.

— Për pak kohë, — tha siriani duke vështruar qiellin. — Do të zërë shi.

— Të mërkurave nuk bie shi, — tha alkaldi.

Ndenji me bërryla në banak duke vështruar retë e trasha e të dendura, që pluskonin mbi port, deri kur siriani mbaroi së futuri mallin dhe i dha urdhër gruas t'u sillte kafe.

— Si vajti kjo punë, — ofshau ai vetmevete, — do duhet t'u lypim njerëz hua fshatrave të tjerë.

Alkaldi rrufiste kafenë me gërrqe të ngadalta. Edhe tri familje të tjera kishin ikur prej fshatit. Me to, sipas llogarive të sirianit Moises, bëheshin pesë familjet që kishin ikur brenda një jave.

— Do të kthehen, në mos sot nesër, — tha alkaldi. Vëzhgoi njollëzat e mistershme që pat

lënë kafeja në fund të filxhanit dhe tha me një pamje krejt të përhumbur:

— Ngado që të venë, këtu do të vijnë përsëri, ku u ka rënur koka.

Me gjithë fjalët që pat thënë, iu desh të priste në dyqan sa të kalonte një rrebesh i furishëm që vetëm për disa minuta e bëri fshatin det. Pastaj vajti në alkaldi dhe gjeti senjor Karmiçaelin, gjithmonë të ulur në një banko në mes të oborrit, të bërë qull nga rrebeshi.

S'u mor me të. Si dëgjoi raportimet e policit rojë, hapi qelinë ku Pepe Amadori dukej sikur kish rënë në gjumë të thellë i shakullepsur përmbys në dyshemenë me pllоça. E ktheu me këmbë dhe për një çast hetoi me një mëshirë të fshehtë fytyrën e shpërfytyruar nga të goditurat.

— Sa ka që nuk ha?

— Qysh mbrëmë.

Dha urdhër ta ngrinin. Duke e mbërthyer nga sqetullat, tre policë e zvarritën trupin nëpër qeli dhe e ulën në bllokun prej betoni të ngritur gjysmë metri mbi dyshemenë. Në vendin ku kish qenë trupi mbeti një njollë e lagët dhe e errët.

Në kohën që dy policët e mbanin ndenjurazi, i treti i ngriti kokën lart duke e mbërthyer prej flokësh. Po të mos qe frymëmarrja e çrregullt dhe shprehja e dërrmimit të plotë ndër buzë, mund të thoshe fare mirë se kish vdekur.

Kur policët e lëshuan, Pepe Amadori hapi sytë dhe u ngërthye me tahmin pas anëve të bllokut të betonit. Pastaj ra përmbys sipër bllokut me një ankim të ngjirur.

Alkaldi doli nga qelia dhe dha urdhër t'i jepnin për të ngrënë e ta linin të flinte një copë

herë. «Pastaj, — tha, — zbrujeni mirë e mirë derisa t'i nxjerrë të gjitha. S'ma ha mendja të rezistojë shumë.» Nga ballkoni pa edhe një herë senjor Karmiçaelin në oborr, me fytyrën ndër duar, të kruspullosur në banko.

— Rovira, — thirri. — Shko në shtëpinë e Karmiçaelit dhe thuaji së shoqes t'i dërgojë rroba. Pastaj, — shtoi prerë, — sillma në zyrë.

Kish filluar ta zinte gjumi të mbështetur pas tryezës, kur i trokitën te dera. Ishte senjor Karmiçaeli, i veshur në të bardha dhe krejt i tharë, me përjashtim të këpucëve që i qenë mbufatur dhe squllur si këpucë të mbyturi. Para se të merrej me të, alkaldi i dha urdhër policit që të shkonte prapë për një palë këpucë.

Senjor Karmiçaeli ngriti një krah nga polici. «Më lër kështu», i tha. Pastaj, duke iu drejtuar alkaldit me një vështrim gjithë dinjitet të rreptë, shpjegoi:

— Nuk kam të tjera.

Alkaldi i tha të ulej. Para njëzetekatër orësh senjor Karmiçaelin e kishin sjellë në zyrën e blinduar dhe e kishin vënë nën një hetim të fortë mbi gjendjen e pasurisë së Montielit. Më në fund, kur alkaldi pat bërë propozimin e vet për ta blerë trashëgiminë me çmimin që do të caktonin specialistët e Bashkisë, senjor Karmiçaeli kish shprehur një vendosmëri të paepur për të mos e lejuar këtë blerje sa kohë që nuk qe bërë kalimi i trashëgimisë.

Asaj ndajnate, pas dy ditësh urie e moti të lig, përgjigjja e tij qe po aq e paepur.

— Qenke një kokëmushkë ti, Karmiçael, — i tha alkaldi. — Po prite sa të bëhet kalimi, ai don Sabas hajduti ka për t'i vënë gjithë bagëtisë së Montielit damkën e vet.

Senjor Karmiçaeli mblodhi supat.

— Mirë pra, — i tha alkaldi pas një heshtjeje të gjatë. — E dimë që je burrë i ndershëm. Por mos harro një gjë: para pesë vjetësh don Sabasi i dha Hosé Montielit listën e plotë të njerëzve që mbanin lidhje me çetat guerilje, ndaj dhe qe i vetmi kre i opozitës që mundi të mbetej në fshat.

— Mbeti edhe një tjetër, — tha senjor Karmiçaeli me një fije sarkazme: — dentisti.

Alkaldi bëri sikur s'e dëgjoi ndërprerjen.

— Thuaj tani, a ia vlen barra qiranë që për një kësisoj burri, i cili i shet për hiçgjë njerëzit e vet, të rrish njëzetekatër orë jashtë, në diell e në shi?

Senjor Karmiçaeli uli kryet dhe filloi të shikonte thonjtë. Alkaldi u ul mbi tryezë.

— Veç kësaj, — tha më së fundi me një ton të butë, — mendo pak për fëmijët.

Senjor Karmiçaeli nuk e dinte se e shoqja dhe dy djemtë e mëdhenj kishin ardhur tek alkaldi të mbrëmëshmen dhe ai u pat premtuar se pa u mbushur 24 orë do ta lironte.

— Mos u bëni merak, — tha senjor Karmiçaeli. — Ata dinë ta mbrojnë veten.

E ngriti kokën vetëm kur ndjeu alkaldin të çapitej nga një cep i zyrës në tjetrin. Atëherë lëshoi një psherëtimë dhe tha: «Keni edhe një mjet tjetër, toger.» Para se të vazhdonte, e këqyri me një butësi të dhembysur.

— Më futni një plumb.

Nuk mori përgjigje. Pas një grime alkaldin e pat zënë gjumi top në dhomën e tij, kurse senjor Karmiçaeli qe kthyer sërish në banko.

Vetëm dyqind metra larg alkaldisë, sekretari i gjykatës po fluturonte nga lumturia. E pat kaluar mëngjesin duke dremitur në fund të zyrës

dhe krejt pa dashur kishte parë gjinjtë e mrekullueshëm të Rebeka de Asisit. Pat qenë si një rrufe në mot të kthjellët: qe çelur papritmas dera e banjës dhe ajo grua magjepsëse, vetëm me një peshqir të mbështjellë rreth kokës, kish lëshuar një klithmë të nemitur dhe kish mbyllur shpejt driften.

Për gjysmë ore rresht sekretari kish vazhduar të ndiente në të mugëtit e zyrës hidhësirën e atij vegimi. Aty nga dymbëdhjeta, i hodhi dryni portës dhe shkoi t'i jepte diç për të ngrënë kujtimit.

Tek kalonte para telegrafës, përgjegjësi i postës i bëri një shenjë. «Do të na vijë një famullitar i ri, — i tha. — Vejusha De Asis i ka bërë një letër Prefektit Apostolik.» Sekretari e sikterisi.

— Burri që është burrë, — tha, — di ta ruajë sekretin.

Te qoshja e sheshit u ndesh me senjor Benhaminin që po mendohej si e qysh t'i kaptonte llogaçet para dyqanit. «Sikur ta dinit, senjor Benhamin», filloi sekretari.

— Çfarë? — pyeti senjor Benhamini.

— Asgjë, — tha sekretari. — Varrit kam për t'ia treguar.

Senjor Benhamini mblodhi supet. Pa sekretarin të kërcente sipër llogaçeve me një shkathtësi prej djaloshi të ri dhe u sul edhe ai vetë pas tij.

Në mungesë të tij dikush kish vënë në kthinën e pasme të dyqanit një sofratas me tri tasa, pjata, lugë e pirun dhe një cilore të palosur. Senjor Benhamini shtroi ciloren në tryezë dhe gatiti gjërat për të ngrënë. Gjithçka e bëri me një kujdes të madh. Të parë hëngri supën, një supë të

verdhë me rrofullame të mëdha dhjami përsipër dhe një kockë të shpulpuar. Të dytë hëngri pilaf, mish turli dhe një copë *manioke* të skuqur. Kur mbaroi së ngrëni, si i mblodhi pjatat pirg dhe vuri sërish në vend tasat e sofratasit, piu një gotë ujë.

Po matej të lidhte hamakun, kur dëgjoi se dikush po hynte në dyqan.

Një zë i përgjumur pyeti:

— Është senjor Benhamini?

Zgjati kokën dhe pa një grua të veshur në të zeza, me flokët lidhur me një peshqir dhe me lëkurën ngjyrë hiri. Ishte e ëma e Pepe Amadorit.

— Nuk jam, — tha senjor Benhamini.

— Ju jeni, — tha gruaja.

— E di që unë jam, — tha ai, — po zëreni se s'jam, mbasi e di përse më kërkoni.

Gruaja u luhat para deriçkës së kthinës së pasme, ndërkohë që senjor Benhamini vari hamakun. Gjithsaherë merrte frymë, i dilte nga mushkëritë një vizhgëllimë e hollë.

— Mos rrini aty, — tha senjor Benhamini ashpër. — O ikni, o futuni brenda.

Gruaja zuri vend pranë tryezës dhe filloi të dëneste në heshtje.

— Më falni, — tha ai. — Duhet ta kuptoni se më komprometoni duke ndenjur aty faqe gjithë botës.

Nëna e Pepe Amadorit zgjidhi kokën dhe fshiu lotët me peshqir. Ngaqë i qe bërë zakon, pasi kish varur hamakun, senjor Benhamini provoi qëndrueshmërinë e litarëve. Pastaj u mor me gruan.

— Me një fjalë, — tha, — ju doni t'ju shkruaj një lutje.

Gruaja ia bëri po me kokë.

— Pra, — vazhdoi senjor Benhamini, — besoni ende te lutjet. Kështu si kanë ardhur punët, — shpjegoi duke ulur zërin, — e drejta nuk fitohet me lutje, po me pushkë.

— Kështu thonë të gjithë, — ia ktheu ajo, — po ja që vetëm unë e kam djalin në burg.

Ndërsa fliste, zgjidhi nyjet e shamisë që e kish mbajtur shtrënguar në ngrusht dhe nxori disa kartëmonedha të djersitura: tetë pesos. Ia zgjati senjor Benhaminit.

— Vetëm këto kam, — tha.

Senjor Benhamini u hodhi një sy parave. Ngriti supet, mori kartëmonedhat dhe i vuri mbi tryezë. «E di që është e kotë, — tha. — Por do ta bëj vetëm për t'i treguar zotit se ç'kokë kam.» Gruaja e falënderoi në heshtje dhe u shkreh në vaj përsëri.

— Sidoqoftë, — e këshilloi senjor Benhamini, — përpiqu që alkaldi të të lërë ta takosh djalin edhe mbushja mendjen t'i kallëzojë ato çka di. Përndryshe, piju lëngun lutjeve.

Ajo fshiu hundët me peshqir, lidhi përsëri kokën dhe doli nga dyqani pa e kthyer fytyrën.

Senjor Benhamini bëri gjumin e drekës deri në ora katër. Kur doli në oborr për t'u larë, moti qe çelur dhe ajri qe gjithë milingona fluturake. Pasi u ndërrua dhe krehu ato pak qime që i kishin mbetur, vajti në telegrafë për të blerë një fije letre me vulë.

Po kthehej në dyqan për të shkruar lutjen, kur e kuptoi se diçka po ndodhte në fshat. I zuri veshi britma nga larg. Një tufë djemsh i kaluan pranë me vrap, i pyeti se ç'po ndodhte dhe ata iu përgjigjën pa u ndalur. Atëherë u kthye në telegrafë dhe e la fijen e letrës me vulë.

— S'hyn më në punë, — tha. — Pepe Amadorin e paskan vrarë.

Ende gjysmë përgjumësh, duke mbajtur me njërën dorë gjerdanin e me tjetrën duke kopsitur xhaketën ushtarake, alkaldi zbriti me dy të kërcyera shkallët e dhomës së gjumit. Ngjyra e dritës ia ngatërroi kuptimin e kohës. Para se të merrte vesh si qe puna, e kuptoi se duhej të shkonte në alkaldi.

Dritaret mbylleshin kur kalonte ai. Një grua po afrohej turravrap me krahët hapur, nga mesi i rrugës në drejtim të kundërt. Ajri i pastër qe mbushur me milingona fluturake. Pa e marrë vesh ende se ç'po ngjiste, alkaldi nxori revolverin dhe ia dha vrapit.

Një tufë grash po përpiqeshin të shkallmonin derën e alkaldisë. Disa burra po përlesheshin me to për t'i ndaluar. Alkaldi i largoi me të goditura, i vuri shpatullat portës dhe u drejtoi revolverin të gjithëve.

— Kush bën një hap, e hëngri.

Një polic që po e mbante nga brenda, ia hapi atëherë portën, me pushkën ngrehur, dhe kërciti shulin. Dy policë të tjerë çatisën te ballkoni, shkrehën disa pushkë në ajër dhe turma u shpërnda nga fundi i rrugës. Atë çast, duke angullitur si qen, një grua u dha te kthesa. Alkaldi njohu nënën e Pepe Amadorit. Kërceu brenda dhe i dha urdhër policit që nga shkallët:

— Ma hiq atë grua.

Brenda qe heshtje e plotë. Në të vërtetë alkaldi e mori vesh ç'pat ndodhur vetëm kur lar-

goi policët që kishin zënë hyrjen e qelisë dhe pa Pepe Amadorin. I shtrirë përmbys, i mbledhur kruspull me duart mes kofshëve, ai qe krejt i zbehtë, por shenja gjaku nuk kishte.

Kur u ngrit, e kishte mbledhur veten, por nga shprehja e fytyrës me të cilën i kërqyri policët dukej që kish filluar të lodhej.

— Kush e bëri?

— Të gjithë, — tha vigani leshverdhë. — Deshi t'ia mbathte.

Alkaldi e vështroi mendueshëm dhe për disa çaste u duk sikur s'kish më asgjë se ç'të thoshte. «Ato përralla mos m'i trego mua», tha. Iu afrua viganit leshverdhë dhe zgjati dorën.

— Bjer revolverin.

Vigani hoqi gjerdanin dhe ia dha. Fishekët e rinj, me të cilët kish zëvendësuar dy gëzhojat e zbrazura, alkaldi i futi në xhep dhe revolverin ia dha një polici tjetër. Vigani leshverdhë, që tek e shihje nga pranë dukej si i mveshur me një brerore të shndritshme miturie, vajti vetë deri te qelia ngjitur. Aty u zhvesh krejt dhe ia dha rrobat alkaldit. Gjithçka u bë pa ngut, duke e ditur sikush se ç'duhej të bënte, si në një ceremoni. Më në fund, vetë alkaldi mbylli qelinë e të vdekurit dhe doli në ballkonin e oborrit. Senjor Karmiçaeli vazhdonte të ishte në banko.

Kur e shpunë në zyrë, nuk e pranoi ftesën për t'u ulur. Ndenji në këmbë përpara tryezës, përsëri me rroba të lagura, dhe mezi sa lëvizi kokën kur alkaldi e pyeti nëse e kishte mbledhur mendjen.

— E po mirë, — tha alkaldi. — Ende s'kam pasur kohë të mendoj se ç'do të bëj, bile as që e di në do të bëj gjë. Veçse çkado që të bëj, — shtoi, — mos e harro këtë që po të them: do s'do, ti ke hyrë në këtë valle.

Senjor Karmiçaeli vazhdoi të rrinte si hu përpara tryezës, me rrobat të ngjitura për trup dhe me ca shenja enjtjeje në lëkurë, sikur ende të mos kish dalë në sipërfaqe as të tretën natë të mbytjes.

— Pra tani s'ke se nga ia mban, Karmiçael: jemi ortakë.

E tha këtë rëndë-rëndë, madje me një fije dramatizmi. Por truri i senjor Karmiçaelit s'e regjistroi, me ç'dukej. Vazhdoi të rrinte para tryezës pa lëvizur, i mbufatur e i pikur, edhe pasi u mbyll dera e blinduar.

Përpara alkaldisë dy policë mbanin për kyçesh të ëmën e Pepe Amadorit. Të tre dukeshin sikur po bënin pushim. Gruaja merrte frymë me një ritëm të qetë dhe sytë i kishte të tërur. Por, kur alkaldi doli te porta, ia dha një angullime të ngjirur dhe u shkund me aq fuqi, sa njërit prej policëve iu desh ta lëshonte, kurse tjetri e palosi përtokë me një goditje qyte.

Alkaldi nuk ia hodhi sytë. Mori policin tjetër që ta shoqëronte dhe u ndal para grupit që ndiqte përleshjen nga qoshja. Nuk iu drejtua askujt në veçanti.

— Çdonjëri prej jush, — tha: — po deshët që punët të mos venë më keq, merreni dhe shpjereni në shtëpi atë grua.

Gjithnjë i shoqëruar prej policit çau përmes grupit dhe vajti drejt e në gjykatë. Nuk gjeti asnjeri. Atëherë vajti në shtëpinë e gjykatës Arkadios dhe, duke shtyrë portën pa trokitur, thirri:

— Gjykatës.

Gruaja e gjykatës Arkadios, me atë humorin e rëndë të barrës, iu gjegj nga gjysmerrësira.

— Ka ikur.

Alkaldi s'lëvizi nga pragu.

— Ku?

— Tek ajo rrospia e mutit, — tha gruaja, — ku tjetër.

Alkaldi i bëri policit shenjë të futeshin brenda. Kaluan pa ia hedhur sytë gruas. Si e kthyen përmbys dhomën e gjumit dhe e panë që s'kish askund plaçka burrash, u kthyen në treme.

— Kur ka ikur? — pyeti alkaldi.

— Ka dy net, — tha gruaja.

Alkaldi heshti një copë herë të gjatë që të mendohej.

— Biri i bushtrës, — thirri pastaj. — Edhe pesëqind pashë nën dhé sikur të fshihet, edhe në të s'ëmës po të futet prapë, ne kemi për ta gjetur, gjallë a vdekur. E ka të gjatë krahun Qeveria.

Gruaja ofshau:

— Fjala juaj në vesh të zotit, toger.

Po ngrysej. Kishte ende ndonjë grup njerëzish që policët e mbanin larg prej qosheve të alkaldisë, por nënën e Pepe Amadorit e kishin shpënë në shtëpi dhe fshati dukej i qetë.

Alkaldi vajti drejt e në qelinë e të vdekurit. Kërkoi t'i sillnin një fletë çadre dhe me ndihmën e policit i vuri kapelen e syzet kufomës dhe e mbështolli me të. Pastaj kërkoi andej-këtej nëpër alkaldi copra litari e teli dhe e lidhi trupin vilar nga koka te këmbët. Kur mbaroi, po i vinin djersët, porse dukej i çlodhur. Pati një ndjesi sikur fizikisht ta kish hequr nga shpina peshën e kufomës.

Vetëm atëherë e ndezi dritën e qelisë. «Merr lopatën, kazmën e një fener, — i dha urdhër policit. — Pastaj thirr edhe Gonsalesin dhe shkoni në oborrin e pasmë e hapni një gropë mjaft të thellë, atje ku toka është terake.» E tha këtë

sikur t'i ngjizte fjalët një e nga një gjatë kohës që fliste.

— Dhe një gjë mbajeni mend derisa të vdisni, — përfundoi: — ky djalosh nuk ka vdekur.

Pas dy orësh ende nuk kishin mbaruar së mihuri varrin. Që nga ballkoni alkaldi vuri re se në rrugë s'kish frymë njeriu, përveç njërit prej policëve të tij që bënte rojë nga qoshja në qoshe. Ndezi dritën e shkallëve dhe u shtri të prehej në këndin më të errët të sallës, ku mezi dëgjoheshin klithmat e herëpashershme të një gate të largët.

Zëri i at Anhelit e shkëputi nga përsiatja. Në fillim e dëgjoi t'i fliste policit të rojës, pastaj dikujt që e shoqëronte e më në fund njohu edhe zërin tjetër. Ndenji i përkulur në shezlong, deri kur dëgjoi përsëri zërat, tashmë brenda alkaldisë, dhe hapat e parë nëpër shkallë. Atëherë zgjati krahun e majtë në të errët dhe rroku karabinën.

Kur e pa të jepej në krye të shkallëve, at Anheli u ndal. Dy shkallina më poshtë ndodhej doktor Hiraldoja, me një bluzë me mëngë të shkurtëra, të bardhë e të kollarisur, dhe një çantë në dorë. Zbuloi dhëmbët e mprehtë.

— E prishët kësaj radhe, toger, — foli gjithë humor. — Kam tërë mbasditen që po pres të më thërrisni për të bërë autopsinë.

At Anheli ia nguli sytë e tejdukshëm e të urtë, pastaj i ktheu nga alkaldi. Edhe alkaldi yuri buzën në gaz.

— S'ka autopsi, — tha, — përderisa s'ka të vdekur.

— Duam të shohim Pepe Amadorin, — tha famullitari.

Duke e mbajtur karabinën me tytë poshtë, alkaldi vazhdoi t'i drejtohej mjekut. «Edhe unë

do të desha, — tha. — Por s'ke ç'i bën.» Dhe pushoi së buzëqeshuri kur tha:

— Ia mbathi.

At Anheli hodhi një shkallinë. Alkaldi ngriti karabinën drejt tij. «Rri urtë, at i shenjtë», e paralajmëroi. Edhe mjeku hodhi një shkallinë.

— Dëgjo këtu, toger, — tha duke vazhduar të buzëqeshte: — në këtë fshat nuk mbetet gjë pa u marrë vesh. Qysh në katër pasdite të gjithë e dinë se atij djali i kanë bërë po atë marifet që u bënte don Sabasi gomerëve që shiste.

— Ai ia mbathi, — përsëriti alkaldi.

Siç ruante mjekun, mezi pati kohë të vihej në mbrojë kur at Anheli hodhi dy shkallina njëherësh me krahët lart.

Alkaldi i hoqi sigurecën armës me një goditje të thatë të trinës së dorës dhe qëndroi si shtyllë me këmbët hapur.

— Ndal, — thirri.

Mjeku e kapi famullitarin nga mënga e veladonit. At Anhelin e zuri kolla.

— T'i hapim kartat, toger, — tha mjeku. Zëri i qe ashpërsuar për herë të parë pas shumë kohe. — Duhet ta bëjmë atë autopsi. Tani do ta sqarojmë edhe misterin e atyre sinkopave që pësojnë të arrestuarit në këtë burg.

— Doktor, — tha alkaldi: — po lëvizët nga vendi, e hëngrët. — E ktheu nishanin në drejtim të famullitarit. — Edhe ju gjithashtu, at i shenjtë.

Të tre qëndruan pa lëvizur.

— Pastaj, — vazhdoi alkaldi duke iu drejtuar priftit, — ju duhet të jini i kënaqur, at i shenjtë: ai djalosh i vinte paskuinët.

— Për hir të zotit... — filloi at Anheli.

Por e mbyti kolla dhe s'e la të vazhdonte. Alkaldi priti sa t'i kalonte kriza.

— Tani dëgjoni, — tha: — do të filloj të numëroj. Kur të them tre, do të shtie me sy mbyllur para kësaj dere. Merreni vesh një herë e përgjithmonë, — paralajmëroi qartas mjekun: — mbaruan shakaçkat. Jemi në gjendje lufte, doktor.

Mjeku mbërtheu at Anhelin për mënge, filloi të zbriste pa i kthyer shpinën alkaldit dhe pas pak ia plasi një të qeshure të çiltër.

— Kështu po më pëlqeni, gjeneral, — i tha. — Tani po fillojmë të merremi vesh.

— Një, — numëroi alkaldi.

Nuk e dëgjuan numrin tjetër. Kur u ndanë te qoshja e alkaldisë, at Anheli qe krejt i dërrmuar dhe iu desh të fshihte fytyrën, se i kishte sytë të njomur. Doktor Hiraldoja i ra një pëllëmbë në sup, duke vazhduar të buzëqeshte. «Mos u çuditni, at i shenjtë, — i tha. — I ka jeta këto.» Tek merrte kthesën për në shtëpi të tij, pa orën në dritën e shtyllës: ishte tetë pa një çerek.

At Anheli nuk hëngri dot. Pasi ra sinjali i ndalimqarkullimit, u ul të shkruante një letër dhe ndenji i kërrusur mbi tryezë deri pas mesnate, ndërkohë që shiu i imët shpëlante botën përqark tij. Shkroi me ngulm e kokëfortësi, duke vizatuar germë pas germe gjithë trille e zbukurime, edhe me aq pasion e bënte këtë, saqë e ngjyente penën pasi pat shkruar gjer edhe dy fjalë të padukshme, duke gërricur letrën me penicën e thatë.

Të nesërmen, pas meshës, e hodhi letrën në

postë, ndonëse e dinte që s'nisej para së shtunës. Gjatë mëngjesit ajri kish qenë i njomësht e i mjegullt, por aty nga dreka qe bërë përsëri i tejpashëm. Një zog që kish humbur udhën u duk në oborr dhe ndenji ndonja gjysmë ore duke kërcyer si gjytyrym mes lulelandrave. E kish kënduar meshën me një notë që sa vinte e rritej, duke ngjitur çdoherë nga një oktavë, deri kur qe bërë aq e mprehtë saqë ish dashur të merrej me mend.

Në shëtitjen e ndajnatës pati ndjesinë e sigurt se gjatë gjithë mbasdrekës e kish ndjekur një kundërmim vjeshtarak. Në shtëpinë e Trinidadit, tek bënte me të sëmurën një bisedë të trishtme rreth lëngatave të tetorit, iu duk sikur dalloi erëmimin që pat lëshuar një natë në kthinën e tij Rebeka de Asisi.

Ndërsa kthehej, kaloi një herë nga familja e senjor Karmiçaelit. E shoqja dhe vajza e madhe qenë mbytur në lot dhe, sa herë zinin ngoje të arrestuarin, nxirrnin nga një notë false. Por fëmijët qenë shend e verë në mungesë të rreptësisë së babait dhe përpiqeshin t'i jepnin për të pirë ujë në një gotë çiftit të pëllumbave që u kishte dërguar vejusha De Montiel. Pas pak at Anheli ua kish ndërprerë bisedën dhe, duke bërë një shenjë me dorë. kish thënë:

— Ah, po, është era e bar-qenit.

Por s'ishte era e bar-qenit.

Askush nuk fliste më për paskuinët. Në vorbullën e ngjarjeve të fundit ata s'qenë veçse një anekdotë e këndshme që tashmë i përkiste së shkuarës. At Anheli e provoi këtë gjatë shëtitjes së ndajnatës, si dhe pas lutjes së mbrëmjes, duke kuvenduar në qelën e tij me një grup zonjash katolike.

Kur mbeti vetëm, pati uri. Skuqi ca thela

bananeje, vuri kafe me qumësht dhe i shoqëroi me një copë djathë. Të kënaqurit e stomakut e bëri të harronte erën. Ndërsa zhvishej për të rënë, si dhe më pas përposh batanijes, duke gjuajtur mushkonjat të cilave s'u kish bërë gjë insekticidi, gromësiu disa herë. E digjte urthi, por shpirtin e kishte të qetë.

Fjeti si shenjt. Në heshtimin e ndalimqarkullimit dëgjoi ca pëshpërima të zhuritura nga malli, ca akorde telash kitare të ngrirë nga acari i mëngjesit dhe më së fundi një këngë të tjetërkohshme. Në pesë pa dhjetë e kuptoi se qe gjallë. U ngrit me një sforcim gjithë madhështi, duke fërkuar qepallat me gishtërinj, dhe tha me vete: «E premte njëzetenjë tetor.» Pastaj tha me zë të lartë: «Shën Hilarioni.»

U vesh pa u larë e pa thënë rruzaren. Si shkopsiti e kopsiti për së mbari veladonin, mbathi këpucët e çara që mbante përditë, me shoje që kishin filluar të shqepeshin. Tek hapi derën e oborrit dhe pa lulelandrat, i erdhën ndër mend fjalët e një kënge:

—Do mbes në ëndrrën tënde gjer të vdes, — ofshau.

Mina shtyri derën e kishës kur ai po i binte kambanës së dytë. Vajti në pagëzimtore dhe i gjeti djathin të paprekur e çarçet të ngrehura. At Anheli sapo kish hapur portën e sheshit.

— C'tersllëk, — tha Mina duke tundur kutinë e kartonit bosh. — Sot s'paska rënë asnjë.

Por at Anheli s'e kishte mendjen tek ajo. Po gdhinte një ditë mjaft e bukur, me një ajër të kulluar, si një paralajmërim se edhe atë vit, sido që të qe puna, dhjetori do të ishte i përpiktë. Kurrëndonjëherë s'iu pat dukur aq e qartë sa atë ditë heshtja e Pastorit.

— Mbrëmë pati serenatë, — tha.

— Serenatë me plumba, — ia përforcoi mendimin Mina. — S'ka pak që mbaroi.

Famullitari e vështroi për herë të parë. Edhe ajo, tej mase e zbehtë si e gjyshja e verbët, mbante brez prej mëndafshi të kaltër të një kongregacioni laik. Por, ndryshe nga Trinidadi, që kishte një humor si prej mashkulli, ajo sa po fillonte të piqej e të bëhej grua.

— Ku?

— Gjithandej, — tha Mina. — Thua se dolën mendsh duke kërkuar armë. Thonë se paskan ngritur dyshemenë e rrojtores, krejt rastësisht, dhe paskan gjetur armë. Burgu është mbushur plot, por thonë edhe se burrat po u hidhkan në mal për t'u futur në çetat guerilje.

At Anheli ofshau.

— Dhe unë s'mora vesh asgjë, — tha.

U çapit nga fundi i kishës. Ajo e ndoqi në heshtje deri te lteri kryesor.

— Po kjo s'është asgjë, — vazhdoi Mina. — — Mbrëmë, pa pyetur për ndalimqarkullimin e për plumbat...

At Anheli u ndal. Ktheu nga ajo sytë e tij të angësht, me një të kaltër të pafajme. Edhe Mina u ndal, me kutinë e zbrazët nën sqetull, dhe vuri buzën në gaz me nervozitet para se ta mbaronte fjalinë.

PËRMBAJTJA

Parathënie 5
Gjethurinat 19
Një histori me Pasjuinë 143

GABRIEL GARSIA MARKES

GJETHURINAT
NJË HISTORI ME PASKUINË

Redaktor teknik
Salih Lutolli

Tirazhi: 3000 copë

U shtyp në shtypshkronjën e OPBGB
«Rilindja» – Prishtinë

6 €